

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI DHËNIEN LLOGARI PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË VITIT 1977 DHE MBI DETYRAT E PLANIT TË VITIT 1978»

30 janar 1978

Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të Partisë dhe raporti me rëndësi historike që mbajti shoku Enver në këtë Plenum, të cilët u bënë një analizë të thellë shkencore marksiste-leniniste rrymave të ndryshme të revizionizmit modern, kanë gjetur aprovimin dhe mbështetjen e njëzëshëm të të gjithë Partisë. Diskutimi i raportit të shokut Enver në organizatat e Partisë tregoi edhe një herë drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë sonë, pjekurinë politike e ideologjike të të gjithë komunistëve, unitetin e çeliktë të Partisë rreth Komitetit Qendror, vendosmërinë e tyre për të mbrojtur me besnikëri marksizëm-leninizmin, socializmin, revolucionin.

Viti 1977 ishte viti i parë pas Kongresit të 7-të të Partisë. Ai u karakterizua nga një mobilizim i madh dhe entuziazëm i paparë për realizimin e planit. Kudo u bë një punë e gjerë e intensive për zberthimin, për kuptimin politik e ideologjik dhe për marrjen e një vargu masash organizative e teknike për zbatimin e detyrave që shtrohen në dokumentet historike të këtij Kongresi.

Në kushtet e ashpërsimit të luftës së klasave, në shkallë ndërkombëtare, dhe të rrethimit të egër imperialisto-revizionist ndaj vendit tonë, gjatë vitit 1977 ekonomisë sonë iu desh të përballonte edhe pengesa të tjera serioze në livrimin e mallrave, të makinerive e të pajisjeve sipas marrëveshjeve, të cilat bënë të pamundur përfundimin në afat të mjaft objekteve të rëndësishme industriale.

Në përputhje me gjendjen e re të krijuar, klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste, gjithë kuadrot, me komunistët në krye, kanë punuar e kanë luftuar me të gjitha forcat për realizimin dhe për tejkalimin e planit të gjashtë pesëvjeçar. Ky mobilizim dhe ky vrull revolucionar çuan në zvogëlimin e pasojave të thatësirës së gjatë që preku bujqësinë dhe disa degë të tjera të ekonomisë.

Fuqizimi i ekonomisë dhe forcimi i mbrojtjes së vendit kanë qenë kurdoherë fronti kryesor i punës dhe i përpjekjeve të Partisë e të masave tona punonjëse. Por, që t'u përgjigjemi si duhet situatave të reja të krijuara, kërkohet një ndërgjegje më e lartë politike, një mobilizim e organizim më i fortë, një luftë më këmbëngulëse në zbatimin e detyrave. Në këtë vështrim, analiza e plotësimit të planit të vitit 1977 dhe detyrat e planit të vitit 1978 marrin një kuptim dhe një rëndësi të veçantë.

Me gjithë kushtet e vështirësitë e krijuara, vitin e kaluar u arrit shtimi i mëtejshëm i prodhimit shoqëror dhe i të ardhurave kombëtare, u mbajt, e në disa drejtime u ngrit më tej, niveli materialo-kulturor i masave punonjëse dhe u forcua akoma më shumë aftësia mbrojtëse e vendit. Këto tregojnë se ekonomia jonë ecën dhe zhvillohet sipas direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë dhe po u bën ballë me sukses situatave të krijuara nga armiqtë imperialisto-revizionistë.

Në vëllimin e prodhimit të përgjithshëm industrial plani u plotësua 98 për qind, me një rritje prej 6,6 për qind në krahasim me vitin 1976. Në prodhimin e mineralit të kromit, të bakrit, të hekurit, në metalurgjinë e zezë, në industrinë mekanike, në atë kimike, të material-ndërtimit e të industrisë së lehtë, në përgjithësi, detyrat e planit u plotësuan ose u tejkaluan. Por, në disa zëra të prodhimit të nomenklaturës së Qeverisë, të ministrive e të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, plani nuk u realizua...

Edhe vitin e kaluar, detyra kryesore, që vuri Kongresi i 7-të i Partisë për sigurimin e bukës në vend, u arrit, megjithëse plani i prodhimit nuk u realizua plotësisht. Kjo përbën një sukses dhe fitore për tërë ekonominë tonë. Prodhimi i pambukut, i orizit, i luledielli, i perimeve, i ullinjve, i mishit, i qumështit ishte më i madh në krahasim me vitin e mëparshëm, në një kohë kur në shumë shtete kapitalisto-revizioniste pati një rënie të theksuar në prodhimin e drithërave dhe të prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, rënie që çoi në thellimin e mëtejshëm të krizës ekonomik-financiare në këto vende. Këto rezultate vërtetojnë edhe një herë epërsinë e sistemit tonë socialist, si dhe rolin vendimtar e përcaktues të faktorit subjektiv për të kapërcyer dhe për të mposhtur vështirësitë, për realizimin e detyrave në bujqësi.

Megjithatë, në bujqësi detyrat e planit nuk u realizuan, duke krijuar deficite.

Plani i ndërtimeve në tërësi u plotësua 92 për qind. Në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan detyrat u plotësuan dhe u tejkaluan. Përpjekje të mëdha janë bërë edhe nga kolektivi i ndërtim-montimit në Uzinën e Përpunimit të Naftës në Ballsh, në Hidrocentralin e Fierzës, si dhe nga disa ndërmarrje e kantiere të veçanta. Por Byroja Politike vëren se, prej disa vjetësh, plani në ndërtim nuk realizohet as në tërësi, as në dorëzimin në afat të veprave, kryesisht për shkaqe subjektive, për dobësi të punës në këtë sektor.

Në komunikacion, në tregti, në komunale, në shëndetësi, në arsim e në kulturë, detyrat e planit, në përgjithësi, u realizuan, por, në këta sektorë, edhe vitin e kaluar u vërejtën të meta. Deficite janë krijuar, sidomos, në transportin e lëndës drusore e në disa minerale. Në tregti, në disa rrethe e në zona të veçanta, ka pasur mungesë në disa lloje mallrash, sepse shpërndarja e tyre nuk bëhet kurdoherë e studiuar. Shërbimi dhe kultura në tregti e në komunale nuk janë akoma në nivelin që kërkon Partia. Në shëndetësi, në disa raste, vihen re pakujdesi dhe vonesa në ekzaminimin e të sëmurëve.

Sigurisht, pozitivja përbën karakteristikën e përgjithshme, por, sidoqoftë, mosplotësimet që u përmendën më lart, si dhe përpjekjet e pamjaftueshme, të bëra për kapërcimin e vështirësive dhe të metave, tregojnë se jo kudo e jo vazhdimisht është luftuar me këmbëngulje për të zbatuar porositë e Kongresit të 7-të të Partisë, që plani të realizohet në çdo zë e në çdo tregues. Nga ana tjetër, këto flasin edhe për atë që puna udhëheqëse e organeve dhe e organizatave të Partisë, puna ideopolitike e tyre dhe e organizatave të masave, si dhe drejtimi ekonomik-administrativ nga organet shtetërore e ekonomike, nuk u janë përgjigjur si duhet detyrave që shtrou situata që kalojmë.

Përfundimet e arritura në zhvillimin ekonomik të vendit janë një bazë reale dhe e shëndoshë, të cilat, edhe në vitin 1978, sigurojnë një rritje të mëtejshme të prodhimit shoqëror, si dhe forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut.

Siç dihet, projektplanin i hartuar në muajin shtator u kthye nga Komiteti Qendror e Këshilli i Ministrave për t'u rishikuar, sepse ai nuk pasqyronte si duhet mundësitë reale, nuk mbështetej në përvojën e përparuar dhe nuk i përgjigjej plotësisht situatës së krijuar. Kuptimi i drejtë i kësaj kritike bëri të mundur që plani i vitit 1978 të hartohej më mirë, mbi bazën e direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, të orientimeve që shtroi Byroja Politike në vendimin për përsosjen e sistemit të planifikimit dhe të detyrave të tjera që ka caktuar Partia në fusha të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë. Ai përputhet me de-

tyrat që janë parashikuar në planin e gjashtë pesëvjeçar dhe, në disa tregues, përmirësohet më tej.

Në krahasim me vitin 1977, vëllimi i prodhimit të përgjithshëm industrial do të rritet 8 për qind, prodhimi i përgjithshëm bujqësor—28 për qind, transporti i mallrave—8 për qind, vëllimi i ndërtimeve—17 për qind, eksporti—10 për qind, importi—17 për qind. Si rrjedhim, prodhimi shoqëror do të ketë një rritje prej 15 për qind...

Që të realizohen këto detyra të mëdha, gjatë këtij viti, lufta dhe përpjekjet e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të gjithë punonjësve të vendit duhet të ngrihen në një shkallë më të lartë; organizimi, disiplina dhe ndjenja e përgjegjësisë të përmirësohen më tej. Plani duhet të realizohet frontalisht, në të gjithë zërat e treguesit, por Byroja Politike mendon të ndalet në disa degë, të cilat, aktualisht, marrin një kuptim e rëndësi të veçantë.

1. — Të marrim të gjitha masat e të mobilizohemi me të gjitha forcat për të nxjerrë nga prapambetja industrinë e naftës, duke plotësuar në kohë dhe mirë detyrat për zbulimin dhe për shfrytëzimin e vendburimeve të naftës e të gazit.

Vitin e kaluar plani i zbulimit të rezervave të naftës nuk u realizua dhe ekonomisë nuk iu dhanë sipas planit naftë dhe gaz. Kjo gjë cenoi rëndë jo vetëm plotësimin e nevojave të brendshme me lëndë djegëse e karburante, por ndikoi dhe në bilancin valutor të eksportit dhe të importit...

Kjo ngarkon me përgjegjësi kuadrot dhe drejtuesit e kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë, si dhe organet dhe organizatat e Partisë që veprojnë në industrinë e naftës.

Në Plenumin e 2-të të Komitetit Qendror, shokët... prem-tuan se do të merrnin të gjitha masat e nevojshme për realizimin e planit, por jeta vërtetoi se ata nuk ia dolën mbanë këtij zotimi. Metoda e punës e Ministrisë së Industrisë e të Minerave dhe lufta për të zgjidhur në kohë problemet që ka ngritur baza, nuk kanë qenë në nivelin e kërkuar.

Byroja Politike e vë edhe një herë theksin mbi domosdoshmërinë e realizimit të planit dhe të dalë nga prapambetja kjo degë e rëndësishme e ekonomisë. Edhe vitin e kaluar, në industrinë e naftës u vërtetuan të meta e dobësi në organizimin e punës dhe në shfrytëzimin e bazës materiale e teknike. Të pamjaftueshme kanë qenë përpjekjet në organizimin dhe në realizimin e studimeve komplekse gjeologo-kërkuese, në zbatimin e disiplinës teknike, si dhe në zbatimin e një kontrolli të vazhdueshëm e të fortë për realizimin e detyrave.

Ndërmarrjet dhe Drejtoria Gjeologjike e Naftës... e realizuan planin e shpim-kërkimeve 87 për qind. Prapambetja në punimet komplekse gjeologjike dhe në shpim-kërkimet solli, si

rrjedhim, mosrealizimin e planit të zbulimit të rezervave të naftës dhe të nxjerrjes së saj nga vendburimet e reja. Në disa puse të kërkimit u vërtetuan përsëri avari. Zbulimi i vendburimit të ri... është një sukses i madh që e saktësoi më mirë atë dhe zgjeroi përfytyrimet gjeologo-kërkuese të zonave e të rajoneve të reja. Tani kërkohen një punë këmbëngulëse dhe mobilizim i gjithanshëm për të realizuar shpejt dhe mirë detyrat.

Edhe në shpim-shfrytëzim plani nuk u realizua. Nga mosvënia e puseve të rinj në punë, u krijua një deficit. Drejtoria dhe ndërmarrjet e nxjerrjes së naftës..., si dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Fierit, ku u vërtetuan të gjitha deficitet në nxjerrjen e naftës, nuk u thelluan në luftën për kapërcimin e të metave.

Në hartimin e planit të këtij viti, në fillim, nga disa kuadro, ka pasur ngurrime. Sigurisht, problemet e industrisë së naftës nuk janë të lehta e të thjeshta për t'u zgjidhur. Por kësaj dege i janë dhënë, me përparësi, mjete monetare e materiale, kuadro, specialistë e punëtorë, prandaj, me një organizim e drejtim më të mirë, me një metodë e stil revolucionar, problemet mund dhe duhet të zgjidhen në kohë dhe pa zvarritje burokratike.

Prodhimi i naftës lidhet ngushtë me nevojat e pazëvendësueshme që ka ekonomia për karburante e për prodhime të tjera që dalin nga ajo. Duhet kuptuar thellë ajo që ka thënë shoku Enver se pa naftë nuk mund të vazhdojmë me sukses luftën tonë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e fitoreve të arritura. Nga kjo e vërtetë e madhe ne duhet të nxjerrim mësimet dhe detyra të veçanta. Ta vlerësojmë çështjen e naftës me gjithë seriozitetin e duhur, si në kërkim dhe në nxjerrjen e saj, ashtu dhe në përdorimin e karburanteve me kursim të madh.

Për të realizuar detyrat në industrinë e naftës, në radhë të parë, është e domosdoshme të forcohet puna gjeologo-kërkuese në Institutin e Naftës dhe në Ndërmarrjen Sizmografimetrike. Rajonet e reja, që do t'u nënshtrohen kërkimeve, të përgatiten me studime të plota komplekse. Rëndësi të veçantë, tani, marrin konkretizimi dhe vënia në shfrytëzim e vendburimit të ri, i cili duhet të japë prodhim qysh në shtator të këtij viti.

Veç kësaj, para punonjësve të shpim-kërkimit vihet detyra jo vetëm të japin për shfrytëzim në kohë vendburimet e reja për të nxjerrë nga ato naftë sipas planit, por, me shpimet në struktura të tjera, të zbulojnë vendburime e rezerva të reja për vitet e tjera. Që të arrihen këto detyra, sikurse ka porositur vazhdimisht Komiteti Qendror, shpimet të përqendrohen aty ku perspektiva është sa më e qartë. Të merren masa

të plota për përgatitjen dhe për dorëzimin në kohë të puseve të rinj për shfrytëzim etj.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe organet e saj vartëse, të marrin të gjitha masat që vendburimet ekzistuese të realizojnë nxjerrjen e planifikuar të naftës dhe të gazit sipas regjimit të vendosur në projektet e shfrytëzimit. Për këtë qëllim, t'i futen seriozisht dhe me efektivitet, shumë më të lartë se deri tani, zbatimit të metodave intensifikuese dhe të dyta. Kjo çështje nuk shtrohet për herë të parë nga Komiteti Qendror, por megjithatë nuk po ecet mirë... Në plan parashikohet të merret bitum edhe nga rërat bituminoze, por vihen re zvarritje të theksuara në prodhim, si dhe në projektimin dhe në ndërtimin e uzinave më të mëdha. Këto detyra mund të gjejmë zbatim të plotë në qoftë se vlerësohen drejt nga organizatat e Partisë dhe merren seriozisht në dorë nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

Zhvillimi i industrisë së naftës kërkon një mbështetje më të fuqishme nga sektorët e prapavijës e, në radhë të parë, nga uzinat mekanike, nga transporti, nga ndërtim-montimi etj. Prandaj edhe këta sektorë duhen vlerësuar drejt, të ndihmohen e të kontrollohen më nga afër nga komitetet e Partisë.

Duke luftuar për realizimin e detyrave në industrinë e naftës, vëmendje, gjithashtu, t'i kushtohet nxjerrjes së qymyrgurit, si lëndë djegëse me rëndësi të madhe në të gjitha degët e ekonomisë. Në Minierën e Valiasit, këtë vit, për shkak të vështirësive të krijuara në projektimin e ndërtimit të kësaj miniere, është parashikuar të nxirret vetëm 44 për qind e sasisë së parashikuar sipas planit pesëvjeçar. Sasi të e qymyrit, që nuk do të nxirren nga kjo minierë, do të sigurohen nga minierat e tjera. Kështu, detyrat e minierave ekzistuese do të rriten, prandaj, atje, duhet të rriten edhe mobilizimi dhe lufta për plotësimin e planit, duke realizuar, në të njëjtën kohë, gjithë punimet minerare e përgatitore, në mënyrë që perspektiva të mbetet kurdoherë e hapur.

Është e domosdoshme që Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës, të merren më seriozisht me zhvillimin e punimeve në Valias, mbasi, në të ardhmen, nga kjo minierë, është parashikuar të sigurohet... për qind e të gjithë sasisë së qymyrgurit të vendit.

E shohim me vend të tërheqim edhe një herë vëmendjen dhe të theksojmë domosdoshmërinë e zëvendësimit të naftës me qymyr. Programin që ka hartuar dhe ka vendosur Qeveria, lidhur me këtë problem, duhet ta ndjekin e ta kontrollojnë edhe komitetet e Partisë dhe të luftohet për tejkalimin e tij. Në përdorimin e naftës e të karburanteve të vendoset kudo një regjim i rreptë kursimi.

2. — T'i vëmë mirë shpatullat bujqësisë dhe të angazhohemi me të gjitha forcat e mjetet për realizimin e planit në të gjitha llojet e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Në planin e vitit 1978 parashikohen detyra të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Në disa tregues arrihen edhe kuotat e pesëvjeçarit, që janë parashikuar për vitin 1979 ose 1980. Prodhimi i drithërave të bukës do të arrijë 30 për qind më shumë se në vitin e kaluar; prodhimi i pambukut do të rritet 72 për qind, i lulediellit—32 për qind, i orizit—76 për qind, i patates—110 për qind, i mishit—23 për qind etj. Këto ritme të larta në prodhim nuk diktohen thjesht nga nevojat gjithmonë në rritje që ka ekonomia për prodhime bujqësore e blegtorale, por edhe nga mundësitë e mëdha reale që ekzistojnë për t'i arritur ato. Në kushtet aktuale, në situatat që kalojmë, shfrytëzimi i të gjitha mundësive për shtimin e prodhimit bujqësor është një domosdoshmëri objektive, që lidhet ngushtë me fuqizimin e ekonomisë, me forcimin e pavarësisë së saj, me furnizimin e popullit dhe me rritjen e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Por, të gjitha këto, akoma nuk kuptohen sa e si duhet, bile edhe nga mjaft kuadro të Partisë e të pushtetit, ndryshe puna dhe përpjekjet do të ishin më të mëdha dhe rezultatet më të mira. Është fakt që kushtet atmosferike nuk qenë të favorshme, por mosrealizimet në bujqësi nuk mund të shpjegohen vetëm me ndikimin negativ të faktorëve objektivë. Arsyet kryesore duhen kërkuar, në radhë të parë, te të metat e te dobësitë e karakterit subjektiv, te mungesa e disiplinës së fortë në punë dhe në zbatimin e teknikës e të shkencës, në organizimin, në drejtimin dhe në kontrollin e dobët të ekonomive bujqësore.

Pikërisht për këto arsye, përgjegjësia e Ministrisë së Bujqësisë, veçanërisht e anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror, që punojnë në udhëheqje të kësaj ministrie, e komiteve të Partisë dhe e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve është e madhe. Për këtë përgjegjësi duhet të reflektojnë, sidomos, komiteti dhe organizata e Partisë e rrethit të Lushnjës, të Durrësit, të Fierit, të Dibrës, të Korçës, të Krutës dhe të Elbasanit, sepse mosrealizimet në planin e drithërave të bukës vetëm në këto rrethe përbëjnë... të drithit si Republikë. Me rezultate të ulëta, në përgjithësi, e mbyllën vitin edhe rrethet Tepelenë, Tropojë e Kolonjë.

Partia ka theksuar vazhdimisht rëndësinë ekonomike e strategjike të prodhimit të bukës në vend dhe të sigurimit të rezervave të domosdoshme, si nga ana e shtetit, ashtu edhe nga ekonomitë kooperativiste. Plotësimi i detyrave në shtimin e prodhimit të drithërave të bukës përbën frontin kryesor të luftës në bujqësi.

Në vitin 1978 është parashikuar një rritje e ndjeshme e

rendimenteve për ha në grurë. Ky është një hap i madh, por edhe plotësisht i mundur për t'u arritur. Mjafton të përmendim se gjatë vitit të kaluar, megjithëse plani nuk u realizua, në afro 40 mijë ha u morën mesatarisht 30 kv për hektar, domethënë, mbi detyrat e parashikuara për këtë vit.

Mbjellja e grurit në vjeshtën e vitit të kaluar, në përgjithësi, u krye në kohë e me cilësi të mirë, por vetëkënaqësia, që vërehet në disa kuadro e drejtues për gjendjen aktuale të grurit, është pa baza dhe me pasoja të rrezikshme. Në fund të fundit, puna e bërë gjer tani është vetëm një fillim që premtonte. Që të arrihet objektivi i caktuar, derisa ai të futet në hambar, kërkojnë organizim dhe mobilizim i madh e i vazhdueshëm për të kryer me disiplinë të fortë shkencore të gjitha shërbimet. Kullimi i përsosur, plehërimi i diferencuar, lesimi e prashitja dhe korrija e shirja pa firo janë proceset kryesore, që kushtëzojnë dhe garantojnë realizimin e tejkalimit e planit të grurit.

Kthesa e realizuar këta dy vjetët e fundit, në kulturën e misrit, është e domosdoshme të konsolidohet e të çohet më tej. Në vitin 1978 është parashikuar të merren, mesatarisht nga e gjithë sipërfaqja, 41,5 kv për hektar, kundrejt 30,4 kv që u morën vitin e kaluar. Caktimi me kohë i tokave për misrin, pa bërë asnjë lëshim në realizimin e sipërfaqeve të caktuara për t'u mbjellë në toka nën ujë, është kushti i parë që përcakton arritjen e këtij rendimenti. Vitin e kaluar, në tokat nën ujë, u morën mesatarisht 41,3 kv misër për hektar. Në këtë mënyrë, duke mbjellë mbi 90 për qind të sipërfaqes së misrit në tokat nën ujë, bëhet plotësisht e mundur që rendimenti i parashikuar për këtë kulturë jo vetëm të arrihet, por edhe të tejkalohet. Prandaj nuk duhet të lejohet mbjellja e misrit në toka mbi ujë, tej caqeve të caktuara, ashtu siç vepruan vitin e kaluar rrethi i Beratit, i Tepelenës etj. Sigurimi i plehut organik dhe i rezervave ujore, gjithashtu, përbëjnë hallkat kyç nga ku duhet kapur fort për të arritur objektivat e caktuar në kulturën e misrit.

Në kushtet e vendit tonë, na shtrohet si një detyrë e ngutshme që të shtojmë me ritme më të larta prodhimin e pambukut e të panxharit, të lulediellit e të ullirit, të orizit e të elbit distik, me synimin që, në një të ardhme jo të largët, të plotësojmë kryesisht ose tërësisht të gjitha nevojat e ekonomisë me prodhimin e vendit. Sigurisht, arritja e këtyre objektivave nuk është një punë e lehtë, por Partia dhe populli ynë, të mbështetur në mundësitë dhe në forcat e veta, këta objektiva do t'i arrijnë patjetër. Të gjitha kushtet për këtë ekzistojnë. Mjafton të bëjmë të ndërgjegjshme masat dhe të forcojmë organizimin, drejtimin dhe kontrollin e punëve.

Shembulli i shkëlqyer, që për vite me radhë vërtetonte se çfarë mundësi të mëdha ekzistojnë për shtimin e prodhimit, janë rezultatet e arritura në luledielli nga kooperativa e Donofrosës¹. Ajo, edhe këtë vit, megjithëse me thatësi të gjatë, në toka kodrinore dhe pa ujë, mori 22 kv për hektar, ose gati sa dyfishin e rendimentit të ekonomive që mbjellin luledielli në toka fushore dhe nën ujë.

Në qoftë se kooperativa e Donofrosës u bën tokave që do të mbillen me luledielli plugimin qilizëm qysh në verë, plehëron një të katërtën e sipërfaqes me pleh organik, zgjedh farën dhe e mbjell atë në muajt janar-shkurt, i bën rrallimin sapo shfaqet çifti i parë i gjetheve të vërteta, siguron numrin e nevojshëm dhe zhvillimin e njëllotje të bimëve e të tjera e të tjera, atëherë, përse nuk janë në gjendje t'i bëjnë këto edhe të gjitha kooperativat e tjera?

Kështu shtrohet çështja edhe për pambukun. Kooperativa e Çermës² dhe e Poshnjës³ vitin e kaluar morën rendimente të larta në kulturën e pambukut për hektarë. Por, në disa ekonomi, rendimentet që u morën ishin shumë më të ulëta. Si mund të justifikohen këto rendimente kaq të ulëta, kur vitin e kaluar kushtet atmosferike kanë qenë shumë më të mira se ato të vitit të mëparshëm? Por të mbjellësh rreth 40 për qind të sipërfaqes në toka mbi ujë, siç veproi rrethi i Fierit dhe i Durrësit, ose të lësh më shumë se gjysmën e sipërfaqes pa e plehëruar, bile ta heqësh plehun atje për t'ia dhënë një kulture tjetër, kjo do të thotë, praktikisht, ta lësh bimën e pambukut të ekspozuar dhe në varësi të kushteve atmosferike, do të thotë, dashje pa dashje, t'i vësh bërrylin plotësimi të planit qysh në kohën e mbjelljes.

Eksperiencia e këtyre dy ekonomive bujqësore dhe e brigadave që morën nga 17 deri 21 kv për hektar tregon se, po të punohet seriozisht me tokën, sidomos për sistemimin dhe drenazhimin e saj, po të zbatohen me rigorozitet afatet e mbjelljeve e të shërbimeve, është plotësisht e mundur që të merren rendimente të larta edhe në pambuk.

Por, për të gjitha këto, në radhë të parë, është e domosdoshme të kuptohet seriozisht nga komitetet e nga organizatat-bazë të Partisë, nga organet shtetërore e ekonomike dhe nga organizatat e masave e, nëpërmjet tyre, nga të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit, nevoja e një kthese rrënjësore për plotësimin e detyrave në prodhimin e të gjitha llojeve të bimëve industriale. Kjo diktohet jo vetëm nga fakti se deri tani janë kri-

1 Në rrethin e Beratit.

2 Në rrethin e Lushnjës.

3 Në rrethin e Beratit.

juar disa deficite, por edhe sepse, në kushtet e bllokadës, nga mossigurimi i nevojave me prodhimin në vend, krijohen probleme e shqetësime më të mëdha. . .

Për të kapërcyer gjendjen që krijohet, si rrjedhim i këtyre mosrealizimeve, sikurse ka thënë shoku Enver, ka dy alternativat:

— Ose të ulët nivelin e konsumit për frymë të këtyre artikujve, por kjo nuk do të ishte e dëshirueshme dhe është në kundërshtim me direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë;

— ose të importojmë pambuk, yndyrna e sheqer, mbi parashikimet e planit pesëvjeçar, por për këtë nevojiten sasi suplementare valutë, të cilat mund të sigurohen vetëm duke ua hequr sektorëve të tjerë. . .

Pikërisht për këtë arsye, organet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të bëjnë një punë të madhe ideopolitike për t'i bërë të ndërgjegjshëm komunistët, kuadrot e masat se, për të zgjidhur problemet e mësipërme, ka e duhet të ketë vetëm një alternativë: të sigurohet medoemos realizimi i planit të prodhimit të bimëve industriale.

Këshilli i Ministrave i RPSSH, kohët e fundit, analizoi gjendjen e blegtorisë dhe nxori një vendim të posaçëm¹ për zhvillimin e saj dhe për masat që duhen marrë për realizimin e planit të prodhimeve blegtorale. Por Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë tërheq edhe një herë vëmendjen se faktori vendimtar për realizimin e planit në sektorin e blegtorisë ka qenë dhe mbetet sigurimi i bazës ushqimore. Eksperiencia tregon se rezultatet e arritura në prodhimin dhe në sigurimin e ushqimeve shoqërojnë, hap pas hapi, dhe kushtëzojnë tërë punën që bëhet për zhvillimin intensiv të blegtorisë. Me sigurimin ose me mungesën e bazës ushqimore shpjegohen rezultatet pozitive ose të kundërta në blegtori, sidomos ngordhjet e dëmtimet, pjelloria, shtesa në peshë dhe rendimentet që merren. Por, me gjithë porositë e vazhdueshme që janë dhënë, Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse, si dhe organet e organizatave-bazë të Partisë, akoma nuk e kanë marrë mirë në dorë dhe nuk u dalin në kohë përpara problemeve të bazës ushqimore.

Të dhënat e viteve të fundit vërtetojnë se rrethet, që kanë pasur ritmet më të larta në rritjen e rendimenteve në foragjere dhe në forcimin e bazës ushqimore, kanë pasur, njëkohësisht, edhe rritjen më të madhe në prodhimet blegtorale. Komitetet e Partisë të rretheve Korçë, Gjirokastër, Sarandë e Durrës e kanë të qartë se në rrethin e Pogradecit nuk ekzistojnë

1 Është fjala për vendimin nr. 390, datë 17 nëntor 1977, «Mbi gjendjen e blegtorisë dhe masat për zbatimin e detyrave të Kongresit të 7-të të PPSH».

kushte më të mira, bile ndoshta më pak të favorshme se në rrethet e tyre për blegtorinë. Rrethi i Pogradecit nuk e ka shtuar sipërfaqen e foragjereve, përkundrazi, vitet e fundit e ka ulur, megjithatë, ai ecën mirë sepse merret e punon konkretisht me bazën ushqimore në tërësi, sepse gjithë tokën bujqësore e konsideron të bujqësisë dhe të blegtorisë, kurse tokat e planifikuara për blegtorinë i mbjell vetëm me kultura foragjere.

Këto çështje janë ngritur vazhdimisht. Sigurisht, disa përmirësime ka, por kërkohen punë dhe përpjekje shumë të mëdha, sepse qumështi, mishi, vezët e prodhimet e tjera blegtorale janë të nevojës së përditshme. Çdo mosrealizim në plotësimin e detyrave të planit ndikon drejtpërsëdrejti në krijimin e vështirësive për furnizimin e popullit dhe sjell shqetësime, gjë që nuk duhet ta lejojmë.

Partia ka theksuar, jo një herë, dhe ka porositur vazhdimisht se njohja, studimi dhe përgjithësimi i eksperiencës së përparuar përbëjnë hallkën kyç, faktorin vendimtar për realizimin e detyrave në bujqësi dhe rezervën më të madhe për revolucionarizimin e mëtejshëm të prodhimit bujqësor. Megjithëse flitet shumë për këtë, përsëri ka mjaft formalizëm, bëhet një punë e përciptë e jo aq efektive, pra, nuk ndiqet zbatimi i realizimit të saj në çdo njëjë e proces pune.

Komitetet e Partisë në rrethet Dibër, Kukës, Mat e Tropojë e dinë mirë se në rrethin e Mirditës nuk ka kushte më të mira se në rrethet e tyre. Edhe në këtë rreth, para 3-4 vjetësh, gjendja e bujqësisë nuk ishte e kënaqshme, mirëpo tani ajo është përmirësuar. Kjo u arrit, sepse komiteti i Partisë i rrethit bëri një punë këmbëngulëse kundër lëkundjeve e mosbesimit. Ai krijoi bindje për mundësitë që ekzistonin dhe i orientoi drejt organet shtetërore e ekonomike për zbulimin e për shfrytëzimin e rezervave.

Pra kjo tregon atë që ka thënë vazhdimisht Partia se, në radhë të parë, është puna këmbëngulëse e njerëzve, janë drejtimi e organizimi i zbatimit të detyrave, janë përvoja e përparuar dhe eksperimentimi shkencor, që përcaktojnë arritjet e larta në bujqësi. Por ky konkluzion nuk është bërë motoja e tërë punës së Ministrisë të Bujqësisë, e organizatave të Partisë dhe e organeve shtetërore. Ende nuk është arritur që të rrënjosen thellë, kudo, koncepte e bindje të drejta, se pengesat dhe vështirësitë përballohen, në radhë të parë, me përsosjen e vazhdueshme të organizimit të punës e të drejtimit, me forcimin e disiplinës e të kontrollit të zbatimit të vendimeve.

Organizatave e masave, organet e shtypit e të propagandës përvojën e përparuar, shembullin pozitiv t'i përdorin më gjërësisht. E gjithë kjo punë në këtë fushë të shërbejë për të ngri-

tur më këmbë të gjithë kuadrot dhe punonjësit e bujqësisë, në ballë të të cilëve të jenë komunistët, për të frymëzuar fshatarësinë kooperativiste, punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore, të SMT-ve e të ujërave për arritje më të larta. Partia t'i bëjë ata të ndërgjegjshëm se populli, ekonomia dhe mbrojtja e vendit kërkojnë më shumë nga bujqësia, se vetëm po të rritet më shpejt prodhimi i drithit, i pambukut, i yndyrnavë, i sheqerit dhe i prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale, do të krijohen mundësi më të mëdha që, me forcat tona, të zhvillojmë më shpejt edhe degët e tjera të ekonomisë. Çështja shtrohet që sot, më tepër se kurrë, të shfrytëzojmë plotësisht e mirë jo vetëm tokën e punuar, por edhe sipërfaqet e papunuara, të shfrytëzojmë më mirë kullotat e livadhet, florën dhe faunën, spon-tane e të kultivuar, për të marrë më shumë dhe gjithfarë prodhimesh nga pylli, nga ujërat, nga rezervuarët e ujitjes, nga çdo burim i mundshëm.

3. — Të realizojmë në afatet e caktuara e sipas grafikëve planin e ndërtimeve e, në radhë të parë, veprat e mëdha industriale.

Në vitin 1978 vëllimi i investimeve dhe i ndërtimeve themelore parashikohet të rritet 17 për qind, kundrejt vitit të kaluar. Gjatë këtij viti do të përfundojnë punimet e ndërtim-montimit në 37 vepra industriale, në 36 vepra të bujqësisë, si dhe në mjaft të tjera me karakter shoqëror e kulturor.

Në plan është parashikuar që këtë vit Kombinati Metalurgjik të punojë plotësisht me mineralin tonë... Në Hidrocentralin e Fierzës do të vihen në punë tri turbina. Ritmi i ndërtimeve në bonifikime e në ujitje, duke përfshirë edhe ato që do të ndërtojnë kooperativat me burimet e veta, do të rritet 48 për qind, në krahasim me atë që u arrit në vitin 1977.

Sikurse jeni në dijeni, mjaft nga këto vepra duhet të ishin vënë në shfrytëzim vite më parë. Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror na i bëri të qarta shkaqet. Në këtë situatë ka rëndësi të madhe që, nga ana jonë, të mos mungojë asgjë për ndërtimin dhe për vënien në shfrytëzim të këtyre veprave. Por, që të realizohet kjo, është e nevojshme që në sektorin e ndërtimit të zhduken të metat e dobësitë që vërehen në organizimin dhe në drejtimin e punës.

...Ministri i Ndërtimit mori zotim para Byrosë Politike dhe Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror se detyrat në Hidrocentralin e Fierzës do të plotësoheshin sipas planit e grafikut, mirëpo këtë premtim nuk e mbajti. Plani i ndërtimit të veprave ujore nuk realizohet plotësisht dhe vazhdon zvarritja e përfundimit të tyre prej një kohe të gjatë.

Disa sekretarë të komiteteve të Partisë të rretheve, gjithashtu, premtuan se detyrat në ndërtim do të plotësoheshin.

Mirëpo të dhënat tregojnë se shumë nga ndërmarrjet e ndërtimit nuk i plotësuan planet. Deficite në ndërtim janë krijuar, sidomos, në rrethet Korçë, Durrës, Vlorë e Sarandë. Dikasteret qendrore dhe rrethet Tiranë, Fier e Përmet, ndërsa kërkojnë me këmbëngulje investime për ndërtime, në të njëjtën kohë, nuk interesohen po me atë këmbëngulje për realizimin e tyre, zvarritin lirim të shesheve të ndërtimit dhe sigurimin e fuqisë punëtore.

Ministria e Ndërtimit dhe organet e saj vartëse, organizatat dhe komitetet e Partisë të ndiejnë më thellë përgjegjësinë dhe të bëhen të ndërgjegjshme për dëmin që i shkaktohet ekonomisë kur nuk plotësohen detyrat e planit në ndërtim.

Organet e organizatave-bazë të Partisë dhe organet shtetërore e ekonomike ta kuptojnë, gjithashtu, se rrethimi e bllokada mposhten kur bëhet punë këmbëngulëse për realizimin me çdo kusht të të gjitha detyrave, kur përfundohen në kohë veprat, sipas grafikëve, me cilësi e kosto të ulët, se parimi i mbështetjes në forcat e veta gjen zbatim konkret kur materializohet në çdo hallkë, në çdo ndërmarrje e në çdo individ. Prandaj projektuesit, inxhinierët zbatues, teknologët, novatorët e racionalizatorët të mendojnë e të studiojnë me kujdes çdo nyjë e detal, të skicojnë, të projektojnë dhe t'i futen prodhimit me forcat e veta.

Detyra të mëdha u dalin edhe punonjësve të industrisë për përgatitjen dhe për vënien sa më shpejt në shfrytëzim të veprave të reja, që përfundojnë së ndërtuari. Kjo shtrohet si për veprat e mëdha, ashtu edhe për ato të mëdha e të vogla, sepse, shpeshherë, vënia e tyre në prodhim vonohet edhe për gjëra që kanë të bëjnë me sigurimin e lëndës së parë, me përvetësimin e proceseve teknologjike, bile edhe për mosaktivimin e çmimeve në kohën e duhur.

Një hallkë e rëndësishme për ekonominë është transporti, të cilit i duhet dhënë një ndihmë më e madhe që të kryejë plotësisht detyrat. Vitin e kaluar, në mjaft tregues, detyrat e planit u realizuan, por në këtë sektor u vërtetuan dhe të meta e dobësi, sidomos në zbatimin e kontratave, në mirëmbajtjen dhe në shfrytëzimin e mjeteve, në administrimin dhe në trajtimin e mallrave në tranzit. Ministria e Komunikacionit duhet të marrë masa e të organizojë më mirë gjithë rrjetin e transportit e të speditimit, duke fuqizuar nyjat tranzite, për të siguruar me kohë lëvizjen e mallrave të mëdha e të vogla, sidomos nga portet e nga stacionet hekurudhore; të forcojë disiplinën kontraktuale dhe atë teknike në transportin hekurudhor.

Praktika shumëvjeçare tregon se transporti mbetet një nyjë delikate e ekonomisë sonë, që nuk mund të zgjidhet vetëm duke importuar automjete e lokomotiva. Shumë dikasterë e

ndërmarrje ankohen se u vonohet transportimi i lëndës së parë, i materialeve dhe i prodhimeve të gatshme. Por, që të evadohen mallrat në kohë, duhet organizim e disiplinë si nga organet e transportit, kjo po se po, ashtu edhe nga organet prodhuese e konsumatore. Mungesa e realizimit ritmik të planit të prodhimit dhe vonesat në ngarkim-shkarkim nuk mund të mos sjellin çrregullime e vonesa edhe në transportimin e tyre, si dhe krijimin e nevojave suplementare për mjete transporti.

Kërkohet një vlerësim më serioz në gjetjen dhe në përdorimin e burimeve të brendshme për të përballuar nevojat gjithnjë në rritje për transport. Shtimi i qerreve e i karrove nuk duhet të mbetet një çështje fakultative, por të vihen detyra e të hartohen plane konkrete, sidomos në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore, por edhe në qytetet e vogla. Në këtë vështrim duhet parë dhe shtimi i rrjetit të teleferikëve.

4. — Të forcohet e të përmirësohet më tej puna në tregtinë e jashtme.

Tregtia e jashtme, në situatën e re, merr një rëndësi të madhe ekonomike dhe politike. Ne jemi të ndërgjegjshëm se imperialistët e revizionistët, si dhe oportunistët e të gjitha ngjyrave do të mundohen të ngushtojnë rrethimin e të forcojnë bllokadën dhe do të na sjellin pengesa e vështirësi nga më të ndryshmet në marrëdhëniet tregtare me jashtë.

Këta dy vjetët e fundit, në luftë për të çarë bllokadën dhe për zhdukjen e pasojave të veprimtarisë armiqësore në këtë sektor, janë arritur disa rezultate. Megjithatë, edhe vitin e kaluar, detyrat në eksport e në import nuk u realizuan... Nuk kanë ardhur sipas planit sondat e shpimit, armaturat, daltat, tubat, traktorët, makineritë e ndërtimit, çeliqet, pjesët e ndërrimit për automjete e disa materiale të tjera.

Në qoftë se ekonomia jonë i përballoi këto deficite, kjo gjë është e lidhur ngushtë me politikën e drejtë ekonomike që ka ndjekur Partia jonë për të siguruar rezerva për situata të tilla. Por kjo nuk mund të vazhdojë gjatë, sepse rezervat na duhen për kohë më të këqija.

Vështirësi ka dhe do të ketë edhe në të ardhmen, por pra tyre nuk duhet të fshihen e të justifikohen mungesat e përpjekjet e pamjaftueshme të punonjësve të tregtisë së jashtme. Duke filluar nga ministria, vërehen të meta e dobësi, praktika e veprime të gabuara, ngathtësi e ngurrime, që pengojnë mbarëvajtjen e punës. Punonjësit e këtij sektori nuk janë më të rinj, prandaj duhet të punojnë me tempin e kohës, të dërsijnë, ashtu siç dërsijnë punonjësit e prodhimit.

Në marrëdhëniet tregtare me jashtë do të jemi të detyruar të kalojmë në shitblerje mbi bazën e çmimeve të kohës, që diktohen nga koniunkturat e tregut botëror, prandaj, para

punonjëse të tregtisë së jashtme, shtrohet domosdoshmëria e njohjes së këtyre koniunkturave, të bëjnë vlerësime të drejta të tyre dhe veprime të shpejta, për të përfituar në maksimum, duke ruajtur gjithmonë dinjitetin dhe korrektësinë në marrëdhëniet tona tregtare. Disa herë Komiteti Qendror ka përsëritur detyrën për të çarë me guxim në tregje të reja, por sot kjo shtrohet në mënyrë më imperative, po të marrim parasysh edhe faktin se, në këtë drejtim, gjatë këtyre dy vjetëve, nuk janë arritur rezultate të dukshme.

Nga ana tjetër, Ministria e Tregtisë së Jashtme të marrë masa për të forcuar rregullin e disiplinën në punë, për të forcuar kërkimin e llogarisë për njerëzit që punojnë në këtë sektor e për ata që dërgohen jashtë për tregti. Të kihet mirë parasysh porosia e Plenumit të 3-të të Komitetit Qendror që çdo njeri që del jashtë shtetit duhet të jetë një propagandist i qartë i vijës së Partisë sonë marksiste-leniniste dhe të jetë plotësisht i përgatitur që të kryejë detyrën që i është ngarkuar.

Zbatimi i detyrave në tregtinë e jashtme nuk kryhet vetëm nga ata punonjës që punojnë në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme apo në ndërmarrjet e saj. Me ato duhet të merren organizatat-bazë, komitetet e Partisë, organet shtetërore e ekonomike dhe të gjithë punonjësit e vendit. Masat punonjëse të qytetit e të fshatit duhet të ngrihen më këmbë dhe të zbatohen me vendosmëri detyrat që shtrohen në planin e vitit 1978 për rritjen e eksportit dhe për uljen e importit.

Veçanërisht, kujdes i madh duhet të tregohet për përmirësimin e cilësisë së prodhimeve për eksport. Për këtë çështje, Komiteti Qendror ka tërhequr disa herë vëmendjen. Sigurisht, edhe disa përparime janë arritur, por tani, kur kërkesat e blerësve të jashtëm rriten mjaft për cilësinë, ka ardhur koha t'i jepet fund çdo qëndrimi nënvleftësues ndaj këtij problemi. Vëmendje, sidomos, u duhet kushtuar mallrave të tilla, si: kromit, duhanit e cigareve, konfeksioneve dhe perimeve të freskëta e të konservuara. Nuk mund të lejohet që kromi të jetë nën cilësinë e planifikuar dhe bashkë me të të transportohen mijëra tonë gurë. A e kuptojnë organet e Partisë, të shtetit e të ekonomisë, kultivuesit dhe përpunuesit e duhanit e të cigareve se prodhimi i tyre me cilësi të dobët, ose ambalazhimi me cilësi të ulët krijon vështirësi serioze për shitjen e tyre dhe çon në uljen e çmimit?

Cilësia e mallrave dhe ambalazhimi pasqyrojnë nivelin ekonomikokulturor të vendit tonë. Edhe nëpërmjet tyre, sikurse ka thënë shoku Enver Hoxha, njerëzit jashtë duhet të shohin e të njohin vendin tonë, forcën e organizimit e të drejtimit socialist të ekonomisë, korrektësinë e një shteti socialist, siç është vendi ynë.

Për forcimin e punës në organet e tregtisë së jashtme, është

e domosdoshme që komitetet e Partisë të tregojnë një vëmendje më të madhe për rritjen e rolit udhëheqës të organizatave të Partisë në këto organe, për të gjallëruar jetën e tyre të brendshme dhe të marrin masa për t'i forcuar me kuadro të aftë.

5. — Të përmirësojmë furnizimin e popullit me mallra të përdorimit të gjerë.

Në planin e këtij viti qarkullimi i mallrave, me të holla në dorë, parashikohet të rritet, veçanërisht në fshat.

Roli dhe detyrat e organeve të tregtisë janë që t'i administrojnë mirë këto mallra dhe t'i shërbejnë popullit me korrektësi e kulturë, duke dëgjuar gjithmonë zërin e tij. Duke i parë kështu detyrat, atyre nuk u lejohet të krijojnë situata të papranueshme, siç krijuan vitin e kaluar me praktikat e vendosura për disa artikuj ushqimorë, as edhe të ulin kërkesat për mallra industriale, nën nivelin e nevojave të popullatës, nga frika e krijimit të stoqeve dhe të mbinormativave.

Prandaj, ato, duhet të studiojnë jo vetëm në shkallë kombëtare, por edhe në shkallë rrethi e zone strukturën e mallrave për shitje e të parandalojnë prodhimin me cilësi të dobët. Të jenë shumë më të zhdërvjellëta për lëvizjen e mallrave nga njëri rreth në tjetrin, në mënyrë që të mos krijohen mallra mbi normativë, të mos ketë mungesa në treg për artikuj, që në një rreth tjetër gjenden me bollëk. Përvoja e vitit të kaluar tregon se, me lëvizjen, mallrat që konsiderohen stoqe e mbinormativë në një rreth, u shitën në rrethe të tjera, prandaj të ecet më tej në këtë rrugë, duke gjetur forma e mjete të ndryshme. Për asnjë arsye nuk duhet të ndodhë më që në Vlorë apo në Durrës të dëmtohen portokallet e perimet, në një kohë kur në Kukës e në Peshkopë, në Fierzë e në Gurin e Kuq ato kërkohen në sasi më të mëdha.

Për thithjen dhe për qarkullimin e shpejtë të monedhës detyra u dalin edhe kooperativave bujqësore, sepse, në planin e qarkullimit të mallrave, rreth 13 për qind e përbën xhiroja e brendshme e tyre.

Punonjësit e industrisë së lehtë e ushqimore dhe ata të bujqësisë, që janë prodhuesit kryesorë të mallrave të përdorimit të gjerë, jo vetëm duhet të plotësojnë sipas planit dhe kërkesave prodhimin në asortiment, në cilësi, në lloje dhe në stinë, por duhet të ndjekin edhe shitjen e tyre, të dëgjojnë me kujdes edhe vërejtjet konkrete të konsumatorëve, kërkesat dhe nevojat e tyre.

Nga të dhënat rezulton se, nga mosplotësimi i planit të furnizimit të tregut me perime, vitin e kaluar u krijua pjesa më e madhe në deficitin e tregtisë me pakicë... Por a duhet lejuar një fenomen i tillë kur Partia, disa herë, e ka ngritur me forcë përdorimin sa më të gjerë të perimeve si në qytet,

ashtu dhe në fshat?... Kur konsumatorët nuk i shpenzojnë lekët për të blerë perime, patate, fruta e qumësht, atëherë, ata, gjithë këta lekë ose do t'i përdorin për të blerë sende të tjera, sidomos ato që janë deficitare (oriz, makarona, djathë, marmelat), ose do t'i mbajnë nëpër xhepa për të blerë artikuj industrialë, që ekonomia jonë akoma nuk i prodhon me shumicë. E njëjta gjë ndodh edhe në qoftë se në treg mungojnë tullat, tjegullat, çimentoja e materiale të tjera ndërtimi.

Prandaj, siç ka porositur vazhdimisht Partia, punonjësit e prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë duhet t'i shqetësojë vazhdimisht gjendja e tregut, që ky të jetë gjithmonë i mbushur e të luftohet për t'i dhënë atij vazhdimisht prodhime të reja. Janë mjaft të mira përpjekjet që bëhen për prodhimin në vend të biçikletave apo të frigoriferëve shtëpiakë, por ka akoma artikuj që mungojnë në treg, ose që i sjellim nga importi, të cilët, me më shumë përpjekje, mund të prodhohen në vend.

Si punonjësve të tregtisë, ashtu dhe atyre të grumbullimit u dalin detyra shumë të rëndësishme për thithjen e prodhimeve nga fshati. Këtu nuk është fjala vetëm për të pranuar këto prodhime në çdo kohë, për t'i trajtuar ato teknikisht mirë, që të mos dëmtohen, por edhe për të ndjekur realizimin e tyre në periudha të ndryshme, gjatë tërë procesit të prodhimit. Nuk mund të pranohet që panxhari, ulliri apo perimet, për mungesë depush apo kapaciteti përpunimi, të dëmtohen e të kalben, që drithi të mbesë në lëmenj, që duhani të myket në hangarë, që për prodhimet e pakta të oborrit, kooperativisti të shkojë në treg e të humbë ditën e punës, për arsye se dyqanet nuk pranojnë vezën apo rrushin, pulën apo gjalpin. Organet e tregtisë dhe të grumbullimit duhet t'u dalin përpara e në kohë këtyre çështjeve, të marrin masa organizative e teknike që të gjitha prodhimet e tepërta të fshatit të thithen në kohë e me leverdi për ekonominë në tërësi.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet t'i udhëheqin më mirë punonjësit e tregtisë, si njerëz që ballafaqohen çdo ditë me popullatën. Në situatat e krijuara, me një furnizim të mirë dhe të kulturuar, janë të gjitha mundësitë që ne jo vetëm të mbajmë nivelin e tregut, por edhe ta përmirësojmë atë më tej. Por kjo kërkon punë të gjithanshme e të ndërgjegjshme, kërkon që detyrat në fushën e tregtisë të kuptohen thellë dhe, në radhë të parë, në aspektin politik.

Shokë,

Kaluan dy vjet nga plani i pesëvjeçarit të gjashtë. Gjatë kësaj periudhe sukseset që u arritën kanë qenë të mëdha e në

të gjitha fushat. Por kemi edhe deficite në disa degë e sektorë të tjerë të ekonomisë...

Në planin e vitit 1978 është parashikuar që të mbulohet një pjesë e deficiteve në prodhimin industrial, në eksport dhe diçka në prodhimin bujqësor. Megjithatë, përsëri mbeten deficite të pambuluara, sidomos në naftë, në drithërat e bukës, në perime, si dhe gati krejt deficitet e krijuara në bimët industriale e në prodhimet blegtorale.

Në këto kushte, dikasteret qendrore dhe organet lokale të pushtetit, organet dhe organizatat-bazë të Partisë në rrethe, në përcaktimin e masave dhe në organizimin e punës për plotësimin e planit të vitit 1978, duhet të thellohen e të parashikojnë detyra suplementare edhe për tejkalimin e tij, në mënyrë që të pakësohen, në maksimumin e mundshëm, këto deficite. Për tejkalimin e planit të synohet sidomos: në naftë, në mineralet që eksportohen, në prodhimin e mallrave me lëndë të para të vendit dhe veçanërisht në prodhimet bujqësore e blegtorale.

Realizimi i këtyre detyrave të mëdha të lidhet ngushtë me situatat. Të kuptosh, të jetosh e të përballosh situatat në frontin e ekonomisë, do të thotë, para së gjithash, të realizosh planin, të plotësosh detyrat ndaj ekonomisë dhe ndaj popullit. Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, duke ndjekur me vazhdimësi zhvillimin e ngjarjeve në botë e brenda vendit, të bëjnë të qartë e të ndërgjegjshëm çdo kolektiv, sado i vogël që të jetë, se detyrat e planit, që realizon ai, janë pjesë përbërëse e planit unik e të përgjithshëm shtetëror dhe e tërë frontit të luftës që bëjnë Partia e populli ynë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e pavarësisë politike e ekonomike të vendit. Ashtu si në luftë, edhe në frontin ekonomik, arritja e objektivave, në tërësi, sigurohet nga plotësimi i detyrave në çdo repart e brigadë, në çdo ndërmarrje, kooperativë e rreth.

Për realizimin dhe për tejkalimin e planit të këtij viti, vëmendja kryesore e organeve dhe e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore e ekonomike dhe e gjithë punonjësve, të përqendrohet, sidomos, në këto drejtime:

Së pari, problemet ekonomike dhe ato të realizimit të planit të merren më mirë në dorë nga komitetet dhe nga organizatat e Partisë. Pa dyshim, sukseset që kemi arritur në ekonomi, si dhe në të gjitha fushat e tjera janë të lidhura ngushtë me punën e madhe të Partisë, me rritjen e mëtejshme të rolit udhëheqës të organeve dhe organizatave-bazë në të gjithë sektorët e në çdo qelizë të veprimtarisë së vendit tonë. Rritja e vazhdueshme e këtij roli ka bërë që të kemi një ekonomi të fortë, të stabilizuar, dinamike dhe me perspektivë të qartë. Kjo përbën faktorin themelor edhe për realizimin me sukses të të gjitha detyrave të planit, që na shtrohen për vitin 1978.

Ekspierienca e deritanishme tregon se sukseset apo dobësitë, në realizimin e detyrave të planit, janë të lidhura me nivelin e punës udhëheqëse të Partisë për kuptimin dhe për zbatimin e politikës ekonomike të saj nga organet e nga organizatat e Partisë, nga organet shtetërore dhe ekonomike, nga organizatat e ndryshme të masave, nga çdo kuadër e punonjës. Efekti i kësaj pune matet me rezultatet që arrihen, me detyrat që plotësohen, me vështirësitë e pengesat që kapërcehen.

Në rrethin e Tiranës e të Shkodrës, megjithëse pati vështirësi në prodhimin e grurit, plani dyvjeçar i prodhimit të drithërave të bukës u realizua. Këto rezultate u bënë të mundshme, para së gjithash, nga puna e gjithanshme e Partisë në këto rrethe, për krijimin e bindjeve të thella, si për domosdoshmërinë, ashtu dhe për mundësitë e realizimit të tyre, për rritjen e ndjenjës së përgjegjësisë për zbatimin e detyrave të ngarkuara, duke marrë, njëkohësisht, edhe masat organizative e teknike përkatëse.

Dobësitë në industrinë e naftës, zvarritjet në ndërtimin e objekteve, deficitet në sektorin e bujqësisë, njëanshmëria që vihet re akoma në realizimin e detyrave, tregojnë se ka akoma boshllëqe në veprimtarinë udhëheqëse të organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë, në punën ideopolitike për kuptimin dhe për zbatimin e direktivave e të vendimeve të Partisë në fushën ekonomike. Në këtë vështrim, puna e Partisë dhe e organizatave të masave, veçanërisht në rrethet ku detyrat nuk realizohen, ka nevojë të përmirësohet seriozisht.

Kjo kërkon, në radhë të parë, që metoda dhe stili në punë i organeve e i organizatave-bazë të Partisë të përmirësohen më tej, në përshtatje me kërkesat e kohës, me karakterin e detyrave që shtrohen, me problemet që dalin. Puna e Partisë nuk i duron rutinën, javashllëkun, spontaneitetin, ajo duhet të bëhet më dinamike dhe t'u paraprijë problemeve. Organizatat e Partisë, byrotë e Partisë në ndërmarrje e në kooperativa, sekretariatit apo byroja e komitetit të Partisë të rrethit nuk duhet të presin fundin e muajit e të tremujorit apo radhën e mbledhjes, sipas planeve të aprovuara, për të shqyrtuar deficitet që krijohen gjatë punës. Ato të ndalen menjëherë për të zbuluar shkaqet, për të ngritur peshë punonjësit që plani të plotësohet jo vetëm në global, por zë për zë, ritmikiisht dhe nga të gjithë.

Por a mund të thuhet se punohet mirë, me një metodë dhe me stil revolucionar, siç e shtron Partia, kur pothuajse asnjë nga komitetet e Partisë të rretheve ku kultivohet pambuku nuk kishte menduar vitin e kaluar të merrte në shqyrtim e të analizonte gjendjen e kësaj bime në një nga organet udhëheqëse të tyre, megjithëse prodhimi i pambukut ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues për Partinë dhe për shtetin? Të veprosh kë-

shtu, do të thotë të mos u dalësh problemeve përpara, të mos parashikosh vështirësitë që mund të lindin dhe të mos marrësh me kohë masat për realizimin e detyrave.

Kontrolli i zbatimit të vendimeve është një normë e rëndësishme në jetën e organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë.

«Pa kontroll, — tha shoku Enver në Kongresin e 7-të të Partisë, — nuk ka si të vërtetohet drejtësia e direktivës, rezultati i punës së bërë, nuk mund të njihen e të zbulohen vështirësitë, pengesat, dobësitë, kontradiktat dhe të merren masa për kapërcimin e tyre. Pa kontroll nuk ka kërkesë llogarie, nuk ka kritikë e autokritikë, nuk ka përpjekje e luftë për realizimin e detyrave»¹.

Në organizatat-bazë dhe në forumet e Partisë në rrethe gjen mjaft vendime të drejta e të rëndësishme për zbatimin e politikës ekonomike të Partisë në fusha të ndryshme. Ka edhe shumë raste që tregojnë për luftën dhe për përpjekjet që bëhen për ndjekjen e zbatimit të tyre. Rezultatet pozitive të arritura në mjaft ndërmarrje, kooperativa e rrethe e vërtetojnë këtë. Por, krahas me këto, gjen edhe vendime pas vendimesh për të njëjtat çështje, të cilat, meqenëse nuk ndiqen e nuk zbatohen, nuk japin rezultatet e dëshiruara. Disa komitete partie në rrethet e Veriut e kanë analizuar dhe kanë marrë vendime, jo një herë, për zhvillimin e blegtorisë, të frutikuturës apo për rritjen e vlerës së ditës së punës e, megjithatë, ndonjë ndryshim i dukshëm nuk vërehet.

Prandaj duhet të forcohet e të gërshetohet më mirë kontrolli i Partisë me atë shtetëror e me grupet e kontrollit punëtor e fshatar, si dhe me të gjitha format e tjera të kontrollit, për plotësimin e planit në kohë e në të gjithë treguesit, për të luftuar shfaqjet e rutinës, të javashllëkut, frymën e justifikimit, thyerjet e disiplinës, indiferentizmin, si edhe të gjitha shfaqjet e huaja të liberalizmit e të burokratizmit.

Për plotësimin e detyrave të planit, organizatat-bazë të Partisë një vëmendje të veçantë të tregojnë për rritjen e mëtejshme të rolit pararojë të komunistëve, të shembullit të tyre personal. Është pozitiv fakti që, gjatë vitit të kaluar, komunistët, duke punuar në frontet kryesore e më të vështira të prodhimit, kanë dhënë shembull në punë dhe, me ndikimin e tyre, kanë tërhequr e kanë mobilizuar edhe punonjësit. Rreth 1 000 anëtarë e kandidatë partie, që një vit më parë punonin në administratë

¹ Shih në këtë vëllim, f. 82.

ose në sektorë e reparte ndihmëse, kaluan në frontet kryesore të prodhimit dhe afro 300 të tjerë nga qyteti, shkuan për të punuar në fshat.

Por organizatat-bazë të Partisë duhet të luftojnë vazhdimisht që roli pararojë i komunistit, çdo ditë, të vijë duke u rritur. Ato nuk duhet të pajtohen me rastet e thyerjeve të disiplinës e të punës me cilësi të dobët. Me mijëra janë komunistët që punojnë direkt në prodhim, bashkë ose pranë punëtorëve e kooperativistëve të tjerë e, megjithatë, rastet e prodhimit e të punës me cilësi të dobët nuk janë të pakta. Në sektorin e komunales, megjithëse dhe aty ka mjaft komunistë, shfaqjet mikroborgjeze, javashllëku e neglizhenca, deri tek ushtrimi i profesioneve private, janë relativisht të përhapura dhe ndikimi pozitiv i disa komunistëve është ende i pakët.

Gjithashtu, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të merren më mirë me shtrirjen dhe me shpërndarjen e forcave të Partisë, sidomos në veprat e reja, sepse ka akoma sektorë, brigada e reparte të rëndësishme që nuk kanë fare komunistë ose numri i tyre është i pakët.

Plotësimi me sukses i detyrave të planit të vitit 1978 kërkon që të rriten e të forcohen më tej ndihma e kontrolli i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe i organeve e i organizatave-bazë, sidomos mbi administratat, për përmirësimin e mëtejshëm të drejtimit të ekonomisë në të gjitha hallkat e në çdo qelizë të saj. Kjo do të bënte që organet shtetërore dhe ekonomike, çdo kuadër e punonjës, të rritin ndjenjën e përgjegjësisë ndaj detyrës, të kenë më tepër iniciativë, të forcojnë disiplinën e punës dhe kërkesën e llogarisë për plotësimin e planit dhe për zbatimin kurdoherë drejt të politikës ekonomike të partisë.

Së dyti, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore e ekonomike të thellojnë më tej luftën për forcimin e disiplinës së planit. Në luftën për plotësimin dhe për tejkalimin e detyrave të planit, ne duhet të udhëhiqemi kurdoherë nga porosia e shokut Enver, i cili na mëson se

«Ekonomia dhe shërbimet tona kulturore-arsimore janë si një organizëm i gjallë që jeton e zhvillohet normalisht në sajë të funksionimit të rregullt të të gjitha organeve e qelizave të tij. Mjaft që njëri organ, apo pjesë e trupit të mos kryejë funksionin e plotë normal të tij, që gjithë organizmi të pësojë çrregullime, vuajtje e të sëmuret, të dëmtohet ky apo ai proces fiziologjik. Kështu duhet kuptuar edhe puna në ekonomi, kështu duhet vlerësuar në çdo kohë e vend detyrimet që rrjedhin nga planet tona e që shprehen në sistemin e kontra-

ktimeve midis ndërmarrjeve, kooperativave dhe institucioneve të tjera»¹.

Me gjithë përmirësimet që janë bërë në këtë drejtim, përsëri kemi akoma mjaft të meta e dobësi. Plani nuk realizohet nga çdo ndërmarrje e kooperativë. Mungesa të theksuara vërehen në mosplotësimin e planit sipas asortimenteve dhe treguesve të tjerë cilësorë, në zbatim të detyrimeve kontraktuale.

...Nuk mund të bëhet fjalë për disiplinë teknike kur, për mungesë organizimi ose furnizimi ritmik, puna sforcohet ditët e fundit të muajit dhe në muajin e fundit të tremujorit, për të siguruar realizimin e planit, që, shpeshherë, bëhet në dëm të cilësisë.

Partia dhe shoku Enver, vazhdimisht, kanë theksuar se prodhimi konsiderohet i përfunduar vetëm kur shkon te përdoruesi në kohë dhe kur përdoret për qëllimin e caktuar. Mirëpo këto porosi të Partisë e të shokut Enver akoma nuk kuptohen e nuk zbatohen si duhet e nga të gjithë. Disiplina e planit dhe ajo kontraktuale nuk zbatohen kudo me rreptësi, në bazë të rregullave e të normave të caktuara nga shteti... Si mund të bëhet fjalë për disiplinë plani kur ka akoma me dhjetëra raste që ndërmarrjet refuzojnë të tërheqin mallrat e kontraktuara, kur nuk likuidojnë faturat në afatin ligjor, kur nuk kthejnë ambalazhin, kur nuk dorëzohen objektet e ndërtimit sipas kontratave, kur në hekurudhë ato janë zbatuar vetëm 77 për qind?

Është shqetësues fakti se shkeljet e kontratave, dënimet që u jepen ndërmarrjeve e kooperativave dhe personave përgjegjës, mbeten në heshtje, për to, në mjaft raste, nuk kanë dijeni as organizatat-bazë të Partisë, as kolektivat punonjës. Si është e mundur që Drejtoria e Hekurudhave në Durrës ose Kombinati i Konservave në Vlorë të dënohen disa herë dhe organizatat-bazë të Partisë të qëndrojnë indiferente, të pajtohen me këtë gjendje, bile ta quajnë atë normale?

Komitetet të Partisë të rretheve duhet t'u tërheqë më shumë vëmendjen fakti se, edhe kur shqyrtohen në byro e në sekretariat apo në organizata-bazë të Partisë shkeljet e disiplinës së planit, nuk janë të rralla rastet që kritika zbehet dhe mbahen qëndrime sentimentale e liberale...

Të gjitha këto flasin se, me gjithë punën e bërë dhe përmirësimet e arritura, shfaqjet e liberalizmit në fushën e drejtimit të ekonomisë janë akoma të forta. Prandaj organizatat e Partisë, luftën kundër shfaqjeve të liberalizmit, ta mbajnë kurdoherë të ngritur. Pa organizuar mirë luftën kundër shfaqjeve e qëndrimeve liberale, pa e trajtuar këtë nga ana ideologjike

1 Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 193.

si luftë klasore, nuk mund të mendohet e nuk mund të arrihen përfundimet e dëshiruara për forcimin e disiplinës së planit, për plotësimin e të gjitha detyrave që na vihen përpara.

Me ashpërsi duhen luftuar edhe shfaqjet, zvarritjet dhe qëndrimet burokratike, si në punën e organeve shtetërore e ekonomike, ashtu edhe në atë të organeve e të organizatave të Partisë. Një rol më dinamik duhet të luajnë, sidomos, organizatat e Partisë në dikasteret qendrore dhe në aparatet e komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Aparati i Këshillit të Ministrave të RPSSH t'u futet më mirë problemeve të organizimit të punës nëpër dikastere, në rrethe e në ndërmarrje. Kontrolli i tij duhet të shtrihet, sidomos, në metodën e në stilin e punës së aparateve, me synim që ato të bëhen më të shkathëta, më të manovrueshme e më operative, që të goditen e të luftohen më me forcë shfaqjet e dikasterializmit e të lokalizmit, që të forcohen drejtimi unik dhe disiplina shtetërore. Këshillat teknikë në ndërmarrje dhe kolegjiomet në dikastere nuk duhet as të dublojnë e as të zëvendësojnë drejtimin e centralizuar. Të përmirësohen më tej ndihma e kontrolli, të pakësohen mbledhjet dhe shkresat e panevojshme, që gozhdajnë aparatet dhe të rriten më shumë kontaktet e gjalla me njerëzit, që çështjet të zgjidhen shpejt.

Së treti, t'i futemi më mirë se deri tani zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor në të gjitha fushat.

«Në fazën e tanishme, — theksoi shoku Enver Hoxha në Kongresin e 7-të të Partisë, — janë krijuar të gjitha mundësitë materialo-teknike e njerëzore që të zgjidhim me forcat tona shumë probleme të ndërlikuara ekonomike, ideotorike, kulturore e tekniko-shkencore, që qëndrojnë para nesh»¹.

Kjo detyrë, në situatat që kalojmë, merr një rëndësi të veçantë.

Arritja me sukses e objektivave të planit, si dhe zgjidhja sa më e mirë e problemeve të ndërlikuara të prodhimit dhe të zhvillimit tonë ekonomik e kulturor kërkojnë që, duke u mbështetur në forcat tona, t'i futemi me energji të shumëfishuara revolucionit tekniko-shkencor, të zgjidhim shpejt e mirë problemet që ngre jeta. Për këtë, siç na mëson shoku Enver, kërkohet një kuptim më i thellë i vetë këtij revolucioni, si pjesë përbërëse e revolucionit tonë socialist, që ka për qëllim kryesor transformimin e vazhdueshëm të mjeteve të prodhimit.

Partia kurdoherë e ka pasur në qendër të vëmendjes këtë transformim. Fakti është se ndryshimet dhe përparimet tona

¹ Shih në këtë vëllim, f. 128.

janë shumë të mëdha, por, në të njëjtën kohë, kemi akoma disa prodhime që janë në fazën artizanale. Shumë procese pune kryhen me dorë, pa mekanizma e pa rendiment të lartë. Në disa qendra pune kemi nivel akoma të ulët të organizimit të prodhimit e të punës. Në mjaft raste zbatojmë një teknologji jo të përparuar. Për disa prodhime harxhojnë shumë lëndë të para e materiale ndihmëse etj. Por, megjithëse këto rëndojnë në ekonomi dhe pengojnë realizimin e mirë të detyrave, mjaft organe e organizata-bazë partie nuk merren konkretisht dhe si duhet me zgjidhjen e tyre, nuk organizojnë e nuk nxitin kapërcimin e kësaj gjendjeje me studime e kërkime tekniko-shkencore, me aksione konkrete, duke shfrytëzuar mirë edhe mundësitë dhe aftësitë e mëdha që disponojmë.

Sot, mjetet që prodhojnë mjete prodhimi, në krahasim me vitin 1960, janë 13 herë më shumë, numri i makinave metalprerëse 5 herë më i madh dhe numri i specialistëve të lartë mbi 7 fish. Tani ne kemi çelikun dhe gizen tonë, kemi ngritur një industri të fuqishme përpunuese, mekanike, kimike, energjetike etj. Bujqësinë po e vëmë si duhet në baza moderne të prodhimit të zgjeruar socialist. Ndërtimi dhe transporti janë fuqizuar dhe përballojnë mirë nevojat e vendit. Po t'u shtojmë këtyre dhe rritjen e madhe të ndërgjegjes ideopolitike e revolucionare të punonjësve tanë, përsosjen e aftësive drejtuese e udhëheqëse të organeve e të organizatave të Partisë dhe të levave të tyre, del se i kemi të gjitha mundësitë ta çojmë përpara me ritme më të shpejta revolucionin tekniko-shkencor në të gjitha fushat. Por, që ta bëjmë si duhet këtë, është e nevojshme të përsosim më mirë organizimin e forcave e të mjeteve, të caktojmë objektiva të qartë dhe të guximshëm për tani e për perspektivën.

Në vendin tonë janë ngritur dhe zhvillojnë një aktivitet të gjerë teknik e shkencor Akademia e Shkencave, mbi 20 institute kërkimore e projektuese e qendra byro e bërthama teknike, me qindra laboratorë, stacione kërkimore, fusha dhe impiante eksperimentale. Ne kemi rreth 39 mijë punonjës me arsim të lartë dhe 88 mijë të tjerë me arsim të mesëm profesional, pa përmendur disa mijëra racionalizatorë e punëtorë të talentuar, që çdo ditë luftojnë, krijojnë dhe transformojnë mjetet e prodhimit. Të gjitha këto forca kërkojnë një organizim e një aktivizim më të gjerë e më të plotë.

Komiteti Qendror i Partisë e dënoi ashpër fryrjen pa vend të byrove e të organizmave kërkimore, si dhe shkëputjen e tyre nga zgjidhja e problemeve që preokuponin vendin. Por, në të njëjtën kohë, Komiteti Qendror porositi që këta organizma të dalin nga puna e mbyllur, të shkrihen me luftën që bëjnë punonjësit, për të çuar përpara prodhimin dhe, së bashku me ta,

të vënë të gjitha forcat për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemeve që nxjerr jeta, nëpërmjet thellimit të revolucionit tekniko-shkencor.

Komitetet e Partisë në rrethe, organizatat-bazë në institucionet kërkimore e projektuese, si dhe dikasteret qendrore nuk i kanë zbatuar si duhet këto porosi. Prandaj ato, tani, duhet të tregojnë më shumë kujdes për bashkërendimin e problemeve, për organizimin e forcave e të mjeteve dhe për kooperimin e gjerë në shkallë kombëtare, degë e rrethi. Shfrytëzimi i përvojës së përparuar, si dhe shfrytëzimi racional i dokumentacionit tekniko-shkencor, që disponojmë, përbën një detyrë me rëndësi për të çuar përpara prodhimin. Në të njëjtën kohë, për probleme e detyra të rëndësishme, të zbatohet përvoja e mirë e ushtrisë, e cila ka ngritur grupe të veçanta, me një numër të caktuar specialistësh e racionalizatorësh, për të studiuar dhe për të çuar deri në zgjidhjen e plotë të prodhimit që kërkohet.

Ne kemi akoma mjaft materiale dhe mallra që sjellim nga jashtë, megjithëse, për një pjesë të tyre, janë të gjitha kushtet për t'i siguruar në vend. Nuk është e udhës që ne të vazhdojmë akoma të sjellim nga jashtë rërë, elektroda, mentesha, gërshtë-rë, karbit, lindan etj., kur te ne ekzistojnë mundësitë që të organizohet prodhimi i tyre në vend. Çështja është që t'i futemi në formë të organizuar dhe ta çojmë deri në fund, pa zvarritje, zgjidhjen e këtyre problemeve.

Çdo rreth dhe çdo dikaster duhet të programojë saktë objektivat për këtë vit dhe, deri në fund të pesëvjeçarit, në lëmin e revolucionit tekniko-shkencor, si dhe të marrë masa organizative e teknike për arritjen e tyre. Në fushën e gjeologjisë, për shembull, po ecet mirë. Zbulimet e rezervave të reja të mineraleve të ngurta janë të kënaqshme, por këtij ritmi nuk po i përgjigjen ndërtimi e zgjerimi i minierave, as edhe ngritja e fabrikave të pasurimit. Prandaj këtu duhen caktuar objektiva konkretë, forcat dhe mjetet e nevojshme, me afate të studiuar mirë. Kemi zbuluar fosforite, azbest, dhera refraktare, kuarcite etj., por ne vazhdojmë të importojmë akoma të tilla nga jashtë, pa folur këtu për boksidet, mineralet e rralla etj. Edhe për këto duhen caktuar objektiva. Kështu duhet parë puna edhe në degë të tjera të industrisë. Në bujqësi ka akoma mjaft probleme të trajtimit të tokës, të farës, të shërbimeve, të përmirësimit racor, të frutikuturës. Edhe në ndërtim e në komunikacion, në shërbimet komunale e shëndetësore ka shumë probleme që kërkojnë zgjidhje.

Në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror, në muajin tetor të vitit të kaluar, duke zbërthyer më tej qëllimet dhe detyrat e revolucionit tekniko-shkencor, shoku Enver i përcaktoi qartë këta objektiva, si dhe domosdoshmërinë e arritjes

së tyre, duke u mbështetur në forcat tona. Tani është detyra e organeve dhe e organizatave-bazë të Partisë, e organeve shtetërore e ekonomike që ta marrin si duhet në dorë këtë çështje dhe ta thellojnë në çdo fushë revolucionin tekniko-shkencor.

Në veprat që ndërtojmë dhe në ato që vëmë në shfrytëzim, si dhe në gjithë luftën për ndërtimin tonë socialist, ne do të ndeshemi edhe me mungesa e me vështirësi. Por në qoftë se ne do të jemi në gjendje t'i kanalizojmë drejt forcat e revolucionit tekniko-shkencor dhe t'i bëjmë të ndërgjegjshëm punonjësit për detyrat e mëdha që kanë, patjetër që këto vështirësi e mungesa do të kapërcehen. Në këtë mënyrë, ne jo vetëm do të jemi në gjendje të plotësojmë si duhet planet tona, por do të tregojmë edhe një herë forcën e rendit tonë socialist, vitalitetin dhe shpirtin krijues të popullit, i cili, sikurse thotë shoku Enver, gjithçka ka mundësi të bëjë, bile më të mira se ato të jashtmet.

Së katërti, në luftën dhe në përpjekjet për realizimin e planit, të merren më mirë në dorë problemet e shtimit e të përdorimit të akumulimit socialist, si një nga faktorët kryesorë për sigurimin e ritmeve të larta të ndërtimit socialist. Sot ekonomia jonë është e aftë të sigurojë pjesën vendimtare të nevojave materiale e financiare me burimet e saj të brendshme. Por, në kushtet e sotme të rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste dhe në përshtatje me situatat e reja që po krijohen, na shtrohet si detyrë imperative jo vetëm rritja e vazhdueshme e peshës së burimeve të brendshme të akumulimit socialist, por edhe zbatimi i masave të tilla që do të çojnë në realizimin sa më shpejt të një buxheti të bazuar plotësisht në burimet e brendshme.

Për të realizuar këtë detyrë me rëndësi jetike për fatet e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, është e nevojshme që organet e organizatave-bazë të Partisë dhe organet shtetërore e ekonomike, t'i kushtojnë vëmendje më të madhe dhe të ndjekin, hap pas hapi, problemet që lidhen me balancimin e importit me eksportet tona.

Faktet tregojnë se nuk ka gjithnjë e nga të gjithë një kupim të qartë e të drejtë për domosdoshmërinë e rritjes së akumulimit dhe të përdorimit racional të mjeteve materiale e financiare. Për këto çështje, Partia ka tërhequr shumë herë vëmendjen, janë bërë dhe parashikime e janë marrë zotime, por, në praktikë, gjatë zbatimit, pa mohuar rezultatet, ka boshllëqe dhe të meta të palejueshme.

Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të Partisë vuri në dukje se prodhimet, sektorët dhe ndërmarrjet, që dalin në humbje, janë një barrë e rëndë për ekonominë, prandaj duhen nxjerrë nga prapambetja. U bënë disa studime, u morën edhe disa masa, por fakti që humbjet mbetën gati në atë nivel që

ishin një vit më parë... , tregon se ky problem, me rëndësi për ekonominë, nuk u mor mirë në dorë dhe nuk u udhëhoq si duhet nga organet dhe nga organizatat e Partisë. Edhe Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe dikasteret e tjera qendrore nuk i qëndrojnë mbi kokë kësaj çështjeje dhe nuk ndihmojnë sa duhet për t'i hapur perspektiva bazës.

Një gjë e tillë ndodhi edhe me të ashtuquajturat firo të ligjshme. Komiteti Qendror i Partisë, kohët e fundit, dha porosi të qarta për të studiuar dhe për të marrë masa konkrete për uljen gjer në minimum të këtyre firove, por as dikasteret, as komitetet ekzekutive dhe as komitetet e Partisë të rretheve nuk u thelluan sa duhet në këtë çështje. . .

Çështja e akumulimit në kooperativat bujqësore dhe mbajtja e raporteve sa më të drejta në shpërndarjen e të ardhurave në fond konsumi dhe në fond akumulimi, kanë nevojë të trajtohen më thellë. Gjithashtu, të tërheq vëmendjen fakti që vitin e kaluar shpenzimet e prodhimit ishin 2 për qind më të larta në krahasim me vitin 1976, ndërsa të ardhurat 3 për qind më të pakta. Kjo flet për një ulje të efektivitetit të shpenzimeve, prandaj organizatat-bazë të Partisë dhe organet shtetërore duhet të ndalen e t'i analizojnë seriozisht këto probleme, aq më tepër, kur një e katërta e numrit të kooperativave bujqësore e pakëson nivelin e akumulimit, në krahasim me vitin 1976.

Të gjitha këto tregojnë se problemet ekonomike e financiare, që lidhen ngushtë me rritjen e akumulimit socialist, nuk janë bërë akoma si duhet probleme të kolektivave punonjës. Interesat e ndërtimit dhe të mbrojtjes së socializmit kërkojnë që organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet e pushtetit në rrethe dhe dikasteret qendrore më shumë dhe më mirë të ndalen e të kërkojnë llogari. Ato të mbajnë qëndrim për rastet e përdorimit me dorë të lëshuar të mjeteve materiale e financiare, të caktojnë masat dhe afatet për nxjerrjen e ndërmarrjeve e të kooperativave nga prapambetja në plotësimin e treguesve ekonomiko-financiarë.

Armiku i klasës, gjithmonë, por sidomos në situatat aktuale, ka intensifikuar veprimtarinë e tij në të gjitha drejtimet, pra, edhe për të goditur bazën e rendit tonë, pronën socialiste. . . Dëmtimet, shpërdorimet dhe vjedhjet ndodhin, sidomos, atje ku puna politike është e pamjaftueshme dhe kur rregullat e ligjet e shtetit nuk zbatohen. Prandaj duhet të forcohet më tej vigjilenca dhe të ngrihen më këmbë masat, me në krye komunistët, për t'i dhënë, në çdo rast, kundërgoditjen kësaj veprimtarie.

Në luftën për forcimin e regjimit të kursimit rëndësi të veçantë marrin sigurimi dhe shtimi i rezervave. Ne duhet të përgatitemi për situata më të shtrënguara. Është e nevojshme

që organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike të kuptojnë drejt porositë e vazhdueshme të Komitetit Qendror të Partisë se sigurimi dhe shtimi i rezervave kanë karakter politik dhe ekonomik, që u shërbejnë forcimit të ekonomisë, mbrojtjes së vendit dhe realizimit me sukses të planeve. Prandaj, çdo ndërmarrje e kooperativë, t'i futet llogarisë me laps në dorë, të shohë ku është me këto detyra dhe të caktojë detyra konkrete se ku do të arrijë në fund të vitit.

Së pesti, për plotësimin e planit të vitit 1978 të merren masa me kohë për rritjen e rendimentit të punës dhe për sigurimin e fuqisë punëtore. Në plan parashikohet që rreth 45 për qind e shtesës së prodhimit industrial dhe 31 për qind e shtesës së vëllimit të ndërtimeve të sigurohet nga rritja e rendimentit të punës. Këto detyra janë të mëdha. . .

Për realizimin e tyre, përveç mobilizimit të të gjithë faktorëve të tjerë, që çojnë në rritjen e rendimentit, gjatë këtij viti, organet dhe organizatat-bazë të Partisë, bashkimet profesionale dhe organet shtetërore e ekonomike kujdes më të madh t'u kushtojnë masave ideopolitike dhe organizative për forcimin e disiplinës në punë. E theksojmë këtë se, vitin e kaluar, në këtë drejtim u vërejtën të meta e dobësi. Detyrat për rritjen e rendimentit nuk do të realizohen, në qoftë se mungesat pa arsye në punë nuk ulen, në qoftë se nuk merren masa për forcimin e mëtejshëm të organizimit të punës e të prodhimit. . .

Sigurimi i krahëve të punës për ndërmarrjet shtetërore në disa sektorë përbën një problem të rëndësishëm. Me këtë lidhet edhe plotësimi i detyrave të prodhimit, të ndërtimit etj. Vitin e kaluar minierave, ndërmarrjeve bujqësore, atyre të ndërtimit e të bonifikimit nuk iu plotësuan tërësisht dhe në kohë nevojat e planifikuara për fuqi punëtore. Kjo gjë nuk duhet lejuar të përsëritet edhe këtë vit.

Për këtë kërkohet që, nga dikasteret dhe ndërmarrjet përkatëse, të merren masa serioze për rritjen e mëtejshme të shkallës së mekanizimit të punimeve, duke vënë në përdorim mekanizmat që disponohen dhe duke prodhuar të reja, me qëllim që të pakësohen kërkesat për krahë pune.

Organet e Partisë e të pushtetit t'u futen më thellë problemeve të sigurimit të fuqisë punëtore dhe zënies me punë të forcave të reja që krijohen. Këtu pleksen një varg kontradiktash. Nga njëra anë, në qytete ka e krijohen forca të reja për punë, nga ana tjetër, hapen vende të reja, që kërkojnë fuqi punëtore.

Fakti që një pjesë e forcave të reja nuk janë të zëna me punë dhe nuk shkojnë të punojnë atje ku është nevoja, duhet të na preokupojë seriozisht. Është e vërtetë se këto janë frontet më të vështira, por, pikërisht për këtë, kërkohet një punë më e organizuar dhe më e dendur edukuese, bindëse nga ana e orga-

nizatës së rinisë dhe e bashkimeve profesionale, nën udhëheqjen e Partisë.

Lidhur me këtë çështje, një kujdes më i madh duhet treguar edhe për ndërtimin e banesave në fshat e në qendrat e punës jashtë qyteteve, sepse plani i tyre nuk po plotësohet. Dhe, kur themi të ndërtojmë banesa në fshat, të kemi parasysh ndërmarrjet bujqësore, si dhe ato kooperativa bujqësore ku këto janë të domosdoshme, duke evituar ndërtime të panevojshme e që nuk përdoren për qëllimin e caktuar.

Ndryshe paraqitet gjendja në fshat. Në mjaft kooperativa punimet bujqësore nuk kryhen as në sasi e as në kohë për mungesë të krahëve të punës. Kjo ndodh në një kohë kur një numër jo i vogël kooperativistësh nuk dalin në punë. Kjo nuk është e drejtë dhe e pranueshme. Prandaj duhet të bëhet problem i madh i Partisë, i pushtetit dhe i organizatave të masave...

*
* * *

Këto ishin disa nga detyrat dhe problemet kryesore të planit të vitit 1978. Ne jemi të përgatitur për të përballuar me sukses çdo situatë që mund të na krijohet dhe çdo vështirësi që mund të na dalë përpara. Byroja Politike ka bindje të patundur se, duke filluar nga shokët e Plenumit, gjithë Partia, mbarë punonjësit e vendit, do të ngrihen më këmbë, si një trup i vetëm dhe, me një organizim e disiplinë të lartë, me frymë revolucionare dhe me mobilizim të gjithanshëm, me besnikëri ndaj rrugës që na udhëheq Partia e shoku Enver, do të vënë të gjitha forcat mendore e fizike për të plotësuar çdo zë e çdo tregues të planit.

*Botohet për herë të parë me
disa shkurtime sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DHËNIEN LLOGARI PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PLANIT TË VITIT 1977 DHE MBI DETYRAT E PLANIT TË VITIT 1978»

31 janar 1978

Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 30 e 31 janar 1978, pasi shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi dhënieën llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978», mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Prokop Murra,

V e n d o s i :

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978.

2. — Porosit organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë që të marrin të gjitha masat e duhura për të zbrërthyer dhe për të realizuar me sukses detyrat e planit për vitin 1978.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

KONKLUZIONE

TË BYROSE POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI DISA PROBLEME TË EMANCIPIIMIT TË PLOTË TË GRUAS»

25 shkurt 1978

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 25 shkurt 1978, shqyrtoi raportin e Kryesisë së BGSH «Mbi veprimtarinë e BGSH midis dy kongreseve dhe detyrat për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë», si dhe tezat për Kongresin e 8-të të BGSH.

U konstatua se emancipimi i gruas ka ecur përpara. Krahas zhvillimit të gjithanshëm të shoqërisë socialiste në vendin tonë, është rritur pjesëmarrja e gruas në jetën politike e shoqërore, është rritur edhe niveli ideopolitik e tekniko-profesional i saj. Gratë përbëjnë sot 46 për qind të forcave të punës në fshat e në qytet dhe zënë vende drejtuese në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës. Mjaft koncepte të vjetra, patriarkale e feudale janë tronditur e janë shembur. Norma e zakone të reja po hyjnë përditë e më tepër në punë, në marrëdhëniet midis burrit e gruas, në familje etj. Në sukseset e arritura, Byroja Politike vlerëson punën e mirë të BGSH, e cila është një organizatë aktive e luftarake.

Me gjithë përparimet e mëdha, që janë bërë në çështjen e emancipimit të gruas, Byroja Politike theksoi se vihet re njëfarë vetëkënaqësie, ndërsa duhet akoma shumë punë për të realizuar direktivat e Partisë dhe vendimet e Kongresit të 7-të të saj, lidhur me emancipimin e plotë të gruas në vendin tonë.

1. — Partia ka theksuar vazhdimisht se emancipimi i gruas dhe i shoqërisë janë në raport të drejtë me njëri-tjetrin. Sa më e emancipuar të jetë shoqëria aq më e emancipuar do të

jetë edhe gruaja. Niveli i emancipimit të gruas shpreh dhe nivelin e shkallën e zhvillimit të shoqërisë.

Konceptet e ngushta mbi këtë problem nuk janë kapërcyer ende plotësisht. Në këtë drejtim ndikon edhe puna e pamjaftueshme e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe ekonomike, të cilat jo gjithnjë e lidhin zbatimin e detyrave të ndryshme, që shtrun Partia në punën e gruas, me aktivizimin e saj.

Emancipimi i gruas nuk është qëllim në vetvete as problem vetëm i BGSH, por është detyrë e gjithë Partisë, e gjithë shoqërisë. Në emancipimin e gruas secili të shikojë veten, por edhe gratë të kuptojnë më mirë se sa më shumë të luftojnë për zhvillimin e për përparimin e gjithanshëm të shoqërisë, aq më shpejt arrihet emancipimi i tyre i plotë. Pa një punë të përbashkët të organeve shtetërore dhe ekonomike, si dhe të të gjitha organizatave të masave, nën udhëheqjen e organizatave të Partisë, nuk mund të zgjidhen si duhet e plotësisht problemet e emancipimit të gruas.

2. — I duhet kushtuar më shumë vëmendje, nga Partia dhe nga Bashkimi i Grave, punës për ngritjen e ndërgjegjes politike e të nivelit ideologjik të grave. Sa më i lartë të jetë ky nivel, aq më mirë gruaja do të kuptojë misionin e saj në shoqërinë socialiste dhe do të bëjë që këtë ta kuptojnë dhe burrat. Kjo është një punë reciproke. Një burrë i ngritur politikisht dhe ideologjikisht është një faktor me rëndësi në edukimin e gruas me pikëpamje të drejta politike, me qëndrime të drejta shoqërore ndaj saj, për të krijuar barazinë e vërtetë midis tyre me frymë të shëndoshë proletare. Prapa nivelit relativisht të ulët të gruas, duhet parë se janë edhe burrat në këtë gjendje, ashtu siç duhet parë që, prapa pozitës superiore që mbajnë burrat nga «prepotenca» e tyre, fshihet një mungesë e theksuar e pikëpamjeve të drejta politike për problemet e shoqërisë dhe të zgjidhjes së tyre.

3. — Rritja e ndërgjegjes politike të grave duhet parë e lidhur ngushtë me situatat që kalojmë, me nevojën e forcimit të pareshtur të unitetit të popullit, të rritjes së aktivitetit dhe të pjesëmarrjes së gruas në qeverisjen e vendit, në ndërtimin socialist dhe mbrojtjen e atdheut. Prandaj duhet të përmirësohet puna për sqarimin politik dhe për edukimin e grave, duke mbajtur parasysh jo vetëm që ato përbëjnë tashmë gati gjysmën e punonjësve, ndërtues aktivë të shoqërisë socialiste, por dhe rolin e madh që luan gruaja në familje, ndikimi që ushtron ajo si nënë të fëmijët dhe si shoqe jete të burrat.

4. — Me ngritjen e ndërgjegjes politike lidhet dhe ngritja e nivelit arsimor e tekniko-profesional të grave. Këtu disniveli me burrat mbetet akoma i madh. Afirmimi i vlerave të

mëdha të gruas, që me aq kujdes i zgjoi e i kultivoi Partia, kërkon që të ngrihet dhe niveli arsimor e tekniko-profesional, në mënyrë që të arrihet, edhe në këtë fushë, barazia e saj me burrin. Organizatat e Partisë, si dhe bashkimet profesionale e Bashkimi i Grave të Shqipërisë duhet të bëjnë më tepër kujdes e ta marrin më mirë në dorë çështjen e arsimimit dhe të kualifikimit tekniko-profesional të gruas. Kjo detyrë bëhet më evidente tani, kur Partia ka shtruar me forcë nevojën e zhvillimit dhe të thellimit të mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, i cili, si çdo revolucion tjetër, nuk mund të kryhet me sukses pa pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive të gruas.

5. — Emancipimin e plotë të gruas e pengojnë akoma mjaft konceptet e qëndrimet e huaja, me karakter liberal e konservator, e pengojnë zakonet e vjetra prapanike e besimet fetare, që shfaqen, herë pas here, në punë, në jetë dhe në familje. Kundër këtyre duhet të zhvillohet një luftë e vazhdueshme e frontale nga organizatat e Partisë dhe nga të gjitha organizatat e masave. Dhe kjo luftë mund të bëhet me sukses kur kuptohet e vlerësohet rrezikshmëria e koncepteve dhe e qëndrimeve të huaja, kur vihen ato nën zjarrin dhe nën goditjet e tërë opinionit shoqëror. Vëmendje shumë më e madhe duhet treguar për gruan në fshat, ku mbeturinat e zakoneve të vjetra, konceptet e qëndrimet konservatore e patriarkale janë ende më të forta. Transformimet e thella, që janë bërë dhe zhvillimi i gjithanshëm, që ka marrë fshati, kanë krijuar mundësi më të mëdha për një ngritje të re edhe të emancipimit të gruas.

a) Ngritja e gruas në përgjegjësi është një tregues me rëndësi i emancipimit të saj dhe të shoqërisë. Por fakti që vetëm 18 për qind e brigadierëve në kooperativat bujqësore janë gra, flet për mungesë besimi në aftësitë e gruas. Zigzagët, që vihen re në këtë çështje, tregojnë se ka nevojë për të konsoliduar më mirë konceptet e drejta, revolucionare të Partisë për gruan dhe aftësitë e saj, që ajo di jo vetëm të punojë, por dhe të drejtojë. Kjo kërkon që të bëhet një punë më e madhe, nga e gjithë shoqëria dhe nga vetë gratë, për të luftuar më mirë konceptet dhe praktikatat frenuese, që pengojnë ecjen e tyre përpara.

b) Organizatave të Partisë dhe levave të saj duhet t'u tërheqë vëmendjen më seriozisht çështja e ngarkesës së gruas, si një problem i madh shoqëror, por edhe fiziologjik. Shteti ka nxjerrë dhe ligj të posaçëm që e ndalon zakonet poshtëruar të ngarkesës së gruas, por ka akoma disa raste, sidomos në zonat malore, që gratë ngarkohen jo vetëm për punët familjare, por dhe për ato të kooperativës. Kjo nuk është aspak e lejueshme. Për këtë qëllim duhet të shfrytëzohen mirë mjetet e transportit e kafshët e punës të kooperativës, si dhe kafshët e kooperativistëve, kundërshtimisht me ditë-punë. Dhe kjo detyrë

duhet planifikuar e duhet vënë në baza të organizuara e të kontrolluara, materiale e teknike, në çdo kooperativë bujqësore.

c) Ndarja e punës midis burrit dhe gruas, jo vetëm në jetën familjare, por dhe në ndërmarrjet e, sidomos, në kooperativa bujqësore, është një çështje tjetër, që duhet të zgjidhet sa më mirë. Duhet të luftohet kundër prirjeve dhe tendencave për t'u lënë burrave punët më të lehta. Detyra të tilla, si: magazinierë, karrocierë, qerrexhinj etj. nuk janë vetëm për burrat. Këto dhe punë të tjera mund t'i bëjnë fare mirë dhe gratë, ashtu siç mund ta bëjnë fare mirë edhe detyrën e rojave, duke përfshirë dhe ato të materialeve e të objekteve ushtarake në turnet e ditës.

Me ndarjen më të drejtë të punëve midis burrit e gruas, duhet parë dhe problemi i zënies në punë të të gjitha forcave të afta. Zhvillimi i forcave prodhuese në vendin tonë krijon e do të krijojë gjithnjë fronte të reja pune. Ndërsa, aktualisht, mjaft vepra të mëdha e degë të industrisë kanë nevojë të ngutshme për krahë pune, në disa rrethe, sidomos në qytete, ka akoma forca të pazëna në punë, në pjesën më të madhe janë të reja dhe gra. Zgjidhja graduale e këtij problemi kërkon masa të gjithanshme edukative, organizative e administrative nga gjithë Partia, nga organizatat e masave dhe nga organet e shtetit, kërkon punë këmbëngulëse e ndjekje të vazhdueshme.

ç) Thellimi i frymës demokratike në familje, revolucionarizimi i saj i vazhdueshëm, përbëjnë një drejtim shumë të rëndësishëm të luftës për emancipimin e gruas dhe të gjithë shoqërisë. Problemet e familjes janë të shumta, që nga marrëdhëniet midis burrit e gruas, si dhe midis pjesëtarëve të tjerë të familjes e deri te mënyra e jetesës. Në radhë të parë, u duhet kushtuar kujdes i veçantë lidhjeve martesore, sepse, me gjithë përparimet e mëdha, akoma nuk është arritur që ato të realizohen kudo e kurdoherë sipas koncepteve ideologjike e morale marksiste-leniniste të Partisë sonë. Organizatave të Partisë dhe atyre të masave duhet t'u tërheqë vëmendjen seriozisht fakti që, në mjaft zona e fshatra të rretheve Elbasan, Librazhd, Gramsh, Mat, Kukës, Dibër etj., ka raste që lidhjet martesore bëhen me këmbim. Këto lidhje martesore, si dhe martesat e nxituara janë shkaku kryesor i divorceve dhe i shumë pasojave të tjera të këqija.

6. — Partia dhe shteti kanë bërë shumë për të lehtësuar punën e gruas, por, siç theksoi Kongresi i 7-të i Partisë, është e nevojshme të krijohen kushte materiale edhe më të mira për të lehtësuar më tepër gruan nga punët drobitëse shtëpiake, në mënyrë që të ngrihen në një shkallë më të lartë efektiviteti i punës së saj në frontin e prodhimit dhe veprimtaria e gruas në jetën politike, shoqërore e kulturore. Është detyrë e Partisë, e

organeve shtetërore dhe e atyre ekonomike që të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ka dhe që krijohen në çdo degë dhe sektor për të lehtësuar punën e gruas. Ky është një problem i gjerë, që nis nga ndarja më e mirë e punëve në familje e deri te shërbimi tregtar, shëndetësor, komunal etj. Ndërkohë, është detyrë e organizatës së gruas dhe e organizatave të tjera shoqërore që të punojnë më mirë për shfrytëzimin me kapacitet të plotë të mjeteve e të institucioneve socialkulturore, që janë ngritur për këtë qëllim, si: çerdhe, kopshte, mensa, lavatarë etj.

* * *

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë shpreh bindjen se përgatitjet për Kongresin e 8-të të BGSH, të kësaj ngjarjeje me rëndësi të madhe për mbarë vendin, do të shërbejnë për një aktivitet të gjerë e të gjithanshëm edukativ me masat e grave e të të gjithë punonjësve për emancipimin e mëtejshëm të gruas, do të ngrenë akoma më lart frymën mobilizuese, revolucionare të masave për të shkuar në këtë Kongres me detyra të realizuara, me një unitet të çeliktë e luftarak rreth Partisë, me ballin lart e me duart plot.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KONKLUSIONE

TË SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH «MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË BASHKËPUNIMIT TË ORGANIZATAVE TË MASAVE PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE TË KONGRESIT TË 7-TË TË PPSH»

27 shkurt 1978

Në mbledhjen e datës 27 shkurt 1978 Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH shqyrtoi raportin e paraqitur nga organet qendrore të organizatave të masave «Mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të organizatave të masave për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të PPSH».

Në këtë mbledhje u konstatua se orientimet e Partisë, këshillat dhe porositë e vazhdueshme të shokut Enver Hoxha, për domosdoshmërinë e bashkëpunimit midis organizatave të masave, kanë krijuar një kuptim më të drejtë në organet dhe në organizatat e Partisë dhe në ato të masave për këtë çështje. Nën udhëheqjen e Partisë, organizatat e masave po i bashkërendojnë gjithnjë e më mirë e në mënyrë të organizuar forcat e tyre në zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që shtrihen Partia. Ato janë ndihmëse efektive dhe luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e në mobilizimin e masave të gjera të punonjësve, për forcimin e vazhdueshëm të lidhjeve të Partisë me klasën punëtore, me rininë, me gratë, me tërë punonjësit e qytetit dhe të fshatit.

Duke vlerësuar punën e mirë që kanë bërë dhe bëjnë organizatat e masave dhe organet e tyre drejtuese në rrethe e në qendër, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë porosit që të forcohet e të thellohet më tej bashkëpunimi midis organizatave të masave, me qëllim që ky bashkëpunim të jetë më efektiv e të japë rezultate më të mira në zgjidhjen e problemeve të mëdha politike e ideologjike, ekonomike e ushtarake, arsimore, kulturore e shoqërore të Partisë.

1. — Direktiva e Partisë është universale për të gjithë. Ajo është një orientim dhe udhëheqje për veprim. Asnjëri nuk mund të thotë se kjo apo ajo direktivë e Partisë, qoftë për ekonominë, për mbrojtjen apo për edukimin ideopolitik, arsimor e tekniko-profesional të masave, nuk i përket, ashtu siç nuk mund të thuhet se forcimi i unitetit është vetëm çështje e Frontit Demokratik, emulacioni socialist vetëm çështje e Bashkimeve Profesionale, se me edukimin e brezit të ri merret vetëm Bashkimi i Rinisë dhe me emancipimin e gruas vetëm BGSH etj., etj. Nuk ka direktivë ose vendim të Partisë që të realizohet pa pjesëmarrjen aktive të të gjitha organizatave politike, të udhëhequra nga Partia, që të mos kërkojë kombinimin e drejtë të masave edukative me ato organizuese, drejtuese, materiale e teknike.

Organizatave të masave kanë për detyrë të përmirësojnë punën e tyre për sqarimin e direktivave të Partisë në masa, që t'i bëjnë ato sa më të ndërgjegjshme, që të tërë të mendojnë e të organizojnë, të zbatojnë e të kontrollojnë. Specifikat e organizatave të masave nuk duhet të mbivlerësohen, ato ekzistojnë dhe inkuadrohen në problemet dhe në luftën që udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit e për mbrojtjen e atdheut. Jashtë këtyre nuk ka dhe s'mund të ketë specifika. Organizatat e masave, në çdo direktivë të Partisë, gjejnë detyrat e tyre të veçanta e të përbashkëta.

2. — Bashkëpunimi midis organizatave të masave duhet të realizohet më mirë në të gjitha instancat, por sidomos në bazë, atje ku janë masat punonjëse, ku punohet e luftohet për zbatimin e direktivave dhe të orientimeve të Partisë. Në bazë janë organizatat e Partisë dhe komunistët, janë organizatat e masave dhe aktivi i tyre i gjerë, janë kuadrot e specialistët e shumtë. Në bazë gjejnë zgjidhje të gjitha problemet, realizohet plani i zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, bëhet edukimi i njeriut të ri, përgatitet populli ushtarakisht për mbrojtjen e atdheut etj. Nga kjo pikëpamje nuk është e drejtë ajo prirje që vihet re në disa drejtues të organizatave të masave për të kërkuar çdo gjë nga Partia dhe nga shteti. Për punën e organizatave të Partisë e të organeve të shtetit e të ekonomisë ka vend për mjaft kritika dhe këto duhen bërë vazhdimisht, por ka rëndësi që të kuptohet si duhet se zgjidhja e problemeve varet shumë nga shkalla e ndërgjegjes dhe e mobilizimit të masave. Dhe për këtë çështje roli e përgjegjësia e organizatave shoqërore, si leva të Partisë, janë tepër të mëdha.

Shumë të meta, që vihen re në punë, kanë lidhje me qëndrimet e me veprimet burokratike dhe të tilla nuk ka vetëm në organet e pushtetit e në ato ekonomike dhe jo vetëm në qendër, por

ka dhe në organizatat e masave, deri tek individë të veçantë, te komunistë e kuadro pa parti, që kanë mbeturina të huaja të theksuara. Partia e ka theksuar se burokratizmi duhet luftuar kudo ku shfaqet, me forcë e vazhdimisht, duke i vënë përballë veprimin revolucionar të klasës punëtore dhe të masave punonjëse. Kështu, në qoftë se udhëheqja e ndërmarrjes pengon me burokracinë e vet, detyra e organizatave të masave është që të ngrenë klasën punëtore, gratë e rininë për të kritikuar shfaqjet konkrete të burokratizmit në atë ndërmarrje e jo të kërkojnë që Partia e shteti ta bëjnë këtë luftë. Kur drejtori ose kryeinxhinieri ngurrojnë të shkojnë në ministri për të zgjidhur problemet që vështirësojnë realizimin e detyrave, masat, me kritikën e tyre, i detyrojnë të shkojnë dhe, po nuk shkuan, atëherë, i drejtohen Partisë, deri në Komitetin Qendror dhe i thonë se me këtë drejtor ose kryeinxhinier nuk mund të ecet më tej, se kjo ose ajo ministri nuk u përgjigjet detyrimeve që ka sipas ligjeve, normave dhe planeve.

Vështirësitë objektive e subjektive duhet të zgjidhen frontalisht, duke bashkërenduar më mirë veprimtarinë e organizatave të masave dhe duke mobilizuar tërë forcat e masave punonjëse. Kjo nuk mund të kryhet vetëm nga disa drejtues, prandaj del nevoja që, herë pas here, në një ndërmarrje, kooperativë, institucion ose lagje të mblidhet bashkërisht aktivi i zgjedhur në udhëheqje të organizatave të masave në bazë, për të parë se ç'po bëhet me zbatimin e detyrave të Partisë, me zotimet që janë marrë, ç'probleme dalin në punëtorët, në rini, në gratë, ç'vështirësi e pengesa hasen, ç'duhet bërë për t'i zgjidhur e për t'i kapërcyer ato etj. Kështu, në konsultim të përbashkët, caktohen detyrat e punohet për të sqaruar e për t'i mobilizuar masat. Po të veprohet kështu, atëherë nuk shtrohet çështja për të kërkuar që të ndërhyjë Partia ose shteti, por problemet do të zgjidhen në vend. Sigurisht, Partia duhet të informohet, asaj duhet t'i ngrihen probleme, jo sa për të shkarkuar përgjegjësinë, por që ajo të orientojë, të udhëheqë e të ndihmojë që detyrat të kryhen më së miri.

Organizatave të masave duhet t'u kthehen, herë pas here, tezave të Leninit për bashkimet profesionale, për rininë e për gruan, të thellohen më shumë në përvojën e madhe të Partisë sonë, si dhe në mësimet e shokut Enver për rolin dhe për detyrat e organizatave të masave. Ato duhet të përmirësojnë vazhdimisht punën edukative me masat, për t'i sqaruar e për t'i mobilizuar në plotësimin me sukses të detyrave të Partisë. Dhe kjo punë nuk bëhet një herë në muaj, kur zhvillohet forma e edukimit ose mbledhja e zakonshme, por çdo ditë e në mënyrë të shumëllojshme.

3. — Partia, si gjithnjë, do të udhëheqë e do të frymëzojë organizatat e masave, ajo do të mbështetet fort në levat e saj. Organizatat dhe komitetet e Partisë kanë për detyrë që të përmirësojnë më tej punën drejtuese në organizatat e masave, t'u japin atyre një ndihmë më të kualifikuar e të ushtrajnë kontroll të vazhdueshëm, duke luftuar kuptimet e ngushta që e reduktojnë udhëheqjen e Partisë në veprime korente, thjesht organizative e në probleme të dorës së dytë.

Krahas kësaj, është e nevojshme që edhe vetë organizatat e masave, organet e tyre drejtuese në qendër, në rreth e në bazë të tregojnë më shumë iniciativë e të jenë më shumë krijuese. Të mos pritët që çdo gjë të thuhet e të caktohet nga lart, nga organizatat e Partisë, sepse kështu frenohen iniciativa e vetëveprimi, ngurosen mendimi e veprimi i masave dhe i organizatave të tyre.

Në stilin dhe në metodën e punës drejtuese të organizatave të masave nuk duhen lejuar as puna me fushata e për bujë, as shfaqjet e rutinës. Puna matet kurdoherë vetëm me rezultatet që arrihen. Një vend me rëndësi duhet të zënë kuptimi e zbërthimi prej tyre i direktivës së Partisë, sqarimi i saj në masat e gjera të popullit, nëpërmjet një pune intensive politike, sqaruese e bindëse dhe nëpërmjet aksioneve revolucionare të për-bashkëta. Drejtuesit e organeve udhëheqëse të organizatave të masave, sidomos të organeve qendrore, duhet të lidhen ngushtë me bazën dhe të mbajnë kontakte të shpeshta me masat, të njohin sa më thellë gjendjen reale të punëve e të nxjerrin konkluzionet e nevojshme.

Në organizatat e masave nuk mund të kërkohet ajo disiplinë e ai rregull siç kërkohet në Parti. Kuptime të tilla duhen luftuar kudo që shfaqen, sepse, siç është theksuar vazhdimisht nga Partia, organizatat shoqërore nuk janë Parti, por organizata të gjera masash, leva që e lidhin Partinë me popullin. Ato e ndërtojnë punën në përshtatje me detyrat e me profesionin që ushtrojnë anëtarët e tyre, me problemet sociale që kanë, sipas seksit e moshës. Ato i edukojnë anëtarët e tyre me ideologjinë e Partisë e i mobilizojnë për plotësimin e orientimeve e të detyrave që u ngarkon ajo.

Komunistët bëjnë pjesë të gjithë në organizatat e masave. Shumë prej tyre janë të zgjedhur edhe në organet drejtuese. Po të punojnë më mirë këta, veprimtaria e organizatave të masave do të ngrihet më lart e rezultatet do të jenë më të mëdha. Për këtë çështje, Partia ka folur edhe herë të tjera, por jo të gjithë e kuptojnë dhe e kryejnë si duhet detyrën e tyre si aktivistë shoqërorë. Organizatat e Partisë duhet të kontrollojnë veprimtarinë e komunistëve në organizatat e masave.

* * *

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH ka besim se komitetet dhe organizatat e Partisë, organet dhe organizatat e masave në qendër, në rreth e në bazë, duke u thelluar gjithnjë e më shumë në vendimet e Kongresit të 7-të të Partisë, në mësimet e saj e të shokut Enver, do të forcojnë më tej bashkëpunimin midis organizatave të masave e udhëheqjen e tyre nga Partia, do të rritin akoma më shumë nivelin e punës politike, ideologjike e organizative, për edukimin e për mobilizimin e masave në luftë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KONKLUZIONE

TË SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH «MBI ZBATIMIN E DETYRAVE QË KA SHTRUAR KOMITETI QENDROR I PARTISË PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS NË SEKTORIN E FIZKULTURËS E TË SPORTEVE»

27 shkurt 1978

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 27 shkurt 1978, mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe nga Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH «Mbi zbatimin e detyrave që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë për përmirësimin e mëtejshëm të punës në sektorin e fizkulturës e të sporteve».

Si rezultat i punës së bërë nga organet dhe nga organizatat e Partisë, nga organizatat e masave dhe nga organet shoqërore e shtetërore të fizkulturës e të sporteve, në zbatim të orientimeve të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë, të mësimëve e të porosive të shokut Enver Hoxha, sidomos, në zbatim të vendimeve të Kongresit të 7-të të Partisë, janë arritur një tok rezultatesh në masivizimin e lëvizjes fizkulturore-sportive dhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së saj, është krijuar një kuptim më i drejtë te punonjësit, sidomos te të rinjtë, për nevojën e të ushtruarit me fizkulturë e sport. Rëndësi u është kushtuar aktiviteteve masive, që sigurojnë përgatitjen e përgjithshme fizike të punonjësve, si: ngjitjeve malore e marshimeve për njohjen e terrenit, zhvillimit të sporteve bazë, atletikës e gjimnastikës, zhvillimit të notit, të lojërave me top dhe të atyre popullore, problemeve të edukimit fizik në shkolla etj.

Niveli cilësor i sporteve ka ardhur duke u rritur. Në këta 4-5 vjetët e fundit janë thyer 521 herë rekordet kombëtare për të rriturit. Në disa sporte, si: në qitjen sportive. në ngritjen e

peshave, si dhe në lojërat me top, sidomos për femra, rezultatet janë rritur në mënyrë më të shpejtë. Vëmendje e veçantë u është kushtuar moshave të reja. Numri i ekipeve dhe i klaseve sportive, në krahasim me vitin 1972, është rritur rreth 6 herë. Ndërkohë, opinioni shoqëror është përpunuar më mirë për nevojën e ushtrimit në mënyrë masive të fizkulturës e të sportit.

Për të siguruar një zhvillim më të madh masiv e cilësor të fizkulturës e të sporteve, Partia ka krijuar kushtet për ngritjen e një baze të fuqishme materiale. Janë ndërtuar mjaft terrene dhe objekte sportive, nga shteti dhe nga vetë punonjësit, me forcat e veta.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë vuri në dukje disa nga arritjet e rëndësishme në drejtim të masivizimit e të ngritjes së cilësisë sportive. Por, duke u thelluar më tej në përmbytjen dhe në rëndësinë politike, ideologjike e shoqërore të fizkulturës dhe të sporteve, duke u mbështetur në mundësitë e krijuara nga Partia dhe në kushtet e mira natyrore që ka vendi ynë, tërheqin vëmendjen disa probleme, që kanë të bëjnë me organizimin e me drejtimin më të mirë të punës në këtë fushë. Kritikat dhe vërejtjet e bëra për këtë sektor nuk duhen konsideruar plotësisht të kapërcyera. Ende ka moskuptime e koncepte jo të drejta për dobinë e fizkulturës e të sportit.

Me qëllim që detyrat e shtruar nga Partia për fizkulturën e për sportin të vihen gjithnjë e më mirë në jetë, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë

Porosit:

1. — Organizatat e Partisë dhe levat e tyre të forcojnë punën edukative për të formuar një kuptim më të plotë ideopolitik, për t'ua bërë të qartë të gjithë punonjësve, e veçanërisht rinisë, nevojën e marrjes me fizkulturë e sport. Këtë problem ta lidhin më mirë me masat për ruajtjen e për forcimin e shëndetit, për rritjen e gatishmërisë luftarake, për uljen e paaftësisë në punë, për edukimin dhe për kalitjen e vazhdueshme të punonjësve. Të goditen më fort konceptet nënvleftësuese dhe kuptimet e ngushta, që e reduktojnë fizkulturën dhe sportin vetëm në një mjet argëtimi. Të rrënjoset te të gjithë bindja se fizkultura dhe sporti ndihmojnë jo vetëm për kalitjen fizike, por edhe për forcimin e rregullit, të disiplinës dhe të vullnetit të njerëzve.

Mjetet e propagandës t'i kushtojnë kujdes më të madh propagandimit të fizkulturës e të sporteve, veçanërisht, televizioni të trajtojë më shumë e më mirë probleme të masivitetit.

Të pasqyrohen, sidomos, aktivitetet që zhvillohen me fëmijët e të rinjtë në shkolla, në ekipe dhe në klasat sportive, në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore. Krahas futbollit, një vëmendje më të madhe kërkojnë popullarizimi e zhvillimi i sporteve të tjera.

2. — Organet shoqërore dhe shtetërore të fizkulturës ta kenë të qartë se detyra e tyre kryesore nuk është të përgatitin disa ekipe dhe sportistë, apo të organizojnë disa gara e kampionate, por, në radhë të parë, të sigurojnë shtrirjen e lëvizjes fizkulturore-sportive kudo dhe të përfshijnë në të sa më shumë punonjës e të rinj nga qyteti e nga fshati. Rëndësi t'i kushtohet zhvillimit të aktiviteve fizkulturore-sportive, që sigurojnë pjesëmarrje të vazhdueshme dhe masive, në përshtatje me kushtet e terrenit dhe me mundësitë fizike, sipas seksit, moshës etj. Të luftohet për një shumëllojshmëri aktivitete, sidomos në kooperativat bujqësore e në qendrat e prodhimit. Në këto të fundit, t'i kushtohet rëndësi gjimnastikës së përditshme, por sidomos gjimnastikës së prodhimit, si një masë preventive për ruajtjen e një gjendjeje të mirë fizike e shëndetësore dhe për rifitim e energjive në punë.

Kolektivat fizkulturore, në qytet dhe në fshat, të tregojnë kujdes më të madh për të zhvilluar më shpesh marshime, krose në distanca të ndryshme, kalimin e brezit të kalitjes fiziko-ushtarake, gara gjimnastike me ushtrime të thjeshta etj. Të nxiten lojërät popullore me karakter kalitës dhe lojërät me dorë, veçanërisht volejboli e basketboli, mundësitë për ushtrimin e të cilave, nga kushdo e kudo, janë më të mëdha, duke tërhequr sa më shumë vajzat.

3. — Një punë më e thelluar duhet të bëhet për edukimin fizik në shkollë dhe, sidomos, për atletikën e për gjimnastikën. Problemi i edukimit fizik në shkollë të mos lidhet vetëm me arritjen e disa normave, por, në radhë të parë, me formimin të nxënësit të pasionit për të ushtruar fizkulturën e sportet gjatë gjithë jetës dhe, mbi këtë bazë, të bëhet vlerësimi i tyre.

Që të kuptohet më mirë dobia e fizkulturës dhe e sportit, në veçanti, mjekët, gjithë punonjësit e shëndetësisë, mësuesit, veçanërisht ata të fizkulturës, të zhvillojnë një punë të gjerë me masat, të shpjegojnë me argumente se fizkultura e sporti parandalojnë sëmundjet e rritin aftësinë për punë. Veçanërisht, kjo të bëhet me nxënësit, duke i pajisur ata me njohuritë e nevojshme mbi rregullat e ruajtjes së shëndetit nga sëmundjet, të kuptojnë dëmet e duhanit dhe të alkoolit, nevojën e pastërtisë, mënyrat e veshjes së përshtatshme, rregullat e kalitjes me elementatë të natyrës edhe nëpërmjet sporteve etj.

4. — Organizatat e Partisë të kenë një kuptim më të drejtë për fizkulturën dhe për sportin, duke i vlerësuar ato si mjete të

rëndësishme për edukimin komunist të punonjësve, për kalitjen fizike të popullatës dhe për përgatitjen për punë e për mbrojtje. Të vihen më mirë në lëvizje organizatat e masave dhe organet e pushtetit për t'u marrë më shumë me aktivitetet sportive, duke rritur bashkëpunimin me organizatat shoqërore të fizkulturës.

Organizatat e rinisë në fshat e në qytet të jenë shpirti i aktiviteve fizkulturore-sportive. Traditat e mira të popullit tonë, që në raste festash organizonte lodra të ndryshme kalitëse, të ruhen e të zhvillohen, duke u dhënë një përmbajtje të re.

Të thellohen iniciativat e organizatave të rinisë për masivizimin e fizkulturës e të sporteve, për ngritjen e terreneve sportive etj. Të shfrytëzohen sheshet e përshtatshme midis banesave nëpër lagje për të ngritur kënde të thjeshta sportive në qytet e në fshat.

5. — Krahas masivitetit, një kujdes më i madh t'i kushtohet cilësisë sportive. Megjithëse në këtë drejtim ka rritje, ritmet e saj duhet të jenë më të shpejta, në përputhje me mundësitë e krijuara. Komiteti i Këshillit të Përgjithshëm të BFSSH dhe federatat përkatëse, të përmirësojnë metodën e stilit në punë, të ndjekin më mirë zbatimin e vendimeve dhe të orientimeve të Komitetit Qendror të PPSH për masivitetin dhe për cilësinë sportive dhe të kontrollojnë më me rigorozitet zbatimin e vendimeve të Qeverisë për stërvitjen e ekipeve.

Për të rritur cilësinë sportive dhe masivitetin, vëmendje t'u kushtohet përgatitjes dhe ngritjes së nivelit të kuadrit trajner e mësues, që ai t'u përgjigjet më mirë kërkesave për zhvillimin e stërvitjes dhe të mësimit mbi baza shkencore. Instituti i kulturës fizike «Vojo Kushi» të bëjë një punë më të kualifikuar mësimore e shkencore për të rritur nivelin e përgatitjes teorike e praktike të kuadrit mësues e trajner. Vëmendje më të madhe kërkojnë forcimi i punës shkencore dhe, sidomos, përhapja e përgjithësimi i përvojës së përparuar, si për rritjen e cilësisë sportive, ashtu dhe për masivitetin.

6. — Problemet e zhvillimit të mëtejshëm të fizkulturës e të sportit, të masivitetit e të ngritjes së cilësisë së tyre duhen parë e duhen trajtuar kurdoherë në kuadrin e zhvillimit të luftës së klasave. Për këtë qëllim, organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe organet shoqërore e shtetërore të fizkulturës duhet të thellohen më shumë në mësimet e Partisë e të shokut Enver për këto probleme, të rritin nivelin e punës ideopolitike, të edukimit e të kalitjes me qëndrimin revolucionar e korrekt të sportistëve, të kuadrove e të punonjësve, që merren me fizkulturë e sport, në luftë të papajtueshme me fenomenet e me shfaqjet antisportive, si dhe me tifozllëkun e sëmurë. Të kuptohet domosdoshmëria e luftës kundër tyre si shfaqje me karakter

ter të theksuar politik e klasor, me pasoja të rrezikshme, që çojnë në cenimin e unitetit të popullit. Gjithashtu, të luftohen shfaqjet e kampionatizmit, të cilat nxitin tifozllëkun, zbehin vlerat edukuese të aktiviteteve sportive dhe ulin cilësinë e tyre. Me sportistët e sportdashësit të bëhet një punë edukative e vazhdueshme, të luftohet për pastërtinë e figurës moralo-politike të sportistëve, të trajnerëve e të gjyqtarëve.

Sekretariati i KQ të PPSH shpreh besimin se organizatat e Partisë dhe levat e saj do të vënë të gjitha forcat për t'i zhvilluar e për t'i çuar më përpara fizkulturën e sportin, për të ngritur në një shkallë më të lartë masivitetin dhe cilësinë e tyre, në përputhje me kushtet e me rrethanat në të cilat ndërtojmë socializmin në vendin tonë dhe mbrojmë fitoret e mëdha të revolucionit.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

VENDIM

I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI MASAT PËR PLOTËSIMIN DHE TEJKALIMIN E DETYRAVE TË PLANIT PËR PRODHIMIN DHE PËR GRUMBULLIMIN E PAMBUKUT»

4 mars 1978

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë vëren se, me gjithë punën e bërë për kultivimin e pambukut, detyrat e planit nuk janë plotësuar. Një gjendje e tillë e prapambetur e ka bazën në mungesën e vlerësimit të duhur nga Ministria e Bujqësisë, nga organet e Partisë e të pushtetit në rrethe dhe nga ekonomitë bujqësore. Nuk ka asnjë arsye objektive që të justifikojë mosrealizimin e planit. Kushtet klimaterike e tokësore të vendit tonë, baza materialo-teknike ekzistuese, si dhe rajonizimi i kësaj bime lejojnë jo vetëm plotësimin, por edhe tejkalimin e detyrave të planifikuara. Këtë e vërteton përvoja e mjaft brigadave, sektorëve dhe ekonomive të dalluara, si: ajo e Kooperativës Bujqësore të Çermës në Lushnjë, e Poshnjës dhe e Lapardhasë në Berat, e Cakranit në Fier, që marrin çdo vit nga 12-15 kv për ha në të gjithë sipërfaqen, ndërsa disa brigada kanë kaluar kufirin e 20 kv për ha.

Nevojat për tekstile të pambukta rriten vazhdimisht. Në kushtet e rrethimit të egër imperialisto-revizionist ndaj vendit tonë dhe të krizës ekonomike e financiare të botës kapitalisto-revizioniste, plotësimi i planit të prodhimit të pambukut, në bazë të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, merr një rëndësi edhe më të madhe politike, ekonomike e strategjike.

Duke u mbështetur në rezultatet e larta, të arritura nga ekonomitë e përparuara, Komiteti Qendror i Partisë e sheh të domosdoshme e të mundshme që t'i përvishemi punës me të

gjitha forcat e mjetet dhe të marrim të gjitha masat për të plotësuar sa më parë nevojat e brendshme të ekonomisë në pambuk, me prodhimin e tij tërësisht në vend.

Që të plotësohen e të tejkalohen në çdo vit të pesëvjeçarit detyrat për shtimin e prodhimit të pambukut, Komiteti Qendror i PPSH,

Vendosi:

1. — Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse, organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore e ekonomike dhe kultivuesit e pambukut të marrin të gjitha masat e nevojshme ideopolitike, organizative, ekonomike e teknike që, gjatë vitit 1978, të bëhet medoemos kthesë rrënjësore në prodhimin e pambukut, për plotësimin dhe për tejkalimin e planit. Në vitin 1980 të merren mbi 15 kv pambuk për hektar.

2. — Për të siguruar plotësimin e detyrave të planit të prodhimit të pambukut, organet e bujqësisë dhe organet e tjera shtetërore e ekonomike, çdo vit, para fillimit të punimeve të vjeshtës, të caktojnë tokat që do të mbillen me pambuk, të cilat të jenë kurdoherë nën ujë dhe të përshtatshme për këtë bimë. Pambuku të mos mbillet më tepër se tre vjet me radhë në të njëjtën ngastër. Në tokat e caktuara për t'u mbjellë me pambuk, pas lirit nga bimët paraardhëse, të bëhen menjëherë drenimi dhe thellimi i vijave kulluese, për të siguruar kurdoherë një kullim të plotë të ngastrës. Drenimi i përhershëm të bëhet me përparësi në tokat që do të mbillen me pambuk.

Çdo vit të bëhet punimi qilizmë në jo më pak se 40-50 për qind të sipërfaqes së caktuar për këtë bimë. Tokat e pambukut të plehërohen me pleh organik një herë në dy-tre vjet, me jo më pak se 200 kv për ha. Në vitin 1978, për çdo hektar pambuk të mbjellë, të përdoren 2-3 kv superfosfat dhe 2 kv plehra azotike për hektar. Duke filluar nga viti 1979 e më tej, të përdoren sasi më të mëdha plehrash kimike, duke shtuar në përbërjen e tyre edhe ato potasike.

3. — Në përpjekjet për sigurimin e prodhimit të pambukut, puna me farën përbën një nga hallkat kryesore. Për këtë në strukturën varietore të futen e të përhapen gjerësisht llojet me pjekje të hershme. Instituti i Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë të punojë për përmirësimin teknologjik të fillit të pambukut, duke synuar që, në vitet e para të pesëvjeçarit të ardhshëm, të mbillet pambuk me lloje me gjatësi filli mbi 30 mm. Deri në vitin 1980, të arrihet që gjithë sipërfaqja e caktuar për pambukun të mbillet me farë të riprodhimit, deri

në të tretin. Ekonomitë e prodhimit të farës së pambukut të parashikojnë masa konkrete e të tregojnë kujdes të veçantë për ngastrat e caktuara për farë.

Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, brenda vitit 1980, të sigurojë depot e nevojshme për grumbullimin dhe për zhveshjen e pambukut për prodhim fare, sipas llojeve, cilësive dhe riprodhimeve.

Dikasteret përkatëse, në bashkëpunim me Komisionin e Planit të Shtetit, të studiojnë dhe të marrin masa për ngritjen e impianteve për heqjen e pushit dhe për kalibrimin e farës, në mënyrë që, në fund të këtij pesëvjeçari, të fillojë, gradualisht, mbjellja e farërave të tilla të pambukut.

4. — Procesi i mbirjes së shpejtë e herët, deri në përfundim të plotë, duke plotësuar në kohën e duhur çdo boshllëk për të siguruar numrin e plotë e të domosdoshëm të bimëve për hektar, të ndiqet e të kontrollohet hap pas hapi, duke e konsideruar si një ndër hallkat vendimtare për të marrë rendimente të larta në pambuk. Plotësimi i boshllëqeve të bëhet kryesisht me fidanë të rritur në kubikë ose me farë të mbirë.

5. — Ujitja e pambukut për mbirjen e tij të plotë e sa më herët dhe ujitja gjatë vegetacionit kërkojnë një kujdes të vazhdueshëm dhe të mbahet kurdoherë parasysh nga drejtuesit, specialistët e kultivuesit e pambukut.

Për të plotësuar sa më mirë këto detyra, qysh në pranverën e vitit 1978, rretheve që kultivojnë pambuk t'u jepen me prioritet impiantet për ujitje në formë shiu, të cilat të shfrytëzohen me aftësi të plotë e me tri ndërresa.

Për të vënë në lëvizje impiantet e ujitjes në formë shiu, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të studiojnë mundësitë dhe të përcaktojnë masat konkrete për këtë vit dhe për vitet e tjera të pesëvjeçarit për të prodhuar motorë, si dhe për të ndërtuar linjat, kabinat dhe pikat e nevojshme të komandimit.

6. — Për zbatimin me rigorozitet e me disiplinë shkencore të të gjitha proceseve të kultivimit të kësaj bime, vëmendje e veçantë t'u kushtohet rrallimit e prashitjeve, si dhe mbrojtjes së bimëve nga sëmundjet e nga dëmtuesit. Të luftohet me këmbëngulje që të ngushtohet medoemos afati i kryerjes së shërbimeve në fazat e para të zhvillimit të bimëve, për të arritur që prashitja e parë të fillojë menjëherë me daljen e bimëve dhe prashitja e dytë jo më vonë se 10-15 ditë pas së parës.

Ndjekja dhe kontrolli sistematik e rigoroz i kryerjes së shërbimeve, i punës e i cilësisë së saj, të ngrihen në një shka-

llë më të lartë, që nga skuadra, brigada e sektori, deri në kooperativë, në ndërmarrje e në rreth, si nga organet shtetërore, ashtu dhe nga organet e organizatat e Partisë.

7. — Të rritet më tej shkalla e mekanizimit për bimën e pambukut, sidomos për përgatitjen e tokave dhe për prashitjen e bimëve me anë të frezave shkruftuese, për shpërndarjen e pesticideve, për përdorimin e kultivatorëve prashitës të kombinuar me hedhjen e plehut kimik. Për këtë, gjatë vitit 1978, të studiohen nga dikasteret përkatëse dhe të caktohen detyra konkrete për prodhimin e tyre në vend.

8. — Ekonomitë bujqësore të marrin të gjitha masat për ta mbledhur shpejt, me cilësi të lartë e pa firo pambukun. Në të gjitha rrethet që kultivohet pambuku të bëhen studime të veçanta dhe, brenda gjashtëmujorit të parë të këtij viti, të përcaktohen masa konkrete për ndërtimin e lokaleve të tharjes së boçeve të pambukut për çdo vit të pesëvjeçarit të gjashtë.

Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore dhe organet e saj vartëse ta vlerësojnë drejt e objektivisht cilësinë e pambukut, ta marrin në dorëzim sa më shpejt atë dhe ta depozitojnë të ndarë sipas klasave, duke ndihmuar vazhdimisht kultivuesit deri në brigadë, sidomos në periudhën e vjeljes së prodhimit.

Ministria e Komunikacioneve të marrë të gjitha masat për transportimin e shpejtë, krahas vjeljes së prodhimit, nga qendrat e grumbullimit në uzinat e zhveshjes.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, si dhe me komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve përkatëse të organizojnë sa më mirë punën prodhuese të nxënësve të shkollave e të nëpunësve, duke pasur si synim që ajo të kryhet, sidomos, në ato periudha kur pambuku kërkon punimet më intensive.

9. — Domosdoshmëria e plotësimit të detyrave të planit të prodhimit të pambukut, për të siguruar gjithmonë e më mirë nevojat e industrisë tekstile me lëndën e parë, të kuptohet e të vlerësohet nga të gjithë si një zbatim konkret i parimit revolucionar të mbështetjes në forcat tona, sidomos në situatat aktuale. Puna idepolitike e Partisë të ngulitë thellë në mendjen dhe në ndërgjegjen e çdo punonjësi të bujqësisë bindjen e plotë e të qëndrueshme se ekzistojnë të gjitha kushtet e mundësitë reale jo vetëm për t'i plotësuar, por edhe për t'i tejkaluar detyrat e planit të prodhimit të pambukut.

Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve Lushnjë, Fier, Durrës, Berat, Vlorë e Sarandë një kujdes të veçantë t'u kushtojnë njohjes, propagandimit dhe përgjithësimin të përvojës së përparuar të Institutit të Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë dhe të ekonomive bujqësore, të sektorëve e të brigadave të përparuara. Koo-

perativa Bujqësore e Çermës në Lushnjë dhe Kooperativa Bujqësore e Poshnjës në Berat të bëhen flamur dhe shkolla të vërteta ku të mësojnë teorikisht e praktikisht të gjithë kultivuesit e pambukut. Organet qendrore e lokale, të shtypit, Radioja, Televizioni dhe Shtëpia e Propagandës Bujqësore t'i trajtojnë e t'i pasqyrojnë, në një shkallë sa më të gjerë, eksperiencën e përparuar dhe rezultatet e shkencës në prodhim.

10. — Organet dhe organizatat e Partisë, organizatat e Frontit, ato të bashkimeve profesionale, të rinisë e të gruas të zhvillojnë një punë të dendur idepolitike, të diferencuar dhe me objektiva konkrete, të përdorin gjerësisht format e ndryshme të emulacionit socialist, të organizojnë gara, konkurse, fotoekspozita, debate e ballafaqime, të nxitin e të organizojnë aksione masive, t'i ngrënë më këmbë gjithë kultivuesit e pambukut për t'i plotësuar dhe për t'i tejkaluar detyrat e planit të prodhimit e të grumbullimit të kësaj bime me vlerë shumë të madhe ekonomike dhe që ka të bëjë me veshjen dhe me mbathjen e popullit.

Çdo organizatë partie të zërthejë e të konkretizojë detyrat që dalin nga ky vendim, të përcaktojë qartë synimet dhe intensitetin e punës sqaruuese e bindëse, edukuese e propagandistike, të orientojë dhe të kontrollojë zbatimin e saktë të masave tekniko-organizative dhe të ndjekë, hap pas hapi, zbatimin e tyre. Në të njëjtën kohë, ato të rritin mobilizimin dhe frymën luftarake për të kapërcyer e për të mposhtur çdo vësh-tirësi, për t'i dalë përpara çdo të papriture dhe për ta bërë prodhimin e pambukut sipas planit, të pavarur nga kushtet atmosferike.

12. — Për të ndihmuar e për të ndjekur në vazhdimësi zbatimin e të gjitha masave idepolitike dhe tekniko-organizative, që nga faza përgatitore, deri në vjeljen e në grumbullimin e pambukut, është e nevojshme të përmirësohet metoda e punës, të forcohen drejtimi e kontrolli i organeve të bazës nga aparatit i Komitetit Qendror të Partisë dhe i Këshillit të Ministrave, nga Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Në seksionet e bujqësisë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të Lushnjës, të Fierit, të Beratit e të Durrësit, në Institutin e Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë dhe në të gjitha ekonomitë bujqësore, që mbjellin mbi 300 ha pambuk, të caktohet një agronom që të merret vetëm me kultivimin e pambukut.

13. — Me kontrollin e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë.

Komiteti Qendror i Partisë u bën thirrje komunistëve, kuadrove, specialistëve, gjithë kultivuesve të pambukut që të mobilizohen me të gjitha forcat mendore e fizike, me të gjitha mjetet që kanë për t'i plotësuar dhe për t'i tejkaluar detyrat e planit të prodhimit e të grumbullimit të pambukut. Komiteti Qendror shpreh, gjithashtu, bindjen se punimi dhe zbrërthimi i këtij vendimi do t'i japin një nxitje të gjithanshme punës ideopolitike dhe tekniko-organizative, për të vënë plotësisht në jetë direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë, për t'i plotësuar në bujqësi të gjitha detyrat në front të gjerë, duke i dhënë prioritet, si kurdoherë, prodhimit të drithërave të bukës.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 63 (9236), 15 mars 1978*

VENDIM

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE TË PLANIT PËR PRODHIMIN DHE PËR GRUMBULLIMIN E PANXHARSHEQERIT»

4 mars 1978

Komiteti Qendror i Partisë, duke analizuar rezultatet e arritura, vëren se, në pesëvjeçarin e kaluar, detyrat e planit të prodhimit të panxharsheqerit, në përgjithësi, u plotësuan. Por, gjatë vitit 1977, deficitet ishin shumë të ndjeshme. Kjo gjë bëri që, për furnizimin normal të popullit dhe të industrisë, shteti të importojë sheqer mbi sasinë e planifikuar.

Mosplotësimi i planit në prodhimin e panxharit, në vitin 1977, është rrjedhim i një pune të pamjaftueshme nga Ministria e Bujqësisë, nga komitetet dhe nga organizatat e Partisë, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, si dhe nga ekonomitë e kultivuesit e panxharsheqerit.

Me gjithë vështirësitë e krijuara vitin e kaluar nga tharësira, përsëri, mjaft brigada në rrethin e Korçës, si brigada e dytë dhe e tretë në Pojan, e katërta në Plasë dhe e treta në Bulgarec, arritën rezultate të mira dhe morën mbi 400 kv panxhar për hektar. Arritjet e larta në vitin 1976 nga Ndërmarrja Bujqësore Maliq, nga kooperativat e tipit të lartë Plasë e Pojan, të cilat, në të gjithë sipërfaqen, morën mbi 425 kv për ha, ose nga 47 brigada që morën mbi 450 kv për ha, tregojnë se janë të gjitha mundësitë reale për shtimin e mëtejshëm e të shpejtë të prodhimit të kësaj bime të rëndësishme industriale.

Në kushtet e bllokadës së egër ndaj vendit tonë dhe të krizës ekonomiko-financiare, që ka mbërthyer botën kapitalistorevizioniste, sigurimi i prodhimit të sheqerit në vend merr një rëndësi të veçantë.

Duke u nisur nga mundësitë që ekzistojnë dhe nga domos-

doshmëria e plotësimit të nevojave të vendit me sheqer, Komiteti Qendror i Partisë e sheh të mundshme që, qysh në vitin 1978 e në çdo vit të pesëvjeçarit të gjashtë, jo vetëm të plotësohen, por edhe të tejkalohen detyrat e planifikuara për prodhimin e panxharsheqerit dhe, në një të ardhme të afërt, të plotësohen tërësisht nevojat e popullit e të industrisë në sheqer me prodhimin në vend.

Që të arrihen sa më parë këta objektiva, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë,

Vendosi:

1. — Ministria e Bujqësisë, organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore e ekonomike dhe kultivuesit e panxharsheqerit të marrin të gjitha masat e nevojshme që plani i prodhimit të panxharsheqerit, duke filluar nga viti 1978 e në çdo vit të planit të pesëvjeçarit të gjashtë, të plotësohet e të tejkalohet. Në vitin 1980, në shkallë republike, të synohet që, në të gjithë sipërfaqen e mbjellë me panxhar, të merren mesatarisht 340-350 kv për hektar.

2. — Për të siguruar plotësimin e kësaj detyre, bima e panxharit të mbillet tërësisht në toka nën ujë dhe jo më pak se 60-70 për qind e sipërfaqes të punohet qilizmë. Të sigurohen nivelimi, drenimi dhe kullimi i plotë e i përsosur i të gjitha ngastrave.

Duke filluar nga viti 1978 e vazhdimisht, në tokat e panxharsheqerit të përdoren jo më pak se 200 kv për ha plehra organike në mbi 30 për qind të sipërfaqes, si dhe jo më pak se 3 kv për ha superfosfat, 1,5-2 kv për ha klorur potasi dhe 2,5-3 kv për ha plehra azotike.

3. — Të futen në prodhim të gjerë farëra të llojeve me kapacitet të lartë prodhues në tubera e në sheqer dhe të arrihet që, në vitin 1980, mbi 25 për qind e sipërfaqes të mbillet me lloje njëfarëshe. Instituti i Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë, me Bazën Eksperimentale të Panxharsheqerit në Korçë të punojnë për shumëzimin e farërave me prodhimtari të lartë.

Ministria e Bujqësisë, brenda vitit 1979, të marrë masa për të ndërtuar impiantin e copëzimit, të kalibrimit dhe të zhveshjes së farës së panxharsheqerit sipas nevojave.

4. — Puna për mbjelljen e hershme, për mbirjen e plotë të bimëve brenda muajit prill dhe për sigurimin e numrit të domosdoshëm të tyre për hektar të organizohet e të ndiqet si ndër problemet më të rëndësishme që përcakton dhe kushtëzon arritjen e rendimenteve të parashikuara. Të merren masa për luftimin e dëmtuesve të tokës, duke bërë dezinfektimin e

saj në varësi me shkallën e infeksionit dhe me gjendjen e bimëve.

5. — Kujdes i veçantë t'i kushtohet ujitjes dhe veçanërisht përmirësimit të teknikës së përdorimit të ujit. Duke filluar nga viti 1978, t'i jepet përparësi ujitjes së panxharit me impiante për ujitje në formë shiu, të cilat të shfrytëzohen me kapacitet të plotë e me tri ndërresa.

Për të vënë në lëvizje impiantet për ujitje në formë shiu, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë, ajo e Industrisë dhe e Minierave, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale të marrin masa për të prodhuar, gradualisht, në vend motorat dhe për të siguruar shtrirjen e rrjetit elektrik e të pajisjeve të tjera.

6. — Zbatimi me disiplinë të rreptë shkencore i të gjitha hallkave agroteknike, në tërësi e në varësi të njëra-tjetrës, të konsiderohet si faktor i rëndësishëm në luftën për arritjen e rendimentit të planifikuar. Rrallimi i bimëve të zbatohet me forca të përqendruara, me cilësi të lartë dhe jo më vonë se deri në çiftin e tretë të gjetheve. Të bëhen të gjitha përpjekjet për kryerjen e shërbimeve në çdo fazë të zhvillimit të bimëve, veçanërisht në fazat e para dhe t'u bëhen atyre jo më pak se tri prashitje e tri kultivime të plota.

Ndjekja dhe kontrolli sistematik e rigoroz i kryerjes së shërbimeve, i punës e i cilësisë së saj të ngrihen në një shkallë më të lartë, që nga skuadra, brigada e sektori, deri në kooperative, në ndërmarrje e në rreth, si nga organet shtetërore, ashtu dhe nga organet e organizatat e Partisë.

7. — Për t'i përballuar më mirë e në kohë shërbimet agroteknike, të merren masa për zgjerimin e mekanizimit kompleks të shërbimeve, që i bëhen bimës së panxharsheqerit dhe të bazës materiale e teknike të nevojshme, duke futur metoda të reja e racionale në mbjellje, në prashitje, në prishjen e kores, në shpërndarjen e plehut e të insekticideve dhe në shkëlqen e pastrimin e tuberave.

Për këtë Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Ministria e Bujqësisë, brenda gjashtëmuajorit të parë të këtij viti, të studiojnë shkallën e mekanizimit që duhet të arrihet në të ardhmen për bimën e panxharsheqerit, dhe të planifikojnë e të organizojnë prodhimin në vend të mekanizmave të nevojshëm.

Brenda sezonit të vitit 1979, të përfundojë zgjerimi i Kombinatit të Sheqerit, duke përfshirë edhe repartin e larjes së tuberave, si dhe linjën e manipulimit të baltës së filtër-presave, për ta përdorur atë si pleh për përmirësimin e tokave acide.

8. — Shkulja, grumbullimi, ruajtja, transportimi dhe industrializimi i panxharsheqerit të bëhen në kohë, me cilësi e pa

firo. Shkulja e panxharit të bëhet në pjekurinë teknike e të përfundojë, si rregull, brenda nëntorit. Periudha e shkulljes dhe e transportimit të vlerësohet drejt dhe të organizohet si një aksion i madh politik dhe ekonomik.

Ministria e Industrisë së Lehtë e Ushqimore të marrë me kohë masat për ndreqjen e për vënien në gatishmëri të qendrave të grumbullimit dhe, në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, të zgjerojnë aftësitë e tyre, në përputhje me shtimin e prodhimit, me qëllim që panxhari të konservohet në kushte sa më të mira teknike e për kohë të gjatë.

Ministria e Komunikacioneve të sigurojë në kohën e duhur transportimin e të gjithë prodhimit të vjelë.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe me komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve përkatëse, për vitin 1978 e vazhdimisht, të hartojnë plane të përbashkëta për organizimin e punës prodhuese të nxënësve e të studentëve, pa cenuar programet shkollorë, sidomos në kohën e shkulljes së panxharsheqerit. Gjatë periudhës së shkulljes të kësaj bime, në rrethet që e kultivojnë atë, të mos tërhiqen të rinj vullnetarë për në aksionet kombëtare, kurse Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit të ndihmohet me të rinj edhe nga rrethet e tjera.

9. — Komitetet e Partisë të rretheve Korçë, Pogradec, Elbasan, Librazhd e Kolonjë dhe organizatat-bazë të përmirësojnë organizimin dhe nivelin e punës ideopolitike për formimin e bindjeve të thella të çdo punonjësi, komunisti, drejtuesi e specialisti për domosdoshmërinë e realizimit të detyrave të planit dhe të mobilizojnë të gjitha forcat, mjetet e mundësitë e mëdha, që ekzistojnë aktualisht dhe që krijohen vazhdimisht në çdo brigadë, sektor, ekonomi e rreth, që kultivojnë panxharsheqerin, për të marrë rendimente gjithnjë e më të larta.

Vëmendje të posaçme organizatat e Partisë t'i kushtojnë aktivizimit të organizatave të Frontit, të bashkimeve profesionale, të rinisë dhe të gruas, që edhe ato të zhvillojnë një punë të dendur ideopolitike, të përdorin gjerësisht format e emulacionit socialist, garat, konkurset, fotoekspozitat, debatet e ballafaqimet, për të nxitur e për të inkurajuar sedrën e ambicien revolucionare, për të ngritur më këmbë të madh e të vogël që të plotësohen e të tejkalohen detyrat e planifikuara.

10. — Përvoja e përparuar e Ndërmarrjes Bujqësore të Maliqit dhe e kooperativave të tipit të lartë të Plasës e të Pojanit në rrethin e Korçës, për kultivimin e panxharsheqerit, të njihet, të studiohet, të propagandohet dhe të përhapet gjerësisht, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë

të rretheve, në të gjitha ekonomitë dhe brigadat që e kultivojnë këtë bimë.

Organet e shtypit, Radioja dhe Televizioni, si dhe Shtëpia e Propagandës Bujqësore të pasqyrojnë gjerësisht përvojën e përparuar, rezultatet e punës shkencore në prodhim dhe të vënë më mirë në dukje shembullin pozitiv, sidomos, rrugët që kanë ndjekur dhe punën konkrete që kanë bërë për të marrë rendimente të larta nga panxharsheqeri.

11. — Për të ndihmuar e për të ndjekur në vazhdimësi zbatimin e të gjitha masave ideopolitike dhe tekniko-organizative, që nga faza përgatitore, deri në vjeljen e grumbullimin e panxharsheqerit, të forcohet më shumë kontrolli në organet e bazës nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave, nga Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, nga komitetet e Partisë dhe nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Në seksionet e bujqësisë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve Korçë e Elbasan dhe në të gjitha ekonomitë bujqësore, që kultivojnë mbi 300 ha panxharsheqeri, të caktohet një agronom që të merret vetëm me kultivimin e kësaj bime.

12. — Me kontrollin e zbatimit të këtij vendimi, ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë.

* * *

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se komunistët, kuadrot, specialistët dhe kultivuesit e panxharsheqerit do të vënë të gjitha forcat mendore e fizike për t'i plotësuar e për t'i tejkaluar detyrat e planit të prodhimit, të grumbullimit dhe të përpunimit të kësaj bime.

Në të njëjtën kohë, punimi dhe zberthimi i këtij vendimi do të shërbejnë si nxitje e gjithanshme për të realizuar në praktikë direktivën e Kongresit të 7-të të Partisë për plotësimin në front të gjerë të të gjitha detyrave në bujqësi.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 62 (9235), 14 mars 1978

V E N D I M

I BYROSE POLITIKE TE KQ TE PPSH «MBI FUQINE BLERESE TE POPULLSISE, MBULIMIN E SAJ ME MALLRA E ME SHERBIME, MBI QARKULLIMIN MONETAR DHE MASAT PER PERMIRESIMIN E METEJSHEM TE TYRE»

27 mars 1978

Byroja Politike e Komitetit Qendror te PPSH, ne mbledhjen e saj te dates 27 mars 1978, mbasi shqyrtoi studimin e paraqitur nga Ministria e Financave dhe Komisioni i Planit te Shtetit «Mbi fuqine blerese te popullsisë, mbulimin e saj me mallra e me sherbime dhe mbi qarkullimin monetar», arriti ne konkluzionin se rritja e pareshtur e prodhimit shoqëror, e te ardhurave kombetare dhe zbatim i drejt i politikës ekonomike te Partise ne fushen e shperndarjes e te perdorimit te tyre kanë qene dhe jane bazat e qendrueshmerise te ekonomise sonë, te tregut, te çmimeve dhe te qarkullimit monetar, te rritjes se mireqenies se popullit dhe te fuqise blerese te tij. Por, krahas sukseseve qe jane arritur, ne praktikë, akoma vihen re disa fenomene dhe shfaqje te padëshirueshme ne rritjen e fuqise blerese te popullsisë, ne mbulimin e saj me mallra e me sherbime dhe ne qarkullimin monetar, te cilat ndikojne negativisht ne ritmet e riprodhimit te zgjeruar socialist dhe ne plotësimin jo gjithnjë e ne menyre te gjithanshme te kerkesave te masave punojese. Këto shfaqje e kanë burimin ne rastet e kuptimit te cekët te këtyre problemeve dhe ne te metat e ne boshllëqet e drejtimit, te organizimit, te planifikimit e, sidomos, te realizimit te planeve te prodhimit sipas asortimenteve dhe cilësisë, te ndërtimit e te treguesve ekonomiko-financiare, te sherbimeve ndaj popullit dhe te tregtisë.

Ne perputhje me detyrat e shtruara nga Kongresi i 7-të i Partise, duke pasur parasysh te metat e boshllëqet e konstatuara, si dhe veshtiresite e pengesat qe rrjedhin nga ash-

persimi i rrethimit e i bllokades imperialisto-revizioniste ndaj vendit tone, Byroja Politike e KQ te Partise

Porosit:

1. — Organet dhe organizatat e Partise, organet shtetërore dhe ekonomike, ne zbatim te detyrave qe shtruan plenumet e fundit te Komitetit Qendror, te thellohen akoma me shume ne kuptimin e situatave qe kalojne ekonomia dhe vendi yne, te jetojne si revolucionare me bllokaden e eger imperialisto-revizioniste dhe ta lidhin me mire ketë me luftën dhe me punën qe duhen bere per plotësimin me çdo kusht te planit ne te gjitha drejtimet, ne te gjithë zërat dhe treguesit ekonomike e financiarë.

Situatat e sotme dhe realizimi i detyrave ne fushen e ekonomise kerkojne te kuptohet mire e te formohen bindje te thella se pa zhvilluar frontalisht një luftë te ashpër klasore kundër shfaqjeve te theksuara te liberalizmit, kundër shfaqjeve burokratike, qe vihen re ne mjaft dikastere e komitete ekzekutive te keshillave popullore te rretheve, ne hallkat drejtuese te ekonomise, si dhe ne mjaft organe dhe organizata-bazë te Partise dhe qe pengojne zbatimin një per një e ne kohë te detyrave te planit, nuk mund te arrihen rezultatet e dëshiruara.

Ne kushtet konkrete aktuale, ndër problemet me te mëdha, qe duhet te merren ne dorë si hallka themelore nga organizatat e Partise dhe nga organet shtetërore ne sferën e prodhimit e te qarkullimit, te konsiderohen, ne radhë te parë: plotësimi i detyrave te planit ne te gjitha degët, sektorët, treguesit e zërat dhe, sidomos, ne fushen e eksport-importit per te perballuar veshtiresite e reja qe jane krijuar ne tregtinë e jashtme; plotësimi i planit ne te gjithë zërat e nënzërat e bujqësisë dhe mbyllja e një pjese te deficiteve te krijuara, sipas zotimeve te marra; vënia ne shfrytëzim e veprave te ndërtimit ne afatet e caktuara; forcimi i disiplinës financiare ne administrimin e ekonomise dhe zberthimi e zbatim i programeve te punës per thellimin e revolucionit tekniko-shkencor.

Këto çeshtje dhe lufta kundër shfaqjeve liberale e burokratike per zbatimin një per një te planeve te bëhen problem i te gjitha organizatave te Partise, i te gjithë kolektivave punonjës, ne qytet e ne fshat, te cilët, brenda gjashtëmuorit te parë, te analizojne gjendjen dhe te percaktojne masat e mëtejshme per plotësimin me çdo kusht te detyrave te planit vjetor. Këto çeshtje te ndiqen vazhdimisht dhe te shqyrtohen herë pas here ne organizatat e Partise dhe ne kolektivat punonjës.

2. — Në planifikimin dhe në plotësimin e detyrave të planit nga çdo hallkë e nga çdo qelizë e ekonomisë, një vëmendje më e madhe t'i kushtohet respektimit me rigorozitet të parimit të rritjes më shpejt të prodhimit shoqëror, të të ardhurave kombëtare dhe të akumulimit socialist, në krahasim me rritjen e fuqisë blerëse të popullsisë. Vendosja dhe ruajtja e përpjesëtimeve të drejta midis këtyre treguesve kryesorë, të jenë kurdoherë nën vëzhgimin, ndjekjen dhe kontrollin e vazhdueshëm të organizatave të Partisë dhe, sidomos, të organeve të planifikimit, të financës e të bankës, duke pasur parasysh se ruajtja e këtyre përpjesëtimeve përbën një nga parimet themelore të politikës ekonomike të Partisë dhe kërkesa objektive të ligjeve ekonomike të socializmit.

Për këtë qëllim është e nevojshme jo vetëm të mos lejohen në planifikim gabime, që çojnë në prishjen e këtyre përpjesëtimeve, por të vihet në baza më të shëndosha organizimi i punës për ndjekjen e plotësimin të treguesve të planit dhe të fuqisë blerëse të popullsisë, si në shkallë të të gjithë vendit, ashtu edhe për çdo rreth të veçantë. Organet përkatëse shtetërore e ekonomike të thellohen më shumë në analizën e fenomeneve e të prirjeve që vërehen në praktikë, në mënyrë që të merren masa për të parandaluar në kohë shkaqet dhe pasojat negative të tyre.

3. — Për të përballuar rritjen e fuqisë blerëse të popullsisë dhe për të plotësuar gjithnjë e më mirë nevojat e popullit me mallra të përdorimit të gjerë, duke u mbështetur në mundësitë dhe në bazën materiale të planifikuar, një vëmendje e veçantë t'u kushtohet, sidomos, këtyre problemeve:

a) Komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe Ministria e Bujqësisë të thellojnë vazhdimisht masat ideopolitike e tekniko-organizative për të siguruar plotësimin ritmik të detyrave të planit në prodhimet që përbëjnë bazën e furnizimit të përditshëm të popullit, sidomos, perimet, patatet, qumështi, mishi, vezët, frutat, rrushi, agrumet etj.

Të studiohen mundësitë dhe të synohet që, në pesëvjeçarin e ardhshëm, nevojat në rritje të popullit dhe të ekonomisë, për prodhime bujqësore e blegtorale, të përballohen sa më mirë me prodhimin e vendit.

b) Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Ministria e Tregtisë së Brendshme të bëjnë një luftë këmbëngulëse kundër rutinës e globalizmit dhe të marrin të gjitha masat për t'i plotësuar më mirë nevojat e popullit me mallra të përdorimit të gjerë, në natyrë e në të gjithë llojshmërinë e tyre, sipas sasive, asortimenteve dhe cilësisë së planifikuar.

Këto organe, kohë pas kohe, të studiojnë gjendjen dhe nivelin e shfrytëzimit të plotë të aftësive prodhuese për të organizuar më shpejt e në mënyrë dinamike prodhimin e artikujve të rinj dhe zëvendësimin ose ripërtëritjen me një cilësi gjithnjë e më të lartë të artikujve në përdorim, duke synuar që ndërmarrjet, të cilat prodhojnë mallra të përdorimit të gjerë, të bëhen më të manovrueshme në plotësimin e kërkesave të reja e në rritje të popullit.

c) Organet dhe organizatat e Partisë të kujdesen që organet e prodhimit dhe ato të tregtisë të thellojnë vazhdimisht punën për njohjen dhe për studimin e nevojave të popullit për mallra të përdorimit të gjerë, sipas rretheve e krahinave, duke mbajtur parasysh traditat, grupmoshat, seksin etj. dhe t'i reflektojnë këto, çdo vit, në planet ekonomike. Këto shtete të mos bëhen nga zyra, por të tërhiqet, në mënyrë sistematike, mendimi i shitësve dhe, sidomos, mendimi i konsumatorëve, në qytet e në fshat, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e masave.

ç) Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore të merren seriozisht me organizimin, me drejtimin dhe me prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, që janë në nomenklaturë të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve e të ndërmarrjeve dhe të mos i konsiderojnë këto probleme si të huaja për to. Ato të rritin dhe të marrin përgjegjësi të plotë si për një planifikim më të mirë, ashtu edhe për të forcuar kontrollin në zbatimin e disiplinës së planit për prodhimin dhe për shpërndarjen e këtyre mallrave.

d) Krahas plotësimin të detyrave të planit të prodhimit, të sigurohet një furnizim më i mirë i anëtarëve të kooperativave bujqësore me prodhime bujqësore e blegtorale, në përputhje me Deklaratën e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Ministrave të vitit 1967, si dhe plotësimi i nevojave të tyre për shërbimet. Mbi këtë bazë të caktohen edhe detyrat e planit të qarkullimit të mallrave të kooperativave bujqësore. Që të realizohen këto detyra nga kooperativat bujqësore, organet e tregtisë dhe të ekonomisë komunale, si organe të specializuara, të ndihmojnë më shumë dhe vazhdimisht me eksperiencën e tyre.

Plotësimi i detyrave në këtë tregues të planit të ndiqet, të kontrollohet dhe të analizohet në mënyrë sistematike nga organizatat e Partisë, nga komitetet e Partisë dhe nga ato ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, nga Ministria e Bujqësisë dhe nga organet e planit e të financës, në rrethe dhe në qendër, njësoj siç ndiqet edhe plotësimi i planit të qarkullimit të mallrave dhe i shërbimeve të organeve shtetërore.

4. — Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale dhe

komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të marrin më mirë në dorë zhvillimin e shërbimeve komunale, veçanërisht në drejtim të llojshmërisë, të shpejtësisë, të cilësisë dhe të përmirësojnë rrënjësisht shërbimet ndaj popullit. Të rriten me ritme më të shpejta, sidomos, riparimet e enëve të guzhinës, të rrobave, të këpucëve, të pjesëve metalike, të mobilje-orendive, të shërbimeve për lyerje, të mirëmbajtjes së banesave etj.

Drejtorja e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale dhe Komisioni i Planit të Shtetit të studiojnë më mirë nevojat dhe, duke filluar nga viti 1979, të parashikojnë në plan rritjen më shpejt të riparimeve e të shërbimeve, në krahasim me shtimin e popullsisë. Për të plotësuar më mirë, në kohë dhe me cilësi kërkesat e popullit dhe për të luftuar ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë private, të studiohen me intësi gjendja dhe shtrirja e rrjetit të shërbimeve për çdo rreth dhe, po të jetë nevoja, të shtohet numri i punëtorëve dhe i specialistëve në këto shërbime. Krahas me këto, të parashikohen e të zbatohen edhe masa konkrete për rritjen e rendimentit të punës nëpërmjet mekanizmave.

5. — Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave, dikasteret dhe Ministria e Tregtisë së Brendshme, gjatë hartimit të planeve të studiojnë dhe të parashikojnë, në përputhje me fuqinë blerëse të popullsisë, detyra për rritjen kurdoherë më shpejt të qarkullimit të mallrave me të holla në dorë, në krahasim me shtimin e monedhës në qarkullim në fund të vitit. Gjithashtu, Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe dikasteret e tjera prodhuese të marrin masa që përpjesëtimet e vendosura në plan të realizohen me përpikëri dhe të luftojnë për përmirësimin e tyre. Në vitet e ardhshme të synohet që jo vetëm të ruhet shpejtësia e qarkullimit të monedhës, e arritur në vitin 1977, por të merren masa që ajo të rritet më tej, në përputhje me kushtet dhe me mundësitë e zhvillimit të ekonomisë.

Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë dhe Ministria e Financave të marrin më mirë në dorë problemet financiare dhe të kenë në qendër të vëmendjes së tyre luftën për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, për rritjen e akumulimit socialist, për mënjanimin e humbjeve të ndërmarrjeve, të sektorëve dhe të produkteve të veçanta, për eliminimin e debi-kredive të paligjshme, sidomos, të debitorëve në persona, si dhe për rritjen e aftësisë paguese në çdo ndërmarrje ekonomike e kooperativë bujqësore.

Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit të shqyrtojnë çështjen e shpërndarjes më drejt të të ardhurave të anëtarëve të kooperativave bujqësore në periudhat e ndryshme të vitit, në mënyrë që kjo

të përputhet më mirë me ritmikën e planifikuar të prodhimit e të qarkullimit të mallrave.

6. — Vëmendje më e madhe t'i kushtohet plotësimit të detyrave për rritjen e rendimentit të punës në industri, në ndërtim, në transport e në degë të tjera të ekonomisë popullore. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, në bashkëpunim me bashkimet profesionale, brenda këtij viti, të rishqyrtojnë normat e punës, duke bërë unifikimin e tyre, në shkallë sektori e dege ekonomike, mbi bazën e mesatareve të përparuar, si dhe të marrin masa për të shpejtuar zgjerimin e normave teknike të punës.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, në mënyrë të veçantë, të studiojnë dhe të përsosin normimin e punës në kooperativat bujqësore, me synimin që, në ekonomi bujqësore të krahasueshme, ato të jenë të njëjta.

7. — Byroja Politike porositi, në mënyrë të veçantë komitetet e Partisë dhe organizatat e Partisë në dikasteret qendrore, që t'i analizojnë e t'i ndjekin me shumë kujdes problemet që lidhen me fuqinë blerëse të popullit, me mbulimin e saj me mallra e me shërbime dhe me qarkullimin monetar. Të mbahej kurdoherë parasysh porosia e Plenumit të 3-të të KQ se në ekonominë socialiste veprojnë shumë ligje ekonomike, të lidhura e të gërshetuara me njëra-tjetrën, prandaj, problemet që lidhen me fuqinë blerëse dhe me qarkullimin monetar, nuk kanë të bëjnë vetëm me tregtinë dhe me bankën, por me të gjithë.

Ky vendim të punohet në të gjitha organizatat e Partisë të sektorit të prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit, të analizohet gjendja në frymën e tij dhe, në përfundim, të njoftohet Komiteti Qendror i Partisë mbi problemet që dolën dhe masat që do të merren. Komitetet dhe organizatat e Partisë të bëjnë analiza të herëpashershme për këto çështje. Brenda vitit 1978, Ministria e Financave dhe Komisioni i Planit të Shtetit, në bashkëpunim me dikasteret e tjera qendrore të informojnë Komitetin Qendror për masat e marra dhe për problemet që lidhen me përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PROTOKOLL

I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH «MBI PUNËN E ORGANIZATAVE TË PARTISË PËR EDUKIMIN IDEOLOGJIK E POLITIK TË PUNONJËSVE NË NDËRMARRJET E TRANSPORTIT TË JASHTËM DETAR E AUTOMOBILISTIK»

29 mars 1978

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 29 mars 1978, shqyrtoi relacionin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit «Mbi punën e organizatave të Partisë për edukimin ideopolitik të punonjësve të transportit detar e automobilistik të jashtëm» dhe

V ë r e j t i :

1. — Flota jonë Tregtare dhe Parku Automobilistik i Jashtëm, nga viti në vit, janë rritur e janë fuqizuar, sipas direktivave të Partisë dhe zbatimit të planeve pesëvjeçare.

Kuadrot dhe punonjësit e këtyre degëve të transportit tonë, me punën e vazhdueshme të organizatave të Partisë, kanë rritur dhe rritin aftësitë e tyre profesionale dhe, në veçanti, përgatitjen e tyre ideologjike e politike, për të realizuar sa më mirë detyrat dhe planet në të gjithë treguesit, për të përballuar me pjekuri ideopolitike presionin e vazhdueshëm të armiqve të Partisë e të vendit tonë socialist që ndeshin në procesin e punës në forma nga më të ndryshmet.

Megjithëkëtë, për të realizuar akoma më mirë detyrat e rëndësishme që u vihen përpara, në situatat e krijuara në botën borgjezo-revizioniste dhe të presionit të tyre ndaj vendit tonë, për të përballuar me vendosmëri e me guxim, me pjekuri politike e ideologjike provokacionet e sulmet direkte të armiqve në procesin e realizimit të detyrave jashtë vendit, si dhe për

të mënjeluar ato shfaqje e qëndrime të huaja e të palejueshme për ideologjinë e për moralin proletar socialist, që janë vërtetuar në pak raste, është e nevojshme të intensifikohet dhe të thellohet më tej puna edukuese e sqaruese e organizatave-bazë për të njohur më thellë ngjarjet në botë e, veçanërisht, në vendet ku drejtohen për transport mjetet tona, për të kuptuar drejt politikën e Partisë dhe të shtetit tonë ndaj këtyre vendeve dhe për të mbrojtur me vendosmëri këtë politikë, ideologjinë tonë revolucionare, figurën morale të punonjësit tonë.

Komiteti i Partisë i Rrethit të Durrësit, organizatat-bazë në këto ndërmarrje të bëjnë një punë më të gjerë e të thelluar për kuptimin e politikës ekonomike të Partisë, të direktivave e të orientimeve të saj për transportin e jashtëm, duke u mbështetur në vendimet historike të Kongresit të 7-të të Partisë dhe të plenumeve të 2-të, të 3-të e të 4-të të Komitetit Qendror. Ato duhet t'u kushtojnë një kujdes të veçantë kuptimit teorik e praktik të luftës së klasave dhe kalitjes revolucionare të punonjësve, për të goditur në kohë çdo shfaqje të huaj, çdo orvatje për komprometim, si dhe çdo sulm e provokacion të armiqve.

Qëndrimet e shfaqjet e huaja, veprimet që ulin figurën morale të punonjësit tonë socialist të bëhen objekt diskutimi në kolektiv dhe të arrihet që vetë punonjësit t'i dënojnë ato, jo vetëm si qëndrime të palejueshme morale, por dhe ideologjike e politike, që dëmtojnë politikën e Partisë e diskreditojnë vendin tonë.

Kujdes dhe punë më e gjerë duhet bërë për edukimin revolucionar të punonjësve të Flotës e të Parkut Automobilistik të Jashtëm edhe nëpërmjet aktiviteteve kulturore-artistike, si dhe me librin e, në veçanti, me leximin e me komentimin e shtypit.

2. — Vëmendja kryesore e Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit dhe e vetë organizatave-bazë në këto ndërmarrje t'u kushtohet rritjes së vazhdueshme të rolit udhëheqës të organizatës-bazë dhe revolucionarizimit të jetës së brendshme të saj, sepse, me gjithë përmirësimet e bëra, akoma vihen re raste të një jete të vakët në ndonjë organizatë-bazë partie, thyerje uniteti, spostime nga problemet kryesore.

Është e nevojshme të kuptohet thellë, teorikisht dhe praktikisht, se është organizata-bazë e Partisë ajo që udhëheq gjithë punën për zbatimin e politikës dhe të direktivave të Partisë, për realizimin e planit dhe të treguesve të shfrytëzimit të drejtë e të plotë të mjeteve dhe që mban përgjegjësi të plotë për këto. Organizatat-bazë nuk duhet të pajtohen me lëshimet e me qëndrimet liberale në këto çështje, por duhet të kërkojnë

nga drejtoritë e nga kapitaneritë që të realizohen në kohë e plotësisht planet, kontratat, grafikët e lëvizjes e të shërbimeve të mjeteve; të mobilizojnë e të udhëheqin punonjësit, me shembullin personal të komunistëve, në aksione konkrete e me masa organizative teknike, në mënyrë që çdo detyrë të realizohet në kohë e në përputhje me direktivat e Partisë dhe me mësimet e shokut Enver.

Nëpërmjet kritikës e autokritikës konstruktive, në mbledhje të organizatës dhe jashtë saj, të luftojnë të metat e shfaqjet e huaja dhe të përdorin më gjerësisht shembullin pozitiv, eksperiencën e përparuar për plotësimin e për tejkalimin e detyrave dhe të planeve në të gjithë treguesit.

Në të njëjtën kohë, duhen luftuar dhe shfaqje të huaja, si: rendja pas interesit personal, tarafi, familjariteti e shoqëria e sëmurë, që dëmtojnë rëndë figurën morale të punonjësit, unitetin e kolektivit dhe të vetë organizatës së Partisë.

Në zgjedhjen e në plotësimin e kuadrit të mbahen parasysh jo vetëm qëndrimi politik e aftësia profesionale, për të cilat duhet të ketë kurdoherë kërkesa të larta, por dhe qëndrimi moral, sjelljet dhe prirjet e punonjësve, pa u ndikuar nga ndërhyrjet e nga miqësitë, për të pasur kolektiva të shëndoshë e punonjës të denjë, që kryejnë detyrat me partishmëri e me frymë revolucionare kudo që të jenë.

Një punë sistematike duhet bërë dhe për pranimet në Parti, me njerëz të sprovuar e që i kanë kushtet për t'u pranuar. Veçanërisht, duhet mbështetur te rinia, që vjen në këto ndërmarrje nga bankat e shkollës apo nga sektorë të tjerë të ekonomisë.

3. — Një luftë më e organizuar duhet bërë nga drejtoritë e këtyre ndërmarrjeve, si dhe nga vetë Ministria e Komunikacioneve, për plotësimin e për tejkalimin e detyrave të planit, sepse ka disa të meta e dobësi, që e pengojnë këtë realizim, që ulin treguesit tekniko-ekonomikë të tij dhe i sjellin dëme ekonomisë. Prandaj Ministria e Komunikacioneve dhe drejtoritë e Flotës e të Parkut Automobilistik të Jashtëm duhet të rritin në një shkallë më të lartë gatishmërinë dhe shfrytëzimin e mjeteve. Shpesh, për organizim të dobët të punës, për anomali që vërtetohen në hartimin e në zbatimin e grafikëve të qarkullimit të mjeteve dhe për bashkërendim të pakënaqshëm të lëvizjeve të mjeteve të këtyre ndërmarrjeve, si dhe të «transhqip»-it, treguesit e planifikuar të gatishmërisë dhe të shfrytëzimit të mjeteve nuk realizohen, krijohen vështirësi e pengesa. që shpien deri në marrjen e mjeteve të huaja me qira.

Për të realizuar më mirë këta tregues kryesorë, organet drejtuese shtetërore dhe vetë organizatat e Partisë në ministri e në ndërmarrje duhet të rritin kujdesin dhe përpjekjet për

një organizim më të mirë të ngarkim-shkarkimeve, për zgjerimin e shkallës së mekanizimit të tyre, për planifikimin e për realizimin më të mirë të shërbimeve të mesme e kapitale të mjeteve, duke thëlluar më tej revolucionin tekniko-shkencor.

4. — Organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore të bëjnë një punë të gjerë e intensive për edukimin profesional të punonjësve, që të rritet vazhdimisht shkalla e kualifikimit dhe e atestimit kulturor e profesional, me shkolla, me kurse, me sisteme të patronazhit etj. Po kështu, duhet rritur puna ideopolitike për forcimin e disiplinës së punës e të asaj teknike dhe të luftohen indiferentizmi, qëndrimet liberale e nënvleftësuese ndaj këtyre çështjeve.

Ky protokoll të punohet nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Durrësit, nga komiteti i Partisë dhe organizatat-bazë në Flotë, nga organizatat-bazë në Parkun Automobilistik, si dhe nga ato të Ministrisë së Komunikacioneve e të Tregtisë së Jashtme, nga komitetet e Partisë të rretheve të tjera, të cilat duhet të nxjerrin konkluzione e detyra për vënien në jetë të tij.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se komunistët, kuadrot dhe të gjithë punonjësit e Flotës sonë Detare, të brendshme e të jashtme, ata të Parkut Automobilistik, si dhe të gjithë punonjësit e tjerë të komunikacionit do të punojnë më mirë e më shumë për ngritjen e tyre politiko-ideologjike, do të mbajnë kurdoherë lart figurën morale të njeriut tonë të ri, që ka edukuar dhe edukon vazhdimisht Partia, e do të kryejnë me sukses të gjitha detyrat që u ngarkon ajo.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 5-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-27 qershor 1978

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 26 e 27 qershor 1978, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi punën e bërë për zbatimin e vendimeve të plenumeve të 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë, të vitit 1974, dhe të detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit»...

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në fund, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, duke bërë konkluzionet e punimeve të Plenumit, foli mbi detyrat e rëndësishme që u dalin Partisë dhe popullit për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së atdheut tonë socialist.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH
«MBI PUNËN E BËRË PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE
TË PLENUMEVE TË 5-TË DHE TË 6-TË TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISË, TË VITIT 1974 DHE TË DETYRAVE
QË SHTRUI KONGRESI I 7-TË I PARTISË PËR FORCIMIN
E MËTEJSHËM TË MBROJTJES SË VENDIT»**

27 qershor 1978

Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 26 e 27 qershor 1978, pasi dëgjoi dhe diskutoi gjerësisht rreth raportit «Mbi punën e bërë për zbatimin e vendimeve të plenumeve të 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë, të vitit 1974, dhe të detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit»...

Vendosi:

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi punën e bërë për zbatimin e vendimeve të plenumeve të 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë, të vitit 1974, dhe të detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit».

2. — Porosit organet dhe organizatat e Partisë, në terren dhe në ushtri, organizat e masave, organet shtetërore dhe ekonomike që të marrin të gjitha masat e duhura për të zërtëyer dhe për të vënë në jetë të gjitha detyrat që dalin nga ky Plenum.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR E KQ TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË DHE
E QEVERISË SË RPS TË SHQIPËRISË DREJTUAR
KQ TË PARTISË KOMUNISTE TË KINËS
DHE QEVERISË KINEZE**

29 korrik 1978

Më 7 korrik 1978 Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës Popullore të Kinës i dorëzoi Ambasadës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Pekin një notë zyrtare, me anën e së cilës njoftohet se qeveria kineze ka vendosur «të ndërpresë ndihmën ekonomike dhe ushtarake për Shqipërinë, të ndërpresë pagesat e ndihmës për Shqipërinë dhe të tërheqë specialistët ekonomikë dhe ushtarakë» që punonin në Shqipëri deri në atë datë.

Me këtë veprim të pabesë dhe armiqësor ndaj Shqipërisë socialiste, ju çorët pa skrupull marrëveshjet e përfunduara zyrtarisht midis të dy vendeve, shkelët në mënyrë brutale dhe arbitrare rregullat e normat elementare ndërkombëtare dhe mosmarrëveshjet ideologjike i shtritë edhe në marrëdhëniet shtetërore me Shqipërinë.

Duke hedhur këtë hap armiqësor ndaj Shqipërisë socialiste, ju kërkoni të goditni e të dëmtoni ekonominë dhe aftësinë mbrojtëse të vendit tonë, të sabotoni çështjen e revolucionit e të socializmit në Shqipëri. Njëkohësisht, ju minoni rëndë miqësinë vëllazërore midis popujve, shqiptar e kinez. Duke i dashur të keqen një vendi socialist, siç është Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, ju kënaqni armiqtë e socializmit e të revolucionit. Përgjegjësia për këtë akt reaksionar e anti-shqiptar, si dhe për pasojat e tij, bie plotësisht mbi palën kineze.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qe-

veria Shqiptare prerjen brutale të ndihmave e të kredive për Shqipërinë socialiste, nga ana juaj, e denoncojnë përpara gjithë opinionit publik botëror si një veprim reaksionar e nga pozitrat e fuqisë së madhe, si veprim që përsërit, si në përmbajtje, ashtu edhe në formë, metodat e egra e shoviniste të Titos, të Hrushovit e të Brezhnjevrit, të cilat, dikur, edhe Kina i ka pasë dënuar.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare hedhin poshtë përpjekjet që bëhen në notën kineze për ta bërë fajtoreshë Shqipërinë, për të akuzuar, pa asnjë bazë, udhëheqjen shqiptare se gjoja ajo është mosmirënjohëse për ndihmën e Kinës dhe se gjoja është përpjekur të sabotojë bashkëpunimin ekonomik e ushtarak midis të dy vendeve. Për çdo njeri normal është e pabesueshme dhe jashtë çdo logjike që Shqipëria, një vend i vogël, që lufton kundër rrethimit imperialisto-revizionist e bllokadës së tij, që i është përveshur një punë të gjerë e të gjithanshme për zhvillimin e shpejtë ekonomik e kulturor të vendit, që punon pa u lodhur për forcimin e mbrojtjes së atdheut të vet socialist, të nxitë e të kërkojë vetë prishjen e bashkëpunimit ekonomik me Kinën, të refuzojë kreditë e ndihmat e saj civile e ushtarake.

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, të frymëzuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit e nga parimet e internacionalizmit proletar, kanë luftuar sinqerisht e me konsekuencë për forcimin e miqësisë, të bashkëpunimit vëllazëror e të ndihmës reciproke midis Shqipërisë dhe Kinës. Ata e kanë çmuar kurdoherë lart ndihmën që Kina i ka dhënë Shqipërisë, duke e konsideruar atë si një ndihmë internacionaliste të popullit kinez, si një ndihmë që i shërbente çështjes së përgjithshme të revolucionit e të socializmit në botë, si një ndihmë që vinte nga një vend që quhej socialist. Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, ashtu si më parë, edhe tani, u përmbahen vlerësimeve që u kanë bërë kësaj ndihme dhe rolit të saj, midis faktorëve të tjerë të jashtëm, për zhvillimin e vendit tonë.

Shqipëria socialiste miqësinë e saj me popujt e vendeve të tjera kurrë nuk e ka parë si një mjet për të nxjerrë përfitime ekonomike. Në të njëjtën kohë, ajo nuk i ka lejuar askujt që ndihmën e bashkëpunimin ekonomik ta llogaritë si një investim për t'i diktuar dhe për t'i imponuar vendit tonë pikëpamje politike e ideologjike, që janë në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me interesat e socializmit. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i ka shitur kurrë parimet, ajo kurrë nuk ka bërë e nuk bën tregti me to.

Kur Partia e Punës e Shqipërisë e mbrojti Partinë Komuniste të Kinës nga sulmi i revizionistëve hrushovianë në Mbledhjen e Bukureshtit dhe në atë të Moskës të partive komuniste

e punëtore të vitit 1960, ajo këtë e bëri me vetëdije, për të mbrojtur parimet e marksizëm-leninizmit dhe jo për të marrë nga Kina disa fabrika dhe disa traktorë. Kur Shqipëria socialiste, për vite e vite me radhë, mbronte të drejtat e Kinës Popullore në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kundër komplotit amerikan, ajo këtë nuk e bënte për interesa materiale, por për të mbrojtur një çështje të drejtë dhe parimore. Kur Partia e Punës e Shqipërisë dhe klasa jonë punëtore mbështetën qëllimet strategjike të Revolucionit Kulturor të Kinës, këtë nuk e bënë për të marrë ndonjë kompensim, por për të ndihmuar klasën punëtore kineze, komunistët dhe popullin kinez për ta shpëtuar vendin nga elementët kapitalistë që kishin uzurpuar pushtetin në Kinë.

Qeveria kineze, për të justifikuar prerjen e ndihmave për Shqipërinë, në pamundësi që të bëjë ndryshe, është kufizuar në «argumente» ekonomike dhe teknike të praktikës së thjeshtë e të zakonshme në marrëdhëniet midis dy shteteve. Këtë ju e bëni me qëllim që të fshihni arsyet e vërteta, që ju shtynë të ndërmerreni këtë akt armiqësor kundër Shqipërisë socialiste.

Prerja e ndihmave dhe e kredive për Shqipërinë nuk mund të arsyetohet me 8 «faktet» që paraqiten në notën kineze, se gjoja «zëvendësimin e ministrit të Industrisë dhe të Minierave të Shqipërisë... refuzoi konsultimet e mëtejshme... dhe në mënyrë arrogante u dha fund bisedimeve»; se nga specialistët shqiptarë «nuk u respektuan udhëzimet teknike të specialistëve kinezë» në rafinerinë e përpunimit të thellë të naftës; se projekti kinez në një objekt ushtarak nuk doli me sukses «për shkak të zbulimit të vonuar të zgavrave që rridhnin ujë, si rezultat i studimeve gjeologjike të dobëta nga ana shqiptare» dhe se pala shqiptare «ndryshoi mendim duke e marrë përsipër vetë punën dhe i dha fund ndihmës kineze për këtë objekt»; se pala shqiptare «krijoi pretekste të ndryshme dhe, në kundërshtim me marrëveshjen, refuzoi të nënshkruante procesverbalet e vënies në shfrytëzim të objekteve»; se pala shqiptare «papritur, refuzoi të pranonte 25 faturat me një shumë totale prej afro 100 milionë juanë Renminbi»; se «për arsye të mospërfilljes nga pala shqiptare të këshillave teknike të specialistëve kinezë, në Kombinatin Metalurgjik u formua një ngjiturje në furrnaltë» dhe këtë defekt specialistët shqiptarë e zhdokën vetë, pa pritur që të vinin specialistë të posaçëm nga Kina; se «ambasadori shqiptar në Kinë refuzoi të pranonte notën kineze të 7 qershorit 1978».

Këto «argumente» dhe «fakte», që sjell qeveria kineze, jo vetëm janë të sajura e të shtrembëruara, por, edhe sikur të mos ishin të tilla, ato nuk mund të shërbejnë kurrsesi si një bazë morale dhe juridike ku mund të mbështetet një shtet për

të justifikuar prerjen e njëanshme e brutale të ndihmës ekonomike dhe ushtarake ndaj një shteti tjetër, me të cilin ka qenë në aleancë të ngushtë për një kohë të gjatë.

Arsyet e vërteta të prerjes së ndihmave e të kredive për Shqipërinë nuk kanë karakter thjesht teknik, siç paraqiten në notën e qeverisë kineze, por kanë karakter të thellë politik e ideologjik. Në këtë letër Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare do të hedhin dritë të plotë mbi këto shkaqe politike dhe ideologjike. Por, më parë, po ndalemi të vërtetojmë se, edhe «argumentet» që përdor pala kineze në notën e vet, nuk i përgjigjen aspak realitetit.

Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë do ta njohë opinionin botëror me të vërtetën mbi marrëdhëniet ekonomike midis Kinës e Shqipërisë e, në mënyrë të veçantë, për ato çështje që ngrihen në notën kineze, duke botuar notat e plota që janë shkëmbyer për këtë qëllim midis qeverive të dy vendeve. Këtu do të sqarojmë disa «fakte» që përmenden në notën kineze.

Në notën kineze të 7 korrikut, duke radhitur në mënyrë tendencioze një varg shifrash mbi ndihmat që Kina i ka dhënë Shqipërisë, pasqyrohet dëshira e udhëheqjes kineze për t'u mburrur përpara botës. Ajo vepron njësoj, siç ka vepruar dhe siç vepron udhëheqja revizioniste sovjetike, që propagandon vazhdimisht, me mburrje prej shteti të madh, «ndihmën» që i ka dhënë dikur Shqipërisë.

Detyrohemi t'u kujtojmë udhëheqësve kinezë se mburrjet e tyre janë krejt në kundërshtim me deklaratat zyrtare të bëra dikur nga vetë qeveria kineze.

Në Deklaratën solemne mbi 8 parimet e ndihmës së qeverisë kineze për shtetet e tjera thuhet: «Qeveria kineze bazohet gjithmonë në parimin e barazisë dhe të dobisë reciproke në dhënie e ndihmës vendeve të tjera. Ajo nuk e konsideron kurrë një ndihmë të tillë si një lëmshë të njëanshme, por si diçka reciproke». Kurse Çu En Lai, gjatë vizitës së tij në 14 shtete në vitin 1964, theksonte: «...në rast se ne do të mburrëshim për ndihmën tonë ndaj të tjerëve, do të ishte një shovinizëm i shtetit të madh».

Populli, Partia dhe Qeveria Shqiptare nuk e kanë mohuar asnjëherë ndihmën e Republikës Popullore të Kinës dhe rolin e kësaj ndihme në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Ata e kanë njohur dhe e kanë vlerësuar këtë ndihmë, duke u udhëhequr nga ndjenja të sigjerta dhe duke menduar se ajo vinte nga një shtet mik dhe jepej në frymën e parimeve të socializmit.

Por në notën kineze të 7 korrikut, ndërsa paraqitet me përmasa të ekzagjeruara dhe zbukurohet ndihma ekonomike

dhe ushtarake që Kina i ka dhënë Shqipërisë, nuk gjendet asnjë fjalë për të përmendur faktin se edhe Shqipëria e ka ndihmuar Kinën, siç e kanë deklaruar shumë herë, kohë më parë, edhe vetë udhëheqësit kinezë.

VDuke vlerësuar ndihmën që Shqipëria i ka dhënë Kinës, Mao Ce Duni ka thënë: «Ne duhet t'ju falënderojmë, në radhë të parë juve, sepse ju qëndroni në vijën e parë të frontit, sepse ju ndodheni në rrethana shumë të vështira dhe luftoni me këmbëngulje për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Kjo është një gjë shumë e vlefshme, kjo është më e çmueshme se çdo gjë»¹.

Ndërsa Çu En Lai, nga ana e tij, ka deklaruar: «Shokët shqiptarë përmendin shpesh përkrahjen dhe ndihmën nga ana e Kinës për Shqipërinë. Unë do të dëshiroja të theksoja këtu se, në radhë të parë, Shqipëria na ka dhënë neve një ndihmë e përkrahje të madhe».

«Populli kinez nuk do të harrojë kurrë se në kohën kur revizionistët modernë shpifnin dhe sulmonin në mënyrë të turbuar Partinë Komuniste të Kinës, Partia e Punës e Shqipërisë, duke mbajtur një qëndrim të drejtë, pa marrë parasysh të gjitha presionet, vështirësitë dhe rreziqet, doli me guxim për të përballuar këtë rrymë të kundërt, demaskoi dhe goditi pa mëshirë komplotet antikineze të revizionizmit modern»².

Përsëri Çu En Lai ka thënë: «Ne bëjmë detyrën tonë internacionaliste dhe do të ishte tradhti, po të mos ju ndihmonim... Ju, si një kështjellë e socializmit në Evropë, po luftoni kundër imperializmit, revizionizmit dhe gjithë reaksionit. Po të mos ju ndihmojmë, ne nuk do të jemi komunistë internacionalistë, por tradhtarë. Përkrahja dhe ndihma midis nesh, midis Kinës dhe Shqipërisë, është reciproke. Ju në Evropë po qëndroni si një fener ndriçues dhe po luftoni pa u përkulur dhe syapatrembur. Kjo është një ndihmë dhe përkrahje e madhe për ne dhe për gjithë popujt e botës»³.

Një deklaratë të tillë ka bërë edhe Kan Shen: «Unë u kam thënë shpesh shokëve, dhe përsëri këtë radhë e theksova edhe një herë, që shokët shqiptarë neve na japin një ndihmë të madhe, kolosale. Le të mos shohim veç azotikun, tecin, uzinat dhe fabrikat e ndryshme që ju japim ne, ato nuk janë gjë,

1 Nxjerrë nga procesverbali i bisedës me një delegacion shqiptar, më 29 qershor 1962. AQP.

2 «Fjala në mitingun e Tiranës». Shih: «Zëri i popullit», 9 janar 1964.

3 Nxjerrë nga procesverbali i bisedës me një delegacion shqiptar. Pekin, 29 gusht 1971. AQP.

po të llogaritim përkrahjen e madhe që na japin neve dhe lëvizjes komuniste në botë shokët shqiptarë»¹.

Neve na vjen rëndë të flasim për ndihmën që Shqipëria i ka dhënë Kinës, sepse ato çfarë kanë bërë Partia dhe populli shqiptar për Kinën e popullin kinez i kanë bërë me ndërgjegje komuniste e të frymëzuar nga ndjenja vëllazërore dhe internacionaliste. Por na detyruat të flasim për të, sepse ju, duke ndjekur shembullin e Hrushovit e të Brezhnevëve, filluat të na numëroni juanët e fenët, që i keni dhënë Shqipërisë!

Në notën e saj, qeveria kineze orvatet të krijojë përshtypjen në opinionin publik se gjoja Shqipëria, në qoftë se ka pasur ndonjë sukses në zhvillimin ekonomik, këtë e ka vetëm në sajë të ndihmës së Kinës. Për këtë qëllim dhe për të impresionuar opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, shifrat që përmenden në notën kineze janë fryrë e manipuluar me kujdes. Aty thuhet se «Qeveria kineze, për zbatimin e marrëveshjeve të përfunduara midis Kinës dhe Shqipërisë, ka harxhuar më shumë se 10 miliardë juanë Renminbi». Kjo është një shifër arbitrare dhe nuk i përgjigjet së vërtetës.

Në radhë të parë, duhet thënë se ato që qeveria kineze i quan ndihma, në të vërtetë janë kredi, janë obligime, që rrjedhin nga marrëveshjet e përfunduara midis dy qeverive, në përputhje me dëshirat dhe interesat e të dyja palëve dhe me praktikën e njohur ndërkombëtare të marrëdhënieve midis shtetesh sovranë dhe që përmbajnë detyrime të dyanshme. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me lëmosha ose me mëshirë kristiane.

Nga ana tjetër, në bazë të dokumenteve që disponon pala shqiptare, rezulton se, që nga dhjetori i vitit 1954 dhe deri në korrik të vitit 1975, midis Kinës Popullore dhe Shqipërisë janë nënshkruar 17 marrëveshje qeveritare për dhënie kredie Shqipërisë nga Kina Popullore, përveç marrëveshjeve për ndihmën ushtarake. Ndër këto 17 marrëveshje, ka prej tyre ku ndihma në kredi llogaritet në rubla të vjetra, më pas në rubla të reja, pastaj në lira angleze, më vonë në juanë të brendshëm e në juanë tregtarë ose në dollarë amerikanë. Duke i kthyer monedhat e ndryshme të përmendura në këto marrëveshje në juanë tregtarë, me kursin zyrtar kinez të caktuar nga Banka Kineze në periudhat përkatëse, rezulton se vlera e përgjithshme e ndihmës ekonomike kineze në kredi, akorduar Shqipërisë që nga viti 1954 dhe deri në vitin 1975, kur u nënshkrua marrëveshja e fundit, nuk është «më shumë se 10 miliardë juanë», siç përmendet në notën kineze, por vetëm 3 miliardë e 53 milionë juanë tregtarë. Nga kjo shumë, duke e llogaritur vlerën e veprave të plota dhe të materialeve të përgjithshme me çmimet

1 Nga fjala në darkën për nder të delegacionit kinez. Tiranë, 13 nëntor 1966. AQP.

e njëanshme të caktuara nga pala kineze, deri në korrik të vitit 1978 është përdorur nga Shqipëria rreth 75 për qind e saj. Por këtu duhet theksuar se vlerat që përmbajnë faturat e Bankës Kineze për veprat e plota dhe për materialet e përgjithshme nuk janë llogaritur mbi bazën e çmimeve të caktuara «në konsultim të përbashkët», por janë caktuar në mënyrë arbitrare, vetëm nga pala kineze, pa e pyetur fare palën shqiptare, në bazë të marrëveshjes. Prandaj kthimi nga Banka e Shtetit Shqiptar Bankës Kineze i faturave të objekteve të ndërtuara në Shqipëri, nuk është «shkelje e marrëveshjeve», siç pretendon nota kineze.

Çmimet për veprat e plota dhe për materialet e përgjithshme, mbi të cilat janë llogaritur faturat e dërguara nga Kina, janë caktuar jo në përputhje me dispozitat e marrëveshjes zyrtare ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës të datës 8.6.1965 dhe me dispozitat e letërkëmbimit të datës 22.12.1971, në të cilat përcaktohet qartë se «Çmimet për veprat e plota dhe për materialet e përgjithshme... do të përcaktohen në konsultim të përbashkët, sipas principeve të caktimit të çmimeve tregtare midis Kinës dhe Shqipërisë».

Për sa i përket ndihmës ushtarake, vlerësimet nga pala kineze janë bërë krejtësisht në mënyrë arbitrare, mbasi, në marrëveshjet e kësaj kategorie, përpara vitit 1967 vlerësimet janë shënuar në monedhën kineze, pa u konsultuar me palën shqiptare, kurse në marrëveshjet e mëvonshme, të cilat përfshijnë edhe pjesën kryesore të ndihmës ushtarake kineze për Shqipërinë, nuk përcaktohet asnjë vlerë konkrete, as në monedhën kineze dhe as në ndonjë monedhë tjetër.

Pra, ata miliarda juanë, që përmenden në notën kineze, nuk përfaqësojnë shumën e vërtetë të ndihmës ekonomike dhe ushtarake të Kinës për Shqipërinë, por janë një reklamë kineze, e sajuar mbi bazën e llogarive arbitrare, të njëanshme dhe tendencioze. Ne themi se pala kineze, për t'u shërbyer qëllimeve të saj të mbrapshta, është nxituar kur caktoi shifra të tilla. Llogaritë e plota do të bëhen sipas marrëveshjeve, protokolleve dhe kritereve të vendosura nga të dyja palët. Ato do të bëhen duke mbajtur parasysh edhe humbjet e dëmet që i janë shkaktuar ekonomisë sonë nga pala kineze, duke mos i realizuar ajo në kohën e kontraktuar detyrimet, duke e lënë një pjesë të rëndësishme të objekteve të papërfunduara etj.

Pala kineze nuk ka qenë korrekte në zbatimin e marrëveshjeve e të protokolleve zyrtare dhe të kritereve të caktuara bashkërisht. Shumica dërrmuese e objekteve ekonomike, që janë ndërtuar në Shqipëri me ndihmën në kredi nga Kina, kanë përfunduar kurdoherë me vonesë, që shkon nga 1 deri

në 8 vjet vonesë. Ka edhe objekte të tilla, siç është Uzina e Ferrokromit, e përcaktuar që të ndërtohej në Shqipëri në bazë të marrëveshjes për kredi nga Kina, të përfunduar në vitin 1965, që, për fajin e palës kineze, nuk ka përfunduar së ndërtuari akoma edhe sot e kësaj dite. Po kështu, ndërtimi i Kombinatit Metalurgjik filloi me vonesë dhe deri më sot, për fajin e palës kineze, investimet për ndërtimin e tij janë realizuar vetëm në masën 67 për qind, kundrejt vëllimit të vleftës së plotë të Kombinatit dhe nga Kina janë livruar vetëm 74 për qind e pajisjeve.

Këto shkelje flagrante të marrëveshjeve zyrtare nga pala kineze i kanë shkaktuar dëme të mëdha ekonomisë shqiptare dhe për këtë qeveria kineze mban përgjegjësi të plotë materiale dhe morale. Kur të llogariten në bazë të dokumentacionit zyrtar e të fakteve konkrete të gjitha këto, atëherë do të shihet se kush e sa i ka borxh tjetrit.

Në notën kineze ndihma që i ka dhënë Kina Shqipërisë paraqitet si faktori vendimtar i zhvillimit të vendit tonë. Por ajo nuk ka qenë e nuk mund të ishte një faktor i tillë. Faktori vendimtar, që nuk mund ta mohojë askush, ka qenë puna dhe lufta e vendosur, këmbëngulëse dhe heroike e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, për ndërtimin e socializmit, sipas parimit leninist të mbështetjes në forcat e veta. Sukseset madhështore, të arritura nga Shqipëria në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e vendit, janë vepër e Partisë së Punës të Shqipërisë, e shtetit shqiptar të diktaturës së proletariatit, e popullit shqiptar dhe jo fryt i ndihmës nga jashtë.

Ndihma e marrë nga Kina ka qenë vetëm faktor ndihmës. Gjithë kreditë kineze, të përdorura deri në fund të vitit 1977 nga Shqipëria, në raport me të ardhurat tona kombëtare, përfaqësonin një përqindje fare të vogël. Ky është realiteti dhe jo paraqitja e gënjeshtërt e palës kineze, që kërkon të krijojë përshtypjen sikur është Kina që e ka mbajtur gjallë popullin shqiptar.

Konceptet e shovinizmit të shtetit të madh i kanë errësuar logjikën udhëheqjes kineze dhe e kanë bërë atë të flasë me gjuhën e pronarëve feudalë. Në notën kineze përmendet me mburrje se Kina i ka livruar Shqipërisë 1,8 milion ton grurë etj. Gati sa s'thuhet se Shqipëria «e ka mbajtur shpirtin me bukën e Kinës»!

Ky është një qëndrim ofendues për popullin shqiptar. E vërteta është që Shqipëria, gjatë periudhës 1956-1975, ka importuar nga Kina grurë. Jo vetëm shifra që jepet nuk i përgjigjet realitetit, por duhet thënë se Shqipëria vetëm 436 000 tonë grurë ka marrë me kredi nga Kina, gjatë gjithë kësaj pe-

riudhe, ndërsa e gjithë pjesa tjetër është marrë prej saj në rrugë tregtare, duke e paguar grurin me klering. Përderisa në notën kineze është përmbledhur në një shifër të vetme si gruri i importuar nga Shqipëria me kredi, ashtu dhe gruri i importuar me klering, përse pala kineze nuk përmend edhe çfarë ka marrë nga Shqipëria, çfarë është eksportuar me klering nga Shqipëria në Kinë gjatë periudhës 1954-1977? Shqipëria i ka livruar Kinës mbi 1,7 milion ton naftë, mbi 1,3 milion ton bitum, rreth 2,7 milionë tonë mineral kromi e koncentrat kromi etj.

Duke përmendur ndihmën ushtarake në notën e saj dhe duke e bërë publike këtë notë, qeveria kineze ka përhapur me dashje sekretin ushtarak mbi mbrojtjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Me këtë veprim, qeveria kineze ka dëmtuar rëndë mbrojtjen e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe ka ndihmuar armiqtë e saj të jashtëm, veçanërisht forcat e Paktit të NATO-s e imperializmin amerikan dhe forcat e Traktatit të Varshavës e socialimperializmin sovjetik. Ky është një akt pabesie dhe për këtë qeveria kineze mban përgjegjësi.

Në notën e qeverisë kineze një vend të veçantë zënë përpjekjet për të akuzuar punonjësit shqiptarë, se këta gjoja nuk kanë respektuar dhe nuk kanë dashur të bashkëpunojnë me specialistët kinezë që kanë ardhur në Shqipëri. Këto janë trillime fund e krye dhe nuk ia vlen barra t'i përgënjeshtrojmë. Ne jemi të bindur se në ndërgjegjen e tij asnjë specialist kinez, që ka jetuar e ka punuar midis popullit tonë, nuk do t'i aprovojë akuzat që bëhen. Punëtorët, specialistët dhe drejtuesit shqiptarë gjatë gjithë kohës kanë bashkëpunuar në frymë vëllazërore e miqësore me specialistët kinezë, kanë vlerësuar drejt punën e tyre, kanë respektuar dijet dhe eksperiencën e tyre.

Duke ndjekur qëllime të caktuara, në notën kineze thuhet se në Shqipëri janë dërguar 6 000 specialistë brenda 24 vjetëve. Kjo shifër globale serviret për të thënë se gjoja për ndërtimet, për industrinë, për bujqësinë e për çdo gjë që është bërë në Shqipëri merita u takon këtyre 6 000 specialistëve. Por ndërtimi i Shqipërisë së re është vepër e vetë popullit shqiptar. Në ndërtimin e veprave të ndryshme kanë punuar, çdo ditë e vazhdimisht, me dhjetëra mijë specialistë, inxhinierë e teknikë shqiptarë, pa përmendur teknikët e mesëm e punëtorët e kualifikuar, që janë qindra mijë. Pa punën e dijet e tyre asnjë vepër nuk mund të ndërtohej.

Gjithashtu, në notën kineze nuk thuhet se specialistët e dërguar nga Kina për punën e tyre janë paguar jo pak nga populli shqiptar. Kjo nuk përmendet, por nota nuk mungon të

na kujtojë se Kina paska harxhuar 100 milionë juanë për të bërë eksperimente lidhur me hekurin shqiptar! Dhe, në të njëjtën kohë, të urdhëruar nga lart, specialistët kinezë, që u tërhoqën nga Shqipëria, nuk u lanë specialistëve shqiptarë asnjë dokument teknik, por i dogjën, ose i morën me vete të gjitha dokumentet teknike që kishin për objektet që ndërtoheshin në Shqipëri me ndihmën e Kinës.

Për çështje konkrete ekonomike në mes dy partnerësh, midis dy shtetesh është e natyrshme të lindin probleme të ndryshme, për zgjidhjen e të cilave është e nevojshme dhe e domosdoshme të zhvillohen diskutime. Por udhëheqja kineze nuk e ka ndier të nevojshme të zhvillonte diskutime normale, pse donte t'i impononte Shqipërisë mendimet e saj. Pala kineze, jo sot, por për një periudhë kohe të gjatë, për çështjet ekonomike ka ushtruar ndaj Shqipërisë presione të shumta, në forma e në mënyra të ndryshme. Gjatë bisedimeve për nënshkrimin e marrëveshjeve për dhënien ndihmë ekonomike në kredi Shqipërisë nga Kina e pastaj edhe për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, janë bërë debate të shumta dhe janë kundërshtuar me sukses nga pala shqiptare pikëpamjet e udhëheqjes kineze, që kërkonte t'i impononte Shqipërisë një zhvillim ekonomik të njëanshëm, të frenonte përparimin e shpejtë e të sigurt të saj.

Në debatet e zgjatura, presioni i udhëheqjes kineze ka arritur gjer në atë shkallë, saqë pala kineze të hiqte dorë nga projektimi i Hidrocentralit të Vaut të Dejës dhe i atij të Fierzës, me qëllim që ne të mos i ndërtonim fare këto objekte industriale shumë të rëndësishme. Udhëheqja kineze mendonte se Shqipëria, meqë, sipas saj, nuk kishte forca teknike për të projektuar vetë të tilla hidrocentrale të mëdha e të vështira, do të hiqte dorë nga ndërtimi i këtyre objekteve. Por, më në fund, ajo u detyrua të pranonte dhënien e kredisë, mbasi pala shqiptare mori përsipër që t'i projektonte vetë këto dy hidrocentrale. Dhe këto dy hidrocentrale u projektuan dhe u ndërtuan nga specialistët shqiptarë, kurse specialistët kinezë kanë luajtur rolin jo të projektuesit, por të konsulentit.

Faktet dhe dokumentet e shumta tregojnë se në momente të caktuara, sa herë që politika kineze ka marrë kthesa të mëdha, me të cilat Partia dhe Qeveria Shqiptare nuk janë bashkuar, qeveria kineze i ka shoqëruar ato me presione e masa shtrënguese ekonomike nga më të ndryshmet. Këto qëndrime janë një përgënjeshttrim flagrant i deklaratave të bujshme dhe të përsëritura të qeverisë kineze, sipas të cilave «në dhënien e ndihmës vendeve të tjera qeveria kineze respekton me përpikëri sovranitetin e vendeve që marrin ndihmë dhe nuk e shoqëron kurrë atë me kushte, ose nuk kërkon asnjë privilegj».

Në notën kineze thuhet se «...pala shqiptare, si rezultat i nevojave të politikës së saj të brendshme dhe të jashtme... me dashje ka shpifur për ndihmën e Kinës ndaj Shqipërisë...». Kjo tregon shpirtin intrigant të udhëheqjes kineze dhe dëshirën e saj që ta shohë Shqipërinë të robëruar politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht nga socialimperializmi sovjetik ose nga imperializmi amerikan e borgjezia reaksionare. Udhëheqja kineze flet kështu pse mendon se Shqipëria qenka e izoluar, se ajo merrte frymë dhe rronte në sajë të Kinës dhe tashti paska mbetur në mes të rrugës dhe do të bjerë si një gjah në pritën e imperialistëve ose të socialimperialistëve. Kështu kanë menduar e kanë folur dikur edhe Hrushovi e Mikoiani, se Shqipëria do të shitej për «tridhjetë aspra», se ajo «do të vdiste për bukë pas 15 ditësh pa ndihmat sovjetike»!

Por jeta tregoi se Shqipëria as u shit, as vdiq për bukë. Ajo eci përpara në ndërtimin e socializmit me sukses të madh. Dhe kjo u bë jo në sajë të ndihmës kineze, por në sajë të punës heroike e të luftës së lavdishme të popullit shqiptar.

Edhe në të ardhmen populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, duke u mbështetur në forcat e veta, do të ecë gjithmonë fitimtar në rrugën e socializmit, duke u treguar me shembullin e vet miqve dhe popujve forcën dhe vitalitetin e pamposhtshëm të marksizëm-leninizmit, forcën e socializmit, forcën e popullit.

Në luftën tonë për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, në përpjekjet tona për të përballuar e për të kapërcyer me sukses vështirësitë, që i krijohen vendit tonë nga veprimi armiqësor i qeverisë kineze, ne kemi e do të kemi edhe më tepër ndihmën internacionaliste të revolucionarëve të vërtetë, të popujve liridashës e të njerëzve përparimtarë në të gjithë botën. Shqipëria kurrë nuk ka qenë e izoluar, ajo kurrë nuk do të mund të izolohet.

Planet e zhvillimit të Shqipërisë, të caktuara nga Partia, do të realizohen në të gjitha drejtimet, duke përfshirë edhe ato objekte që Kina i la pa përfunduar, si dhe veprat e tjera të reja, që do t'u shtohen këtyre me punën vetëmohuese, me vendosmërinë e popullit dhe me forcat e veta.

II

Prishja e njëanshme e marrëveshjeve të bashkëpunimit ekonomik dhe ushtarak me Shqipërinë nga ana e qeverisë kineze, shkelja arbitrare nga ajo e kontratave të përfunduara zyrtarisht midis dy vendeve, lënia pa mbaruar e mjaft objekteve të rëndësishme për ekonominë tonë socialiste, tërheqja e specialistëve etj., pasqyrojnë një vijë politike dhe ideologjike të caktuar të

udhëheqjes kineze. Ato janë rrjedhim i devijimit të udhëheqjes kineze nga marksizëm-leninizmi dhe nga parimet e internacionalizmit proletar, i afrimit dhe i bashkëpunimit të saj me imperializmin amerikan, me kapitalin ndërkombëtar dhe me reaksionin, i heqjes dorë nga ndihma e përkrahja e forcave revolucionare e çlirimtare në arenën ndërkombëtare, i synimeve të Kinës për t'u bërë një superfuqi imperialiste.

Ky kurs i udhëheqjes kineze, që ka kaluar nëpër një proces plot me zigzage, ka ndeshur në kundërshtimin e vazhdueshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë, për të cilën çështja e socializmit, e revolucionit dhe e çlirimit të popujve qëndron mbi çdo gjë. Kjo ka bërë që midis Partisë së Punës të Shqipërisë e Partisë Komuniste të Kinës të lindnin kontradikta serioze ideologjike e politike, të cilat, gradualisht, kanë ardhur duke u rritur. Pikërisht, pse Partia jonë dhe populli shqiptar nuk i kanë pranuar dhe nuk u janë nënshtruar vijës e pikëpamjeve kineze të fuqisë së madhe, udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës dhe e qeverisë kineze arritën deri atje sa i prenë ndihmat për Shqipërinë socialiste dhe i shtrinë mosmarrëveshjet ideologjike edhe në marrëdhëniet midis shteteve.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë gjatë gjithë kohës është përpjekur që këto mosmarrëveshje t'i zgjidhte në rrugë marksiste-leniniste, me konsultime dhe me sqarime shoqërore reciproke, duke mos i bërë ato kurrë publike.

Në këtë çështje Partia jonë është nisur nga parimi se midis partive e shteteve të ndryshme, qofshin këto edhe në marrëdhënie miqësie të ngushtë midis tyre, mund të lindin mosmarrëveshje e keqkuptime. Pavarësisht se cila palë është fajtoare, këto mosmarrëveshje e keqkuptime kërkojnë bashkëbisedime për t'u zgjidhur. Aq më shumë duhet zbatuar ky parim midis vendeve socialiste e partive komuniste. Norma të tilla, si konsultimet e sqarimet shoqërore reciproke, janë absolutisht të domosdoshme, sepse këto norma marksiste-leniniste mbrojnë miqësinë e pastër dhe jo miqësinë hipokrite e me qëllime të këqija, mbrojnë pastërtinë e teorisë sonë shkencore, marksizëm-leninizmin, fuqizojnë revolucionin dhe luftën e popujve.

Në normat marksiste-leniniste, që rregullojnë marrëdhëniet midis partive komuniste, ekziston edhe norma e kritikës së drejtë e reciproke, parimore e konstruktive për gabimet që vërtetohen në vijën e në veprimtarinë e njëres ose të tjetrës parti. Një kritikë e tillë shoqërore nuk mund të cilësohet polemikë, siç e interpreton udhëheqja kineze këtë normë. Polemika, siç e thotë edhe fjala vetë, është një gjendje lufte ideologjike dhe politike, është një gjendje kur mosmarrëveshjet joantagoniste kthehen në antagoniste.

Partia e Punës e Shqipërisë, në marrëdhëniet me Partinë

Komuniste të Kinës, u është përmbajtur rigorozisht këtyre parimeve e normave marksiste-leniniste që zbatohen midis partive të vërteta komuniste. Sa herë që ajo ka konstatuar te Partia Komuniste e Kinës qëndrime e veprime që binin në kundërshtim me marksizëm-leninizmin dhe me internacionalizmin proletar, në kundërshtim me interesat e socializmit e të revolucionit, ia ka vënë asaj në dukje gabimet dhe e ka kritikuar atë në mënyrë shoqërore. Për këtë ekzistojnë dokumente të shkruara të Partisë e të shtetit tonë, të cilat ju i dispononi. Por cili ka qenë qëndrimi i udhëheqjes kineze? Ndërsa mbështetja dhe mbrojtja që i kanë bërë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare Kinës Popullore mirëpriteshin dhe lavdëroheshin me të madhe nga ajo, vërejtjet e drejta e parimore të Partisë sonë nuk janë mirëpritur asnjëherë nga pala kineze. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës nuk ka dashur asnjëherë të zbatoheshin normat e metodat leniniste në marrëdhëniet midis partive. Ajo, duke arsyetuar e duke vepruar sipas koncepteve e logjikës së fuqisë së madhe, të partisë së madhe e të shtetit të madh, që e konsideron veten gjeni të pagabuar, ka treguar se nuk njeh rrugë tjetër përveç diktatit dhe imponimit të pikëpamjeve të saj ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj të vegjëlve.

Me gjithë divergjencat që ekzistonin, Partia e Punës dhe Qeveria e Shqipërisë i kanë mbështetur botërisht Kinën dhe çështjen e socializmit në Kinë, sidomos në momentet më të vështira politike, të brendshme e të jashtme, që ka kaluar ajo, në momentet kur Kina ishte e izoluar dhe sulmohej nga të katër anët, edhe nga miqtë e saj të sotëm. Partia dhe Qeveria jonë e kanë bërë këtë me zemër të hapur, të bindur se kështu mbronin fatin e revolucionit në Kinë, që kërcënohej seriozisht, se mbronin interesat e lartë të internacionalizmit proletar, miqësinë midis Shqipërisë e Kinës. Duke mbështetur Kinën kundër armiqve të socializmit dhe duke mbrojtur ato qëndrime e veprime të saj që ishin në rrugë të drejtë, komunistët dhe populli shqiptar luftonin që në Kinë të forcoheshin pozitrat e marksizëm-leninizmit e të socializmit.

Për të kuptuar edhe më mirë shkaqet politike dhe ideologjike që e çuan udhëheqjen kineze në veprimin e saj arrogant të prerjes së ndihmës për Shqipërinë, për të kuptuar qëndrimet e saj shoviniste e prej fuqie të madhe në marrëdhëniet me Partinë e Punës të Shqipërisë, si dhe për të treguar qëndrimin e sigurtë, vëllazëror e korrekt që kanë mbajtur Partia, Qeveria e populli shqiptar ndaj Kinës e popullit kinez, është e nevojshme të hedhim një vështrim mbi zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-kineze.

1. Lidhjet midis dy partive e dy vendeve tona u vendosën

pas fitores së revolucionit në Kinë, pas krijimit të Republikës Popullore të Kinës. Por ato u bënë të afërta dhe u forcuan veçanërisht pas vitit 1960, kur filloi lufta e hapur kundër revizionizmit hrushovian. Lufta kundër imperializmit e revizionizmit modern i bashkoi partitë tona, largimi i Kinës nga kjo luftë i ndau rrugët e tyre.

Lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit modern kishte filluar qysh përpara dënimit të titizmit nga ana e Byrosë Informative. Ajo vazhdoi edhe më e ashpër pas vdekjes së Stalinit, kur nisi të shfaqej varianti hrushovian i revizionizmit. Këtë luftë Partia jonë e zgjeroi dhe e intensifikoi gjithnjë e më shumë, duke kundërshtuar qëndrimet e veprimet antimarksiste të Hrushovit e të bandës së tij, si në politikën e jashtme, ashtu edhe në marrëdhëniet me partitë komuniste e veçanërisht me Partinë tonë.

Devijimi hrushovian përfaqësonte revizionimin e teorisë marksiste-leniniste në të gjitha fushat e në të gjitha çështjet. Strategjia hrushoviane synonte minimin e diktaturës së proletariatit dhe rivendosjen e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, shndërrimin e vendit në një superfuqi imperialiste për të ndarë e për të sunduar botën së bashku me imperializmin amerikan. Për realizimin e kësaj strategjie, Hrushovi sulmoi Stalinin e bolshevizmin, predikoi shuarjen e luftës së klasave, si brenda në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe jashtë tij. Me pretekstin se raporti i forcave në botën e sotme ka ndryshuar, se imperializmi amerikan dhe borgjezia reaksionare ndërkombëtare janë bërë të arsyeshme, ai justifikonte braktisjen e tezës kyç të marksizëm-leninizmit mbi revolucionin me dhunë dhe përhapte iluzionin mbi të ashtuquajturën rrugë paqësore. Në marrëdhëniet me partitë komuniste e punëtore hrushovianët vepronin sipas konceptit të «partisë mëmë» e të «shkopit të dirigjentit». Ata donin që partitë t'u nënshtroheshin diktatit dhe pikëpamjeve të tyre, të shndërroheshin në instrumente të politikës së tyre të jashtme. Në këtë rrugë Hrushovi, Brezhnjevi e të tjerë u pajtuan me revizionistët jugosllavë dhe bënë kauzë të përbashkët me ta në luftën kundër marksizëm-leninizmit e revolucionit.

Kundër kësaj vije tradhtare e kundërrevolucionare të hrushovizmit Partia e Punës e Shqipërisë luftoi me vendosmëri e pa u përkulur. Ajo, veçanërisht, nuk pranoi dhe denoncoi rehabilitimin ideologjik të titizmit nga ana e Hrushovit, i cili, me këtë veprim, dëshmonte qartë shkarjen e plotë të tij në batakun e oportunitizmit e të tradhtisë. Dokumentet vërtetojnë se edhe Partia Komuniste e Kinës, me gjithë lëkundjet që ka pasur në qëndrimet e saj ndaj revizionizmit jugosllav, në fillim të vitit 1960, pa qenë e ndikuar nga askush, e dënoi rehabilitimin e Titos e të grupit të tij nga ana e Hrushovit.

Në qershor të vitit 1960, siç dihet, u bë Mbledhja e Bukureshtit. Atje u vërtetua edhe më mirë vija kundërrevolucionare e Hrushovit dhe e hrushovianëve. Ata jo vetëm sulmuan marksizëm-leninizmin në të gjitha drejtimet, por sulmuan drejtpërdrejt edhe Partinë Komuniste të Kinës. Partia e Punës e Shqipërisë në këtë Mbledhje i erdhi hapur në ndihmë Partisë Komuniste të Kinës dhe e mbrojti atë deri në fund, duke tërhequr mbi vete zjarrin e zemërimit e peshën e presioneve të të gjithë revizionistëve hrushovianë. Këtë mbrojtje parimore Partia jonë e bëri me ndërgjegje të pastër komuniste, duke menduar dhe duke qenë e bindur se mbronte marksizëm-leninizmin dhe Kinën Popullore.

Mbledhja e Bukureshtit dhe më pas Mbledhja e 81 partive komuniste e punëtore në Moskë shënuan ndarjen definitive midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve hrushovianë dhe fillimin e polemikës së hapur midis tyre. Ndërsa Partia jonë e filloi dhe e zhvillonte luftën kundër revizionizmit hrushovian me konsekuencë e vendosmëri, udhëheqja kineze tregonte lëkundje dhe nuk mbante qëndrime të prera antihrushoviane. Në kohët e para të polemikës së ashpër, në mes Partisë së Punës të Shqipërisë dhe revizionistëve hrushovianë, Kina ishte dakord me Shqipërinë, por vetëm në sipërfaqe, pasi, në të vërtetë, siç u provua më vonë, ajo synonte pajtimin me sovjetikët dhe shuarjen e polemikës. Kjo u duk edhe në fjalimin e Çu En Lait në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku ai, në fakt, nuk mbrojti Partinë tonë, por kërkoi që të shuhej polemika. Kjo pozitë e zbehtë e udhëheqjes kineze është quajtur prej saj si ndihmë për Shqipërinë, por kërkesa për shuarjen e polemikës nuk ishte as në interesin e Shqipërisë socialiste, as në interesin e vetë Kinës. Ajo favorizonte Hrushovin e luftën e tij kundër socializmit dhe marksizëm-leninizmit.

2. Qëndrimi i lëkundur i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kundër revizionizmit u duk më qartë në qershor të vitit 1962. Në këtë kohë Partia e Punës e Shqipërisë dërgoi një delegacion të saj në Pekin për të biseduar me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës për çështje të rëndësishme, që kishin të bënin me taktikën dhe strategjinë e luftës së përbashkët të të dyja partive në arenën ndërkombëtare. Delegacioni i Partisë sonë u ndesh në atë rast me pikëpamjet shumë të gabuara të udhëheqjes kineze.

Liu Shao Çia, që atëherë ishte udhëheqësi kryesor në Partinë Komuniste të Kinës, pas Mao Ce Dunit, i cili udhëhoqi bisedimet për palën kineze, si edhe Ten Hsiao Pini, që atëherë ishte sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste të Kinës, shtruan me këmbëngulje pikëpamjen e udhëheqjes kineze,

sipas së cilës fronti antiimperialist duhej të përfshinte me doemos edhe Bashkimin Sovjetik, që në atë kohë udhëhoqej nga klika revizioniste e Nikita Hrushovit.

Delegacioni i Partisë sonë mbrojti vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë, që mbështetet në mësimet e Leninit, sipas të cilave, nuk mund të luftohet me sukses kundër imperializmit pa luftuar, në të njëjtën kohë, edhe kundër revizionizmit. Delegacioni ynë insistoi në pikëpamjen e Partisë së Punës të Shqipërisë që fronti antiimperialist jo vetëm që nuk duhet të përfshijë edhe revizionistët sovjetikë, por duhet ta drejtojë luftën e vet, në të njëjtën kohë, si kundër imperializmit në përgjithësi dhe imperializmit amerikan në veçanti, ashtu edhe kundër revizionizmit sovjetik.

Vijën e pajtimit me revizionistët sovjetikë udhëheqja kineze e motivonte me nevojën e bashkimit «me të gjithë» kundër imperializmit amerikan, që, siç thoshte ajo, ishte armiku kryesor. Kjo tezë oportuniste, veç të tjerave, shprehte edhe iluzionet e udhëheqjes kineze ndaj krerëve revizionistë sovjetikë. Ten Hsiao Pini i deklaroi delegacionit të Komitetit Qendror të Partisë sonë, gjatë bisedimeve në Pekin, se «Është e pamundur që Hrushovi ta ndryshojë veten e të bëhet si Titoja... Bashkimi Sovjetik kurrë nuk mund të ndryshojë si vend socialist»¹.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk i pranoi këto pikëpamje dhe as tezën kineze mbi frontin unik antiimperialist, ku të përfshiheshin edhe revizionistët hrushovianë. Ndërsa udhëheqja kineze qëndroi në pozitën e veta oportuniste.

Zhvillimi i ngjarjeve të mëvonshme, rritja e luftës së forcave marksiste-leniniste kundër revizionizmit hrushovian, thellimi i veprimtarisë përçarëse të Hrushovit e sidomos nënshkrimi i Traktatit anglo-sovjeto-amerikan, në gusht 1963, për ndalimin e provave të armëve bërthamore në atmosferë, që pasqyronte bashkimin e përpjekjeve të të dy superfuqive për vendosjen e sundimit të tyre mbi botën, e detyruan udhëheqjen kineze të fillonte polemikën e hapur me Hrushovin. Në këtë mënyrë, kur pajtimi dhe ujdia e dëshiruar e udhëheqjes kineze me revizionistët sovjetikë nuk u realizuan, Partia Komuniste e Kinës vetëm atëherë hyri efektivisht në rrugën e antihrushovizmit dhe u puq me luftën e vendosur konsekuente e parimore të Partisë së Punës të Shqipërisë. Kjo nuk mund të mos e gëzonte Partinë e Punës të Shqipërisë e popullin shqiptar, të cilët, të vetëm, kishin gati tre vjet që po përballonin sulmet e hapëta e të tërbuara të Hrushovit dhe të mbarë revizionizmit modern. Lidhjet dhe bashkëpunimi midis dy partive tona

¹ Nxjerrë nga procesverbal i bisedimeve. 11 qershor 1962. AQP.

në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit u forcuan edhe më shumë.

Partia jonë ka bërë të gjitha përpjekjet që kjo luftë të zgjerohej e të thellohej, mbasi i shërbente mobilizimit të forcave antiimperialiste e antirevizioniste për mbrojtjen e çështjes së socializmit e të çlirimit të popujve. Por udhëheqja kineze, siç do ta shohim më poshtë, nuk u tregua konsekuente e parimore në këtë luftë.

3. Në verën e vitit 1964 propaganda kineze filloi të fliste për problemet kufitare kino-sovjetike. Duke iu referuar një bisede të Mao Ce Dunit me një grup parlamentarësh socialistë japonezë, ajo thoshte se territore të gjera prej qindra mijë kilometrash katrorë i ishin rrëmbyer Kinës nga carët rusë, se probleme territoriale, të lindura si rezultat i Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik kishte edhe në Evropë.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk e aprovoi ngritjen nga ana e Mao Ce Dunit të çështjes së rishikimit të kufijve. Sipas pikëpamjes së Partisë sonë, udhëheqja kineze bënte dy gabime të rënda. Në radhë të parë, ngritja e çështjes së kufijve, në atë moment, nuk ndihmonte luftën ideologjike kundër hrushovizmit. Përkundrazi, ajo i jepte udhëheqjes sovjetike një armë të fortë për ta përdorur kundër Kinës dhe marksistë-leninistëve, për të neutralizuar efektin e luftës ideologjike, që ata bënin për demaskimin e tradhtisë hrushoviane dhe për ta paraqitur çështjen sikur qëllimi i luftës sonë ishte punë kufijsh, punë rivendikimesh territoriale. Nga ana tjetër, duke vënë në diskutim rregullimet që u bënë pas Luftës së Dytë Botërore në kufijtë e Bashkimit Sovjetik me disa vende evropiane, atakohej padrejtësisht J. V. Stalini dhe mbështetej akuza e reaksionit ndërkombëtar kundër tij për krijimin e «zonave të influencës». Udhëheqja kineze puqej me Titon, i cili e përkrahte këtë tezë, por që vetë, kur ishte fjala për të vënë në vend padrejtësitë që fuqitë fituese në të kaluarën i kishin bërë Jugosllavisë, ngrinte zërin në qiell, ndërsa për padrejtësitë që i ishin bërë një populli tjetër, këtë herë në favor të Jugosllavisë, mbante heshtje të plotë.

Teza kineze për rishikimin e kufijve nuk ishte një çështje e thjeshtë. Ajo shprehte frymën e shovinizmit të shtetit të madh e të nacionalizmit borgjez, ajo ushqente nxitjen e luftës në Evropë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke respektuar normat leniniste, në frymën e korrektësisë së plotë dhe në rrugën shoqërore, ia tha hapur pikëpamjet e veta për këto çështje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe personalisht kryetarit Mao Ce Dun, me anën e një letre dërguar atyre më 10 shtator 1964.

Ndër të tjera, në këtë letër thuhej: «Ne mendojmë se, aktualisht, të ngresh çështjet territoriale me Bashkimin Sovjetik është një dëm i rëndë për luftën tonë. Po ta bënim këtë, atëherë do t'i jepnim armikut një armë të madhe për të na luftuar dhe kjo do të paralizonte ecjen tonë përpara».

«Masat e popullit sovjetik, nën presionin e propagandës revizioniste të Hrushovit, nën influencën e shpifjeve e të trillimeve të Hrushovit dhe për shumë arsye të tjera, nuk do ta kuptojnë përse Kina Popullore të paraqesë tani rivendikime territoriale ndaj Bashkimit Sovjetik, nuk do ta pranojnë këtë dhe po punohet nga propaganda sovjetike që ata të revoltohen kundër jush. Por edhe komunistët e vërtetë sovjetikë nuk do ta kuptojnë dhe nuk do ta pranojnë, mendojmë ne. Kjo do të jetë një humbje kolosale për luftën tonë».

«...ne mendojmë se nuk duhet të hapim plagë të vjetra, në qoftë se ka, nuk duhet të hapim luftë e polemikë nëse Bashkimi Sovjetik u ka marrë ose jo toka të tjerëve, por lufta jonë e vetme, e koncentruar, duhet të jetë kundër plagës së madhe, kundër tradhtisë së madhe, që janë: imperializmi e revizionizmi modern, grupet tradhtarë të Hrushovit, të Titos dhe të gjithë besnikët e tyre».

Letrës parimore dhe korrekte të Partisë sonë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës nuk iu përgjigj. Udhëheqja kineze kurrë nuk i dha ndonjë sqarim Partisë sonë mbi këtë çështje me rëndësi të madhe. Mao Ce Duni u kufizua vetëm me një deklaratë verbale, se «Nuk do t'i përgjigjemi letrës suaj, që të mos bëjmë polemikë». Sipas pikëpamjes sonë, në bazë të normave leniniste, shkëmbimi i mendimeve, kritika shoqërore dhe sqarimi i njëri-tjetrit janë normale midis dy partive komuniste. Ato nuk janë aspak polemikë.

Me gjithë këtë qëndrim jokorrekt të udhëheqjes kineze, Partia jonë nuk e bëri publike këtë mosmarrëveshje. Ajo e vazhdoi luftën e vet revolucionare kundër imperializmit e revizionizmit së bashku me Kinën.

4. Në muajin tetor të vitit 1964 u rrëzua N. Hrushovi. Kjo ngjarje nxori përsëri në shesh qëndrimin e lëkundur të udhëheqësve kinezë ndaj revizionistëve sovjetikë. U ringjallën përsëri dëshirat për një pajtim e afrim me ta.

Më 29 tetor 1964, Çu En Lai, në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Këshillit të Shtetit të Republikës Popullore të Kinës, në prezencë të ambasadorëve të Vietnamit, të Koresë, të Rumanisë e të Kubës, i kërkoi ambasadorit shqiptar në Pekin që t'i transmetonte Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë propozimin kinez që partitë tona të dërgonin delegacione në Moskë për të mbë-

shtetur udhëheqjen e re të Bashkimit Sovjetik, me në krye Brezhnjev, dhe për t'u bashkuar me të «në luftën kundër armikut të përbashkët, imperializmit». Ai shtoi se për këtë i kishte sugjeruar palës sovjetike që t'i bënte ftesë edhe Shqipërisë për të marrë pjesë në festimet e 7 Nëntorit.

Në atë takim, duke argumentuar pikëpamjen e udhëheqjes kineze, Çu En Lai tha: «Në Bashkimin Sovjetik ndodhën ndryshime. Influenca dhe rëndësia e tyre nuk kufizohet vetëm në Bashkimin Sovjetik, por shtrihet deri në partitë dhe në vendet socialiste dhe në gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, bile edhe në armiqtë tanë të përbashkët dhe agjentët e tyre. Me një fjalë, kjo është një gjë e mirë, është bërë një ndryshim».

«Për këto arsye ne i bëmë edhe telegram urimi udhëheqjes së re të partisë dhe të qeverisë së Bashkimit Sovjetik, duke u shprehur se e mbështetim dhe e mirëpresim një ndryshim të tillë».

«Tani, në Pekin, në shtypin tonë kemi bërë armëpushim, që nga 16 tetori».

«Këtë ne e bëjmë me qëllim që të bashkohemi, mbi bazat e marksizëm-leninizmit, kundër armikut të përbashkët, megjithëse shumë probleme të mëdha tani për tani mund të mos zgjidhen».

Megjithëse Çu En Lai e dinte se midis Bashkimit Sovjetik e Shqipërisë nuk kishte as marrëdhënie diplomatike, të cilat ishin prerë brutalisht me iniciativën e hrushovianëve, ai insistoi që Shqipëria të dërgonte një delegacion në Moskë dhe i tha ambasadorit tonë: «Ne mendojmë që shokët shqiptarë ta studiojnë propozimin tonë, se ky është një rast i mirë për t'u zgjatur dorën dhe për t'u bashkuar në luftë kundër armiqve».

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk mund ta pranonte këtë propozim, që kërkonte shkuarjen e luftës kundër revizionizmit dhe pajtimin ideologjik me të. Po të pranohej kjo vijë pajtimi me revizionistët sovjetikë do të ishte katastrofike për lëvizjen marksiste-leniniste, do të ishte një goditje shkatërrimtare për të. Prandaj Partia jonë e refuzoi kategorikisht kërkesën e udhëheqjes kineze dhe e hodhi poshtë atë me vendosmëri.

Në letrën që i dërgoi Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, më 5 nëntor 1964, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpjegoi me durim e me korrektësi marksiste-leniniste se vlerësimi që udhëheqja kineze u bënte ndryshimeve që ndodhën në Bashkimin Sovjetik ishte i gabuar dhe propozimi i tyre për të shkuar në Moskë ishte i papranueshëm.

Në këtë letër, midis të tjerave, thuhej:

«Kjo ngjarje, megjithëse e rëndësishme dhe që nuk mund të mos ketë rrjedhime serioze, prapëseprapë, të paktën gjer

më sot, ajo nuk e ka çuar revizionizmin në disfatën e plotë, nuk ka shënuar akoma fitoren përfundimtare të marksizëm-leninizmit mbi revizionizmin, por vetëm e ka shtyrë më tej kalbëzimin e revizionizmit, e ka afruar revizionizmin më shumë afër varrit, kurse pasardhësit e Hrushovit përpigën ta shpëtojnë revizionizmin nga ky varr, duke zbatuar politikën e hrushovizmit pa Hrushovin».

«Megjithëse largimi i N. Hrushovit nga skena politike është një fitore e rëndësishme për marksizëm-leninizmin, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mendon se nuk duhet mbivlerësuar ajo, se nuk duhet ulur vigjilenca e marksistë-leninistëve dhe as të pushohet lufta e tyre parimore për shpartallimin e revizionizmit modern hrushovian».

«Ne mendojmë se polemika e hapët dhe parimore, për demaskimin e pandërprerë të revizionizmit modern duhet të vazhdojë edhe sot e gjer në fund, gjersa të varroset fare revizionizmi si ideologji... Tërheqja jonë nga këto pozita të fituara me luftë do të ishte një humbje për ne dhe një përfitim për revizionistët».

«Ne mendojmë se nuk është e lejueshme për ne, as marksiste, as dinjitoze si shtet sovran, që, në këto kushte, kur qeveria sovjetike ka prerë me iniciativën e saj marrëdhëniet diplomatike dhe ka bërë kundër nesh veprime të tmerrshme antimarksiste, t'i injorojmë këto gjëra, vetëm e vetëm nga fakti se u mënjana personi i N. Hrushovit».

«Për këto arsye ne u detyruam të shfaqim kundërshtimin tonë lidhur me propozimin e shokut Çu En Lai, që një delegacion shqiptar të ftohej nga partia dhe qeveria sovjetike për të marrë pjesë në festën e 7 Nëntorit».

Edhe ndaj kësaj letre të brendshme të Partisë sonë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës mbajti një qëndrim mospërfillës. Udhëheqja kineze nuk iu përgjigj kurrë as kësaj letre dhe nuk i mori në konsideratë vërejtjet e arsyeshme e shoqërore që bëheshin në të.

Çu En Lai, në krye të një delegacioni të partisë e të qeverisë kineze, vajti në Moskë më 7 nëntor 1964 për të përshëndetur ardhjen në fuqi të Brezhnjev. Por, siç e vërtetuan faktet, ai nuk pati sukses në misionin e ngarkuar për pajtim e ujdi me udhëheqjen e re sovjetike dhe, me t'u kthyer ai në Kinë, udhëheqja kineze u detyrua të rifillojë polemikën me Bashkimin Sovjetik.

Pra, rezultoi se qëndrimi që mbajti Partia jonë dhe vlerësimi që u bëri ajo ngjarjeve, lidhur me rrëzimin e Hrushovit, ishin të drejtë, marksistë-leninistë. Kurse pozita e udhëheqjes kineze ishte pajtuese, oportuniste dhe krejtësisht e gabuar në vlerësimin dhe në qëndrimin ndaj udhëheqjes së re revizio-

niste të Bashkimit Sovjetik. Megjithëkëtë, edhe pse udhëheqja kineze nuk u tregua korrekte e nuk bëri asnjë autokritikë, megjithëse divergjencat ideologjike u thelluan më tepër, Partia jonë vazhdoi të ecte përpara në luftën e saj për forcimin e miqësisë e të bashkëpunimit me Partinë Komuniste të Kinës, duke shpresuar se kjo do të ndihmonte që udhëheqja kineze të zinte pozita të shëndosha në luftën e përbashkët kundër revizionizmit e imperializmit.

5. Pavarësisht nga kontradiktat që kishin lindur midis nesh, Partia e Punës e Shqipërisë, duke pasur parasysh situatat e vështira nëpër të cilat kalonte Kina dhe duke dëshiruar sinqerisht t'i ndihmonte Partinë Komuniste të Kinës dhe popullin kinez për t'i kapërcyer ato, vazhdoi ta përkrahte Kinën me vendosmëri, sidomos në ato çështje politike dhe ideologjike ku pikëpamjet tona pugeshin.

Partia jonë e mbështeti Revolucionin Kulturor me kërkesën personale të vetë Mao Ce Dunit, i cili i deklaroi Partisë sonë se Kina gjendej përpara një rreziku kolosal dhe nuk dihej se kush do të fitonte në Kinë, forcat socialiste apo revizionistët¹. Partia e Punës e Shqipërisë e ndihmoi Kinën në një periudhë shumë kritike, kur ajo kalonte nëpër tronditje të mëdha dhe sulmohej egër nga fronti i bashkuar imperialisto-revizionist. Ajo mbështeti vijën e përgjithshme të Revolucionit Kulturor për likuidimin e elementëve kapitalistë e revizionistë, që kishin shtënë në dorë pozita kyç në parti e në pushtet, pavarësisht se nuk ishte dakord me shumë çështje parimore dhe metoda që u përdorën dhe e udhëhoqën këtë revolucion. Duke mbështetur Revolucionin Kulturor, Partia jonë kishte shpresë se ai do ta gjente rrugën e luftës së vërtetë revolucionare, të udhëhequr nga klasa punëtore dhe avangarda e saj, Partia Komuniste. Gjithë periudha e Revolucionit të Madh Kulturor ishte një periudhë shumë e vështirë për socializmin në Kinë dhe krijoi një gjendje të koklavitur dhe kaotike. Kjo gjendje ishte rezultati logjik i luftërave fraksioniste joparimore, që kanë pasur vend në gjirin e Partisë Komuniste të Kinës gjatë periudhës së luftës për zhvillimin e revolucionit demokratiko-borgjez dhe, pas vitit 1949, për rrugën që do të ndiqte Kina në zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit.

Idetë e mëdha të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe ideologjia marksiste-leniniste nuk u bënë si duhet shembulli, boshti dhe busulla e Partisë Komuniste të Kinës në kushtet konkrete të Kinës. Kjo bëri që edhe ajo bërthamë marksiste-leniniste e Partisë të zhytej në një eklektizëm

¹ Nxjerrë nga procesverball i bisedës me delegacionin e Partisë e të Qeverisë Shqiptare. Maj 1966. AQP.

të rrezikshëm, që i dha shkas një kaosi të papërmbajtur lufte fraksionesh, personash dhe grupesh me pikëpamje të shumëllojta jomarksiste-leniniste për pushtet, gjë që pengoi seriozisht ndërtimin e themeleve të socializmit në Kinë. Ky kaos politik, ideologjik dhe organizativ i Partisë Komuniste të Kinës dhe i shtetit kinez bëri që elementë kapitalistë e revizionistë të shtinin në dorë pozitat kyç në parti, në pushtet dhe në ushtri. Në këto kushte shpërtheu Revolucionin Kulturor, i frymëzuar dhe i udhëhequr nga vetë Mao Ce Duni.

Partia e Punës e Shqipërisë e mbështeti strategjinë e përgjithshme të Revolucionit Kulturor. Por ne duam të theksojmë se Partia jonë mbështeti strategjinë e këtij revolucion dhe jo çdo taktikë të tij. Ajo mbrojti me vendosmëri çështjen e socializmit në Kinë, mbrojti popullin vëlla kinez, Partinë Komuniste të Kinës e revolucionin dhe nuk mbrojti aspak luftën fraksioniste të grupeve antimarksiste, cilatdo që të ishin ato, që përplaseshin dhe përlesheshin deri edhe me armë në mes tyre, në mënyrë të hapët ose të maskuar, për të rimarrë fuqinë.

Revolucioni Kulturor, në më të shumtën e herës, ruajti frymën dhe veprimet e një lufte joparimore, jo të udhëhequr nga një parti e vërtetë e klasës punëtore, që të luftonte për vendosjen e diktaturës së proletariatit. Këto përleshje midis grupeve fraksioniste përfunduan kështu në Kinë me vendosjen e një pushteti të sunduar nga elementë borgjezë dhe revizionistë.

Udhëheqja aktuale kineze ka dashur dhe do që Partia e Punës e Shqipërisë të dënojë Revolucionin Kulturor, sipas dëshirës dhe arsyeve të udhëheqjes kineze. Partia e Punës e Shqipërisë kurrë nuk do ta pranojë një diktat të tillë. Ajo dhe gjithë revolucionarët e botës presin që Partia Komuniste e Kinës të bëjë analizën e vërtetë të këtij Revolucionit Kulturor, të ketë guximin të thotë të vërtetën mbi idetë që e udhëhoqën këtë revolucion, mbi grupet dhe njerëzit që e zhvilluan dhe e udhëhoqën, mbi ata kundër të cilëve u drejtua ky revolucion dhe të mbajë qëndrime të qarta mbi këto çështje. Udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës deri sot s'e ka bërë një gjë të tillë, se ajo u trembet fakteve, ndodhive dhe interpretimit të vërtetë marksist-leninist të tyre.

6. Partia e Punës e Shqipërisë ka bërë përpjekje të shumanshme në drejtim të mbrojtjes së fortë dhe të hapët të Kinës në arenën ndërkombëtare, megjithëse, për mjaft çështje, kishte pikëpamje të kundërta parimore me të. E tillë është lufta diplomatike e gjatë e këmbëngulëse e Shqipërisë socialiste, për rivendosjen e të drejtave të ligjshme të Republikës Popullore të Kinës në Kombet e Bashkuara, të cilat i mohoheshin nga imperializmi amerikan dhe aleatët e tij.

Në marrëdhënie me vendet e tjera të botës Kina ndiqte

një politikë të mbyllur. Udhëheqja e Partisë sonë, në raste të veçanta e në mënyrë shoqërore, u kishte shfaqur dëshirën udhëheqësve kinezë që Kina Popullore të ishte më aktive në politikën e jashtme, të zgjeronte kontaktet dhe marrëdhëniet politike, ekonomike, kulturore etj. me vendet e ndryshme e, sidomos, me vendet fqinje të saj. Sipas pikëpamjes sonë, kjo do të ishte në interes të vetë Kinës dhe të çështjes së socializmit e të revolucionit në botë. Por udhëheqja kineze nuk e gjeti të arsyeshme këtë dëshirë të Shqipërisë dhe preferoi izolimin e vet, duke u nxjerrë pretekste të ndryshme të gjitha atyre shteteve, që shfaqnin dëshirën të vendosnin marrëdhënie me të.

7. Në vitin 1968 në Kinë shkoi një delegacion partie dhe qeverie i Shqipërisë, në krye të të cilit ishte ish-anëtari i Byrosë Politike dhe ish-zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave e ish-ministër i Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku. Ky delegacion ishte ngarkuar me detyrën që t'i shtronte udhëheqjes kineze edhe kërkesat tona për ndihmë për forcimin e fuqisë mbrojtëse të Shqipërisë.

Çu En Lai, në atë rast, i tha haptas Beqir Ballukut pikëpamjen e udhëheqjes kineze, sipas së cilës, Shqipërisë, si një vend i vogël, nuk i duheshin armatime të rënda dhe ajo nuk ishte kurrsesi në gjendje që të mbrohej vetëm me forcat e veta nga një agresion i jashtëm, veçanërisht nga socialimperializmi sovjetik dhe nga imperializmi amerikan, sado ndihma ushtarake që të merrte nga Kina. Prandaj, sipas Çu En Lait, për të përballuar një agresion të huaj, Shqipërisë i mbetej vetëm rruga e zbatimit të taktikës së luftës partizane në vend dhe lidhja e një aleance ushtarake me Jugosllavinë e me Rumaninë.

Kur u kthye delegacioni ynë në atdhe, Beqir Balluku e njoftoi Byronë Politike për propozimin e Çu En Lait. Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë sonë e dënoi dhe e hodhi poshtë njëzëri propozimin antishqiptar dhe kundërrevolucionar të Çu En Lait. Beqir Balluku, që u bashkua formalisht me vendimin e Byrosë Politike, shtoi se gjoja ai e kishte kundërshtuar propozimin e Çu En Lait, por faktet dhe ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se Beqir Balluku, në realitet, kishte qenë plotësisht dakord me propozimin e udhëheqjes kineze dhe veprroi në fshehtësi për të realizuar këtë plan strategjik armiqësor kundër Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Të njëjtën tezë Çu En Lai ia përsëriti edhe delegacionit qeveritar shqiptar që ndodhej në Pekin, në korrik të vitit 1975, për të mbyllur marrëveshjen për ndihmë ekonomike nga Kina për Shqipërinë për pesëvjeçarën e gjashtë 1976-1980, tezë të

cilën delegacioni ynë e hodhi përsëri poshtë në mënyrë të prerë e kategorike.

Udhëheqja e Partisë sonë e konsideroi propozimin e Çu En Lait, për aleancën ushtarake, që ai kërkonte të na impononte, si një orvatje me karakter reaksionar nga ana e udhëheqjes kineze për ta futur Shqipërinë socialiste në kurthin e kompleteve luftënxitëse nëpërmjet aleancave ushtarake, me qëllim të fundit për ta kthyer zonën e Ballkanit në një fuçi baruti, siç kërkojnë ta bëjnë socialimperialistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë.

Ne nuk dimë nëse Jugosllavia dhe Rumania dinë gjë për këto plane të udhëheqjes kineze. Por ne shohim edhe sot se udhëheqja kineze po tregohet tepër e zellshme për t'u përzier në çështjet e Ballkanit, për të ngatërruar kartërat dhe për t'i vënë zjarrin e luftës kësaj zone tepër të ndjeshme të Evropës. Por ne kemi besim se popujt e Ballkanit nuk do të pranojnë kurrë të vihen kundër njëri-tjetrit, nuk do të pranojnë kurrë të bëhen as vegla të imperializmit amerikan, as të socialimperializmit rus dhe as të hegjemonizmit kinez.

Këto veprime të udhëheqjes kineze dhe kundërshtimi i Partisë sonë ndaj këtyre veprimeve reaksionare, më vonë, patën rrjedhime tepër serioze në marrëdhëniet midis dy vendeve tona. Partia jonë nuk ka ndërhyrë kurrë në çështjet e brendshme të Kinës. Por udhëheqja kineze, në disa momente të caktuara, ka ndërhyrë në mënyrë kriminale në punët e brendshme të Shqipërisë. Këto fakte, në kohën e duhur, ne do t'i nxjerrim haptazi në dritën e diellit. Po të realizoheshin këto veprime të dënueshme të ndërmarra nga udhëheqja kineze, në bashkëpunim edhe me tradhtarët shqiptarë, do të likuidoheshin Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, pavarësia dhe sovraniteti i saj.

8. Ndërsa Partia jonë punonte për të forcuar bashkëpunimin vëllazëror me Kinën, ndërsa ajo dëshironte që, në një front të përbashkët edhe me të gjitha partitë e forcat marksiste-leniniste, të zhvillonim drejt dhe të intensifikonim luftën kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe reaksionit, Kina çdo gjë e shihte vetëm në prizmin e vet, ajo kërkonte të dominonte mbi të tjerët, që këta t'u bindeshin strategjisë e taktikave të saj.

Ngjarjet që ndodhnin tregonin gjithnjë e më mirë se lufta politike e ideologjike e Partisë Komuniste të Kinës kundër hrushovianëve nuk nisej nga baza të shëndosha, se ajo, në të vërtetë, nuk kishte për qëllim mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të çlirimit të popujve. Ajo bëhej thjesht për qëllime pragmatiste dhe për interesa egoistë. Kjo u duk në ndryshimin rrënjësor të strategjisë kineze, që u vulos zyrtarisht me vizitën e Niksonit në Pekin.

Në verën e vitit 1971, Shqipëria, që konsiderohej si aleatja më e ngushtë e Kinës, mori vesh nga agjencitë e huaja të shtypit lajmin e përhapur në të tërë botën se Kisingeri kishte bërë një vizitë sekrete në Pekin. Me Kisingerin ishin zhvilluar tratativa që shënonin një ndryshim rrënjësor në politikën kineze. Si në raste të tjera, edhe këtë herë, megjithëse bëhej fjalë për një kthesë të madhe politike, për ndryshim të vijës strategjike, Partia Komuniste dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës nuk e quajtën të nevojshme të bisedonin, paraprakisht, edhe me Partinë e Punës dhe Qeverinë e Shqipërisë, të merrnin edhe mendimin e tyre. Udhëheqja kineze ndoqi rrugën e vënies përpara faktit të kryer, duke menduar se të tjerët duhet t'i bindeshin asaj pa bërë asnjë fjalë.

Për Partinë tonë ishte e qartë se vizita e Niksonit në Pekin nuk ishte një shkallëzim i bisedimeve, që deri në atë kohë zhvilloheshin në Varshavë midis ambasadorëve kinez e amerikan, se ajo nuk bëhej për të zhvilluar «diplomacinë e popullit» dhe për t'u hapur rrugën kontakteve me popullin amerikan, siç pretendonin udhëheqësit kinezë. Vizita e Niksonit në Pekin hidhte bazat e një politike të re nga ana e Kinës.

Me vizitën e Niksonit Kina hynte në vallen e aleancave e të rivaliteteve imperialiste për rindarjen e botës, ku edhe Kina të kishte pjesën e saj. Me këtë vizitë iu hap rruga afrit dhe bashkëpunimit nga ana e saj me imperializmin amerikan dhe me aleatët e tij. Inaugurimi i aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës shënonte, në të njëjtën kohë, edhe braktisjen nga ana e udhëheqjes kineze të vendeve të vërteta socialiste, të lëvizjes marksiste-leniniste, të revolucionit dhe të luftës nacionalçlirimtare të popujve.

Kjo aleancë dhe ky takim në Pekin midis udhëheqjes kineze dhe presidentit amerikan, Nikson, bëhej në një kohë kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvillonin luftën e tyre imperialiste grabitqare në Vietnam, kur ato po përdornin të gjitha mjetet më moderne ushtarake, me përjashtim vetëm të bombës atomike, për të vrarë popullin vëlla heroik vietnamez dhe për ta bërë shkrumb e hi Vietnamin. Kjo aleancë e përbindshme dhe takimi kino-amerikan ishin veprime të dënueshme dhe me rrjedhime katastrofike për popujt.

Prandaj Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke parë këtë kthesë të rrezikshme në politikën e jashtme të Kinës, i dërgoi, më 6 gusht 1971, një letër të gjatë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku theksonte në mënyrë të prerë se ishte kundër kësaj kthese të Kinës, që binte në kundërshtim me interesat e vetë Kinës Popullore, të revolucionit e të socializmit.

Në letër, midis të tjerave, thuhet:

«Vendimin tuaj, për të pritur Niksonin në Pekin, e quajmë jo të drejtë, jo të dëshirueshëm, atë nuk e aprovojmë dhe nuk e mbështetim. Mendimi ynë është, gjithashtu, se vizita e shpallur e Niksonit në Kinë nuk do të kuptohet dhe nuk do të aprovohet edhe nga popujt, nga revolucionarët dhe nga komunistët e vendeve të ndryshme».

«Fakti i pritjes së Niksonit në Kinë, i cili njihet si anti-komunist i tërbuar, si agresor e si vrasës i popujve, si përfaqësuesi i reaksionit më të zi amerikan, ka shumë minuse dhe do t'u sjellë mjaft konsekuenca negative lëvizjes revolucionare dhe çështjes sonë.

Ardhja e Niksonit në Kinë dhe bisedimet me të nuk ka se si të mos krijojnë në njerëzit e thjeshtë, në popujt, në revolucionarët iluzione të dëmshme ndaj imperializmit amerikan, ndaj strategjisë dhe politikës së tij».

«Bisedimet me Niksonin u japin armë revizionistëve për të zhvlehtësuar tërë luftën dhe polemikën e madhe që ka bërë Partia Komuniste e Kinës për demaskimin e renegatëve sovjetikë, si aleatë e bashkëpunëtorë të imperializmit amerikan dhe për të vënë shenjën e barazimit midis qëndrimit të Kinës ndaj imperializmit amerikan dhe vijës tradhtarë e të bashkëpunimit që ndjekin ndaj tij revizionistët sovjetikë. Kjo u krijon revizionistëve hrushovianë mundësinë të tundin edhe më shumë flamurin e tyre të antiimperializmit fals dhe të intensifikojnë demagogjinë dhe mashtrimet për të tërhequr pas vetes forcat antiimperialiste».

«Vizita e presidentit amerikan në Kinë nuk ka se si të mos ngjallë pikëpyetje, bile edhe keqkuptime në njerëzit e thjeshtë, te të cilët mund të krijohen dyshime se Kina po e ndryshon qëndrimin e saj ndaj imperializmit amerikan dhe po hyn në lojën e superfuqive».

«Strategjia jonë parashikon aleancë të ngushtë me popujt që luftojnë, me revolucionarët e të gjithë botës, në një front të përbashkët kundër imperializmit e socialimperializmit dhe asnjëherë aleancë me socialimperializmin sovjetik gjoja kundër imperializmit amerikan, asnjëherë aleancë me imperializmin amerikan gjoja kundër socialimperializmit sovjetik».

Letra përfundon duke theksuar se «...vija dhe qëndrimet e Partisë së Punës të Shqipërisë do të mbeten gjithnjë parimore, konsekuente, të pandryshuara. Ne do të luftojmë imperializmin amerikan dhe revizionizmin sovjetik pa kompromis e me konsekuencë». Në letër shprehej shpresa se vërejtjet tona, që Partia e Punës ia bënte një partie motër «do të shqyrtoheshin shoqërisht e do të kuptoheshin drejt».

Udhëheqja kineze, edhe ndaj kësaj letre, mbajti qëndrimin e saj të zakonshëm. Ajo nuk denjoi të jepte ndonjë përgjigje.

Me këtë nuk tregonte vetëm megalomaninë e shtetit të madh, por edhe frikën për t'u ballafaquar me argumentet e drejta e parimore, marksiste-leniniste të Partisë sonë. Fakt është se dy muaj pas letrës sonë u mbajt Kongresi i 6-të i Partisë së Punës të Shqipërisë. Ky ishte një rast i mirë që me delegacionin kinez, të ftuar në këtë Kongres, të shkëmbeheshin mendime dhe të sqaroheshin pozitat e njëri-tjetrit. Por udhëheqja kineze, konsekuente në rrugën e saj të refuzimit të konsultimeve e të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me anë të bisedimeve, edhe këtë herë mbajti një qëndrim në kundërshtim me gjithë praktikën e marrëdhënieve internacionaliste midis partive motra. Ajo nxori disa arsye absurde për të mos dërguar delegacion në Kongresin e Partisë sonë. Praktikisht, që në atë kohë, Partia Komuniste e Kinës, në mënyrë të njëanshme, i rralloi kontaktet me Partinë tonë, duke i kthyer marrëdhëniet midis dy partive në marrëdhënie krejtësisht formale.

Ndryshimi i strategjisë së Kinës është bërë në një luftë të brendshme në gjirin e Partisë Komuniste të saj, ku ekzistonin kontradikta të thella, ku lulëzonin «njëqind lule e njëqind shkolla», ku ekzistonin në udhëheqje prohrushovianë, proamerikanë, oportunistë dhe revolucionarë. Kjo shpjegon ndryshimet e njëpasnjëshme të vijës politike të Partisë Komuniste të Kinës, qëndrimet e saj të lëkundura, oportuniste e kontradiktore, si ndaj imperializmit amerikan, revizionizmit modern dhe reaksionit ndërkombëtar. Brenda 10 vjetëve, që nga viti 1962 deri në vitin 1972, tri herë ka ndryshuar boshti i politikës kineze. Në fillim Partia Komuniste e Kinës i përmbahej formulës strategjike «front unik edhe me revizionistët sovjetikë e të tjerë kundër imperializmit amerikan dhe aleatëve të tij». Më pas, Partia Komuniste e Kinës, doli me parullën «front unik shumë të gjerë të proletariatit dhe të popujve revolucionarë të të gjitha vendeve kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik dhe reaksionit të vendeve të ndryshme». Me vizitën e Niksonit në Kinë, strategjia kineze flet përsëri për një «front unik e të gjerë», por këtë radhë ky përfshin «të gjithë ata që mund të bashkohen», duke futur këtu edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër socialimperializmit sovjetik.

9. Pas afrimit me imperializmin amerikan dhe hapjes drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës e aleatëve të tyre, udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës shpalli teorinë antimarksiste e kundërrevolucionare të «tri botëve», të cilën e paraqiti si strategji të revolucionit dhe bëri përpjekje për t'ia imponuar këtë lëvizjes komuniste marksiste-leniniste dhe të gjithë popujve të botës, si vijë të përgjithshme të luftës së tyre.

Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu edhe Partia Komuniste e Kinës, kur luftonin së bashku kundër revizionizmit modern

dhe, në veçanti, kundër atij hrushovian, kanë pasur si parim dhe kanë theksuar se nuk ekziston «parti mëmë» dhe «parti bijë», se çdo parti ka të drejtën të ketë pikëpamjet e saj për të gjitha problemet, se një parti është me të vërtetë komuniste, revolucionare, kur këto probleme i shikon në prizmin e marksizëm-leninizmit. Partia Komuniste e Kinës i ka shkelur këto parime e këto norma në të gjitha drejtimet. Ajo kërkon që kthesën kundërrevolucionare të bashkimit të Kinës me imperializmin amerikan dhe reaksionin botëror t'ua imponojë të gjithë marksistë-leninistëve, që konceptet e analizat e saj antimarksiste mbi imperializmin, mbi situatën e sotme botërore, mbi aleancat etj. t'i pranojë si të vërteta absolute e të paapeleshme gjithë lëvizja revolucionare e çlirimtare.

Praktika tregon se çështjet ndërkombëtare nga ana e Partisë Komuniste dhe e qeverisë së Kinës, në të shumtën e herës, nuk janë parë në prizmin e marksizëm-leninizmit, të interesave të revolucionit dhe të luftërave çlirimtare të popujve. Politika kineze është një politikë pragmatiste dhe nuk ka se si të jetë ndryshe, derisa strategjia dhe taktika e saj janë të tilla. Prandaj bota ka parë dhe do të shohë edhe në të ardhmen ndryshime 180 gradëshe në strategjinë e në politikën kineze. Këto kthesa paraqiten si marksiste-leniniste, por, në realitet, ato janë antimarksiste, janë kthesa që u shërbejnë interesave të shtetit të madh kinez, në kërkim të aleancave me imperializmin amerikan, socialimperializmin sovjetik dhe me kapitalin botëror për krijimin e ngritjen e Kinës në një superfuqi imperialiste.

Aktualisht, plani kinez për t'u shndërruar në një superfuqi ka gjetur shprehjen e vet të koncentruar në teorinë famëkeqe të «tri botëve». Teoria e «tri botëve» kërkon të zëvendësojë marksizëm-leninizmin me një amalgamë eklektike idesh e tezash oportuniste, revizioniste dhe anarkosindikaliste, ajo kërkon të shuajë frymën revolucionare të proletariatit e luftën klasore të tij, duke propaganduar bashkimin me borgjezinë e me imperializmin. Teoria e «tri botëve», me predikimet e saj, se gjoja nuk është koha për revolucion, kërkon të ruajë statukuonë, gjendjen aktuale të shtypjes e të shfrytëzimit kapitalist, kolonialist e neokolonialist.

Në emër gjoja të mbrojtjes së pavarësisë kombëtare nga socialimperializmi sovjetik, të cilin e konsideron sot si të vetmin rrezik e kërcënim, Kina u kërkon popujve të heqin dorë nga lufta për çlirim kombëtar, ekonomik e social, t'u nënshtrohen imperializmit amerikan e fuqive të tjera kapitaliste të Perëndimit, ish-kolonizatorëve të mëparshëm. Ajo kërkon forcimin e Tregut të Përbashkët dhe të Bashkimit Evropian, organizma të krijuar për të mbajtur në skllavërinë kapitaliste pro-

letariatin e Evropës dhe për të shtypur e për të shfrytëzuar popujt e vendeve të tjera. Teoria e «tri botëve», duke i fryrë garës së armatimeve të superfuqive, duke mbështetur instrumentet e luftës së imperializmit amerikan, siç janë NATO e blloqet e tjera ushtarake të tij, nxit luftën imperialiste botërore.

Teoria e «tri botëve» është një mjegull që shërben për të mbuluar synimin e Kinës për të vendosur hegjemoninë e saj mbi atë që ajo e quan «botë e tretë». Nuk është e rastit që ajo e ka futur veten e saj në «botën e tretë» dhe paraqitet si lidhshipi i saj në arenën ndërkombëtare. Nuk është e rastit, gjithashtu, që udhëheqja kineze flirton edhe me «të paangazhuarit» dhe kërkon që t'i marrë këta nën sjetull.

«Dashurinë» e «kujdesin» për të ashtuquajturën botë e tretë nuk është udhëheqja kineze që e ka treguar e para. Për të sunduar e për të nënshtruar vendet e popujt e kësaj «bote», imperialistët, socialimperialistët dhe neokolonialistët të tjerë kanë përpunuar, shumë kohë përpara asaj, teorira të ndryshme mbi «botën e tretë». Prandaj udhëheqja kineze më kot pretendon se është ajo që në vitin 1974 e nxori këtë teori nga një analizë gjoja objektive e situatave ndërkombëtare që bëri Mao Ce Duni. Gjithë bota e di se teoria mbi «botën e tretë» është teori e krijuar nga reaksioni botëror. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare i kanë demaskuar dhe i kanë luftuar, qysh në vitin 1960 e më parë, në arenën ndërkombëtare spekulimet teorike e praktike mbi «botën e tretë», si manovra e komplete borgjezo-kapitaliste, neokolonialiste e raciste për të shtypur popujt që luftonin për liri e pavarësi.

«Kontributi» i udhëheqësve kinezë në teorinë e «tri botëve» konsiston vetëm në «argumentimin» e nevojës së pajtimit të «botës së tretë» me imperializmin. Ata nuk zbuluan asgjë, vetëm sajuan aleancën e «botës së tretë» me imperializmin amerikan dhe imperialistët e tjerë për të ndjellë ndihmat e këtyre dhe për ta bërë Kinën një superfuqi imperialiste.

Prandaj nuk është Partia e Punës e Shqipërisë që sulmon shpikësin kinez ose mbrojtësit e kësaj teorie, por janë pikërisht këta, që e kanë sulmuar më parë Partinë e Punës të Shqipërisë dhe luftën që ajo ka bërë kundër kësaj teorie të reaksionit botëror, luftën që ka bërë ajo në përkrahje të lirisë dhe të pavarësisë së popujve të Afrikës, të Azisë, të Amerikës Latine etj.

Zbatimi i teorisë së «tri botëve» e çoi udhëheqjen kineze të bashkohet edhe me «djallin», të bashkohet me imperialistët amerikanë dhe monopolistët e Evropës, me fashistët e racistët, me mbretërit e feudalët, me militaristët e luftënxitësit më të tërbuar. Aleatët e saj u bënë Pinoçeti e Frankoja, ish-gjeneralët nazistë të Vermahtit gjerman e të ushtrisë perandorake

japoneze, kriminelë me damkë, si Mobutu, dhe mbretër gjakatarë, bosët amerikanë dhe presidentët e shoqërive shumëkombëshe.

Kjo vijë antimarksiste e çoi udhëheqjen e Kinës të bashkohet me Titon, me Karriljon dhe me revizionistë të tjerë. Ajo dikur ka qenë kundër Titos, kurse tani u bashkua me të. Kjo vërteton mungesën e parimeve marksiste-leniniste dhe inkonsekuencat në vijën e saj. Por Partia jonë dëshiron t'i thotë udhëheqjes kineze: bashkimi juaj aktual me Titon, aleancat e dyshimta që kërkonin të thurni në Ballkan, përmbajnë një rrezikshmëri të madhe për popujt e këtij gadishulli, për popujt jugosllavë, shqiptar, grek, turk e të tjerë. Shqipëria i njeh mirë planet dhe synimet e udhëheqjes kineze ndaj Ballkanit. Prandaj popujt e botës duhet të jenë vigjilentë ndaj intrigave kineze në këtë zonë.

10. Partia e Punës e Shqipërisë ka bërë të gjitha përpjekjet që divergjencat, që lindnin midis dy partive dhe që trasheshin me kalimin e kohës, të zgjidheshin në rrugën marksiste-leniniste.

I udhëhequr nga kjo dëshirë, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke parë se udhëheqja kineze në mënyrë sistematike nuk u përgjigjej letrave tona dhe refuzonte të dërgonte delegacione zyrtare në Shqipëri, duke e parë se divergjencat ideologjike me udhëheqjen kineze po merrnin proporcione të gjera, nuk qëndroi në vend, por bëri përpjekje të tjera për të hyrë në bashkëbisedime shoqërore me të.

Kështu, në janar të vitit 1974, Komiteti Qendror i Partisë sonë i propozoi Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës që në Kinë të shkonte një delegacion i Partisë dhe i Qeverisë sonë i nivelit të lartë për bashkëbisedime, duke propozuar që kjo vizitë të kryhej, mundësisht, brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 1974. Por udhëheqja kineze, megjithëse formalisht e pranoi propozimin e Partisë sonë, në fakt, nuk e pranoi vajtjen e delegacionit tonë në Pekin. Në fillim udhëheqja kineze na tha që delegacioni të shkonte në gjashtëmuorin e dytë të vitit 1974, më vonë e shtyu për në gjashtëmuorin e parë të vitit 1975. Dhe, më në fund, e la krejt në heshtje çështjen, duke u mbyllur kështu rrugën bashkëbisedimeve, në një kohë kur në Pekin priteshin e përcilleshin me një pompë të madhe mbretër e princër, reaksionarë e fashistë të ndryshëm. Ishte e qartë, pra, se udhëheqja kineze ecte me këmbëngulje në rrugën e saj antimarksiste, se ajo në marrëdhëniet me Partinë e vendin tonë udhëhiqej nga konceptet e shovinizmit e të fuqisë së madhe, se ajo kërkonte që të pranoheshin pa kushte e pa diskutime vija e diktati i saj.

Në këto kushte, kur udhëheqja kineze refuzonte çdo kon-

takt, kur i shmangej çdo diskutimi e konsultimi, kur me arrogancë e prepotencë po punonte për t'i imponuar lëvizjes marksiste-leniniste teorinë e «tri botëve», ç'duhej të bënte Partia e Punës e Shqipërisë? Të pranonte vijën antimarksiste të Partisë Komuniste të Kinës dhe të mohonte vetveten? Të hiqte dorë nga lufta kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe të bashkohej me armiqtë e revolucionit, të socializmit, të lirisë e të pavarësisë së popujve? Të ndahej nga revolucionarët marksistë-leninistë dhe të bashkohej me oportunistët e borgjezinë reaksionare? Të mos përkrahte luftën nacionalçlirimtare të popujve kundër superfuqive dhe agjentëve të tyre në gjirin e këtyre popujve?

Partia e Punës e Shqipërisë u qëndroi besnike marksizëm-leninizmit dhe vijës së saj të drejtë revolucionare, që ka ndjekur vazhdimisht me vendosmëri, pa u lëkundur e me konsekuencë. Këtë vijë marksiste-leniniste e paraqiti ajo edhe në Kongresin e saj të 7-të, ku parashtrroi pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për problemet kryesore aktuale ndërkombëtare, të revolucionit e të luftës çlirimtare të popujve. Në Kongresin e 7-të, ashtu siç ka bërë edhe në të gjitha kongreset e saj, Partia jonë, në frymën e internacionalizmit proletar, shprehu pikëpamjet e saj edhe për problemet që lidhen me lëvizjen marksiste-leniniste. Vija e Kongresit të 7-të, që u aprovua unanimisht nga gjithë Partia, qëndron në themel të të gjithë politikës së brendshme e të jashtme të vendit tonë.

Kjo vijë marksiste-leniniste e Partisë sonë, politika e pavarur e Shqipërisë socialiste, qëndrimet parimore e të vendosura të popullit shqiptar, që kanë rënë e bien në kundërshtim me vijën dhe me politikën antimarksiste e të fuqisë së madhe të udhëheqjes kineze, janë shkaku themelor e i vërtetë i qëndrimeve dhe i veprimeve antishqiptare të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës e të qeverisë kineze, që çuan deri në prerjen arbitrare të ndihmave civile e ushtarake për Shqipërinë.

Kjo u duk, sidomos, pas Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë, kur udhëheqja kineze, duke thyer çdo normë të marrëdhënieve midis partive motra, u nxitua dhe sulmoi Kongresin e 7-të të Partisë sonë, duke pretenduar se gjoja ai ka sulmuar Kinën, Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunin.

Akuza e udhëheqjes kineze nuk ka asnjë bazë. Për këtë mjafton të lexohen materialet e Kongresit të 7-të, të cilat janë të gjitha publike. Kushdo nuk e ka të vështirë të konstatojë se atje nuk ka asnjë sulm as kundër Kinës, as kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe as kundër Mao Ce Dunit. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i ka kërkuar

Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, me anën e një letre, më 24 dhjetor 1976, që të sqaronte se për çfarë dhe ku e ka sulmuar Partia jonë Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunin. Deri më sot udhëheqja kineze, si zakonisht, nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

Por çështja nuk qëndron te «sulmet», që nuk ekzistojnë. Zemërimi dhe arroganca e udhëheqjes kineze ndaj Kongresit të 7-të e kanë burimin te fakti se Partia jonë nuk adoptoi tezat e pikëpamjet antimarksiste kineze, teorinë kundërrevolucionare të «tri botëve». Partia e Punës e Shqipërisë, si një Parti e vërtetë marksiste-leniniste, pranon të diskutojë për probleme, por ajo nuk ka marrë kurrë urdhra e direktiva nga askush, se çfarë duhet të shtrojë e si duhet t'i shtrojë pikëpamjet e veta në kongreset e saj. Prandaj ajo nuk i ka lejuar dhe nuk i lejon asnjë partie, e vogël ose e madhe qoftë, duke përfshirë edhe Partinë Komuniste të Kinës, që të ndërhyjë në punët e saj të brendshme dhe të diktojë se çfarë duhet të bëjë e si të veprojë.

11. Në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës kanë ndodhur ndryshime të njëpasnjëshme në vijë, në strategji dhe në njerëz. Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka mbrojtur asnjëherë këtë ose atë grup e personalitet që është mënjeluar nga udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës. Ne kemi pasur dhe kemi mendimet tona, për çdo gjë dhe për çdo person ose grup të udhëheqjes që vepronin në Kinë. Kjo është një gjë e natyrshme.

Udhëheqja aktuale kineze ka dashur shumë që Partia e Punës e Shqipërisë të mbështeste veprimet e saj lidhur me ndryshimet që janë bërë në krye të Partisë Komuniste të Kinës. Meqë këtë ne s'e bëmë, ajo vjen te mendimi se ne jemi partizanë të Lin Biaos dhe të «katërshes». Ajo gabon në të dy tablotë dhe kjo është një nga arsyet e mëdha politike, ideologjike të papohuara, që e ka shtyrë udhëheqjen kineze që të presë ndihmat për Shqipërinë. Udhëheqja aktuale kineze ka dashur që Partia jonë të mbështeste veprimtarinë e saj ilegale e jo në rrugën marksiste-leniniste për të marrë fuqinë në dorë në Kinë. Partia jonë as ia ka përmbushur dhe as do t'ia përmbushë udhëheqjes kineze këtë dëshirë. Partia e Punës e Shqipërisë nuk i shkel kurrë parimet marksiste-leniniste dhe kurrë nuk është bërë e nuk do të bëhet vegël e kurrkujt.

Te divergjencat dhe kontradiktat ideologjike e politike me Partinë e Punës të Shqipërisë, te dështimi i përpjekjeve të udhëheqjes kineze për t'i imponuar Partisë së Punës të Shqipërisë pikëpamjet e vijën e saj qëndron shkaku i vërtetë i vendimit kinez për prerjen e ndihmave Shqipërisë. Udhëheqja kineze, pse nuk mundi ta nënshtronte dot Shqipërinë socialiste, tani kërkon të hakmerret e të dëmtojë ndërtimin e so-

cializmit në Shqipëri. Por, me këtë veprim të saj, ajo e zbulon edhe më mirë fytyrën e vet antimarksiste e kundërrevolucionare.

*
*
*

Prerja e kredive dhe e ndihmave për Shqipërinë socialiste nga ana e udhëheqjes kineze nuk është vetëm një episod, goftë edhe shumë i rëndë, në marrëdhëniet midis Kinës e Shqipërisë. Ky akt merr një rëndësi të madhe ndërkombëtare, ai dëshmon se Kina është vënë kundër marksizëm-leninizmit e internacionalizmit proletar, se ajo ka adoptuar dhe po zbaton politikën shoviniste e të diktatit të fuqisë së madhe, se ajo po zbaton praktika hegjemoniste dhe po kryen veprime arbitrare e brutale prej superfuqie.

Për qëllimet e veta egoiste, për ta bërë Kinën një fuqi qendrore botërore, udhëheqja kineze e propagandon veten si «mbrojtëse të vendeve të vogla e të mesme», se ajo lufton kundër «ndarjes së padrejtë të ekonomisë botërore», se ajo është kundër «diskriminimit ekonomik të vendeve në zhvillim nga fuqitë imperialiste», se është për «zhvillimin e ekonomisë së tyre kombëtare», për «forcimin e pavarësisë e të sovranitetit të tyre», se lufton «kundër diktatit të të mëdhenjve ndaj të vegjëlve» etj., etj. Por kur udhëheqja kineze sillet si armike me Shqipërinë, kur ajo i pret ndihmat e kreditë, sepse Partia e Punës e Shqipërisë nuk i nënshtrohet shkopit të saj të dirigjentit, kuptohet tërë falsiteti i vijës kineze, kuptohen qartë edhe qëllimet aspak të mira, gënjeshtat që udhëheqja kineze kërkon t'u shesë popujve të «botës së tretë» për t'i shtypur e për t'i skllavëruar ata, për t'u imponuar vullnetin e saj dhe atë të kolonizatorëve të vjetër e të rinj.

Duke i prerë ndihmën Shqipërisë socialiste, kur, në të njëjtën kohë, Kina po merr ndihma e kredi të shumta nga imperializmi amerikan e kapitalizmi botëror dhe u akordon ndihma e kredi agjentëve të tyre, si Mobutu me shokë, udhëheqja kineze i tregon hapur opinionit botëror se ajo nuk është dakord ideologjikisht me një vend të vërtetë socialist, por është dakord e në aleancë me armiqtë e socializmit e reaksionarët, se është kundër rendit socialist, kundër vendeve e popujve që kërkojnë çlirim pikërisht nga imperializmi e socialimperializmi, nga shtypja e diktati i shovinizmit të shtetit të madh.

Ne duam t'u themi udhëheqësve kinezë: Ju i shritë mosmarrëveshjet e divergjencat ideologjike edhe në fushën e ma-

rëdhënieve shtetërore me vendin tonë. Me këtë ju goditët rëndë miqësinë shqiptaro-kineze për të cilën kanë luftuar shumë si populli shqiptar, ashtu edhe populli kinez. Ju i bëtë publike mosmarrëveshjet e divergjencat dhe filluat polemikën e hapur. Këtë sfidë ne e pranojmë dhe polemikës nuk i trembemi. Por, për të gjitha veprimet tuaja armiqësore, antimarksiste e antishqiptare, ju mbani përgjegjësi të plotë përpara popullit kinez e popullit shqiptar, përpara gjithë opinionit botëror.

Me qëllim që popullit shqiptar dhe popullit kinez, si dhe gjithë opinionit publik ndërkombëtar t'u jepet mundësia që të njihen dhe të gjykojnë për pikëpamjet e Partisë e të qeverisë suaj dhe të Partisë e të Qeverisë Shqiptare, lidhur me prerjen e kredive e të ndihmave nga ana e Kinës Shqipërisë, ne do të botojmë në gazetën tonë «Zëri i popullit» këtë letër, si dhe notën e qeverisë kineze. Shpresojmë që edhe ju do ta botoni letërën tonë në gazetën «Zhenminzhibao». Kjo është një normë, të cilën, në të kaluarën, Kina e ka përkrahur.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria dhe populli shqiptar do të luftojnë për ruajtjen e miqësisë shqiptaro-kineze, që është një miqësi popujsh. Ata do të përpiqen, sa varet prej tyre, që të mbahen marrëdhënie shtetërore normale midis Shqipërisë dhe Kinës. Ata kanë besim se populli kinez do të vlerësojë drejt qëndrimin shqiptar dhe do të dijë të gjykojë edhe për veprimet antishqiptare të udhëheqjes kineze.

Udhëheqja kineze i preu ndihmën ekonomike dhe ushtarake Shqipërisë, duke menduar se Shqipëria do të detyrohet, ose të kapitultojë dhe t'i nënshtrohet asaj, ose do t'u shtrijë dorën të tjerëve dhe do të diskreditohet. Por udhëheqja kineze nuk i ka njohur akoma Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar, vendosmërinë e tyre, forcën e unitetit të tyre.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe populli shqiptar, nën udhëheqjen konsekuente të Partisë së Punës të Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye, do ta plotësojnë gjer në fund e me nder misionin historik për ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur në forcat e veta, duke vërtetuar më tej para proletariatit botëror dhe gjithë popujve të botës vitalitetin e pashtershëm e të pamposhtshëm të ideologjisë marksiste-leniniste, e cila bën të mundur që edhe një vend i vogël, i rrethuar nga imperializmi e revizionizmi, siç është Shqipëria, ta ndërtojë me sukses socializmin, ta mbrojë dhe ta çojë atë kurdoherë përpara.

Shqipëria kurrë nuk do të dorëzohet te kurrkush, ajo do t'u qëndrojë deri në fund besnike marksizëm-leninizmit dhe internacionalizmit proletar, do të marshojë pa u ndalur në rrugën e socializmit e të komunizmit e ndriquar nga mësimet

e pavdekshme të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit. Populli shqiptar, me Partinë e Punës në krye, do të përkrahë me vendosmëri e me konsekuencë luftërat revolucionare e çlirimtare të popujve, përpjekjet e tyre për liri, për pavarësi e për përparim shoqëror. Ai do të luftojë, pa kompromis e gjer në fund, kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik, revizionizmit modern dhe reaksionit botëror. As kurri- zin, as kokën nuk i ka ulur kurrë Shqipëria, as në të kalua- rën, as sot dhe as në të ardhmen nuk do t'i ulë.

Udhëheqja kineze do të dështojë, si në predikimet, ashtu edhe në intrigat e saj. Veprimi reaksionar që ajo ndërmoi ndaj Shqipërisë revoltonte ndërgjegjen e çdo njeriu të ndershëm në botë. Shqipëria socialiste është e rrethuar, por ajo s'është e izoluar, sepse gëzon respektin e dashurinë e proletariatis botëror, të popujve lirisdashës dhe të njerëzve të ndershëm në të gjithë botën. Ky respekt dhe kjo dashuri do të shtohen akoma më shumë në të ardhmen. Çështja jonë është e drejtë! Shqipëria socialiste do të triumfojë!

KËSHILLI I MINISTRAVE
I RPSSH

KOMITETI QENDROR
I PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 183 (9356), 30 korrik 1978*

**PËRSHËNDETJE E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË DREJTUAR SHOKUT
ENVER HOXHA, ME RASTIN E 70-VJETORIT
TË DITËLINDJES SË TIJ**

16 tetor 1978

I dashur shoku Enver,

Sot, në ditën e 70-vjetorit të ditëlindjes Suaj, gjithë komunistët dhe punonjësit e vendit tonë ndiejnë një gëzim të madh dhe shprehin dashurinë e zjarrtë, të pakufishme, ndaj Jush, duke shtrënguar më tepër radhët rreth Komitetit Qendror të Partisë, me Ju në krye, për ta bërë atdheun tonë socialist akoma më të begatshëm dhe më të fortë.

Me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes Suaj, Komiteti Qendror i Partisë, në emër të të gjithë komunistëve dhe të mbarë popullit shqiptar, ju dërgon përshëndetjet më të zjarrta revolucionare dhe ju uron nga zemra jetë të gjatë, shumë të gjatë, të rroni sa malet e Shqipërisë, për të na udhëhequr, si gjithmonë, me vendosmërinë dhe principialitetin marksist-leninist që ju karakterizon, në rrugën e lavdishme të socializmit e të komunizmit.

Jeta Juaj si revolucionar, shoku Enver, është jeta e një biri besnik të popullit, që të gjitha energjitë e tij, për më shumë se një gjysmë shekulli rresht, i ka derdhur në luftën konsekuente në shërbim të popullit, të atdheut, të revolucionit, të socializmit.

Qysh në ditët e para të rinisë, kur Ju ishit akoma nxënës shkollë, u hodhët në luftë për mbrojtjen e interesave të lartë të popullit, kundër padrejtësive shoqërore të asaj kohe, kundër regjimit feudalo-borgjez zogollian. Duke ecur në këtë rrugë revolucionare, Ju gjithmonë i keni shërbyer me besnikëri popullit dhe keni luftuar me guxim për interesat e tij e të atdheut. Qysh në rininë Tuaj të hershme, Ju përqafuat idetë marksiste-

-leniniste dhe, me kurajë revolucionare shembullore, iu përveshët punës për përhapjen e tyre në Shqipëri dhe për krijimin e një organizate të vërtetë komuniste.

Në vitet e rënda e të errëta të pushtimit fashist italian, kur përpara popullit shqiptar shtrohej çështja nëse populli do të ngrihej në luftë të armatosur për çlirimin e vendit apo do t'i nënshtrohej pushtuesit dhe të zhdukej si komb, Ju, në krye të një grushti revolucionarësh trima dhe të devotshëm, kapërcyet me heroizëm të gjitha vështirësitë e ilegalitetit dhe të elementëve armiq të marksizëm-leninizmit në radhët e grupeve komuniste të asaj kohe dhe, më 8 Nëntor 1941, themeluat Partinë Komuniste të Shqipërisë, duke i dhënë, kështu, popullit shqiptar shtabin revolucionar, që do ta udhëhiqte atë në kryengritje dhe në revolucion, drejt lirisë së vërtetë dhe socializmit.

Ju, në krye të Komitetit Qendror të Partisë, për 37 vjet rresht, që nga themelimi i saj, udhëhiqni Partinë dhe popullin me guxim dhe me heroizëm, me devotshmëri të pafund dhe me principialitet të lartë marksist-leninist.

Me Luftën Nacionalçlirimtare populli ynë shkroi faqen më të lavdishme në historinë e tij të lashtë. Në të ai tregoi virtytet e larta të trimërisë, të guximit, shpirtin liridashës, që e kishte ruajtur të pamposhtur nëpër shekuj. Por këto virtyte shpërthyen si vullkan, sepse në ballë udhëhiqte Partia e komunistëve, sepse në krye të partizanëve heroikë qëndronte Komandanti, shoku Enver Hoxha. Partia dhe Ju ditët të realizoni dhe të bashkoni traditat e vjetra shqiptare të kryengritjeve popullore, me përmbajtjen leniniste të luftës revolucionare.

Në krye të Partisë e të popullit, Ju vazhdoni të zbatoni me vendosmëri dhe me konsekuencë të vërtetën e marksizëm-leninizmit në kushtet konkrete të vendit tonë. Kuptimi i thellë marksist-leninist i ligjeve të revolucionit, besimi absolut në forcën e pamposhtur të popullit dhe në aftësitë e tij krijuese të pashtershme, vullneti i çeliktë dhe guximi i shkallës më të lartë për ta çuar revolucionin deri në fund, që karakterizojnë gjithë veprën Tuaj revolucionare, si bir i popullit dhe nxënës besnik i Marksit, i Engelsit, i Leninit e i Stalinit, janë mishëruar në krijimin e pushtetit popullor në Shqipëri. Diktatura e proletariatit, që udhëhiqet nga Partia, me Ju në krye, është bërë garancia e lirisë dhe e pavarësisë së popullit tonë në marshimin e tij të pandalshëm në rrugën e socializmit.

Emri Juaj, shoku Enver, është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me gjithë jetën dhe veprën e Partisë, me popullin, me atdheun, me socializmin. Organizimi dhe drejtimi i Luftës Nacionalçlirimtare dhe çuarja e saj në fitoren e plotë me vendosjen e pushtetit popullor; plotësimi i reformave të mëdha

demokratike popullore dhe kalimi me sukses në rrugën socialiste; zhdukja e analfabetizmit dhe e prapambetjes shekullore; transformimet e mëdha revolucionare socialiste të bëra në ekonomi, në arsim, në kulturë dhe në jetën shoqërore, që e kthyen Shqipërinë në një vend socialist me ekonominë e vet socialiste, me kulturën e vet socialiste, me një mbrojtje të paprekshme; rritja e respektit dhe e prestigjit të Partisë dhe të atdheut tonë në një shkallë të lartë në arenën ndërkombëtare, të gjitha këto përbëjnë veprën e madhe të Partisë, të udhëhequr me besnikëri dhe me heroizëm nga Komiteti i saj Qendror, me Ju në krye, shoku Enver.

Partisë dhe popullit tonë u është dashur të luftonin jo vetëm kundër vështirësive të panumërta për të kapërcyer prapambetjen e madhe që na la e kaluara, por edhe kundër armiqve të shumtë, të brendshëm dhe të jashtëm.

Lufta e Partisë dhe e popullit për çlirimin e vendit, për vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe për ndërtimin e socializmit karakterizohet nga ndeshjet e ashpra dhe tepër të ndërlikuara që kanë çuar gjithmonë në disfatën e armiqve dhe në fitoren tonë. Më kryesoret ndër këto janë, sidomos: lufta e armatosur kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe tradhtarëve të vendit, që u vunë në shërbim të tyre; lufta kundër komplotit të udhëheqjes revizioniste jugosllave dhe agjentëve të saj në Shqipëri, si Koçi Xoxe e të tjerë, për të likuiduar pavarësinë e Shqipërisë dhe për ta kthyer atë në një krahinë të thjeshtë jugosllave; lufta kundër komplotit të imperializmit amerikan dhe anglez e shërbëtorëve të tyre, për të përmbysur pushtetin popullor dhe për të rivendosur kapitalizmin në Shqipëri; lufta kundër komplotit të madh të revizionistëve hrushovianë sovjetikë, për ta kthyer Shqipërinë në një shtet vasal të socialimperializmit rus; lufta kundër revizionistëve kinezë, që donin ta nënshtonin Shqipërinë socialiste, në interes të planeve të tyre hegjemoniste dhe socialimperialiste; asgjësimi i komplotit të madh të puçistëve dhe të sabotatorëve, të udhëhequr nga tradhtarët Beqir Balluku, Abdyl Këllezi e të tjerë, të cilët ishin bërë zëdhënësit e veglat e verbra të shteteve të huaja, që kërkonin ta nënshtonin Shqipërinë socialiste në interes të planeve të tyre hegjemoniste dhe socialimperialiste, të likuidonin socializmin dhe të rivendosnin kapitalizmin në vendin tonë.

Në të gjitha betejat e ashpra klasore Partia doli fituese dhe armiqtë u mposhtën, sepse Komiteti Qendror i Partisë, me Ju në krye, kanë qenë gjithmonë vigjilentë dhe të vendosur, në unitet të çeliktë mendimi e veprimi dhe nuk kanë vënë asgjë mbi lirinë e popullit, mbi sovranitetin e atdheut dhe mbi parimet e marksizëm-leninizmit. Lufta që ka bërë Partia dhe Ju,

shoku Enver, kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, ka qenë shpëtimtare për popullin e për socializmin.

Lufta e klasave në Shqipëri, e udhëhequr me mençuri e me urtësi nga Partia, e zhvilluar sipas mësimeve Tuaja, ka qenë dhe mbetet një forcë e madhe lëvizëse e shoqërisë sonë, një faktor vendimtar i unitetit të çeliktë të popullit dhe i bashkimit të tij rreth Partisë, një mburojë e sigurt e lirisë dhe e pavarësisë së vendit, e pastërtisë ideologjike e morale të njerëzve tanë.

Vetëm një parti e vërtetë marksiste-leniniste, siç është Partia jonë, me një vijë të drejtë dhe me besim në forcat e popullit mund t'i hynte një ndërmarrjeje të tillë kolosale, siç është industrializimi i vendit me ritme të shpejta, kolektivizimi i plotë i bujqësisë, revolucioni në fushën e ideologjisë, të arsimit dhe të kulturës, emancipimi i plotë i gruas etj. Vetëm zbatimi konsequent i vijës së Partisë, me një besim të patundur në forcën e diktaturës së proletariatit, në aftësitë drejtuese, organizuese e mobilizuese të anëtarëve të Partisë, në talentin e kuadrove, në punën vetëmohuese të punëtorëve e të fshatarëve tanë e të inteligjencies popullore, të kalitur nga Partia me idetë e marksizëm-leninizmit, me mësimet Tuaja të pazëvendësueshme, bëri të mundur që te ne të mos ketë kala që nuk e marrin komunistët.

Kur përreth nesh e në gjithë botën shikojmë atë krizë të rëndë që ka pllakosur vendet kapitaliste e revizioniste, del edhe më madhështore vija e drejtë ekonomike e Partisë sonë për industrializimin e vendit dhe për modernizimin e bujqësisë, forca e madhe e parimit, aq fort të mbrojtur nga Ju, të mbështetjes në forcat e veta.

Nën kujdesin Tuaj të drejtpërdrejtë, shoku Enver, është realizuar ëndrra shekullore e popullit tonë për dritë e dije, për arsim e kulturë. Shqipëria e re mund të krenohet për atë shkallë të lartë që ka arritur në arsimimin e përgjithshëm të popullit dhe në përgatitjen e kuadrove.

Nën udhëheqjen Tuaj të kujdesshme, është forcuar mbrojtja e atdheut dhe kufijtë tanë janë bërë të paprekshëm. Mendimi ushtarak dhe konceptet tuaja teorike e praktike për Artin Ushtarak të Luftës Popullore, të mbështetura në shkencën ushtarake marksiste-leniniste, në traditat luftarake të shkëlqyera të popullit tonë dhe në përvojën revolucionare botërore, janë baza mbi të cilën janë ndërtuar strategjia dhe taktika, organizimi dhe drejtimi i mbrojtjes sonë popullore, që e kanë bërë atdheun tonë të paprekshëm.

Ju, i dashur shoku Enver, i dhatë popullit shqiptar Kushtetutën e tij të parë, me të cilën ai rindërtoi vendin dhe mbylli plagët e luftës, kolektivizoi bujqësinë, ndërtoi industrinë

socialiste, arriti gjithë ato suksese të mëdha në të gjitha fushat e jetës, që i di e gjithë bota. Ju i dhatë popullit, gjithashtu, Kushtetutën e dytë, e cila është kushtetuta më e përpunuar në botë, ku konsakrohen fitoret e arritura dhe hapet perspektiva e shkëlqyer e zhvillimit të pandërprerë socialist të vendit tonë. Në Kushtetutën tonë të re përfshihen të gjitha parimet e mëdha marksiste-leniniste të jetës socialiste. Kjo tregon kujdesin e veçantë të Komitetit Qendror të Partisë dhe Tuajin personalisht për ruajtjen dhe për forcimin e diktaturës së proletariatit, për zhvillimin e pandërprerë të socializmit në Shqipëri, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut.

E gjithë veprimtaria Juaj revolucionare shquhet nga lufta konsequente për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të parimeve të internacionalizmit proletar. Lufta heroike që ka bërë Partia jonë, me Ju në krye, shoku Enver, kundër revizionizmit modern është e pashembullt. Partia jonë, e edukuar nga Ju me besnikërinë e pafund ndaj mësimeve të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, me frymën e papajtueshmërisë me çdo shmangie dhe me çdo tradhti, me ndjenjën e urrejtjes për çdo tradhtar e për çdo renegat të revolucionit e të socializmit, u ngrit me kurajë kundër tradhtisë titiste e u çori maskën revizionistëve jugosllavë, u ngrit dhe demaskoi tradhtinë e klikës hrushoviane dhe, pastaj, demaskoi dhe po demaskon edhe tradhtinë e udhëheqjes revizioniste kineze.

Ju e keni edukuar dhe e edukoni Partinë që të jetë gjithmonë e papajtueshme me rrymat e oportunizmit dhe të revizionizmit, të jetë luftëtare e papërkulur për mbrojtjen e çështjes së revolucionit dhe të socializmit në arenën botërore. Ju e keni edukuar dhe e edukoni Partinë, klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste, inteligjencien popullore, rininë tonë që të jenë vigjilente dhe të luftojnë pa kompromis dhe gjer në fund si kundër imperializmit amerikan, ashtu edhe kundër social-imperializmit sovjetik, që janë njësoj të rrezikshëm për popujt dhe për revolucionin. Partia dhe populli ynë, të edukuar nga Ju, duke u frymëzuar nga parimet e internacionalizmit proletar, do t'i përkrahin e do t'i ndihmojnë, si kurdoherë, partitë marksiste-leniniste dhe forcat revolucionare, kudo në botë, që luftojnë për çlirimin shoqëror e kombëtar.

Politika e sinqertë, e hapur, politika e parimeve proletare, siç e keni përcaktuar Ju politikën e Partisë dhe të shtetit tonë, i ka siguruar vendit tonë miq e dashamirë në të gjithë botën, një prestigj të lartë dhe autoritet të merituar. Ajo i ka siguruar Shqipërisë socialiste përkrahjen e simpatinë e revolucionarëve e të popujve, që është një mbështetje e fuqishme, inkurajim e frymëzim i madh për mbrojtjen e atdheut dhe për çuarjen përpara të socializmit te ne.

Në veprimtarinë Tuaj intensive revolucionare, në krye të Partisë, Ju, i dashur shoku Enver, si gjithnjë, vazhdoni të zhvillonin një luftë të gjithanshme për revolucionarizimin e Partisë dhe të të gjithë jetës së vendit. Masat për thellimin e revolucionit ideologjik, për çrrënjosjen e mbeturinave e të influencave të huaja, për revolucionarizimin e bazës e të të gjithë superstrukturës të shoqërisë sonë socialiste, kanë mbyllur shtigjet për lindjen e revizionizmit dhe restaurimin e kapitalizmit në vendin tonë.

Partia dhe i gjithë populli i konsiderojnë mësimet Tuaja, veprën Tuaj të madhe, teorike e praktike, që përfshin të gjitha fushat e jetës së Partisë dhe të popullit tonë, gjithë historinë 37-vjeçare të Partisë e luftën e popullit për liri e socializëm, si një kontribut të shquar dhe me vlerë të madhe në thesarin e përgjithshëm të marksizëm-leninizmit.

Veprimtaria Juaj udhëheqëse, me rëndësi historike, në krye të Komitetit Qendror, i ka siguruar Partisë sonë unitetin e çeliktë të radhëve të saj, i ka siguruar lidhjet e pazgjydhshme me popullin. Gjithë fitoret e Partisë dhe të popullit tonë mbajnë vulën e personalitetit Tuaj marksist-leninist, të udhëheqësit konsekuent revolucionar, të vazhduesit besnik të veprës së pavdekshme të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit.

I dashur shoku Enver,

Jeta dhe vepra Juaj prej komunisti të papërkulur, prej udhëheqësi dhe mësuesi proletar, janë dhe do të jenë për ne, shokët e bashkëluftëtarët Tuaj, shembull i madh frymëzimi në punën e në luftën tonë për zbatimin konsekuent të vijës marksist-leniniste të Partisë, për ruajtjen e për forcimin e unitetit të saj monolit, për rritjen e për forcimin e vazhdueshëm të rolit të saj udhëheqës.

Edhe një herë ju urojmë nga zemra, i shtrenjti shoku Enver, shëndet dhe jetë të gjatë, për të na udhëhequr, Parti e popull, si gjithnjë, në betejat e mëdha që na presin, kundër imperializmit e revizionizmit, drejt lartësive të reja të socializmit, për lavdinë e marksizëm-leninizmit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 250 (9423), 17 tetor 1978

VENDIM

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI KAKTIMIN E RAPORTEVE KYRESORE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE NË KRAHASIM ME ATO TË PUNËTORËVE DHE TË KOOPERATIVISTËVE»

6 dhjetor 1978

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e datës 6 dhjetor 1978, mbasi mori në shqyrtim relacionin e Kryesisë së Këshillit të Ministrave të RPSSH për projektligjin «Mbi caktimin e raporteve kryesore të pagave të nëpunësve në krahasim me ato të punëtorëve dhe të kooperativistëve»,

Vendosi:

Të miratojë propozimin e paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Ministrave të RPSSH për caktimin e raporteve kryesore të pagave të nëpunësve në krahasim me ato të punëtorëve dhe të kooperativistëve, duke pasur parasysh që raporti midis pagës mesatare të punëtorëve të të gjitha degëve të ekonomisë dhe të pagës më të lartë të nëpunësve të mos jetë më i madh se 1 me 2.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 6-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 29-30 janar 1979

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 29 e 30 janar 1979, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Hysni Kapo.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror ë miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse:

Në fund, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, bëri konkluzionet e punimeve të Plenumit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979»

29 janar 1979

Në këtë Plenum të Komitetit Qendror të Partisë do të shqyrtojmë plotësimin e planit të vitit 1978 dhe të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, si dhe masat që duhen marrë për të realizuar planin e vitit 1979 në të gjithë zërat dhe treguesit e tij.

Punimet e këtij Plenumi i zhvillojmë në një situatë revolucionare, që karakterizon tërë jetën e vendit tonë. Me Partinë në ballë, njerëzit tanë janë ngritur më këmbë dhe po punojnë pa u lodhur për vënien në jetë të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë. Letra e Komitetit Qendror dhe e Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, drejtuar udhëheqjes revizioniste kineze, fjalimet programatike të shokut Enver Hoxha, përfundimi me sukses të plotë i zgjedhjeve të reja për në Kuvendin Popullor dhe punimet e sesionit të parë të legjislaturës së 9-të i kanë ngritur edhe më lart frymën e mobilizimit dhe të optimizmit revolucionar për të zbatuar detyrat që u dalin Partisë dhe popullit tonë në kushtet e sotme për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut.

Në rrugën tonë të lavdishme ne kemi solidaritetin dhe përkrahjen politiko-morale të revolucionarëve në mbarë botën, të cilët janë plotësisht me ne dhe shprehin besimin e patundur në marshimin tonë të pandalshëm, drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë janë

bërë shembull frymëzues për të gjithë revolucionarët e botës, ndërsa armiqtë e Shqipërisë socialiste, që janë armiqtë e të gjithë popujve të botës, përpiqen me të gjitha mënyrat ta pengojnë, ta ndalojnë, ta shuajnë atë, vendin e vetëm në botë që ndërton me sukses socializmin. Në bllokun e armiqve tanë imperialisto-revizionistë u rreshtuan edhe socialimperialistët kinezë me veprimtarinë e tyre të egër armiqësore, antimarksiste e antishqiptare. Tani ata përsëritin, në një mënyrë apo në një tjetër, profetizimet e dikurshme të Hrushovit e të Mikojanit me shokë. Por, njëkohësisht, janë të detyruar të njohin forcën e Shqipërisë socialiste, që, për 18 vjet me radhë, përballon me sukses bllokada nga më të egrat. Edhe pas kësaj, ata nuk do të heqin dorë nga lufta kundër nesh, përkundrazi, do t'i shtojnë e do t'i shumëfishojnë në të ardhmen rrethimin dhe bllokadën kundër vendit tonë. Prandaj Partia jonë, krahas masave për realizimin e detyrave në fushën ekonomike, një vëmendje të veçantë i kushton forcimit të gjithanshëm të aftësisë mbrojtëse të atdheut.

Realizimi i të gjitha detyrave të planit të shtetit, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona, çarja e rrethimit dhe e bllokadës imperialisto-revizioniste kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Me punë të paepur e vetëmohuese për ndërtimin e socializmit, si deri tani, edhe në të ardhmen, duhet të tregojmë vitalitetin e socializmit, të tregojmë se një popull, edhe pse është i vogël në numër, mund ta ndërtojë plotësisht socializmin, kur udhëhiqet nga një parti e vërtetë marksiste-leniniste, siç është Partia e Punës e Shqipërisë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë, kohët e fundit shqyrtoi dhe u bëri një analizë të thellë rezultateve të arritura në plotësimin e detyrave të planit të vitit 1978 dhe zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit gjatë tre vjetëve, 1976-1978, të këtij pesëvjeçari, si dhe miratoi detyrat e planit për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës për vitin 1979.

Në këtë mbledhje shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim shumë të rëndësishëm për punën dhe për detyrat që u dalin gjithë Partisë dhe levave të saj në frontin ekonomik, për kupimin dhe për zbatimin sa më drejt të detyrave të planit në kushtet e sotme ndërkombëtare të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Mbi bazën e këtij fjalimi, të analizës që bëri Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe të Protokollit të posaçëm që u miratua në këtë mbledhje të Byrosë Politike, më poshtë po shtjellojmë problemet dhe detyrat që dalin për të siguruar zhvillimin e ekonomisë e të kulturës sipas direktivave të caktuara nga Kongresi i 7-të i Partisë.

Mbi rezultatet e arritura në plotësimin e detyrave të planit

Viti 1978 u karakterizua nga rritja e vazhdueshme e përpjekjeve dhe e vrullit revolucionar të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, nën udhëheqjen e Partisë, për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 7-të, të plenumeve të Komitetit Qendror dhe mësimet e shokut Enver në fushën e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, duke u mbështetur tërësisht në forcat tona. Në mënyrë të veçantë, luftë dhe përpjekje të gjithanshme u bënë për të përballuar me sukses vështirësitë e krijuara nga bllokada imperialisto-revizioniste, si rrjedhim i veprimtarisë së hapur armiqësore e sabotuese që ndërmorën ndaj vendit tonë revizionistët kinezë, si edhe nga thellimi i vazhdueshëm i krizave në botën kapitalisto-revizioniste.

Në zbatim të detyrave që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë, gjatë vitit 1978 u arrit një ngritje e mëtejshme në zhvillimin e ekonomisë në tërësi dhe në degë të veçanta të saj. Prodhimi i përgjithshëm shoqëror, në vitin 1978, u rrit afër 2 herë më shpejt se rritja e popullsisë. Zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës ka sjellë edhe ngritjen e nivelit të mirëqenies së popullit.

Detyrat u plotësuan dhe u tejkaluan në mjaft prodhime të rëndësishme të industrisë. Vitin e kaluar u vunë në shfrytëzim 2 turbina të hidrocentralit «Drita e Partisë», disa objekte në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», uzina e re mekanike e kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha», e cila prodhoi traktorin e parë të markës shqiptare. Filloi nga prodhimi Uzina e Përpunimit të Naftës në Ballsh, Miniera dhe Fabrika e Pasurimit të Hekur-Nikelit në Gurin e Kuq, Fabrika e Letrës në Lezhë etj. Të gjitha këto fuqizojnë më tej bazën materialo-teknike për rritjen e prodhimit edhe për vitet e ardhshme.

Në bujqësi, megjithëse detyrat nuk u plotësuan sipas planit, përsëri nevojat e popullit me drithëra buke sigurohen, por, për shkak të deficiteve të ndjeshme, nuk krijohen rezervat e nevojshme sipas parashikimeve nga shumica e ekonomive bujqësore. Në disa prodhime bujqësore e blegtorale u morën sasi më të mëdha se në vitin 1977.

Në ndërtim plani është plotësuar në një varg objektesh të rëndësishme, duke siguruar, kështu, ndërtimin dhe vënien në shfrytëzim të mjaft veprave ekonomike e shoqëro-kulturore. Populli u furnizua me më shumë mallra të përdorimit të gjerë të prodhuara në vend dhe u rritën më shumë shërbimet si në qytet, ashtu edhe në fshat. Edhe në sektorët e tjerë, si: në komunikacion, në arsim e në kulturë, në shëndetësi dhe në forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes u arritën rezultate të rëndësishme.

Plotësimet e arritura në plotësimin e planit të vitit 1978 vërtetojnë edhe një herë drejtësinë e vijës politike dhe ekonomike që ka ndjekur dhe zbaton me konsekuencë Partia jonë. Ato janë shprehje konkrete e forcimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë e të vitalitetit të ekonomisë sonë shumëdegëshe dhe tregojnë për mundësitë e mëdha që janë krijuar për të siguruar ecurinë me ritme të kënaqshme të riprodhimit të zgjeruar socialist me forcat tona.

Detyrat për plotësimin e planit të vitit 1978 i kemi miratuar në një mbledhje të veçantë të Plenumit të 4-të të Komitetit Qendror, qysh në fillim të vitit të kaluar. Rezultatet e gjashtëmuorit të parë i shqyrtuam përsëri në mbledhjen e Byrosë Politike. Përveç kësaj, Byroja Politike dhe Këshilli i Ministrave kanë analizuar, herë pas here, një varg problemesh të realizimit të detyrave të planit në sektorë të veçantë.

Por është e domosdoshme të theksojmë se disa detyra të rëndësishme të planit ekonomik të shtetit nuk janë realizuar sipas parashikimeve. Prandaj ne duhet ta shohim e ta analizojmë punën tonë objektivisht e me sy kritik, të nxjerrim në shesh, siç na mëson shoku Enver, se ç'kemi bërë, ç'nuk kemi bërë, pse dhe kush mban përgjegjësi e, mandej, ç'duhet të bëjmë.

Disa nga shkaqet kryesore që kanë ndikuar në mosrealizimin e detyrave të planit

Në mosplotësimin e detyrave të planit të vitit 1978 dhe të dy vjetëve të mëparshëm të pesëvjeçarit, sidomos në disa degë të industrisë dhe në disa vepra të ndërtimit, ka ndikuar edhe veprimtaria armiqësore e sabotuese e revizionistëve kinezë. Siç dihet, ata prenë në mënyrë arbitrare sjelljen e makinerve, të pajisjeve, të projekteve dhe të lëndëve të para të kontraktuara, duke vonuar e duke pezulluar vënien në shfrytëzim të objekteve të rëndësishme dhe duke krijuar vështirësi serioze për ekonominë tonë socialiste. Por sabotimi dhe veprimtaria armiqësore e revizionistëve kinezë nuk kanë pasur efekt determinues në rezultatet e pakënaqshme, që janë vërtuar në mosplotësimin e disa detyrave të planit.

Shkaqet kryesore të mosplotësimit të planit në bujqësi dhe në disa degë e sektorë të tjerë të ekonomisë janë thjesht të karakterit subjektiv. Ato kanë të bëjnë, në radhë të parë, me mungesat në drejtimin dhe në organizimin e punës nga organet e Partisë dhe ato shtetërore, me kontrollin e pamjaftue-

shëm në plotësimin e detyrave, me mungesën e ndjenjës së përgjegjësisë e të disiplinës në punë, me qëndrimet liberale, me përpjekjet e pamjaftueshme për zbatimin e detyrave dhe me kuptimin e cekët të rrethimit e të bllokadës. Akoma nuk kuptohet mirë e nga të gjithë se të jetosh me situatat do të thotë, para së gjithash, të realizosh të tëra detyrat që rrjedhin prej tyre, duke kapërcyer çdo pengesë e çdo vështirësi dhe jo të justifikohesh. Partia dhe shoku Enver vazhdimisht kanë theksuar se justifikimi është i huaj për revolucionarët. Jo të fshehim të metat e dobësitë tona pas vështirësive që na krijohen, por t'u vëmë gjoksin e t'i përvishemi punës për të realizuar me këmbëngulje të gjitha detyrat dhe të mposhtim çdo vështirësi e çdo pengesë. Kjo është rruga që na mëson Partia. Kjo është detyra e çdo komunisti dhe e çdo punonjësi, qoftë ky anëtar i Komitetit Qendror, ministër, komunist a punonjës i thjeshtë, në çdo front pune që të jetë. Prej këndeje dalin edhe detyrat tona për eliminimin e menjëhershëm të të metave e të dobësive që janë vërejtur. Ku qëndrojnë këto të meta?

Së pari, puna e organeve dhe e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe ekonomike nuk është në nivelin e kërkesave të kohës dhe të situatës që po kalojmë, sidomos në fushën e drejtimit të ekonomisë. Ka formalizëm dhe cektësi në kuptimin dhe në zbatimin e direktivave të Partisë dhe në realizimin e tyre me përpikëri. Si pasojë, shpeshherë, direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe vendimet e Këshillit të Ministrave transmetohen thjesht dhe me të meta, zbehen gjatë rrugës, nuk shkojnë në plota në bazë, në çdo front të punës, nuk zbërthehen dhe nuk konkretizohen si duhet dhe akoma më keq punohet për organizimin, për ndjekjen dhe për kontrollin e zbatimit të tyre. Direktiva dhe vendime kemi për çdo gjë, bile edhe në mënyrë të përsëritur. Ç'mund të themi, për shembull, për mosplotësimin e planit të perimeve, të patates, të bimëve foragjere, se nuk dihej ç'duhej bërë, apo se nuk u bënë ato që dihehin? Komiteti Qendror, duke marrë parasysh prapambetjen në bimën e pambukut, mori një vendim të veçantë për shtimin e prodhimit të tij e, megjithatë, edhe këtë vit, plani i kësaj bime nuk u realizua. Sa herë ka porositur Partia për shfrytëzimin e plotë të makinave metalprerëse apo të mekanizmave të rëndë në ndërtim? Po pse e lejojnë një gjendje të tillë organizatat e Partisë, përse bëjnë sehir e nuk marrin masa?

Këta dhe të tjerë shembuj të kësaj natyre tregojnë edhe një herë se ka organe dhe organizata partie, si dhe organe shtetërore, në qendër dhe në bazë, që nuk po e luajnë si duhet rolin e tyre. Byroja Politike dhe shoku Enver, në mbledhjen e 6 dhjetorit të vitit të kaluar, theksuan edhe një herë

se pa forcuar kontrollin gjatë gjithë procesit të organizimit e të drejtimit të ekonomisë e në çdo qelizë të saj, në mënyrë që asnjë direktivë e vendim të mos mbetet pa u zbatuar në kohë dhe plotësisht, nuk mund të sigurohet realizimi i gjithë detyrave që parashikojnë planet tona ekonomike.

Komiteti Qendror i Partisë, në mënyrë të përsëritur dhe me shumë forcë, ka shtruar para organizatave të Partisë dhe organeve shtetërore e ekonomike domosdoshmërinë e përvetësimit dhe të përhapjes së përvojës së përparuar dhe të të reja të shkencës e të teknikës, si faktorë shumë të rëndësishëm për rritjen e prodhimit. Shpesh është folur dhe është rekomanduar nevoja e përgjithësimit të përvojës së përparuar të kultivimit të pambukut në Çermë të Lushnjës dhe në Lapidarha të Beratit, të rendimenteve të larta në luledielli, të arritura për disa vjet rresht, në Kooperativën Bujqësore të Donofrosës në Berat, e cila, edhe vitin që kaloi, mori 20,5 kv për ha luledielli në rreth 200 ha, të kursimit të karburantit sipas përvojës së shoferëve e të traktoristëve pararojë, të rezultateve të mira të prodhimit dhe të atyre ekonomiko-financiare në Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit në Korçë dhe të Bushatit në Shkodër, të kombinatit të materialeve të ndërtimit «Josif Pashko» në Tiranë, si edhe të përvojës së dobishme të mjaft kooperativave bujqësore dhe të ndërmarrjeve të sektorëve të ndryshëm. Megjithëkëtë, rezultatet janë të pakënaqshme, sepse puna edukuese, shpirti organizues dhe këmbëngulja e organizatave të Partisë, në këtë drejtim, nuk janë në lartësinë e duhur; shpeshherë, dominojnë formalizmi, rutina dhe zvarritja, mungesa e bindjeve ideologjike.

Nuk po bëhet akoma sa duhet një punë e thelluar nga ana e organizatave dhe e forumeve të Partisë në rrethe për kuptimin e situatave që po kalojmë. Në këtë fushë ka globalizëm dhe njëfarë euforie pa bazë dhe të rrezikshme. Në shpjegimin e situatave nuk ndalemi sa duhet te masat konkrete që duhet të marrë çdo organizatë-bazë e Partisë dhe çdo komunist për t'u bërë ballë vështirësive, që rrjedhin nga bllokada imperialisto-revizioniste dhe për të shkukur nga rrënjët të metat e dobësitë që kemi në punë. Janë me dhjetëra kolektivat punonjës, të cilët, gjatë vitit të kaluar, bënë një luftë të paepur kundër pengesave dhe vështirësive dhe kanë dalë faqebardhë, sepse organet dhe organizatat-bazë të Partisë shpjegimin e situatave e kanë lidhur me detyrat konkrete të kolektivit punonjës dhe i kanë oëndruar në kokë plotësisht të detyrave. Kurse ata që nuk i realizojnë planet, flasin shumë për situatat, por, në të vërtetë, jetojnë pak me to.

Në shumë raste, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë nuk i kanë rritur e nuk i kanë forcuar kërkesat ndaj vetes

dhe ndaj të tjerëve për plotësimin e detyrave të planit, siç e kërkojnë situatat; lejohen shturje, mosorganizime, zotime boshe, fjalë e slogane nga mbledhja në mbledhje, të cilat nuk japin bërëqet dhe mbjellin indiferentizëm.

Me këtë nuk duam të themi aspak se nuk punohet dhe nuk ka mobilizim, por këto ende nuk u përgjigjen kërkesave të kohës dhe gjendjes aktuale. Faktet tregojnë se kur konstatohet që nuk plotësohet plani i prodhimit të naftës, i qymyreve, i materialeve të ndërtimit, i drithërave, i bimëve industriale, i qumështit, i mishit, i perimeve, i patateve etj., në shkallë rrethi apo në disa ndërmarrje e kooperativa, në vend që të analizohen thellë shkaqet e të jepet llogari deri në një e në kohën e duhur në organizatat-bazë të Partisë, e gjithë kjo kalon, shpesh, me një autokritikë të përciptë dhe me zotime që nuk realizohen. Kjo frymë e sëmurë indiferentizmi dhe justifikimi ekziston jo vetëm në disa quadro drejtues të ndërmarrjeve ekonomike dhe të kooperativave bujqësore, por edhe në disa organe shtetërore dhe të ekonomisë në rrethe e deri në aparatet e organeve qendrore.

Kuptimi i drejtë i situatës që po kalojmë duhet të kishte sjellë dhe duhet të sjellë, medoemos, një shpërthim të gjithanshëm e më të lartë të energjive revolucionare të komunistëve dhe të mbarë popullit tonë, një organizim më të përsosur të punës, një përmirësim rrënjësor të metodës dhe të stilit në drejtimin e ekonomisë, për ta çuar punën tonë më shpejt përpara në të gjitha frontet. Situata e jashtëzakonshme kërkon që organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike të përgjigjen me një punë e mobilizim të jashtëzakonshëm për realizimin e detyrave. Të jetosh me situatat do të thotë të realizosh detyrat e planit. Prandaj edhe puna e Partisë, e çdo kolektivi, e çdo komunisti dhe e çdo quadri, në këto momente, duhet të matet, para së gjithash, me realizimin e detyrave të planit.

Tani, më fort se kurrë, kërkohet të forcohet më tej roli udhëheqës e kontrollues i organeve dhe i organizatave të Partisë në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit e në të gjitha nivelet, për zbatimin e drejtë e të plotë të politikës ekonomike të Partisë, për rritjen e mëtejshme të shembullit pararojë të komunistëve, për t'i bërë ata plotësisht të ndërgjegjshëm për zbatimin e detyrave të planit.

Së dyti, ndjenja e përgjegjësisë së mjaft drejtuesve të organeve të Partisë e të shtetit, të anëtarëve të Partisë, në qendër dhe në bazë, për zbatimin e detyrave të planit, ende nuk është në lartësinë që kërkon Partia. Në përgjithësi, quadrot drejtues, punëtorët dhe kooperativistët, nën udhëheqjen e Partisë, kanë punuar dhe bëjnë përpjekje të mëdha, kanë kapër-

cyer mjaft vështirësi, janë arritur rezultate, ekonomia jonë i ka qëndruar rrebeshit armik dhe kjo gjë flet për forcën dhe për vitalitetin e saj.

Por është fakt se deficitet, që u krijuan gjatë këtyre tre vjetëve, në një pjesë të konsiderueshme të tyre mund të ishin mënjeluar, po të kishim punuar e drejtuar më mirë. Të gjithë e kuptojmë të keqen që u vjen ekonomisë dhe vendit tonë nga këto mosrealizime, të cilat na kanë detyruar të prekim, në disa raste, rezervat e shtetit; por kjo nuk mjafton. Çështja është që të gjenden rrugët dhe të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i mënjeluar të metat, për ta përmirësuar me çdo kusht gjendjen.

Në stadin ekonomik-shoqëror të arritur dhe në situatën që po jetojmë, shfaqet e mungesës së përgjegjësisë e të mosushtrimit të kompetencave nga gjithsecili, të thyerjes së disiplinës shtetërore, të shfaqjeve të theksuara të burokratizmit e të liberalizmit, që manifestohen në mjaft drejtues të aparateve të Partisë e të shtetit, në qendër dhe në rrethe, janë shumë të dëmshme e me pasoja të rënda. Në punën e ministrive ka javashllëk e zvarritje burokratike. Janë të theksuara tendencat e disa drejtorëve e specialistëve, në ministri e në rrethe, për të mos marrë përgjegjësi mbi vete. Nga mjaft organe të bazës problemet për zgjidhje u referohen, pa u thelluar, organeve qendrore, kurse organet qendrore, në mjaft raste, edhe pse çështja është në kompetencën e tyre, ia kalojnë ato bazës, në vend që gjithsecili t'i dalë për zot punës që i takon. Kjo vjen edhe sepse organizatat e Partisë dhe mjaft drejtues të dikastereve, në vend që të kontrollojnë si i zbatojnë kompetencat dhe detyrat drejtorët dhe specialistët dhe t'i vënë ata para përgjegjësisë për t'i realizuar ato sa më mirë, lejojnë rrugën e përqendrimit të tyre në duar të disa kuadrove.

Këtyre shfaqjeve burokratike të drejtimit në dikastere u duhet dhënë fund, sepse ato ngurtësojnë punën e aparatit, shkaktojnë zvarritje, ndrydhnin mendimin dhe iniciativën për të studiuar e për të zgjidhur drejt dhe shpejt problemet që dalin. Duhet të kuptohet mirë se shembulli i drejtuesve në organet e Partisë e të shtetit, lidhur me qëndrimet parimore apo liberale, ka të bëjë drejtpërsëdrejti me zbatimin e vijës, me orientimin, me organizimin dhe me kontrollin e zbatimit të detyrave. Ndërtimi i një metode dhe stili revolucionar në drejtimin e ekonomisë, në qendër dhe në rrethe, kërkon që drejtuesit dhe vartësit e tyre të jenë të shkathët, t'i zgjidhin shpejt e me frymë të lartë partishmërie problemet që ngrihen nga baza, të shqetësohen thellë kur problemet ngecin dhe të marrin masa për t'iu përgjigjur flakë për flakë zbatimit të detyrave të sektorit që mbulojnë.

Me gjithë përmirësimet, kemi akoma disa kuadro që kanë mbetur prapa, që nuk ecin me kohën dhe që, duke i mbajtur për një kohë të gjatë në vende drejtuese, e quajnë veten të imunizuar e të pazëvendësueshëm. Këta kuadro janë mësuar me marrjen e zotimeve sa për të kaluar radhën dhe nuk me-rakosen kur ndërmarrja, kooperativa ose sektori që drejtojnë nuk realizojnë planin. Tani që kemi me qindra dhe me mijëra kuadro të devotshëm dhe revolucionarë, Partia duhet t'i zëvendësojë pa hezitim ata që nuk ndreqen dhe që nuk duan t'i kuptojnë e t'i zbatojnë direktivat e Partisë dhe ligjet e shtetit socialist, duke hequr dorë nga çdo lloj shfaqjeje të sentimentalizmit.

Akoma nuk po u përgjigjet kërkesave të kohës dhe detyrave të mëdha puna drejtuese e organizuese e Ministrisë së Bujqësisë. Është shqetësues fakti që disa tregues të rëndësishëm të prodhimit bujqësor e blegtoral dhe financiar, sidomos në ndërmarrjet bujqësore janë edhe më të ulët se ata të viteve të kaluara. Byroja Politike, sikurse jeni në dijeni, qortoi ministren e Bujqësisë dhe shtabin e Ministrisë së Bujqësisë për mosrealizimin e planit në bujqësi, veçanërisht për pakujdesi shumë të theksuar që tregohet për perimet, për patatet dhe për foragjeret.

Byroja Politike dhe Këshilli i Ministrave vazhdimisht u kanë tërhequr vëmendjen ministrit të Industrisë e të Minerave dhe shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror, që punojnë në këtë sektor, për mosplotësimin e detyrave në industrinë e naftës dhe të qymyreve, si dhe për moskrijimin e rezervës së trupave në kombinatet e drurit, megjithatë, këto detyra nuk po zbatohen si duhet, duke krijuar shqetësime serioze për ekonominë tonë.

Në qershor të vitit 1978 Byroja Politike kritikoi përsëri me forcë mungesat në prodhimin dhe në furnizimin e mallrave të përdorimit të gjerë dhe gjendjen e pakënaqshme në sektorin e peshkimit. Ministri i Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore mori zotime për përmbyshjen e situatës, por gjendja nuk ka ndryshuar.

Për një metodë e stil jo si duhet flet, gjithashtu, fakti që Ministria e Ndërtimit nuk i parashikon gjithnjë drejt nevojat e ndërmarrjeve të veta për materiale ndërtimi dhe nuk organizon si duhet punën për sigurimin e tyre. Ndërsa para dy-tre vjetësh kishim tepicë në tulla dhe në tjegulla, tani ato janë kthyer në materiale deficitare, bashkë me gurët, me rërën, me llaçin dhe me çimenton, materiale këto të gjitha që prodhohen në vend. Me gjithë kritikën e përsëritura kjo ministri ende nuk e ka bërë kthesën e duhur në këtë drejtim dhe, për pasojë, shumë ndërmarrje të saj, gjatë vitit që kaloi, nuk reali-

zuan planin, kryesisht për dobësi organizimi dhe për mungesa në materialet e ndërtimit.

E pakënaqshme është puna e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe e ndërmarrjeve të saj për kapërcimin e vështirësive në gjetjen e tregjeve për eksportimin e mallrave tona dhe për importimin në kohë të pajisjeve, të makinerive dhe të lëndëve të para.

Edhe aparati i Këshillit të Ministrave, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave duhej të kishin ndjekur më mirë plotësimin e detyrave të planit, të ndihmonin dhe të gjallëronin më shumë punën e komiteteve ekzekutive të rretheve dhe të ndërmerrnin më shumë studime serioze për t'i paraprirë zhvillimit dinamik të ekonomisë sonë. Detyra të rëndësishme i dalin dhe aparatit të Komitetit Qendror të Partisë për të kontrolluar e për të ndihmuar më mirë punën e komiteteve të Partisë të rretheve dhe të organizatave të Partisë që të udhëheqin si duhet realizimin e planit në të gjithë sektorët.

Byroja Politike u tërhoqi vëmendjen gjithë komiteteve të Partisë të rretheve që kanë krijuar boshllëqe në realizimin e planit gjatë vitit 1978 e gjatë tre vjetëve të pesëvjeçarit. Veçanërisht ajo qortoi sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve Lushnjë, Korçë, Sarandë e Krujë, si dhe sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit për deficitet që kanë krijuar këto rrethe, sidomos për prodhimin e drithërave të bukës.

Përgjegjësi për mosrealizimet e vërtetuara, këto tre vjetët e pesëvjeçarit të gjashtë, në zbatimin e detyrave të planit e për deficitet e krijuara në bujqësi, në naftë, në ndërtim dhe në sektorët e tjerë të ekonomisë kanë, gjithashtu, edhe organizatat e masave, sidomos bashkimet profesionale dhe Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë. Ato, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, nuk ndihen dhe nuk ndikojnë sa duhet për forcimin e organizimit të punës e të disiplinës proletare. Byroja Politike dhe shoku Enver i kritikuan rreptë forumet e këtyre organizatave, se akoma bëjnë një punë rutinë e burokratike dhe, në shumë raste, nuk ecin me hapin revolucionar që karakterizon masën e punëtorëve e të rinisë.

Udhëheqjet e organizatave të masave është e nevojshme të luftojnë më me vendosmëri kundër shfaqjeve të vetëkënaqësisë e të liberalizmit dhe të reagojnë me forcë lidhur me mosrealizimin e detyrave të planit ndaj individëve, brigadave apo kolektivave punonjës, kundër indisciplinimeve, dëmtimeve të makinerisë e të pronës socialiste, kundër dembelizmit, mungesave e sjelljeve të palejueshme në punë e jashtë saj etj.

Komiteti Qendror i Partisë kërkon që ato, dhe sidomos bashkimet profesionale, të vihen më mirë në ballë të luftës,

ta kthejnë fytyrën më tepër nga punëtorët e bujqësisë. Puna ideopolitike, përgjithësimi dhe përhapja e përvojës së përparuar, forcimi i jetës së brendshme të organizatës dhe gjithë veprimtaria tjetër e tyre t'i shërbejnë plotësimit të detyrave të planit nga çdo punëtor dhe i ri në frontin e punës ku ai punon. Puna edukative të ndërtohet mbi bazën e fakteve të gjalla dhe, duke e ballafaquar atë me direktivën, të vihen para përgjegjësisë morale e administrative ata që thyejnë normat e moralit proletar, rregullat, vendimet dhe ligjet e shtetit.

Së treti, në punën e përditshme vërtetohen akoma shkelje të përsëritura të disiplinës në punë dhe, në mënyrë të veçantë, në zbatimin e detyrave të planit dhe të vendimeve të marra. Ende nuk është përvetësuar porosia e shokut Enver që

«... të rrenjosez thellë dhe një herë e mirë te të gjithë mendimi se plani i shtetit është ligj dhe kush e shkel atë, duhet të japë llogari deri në një...»¹,

si dhe për domosdoshmërinë që të mbahet parasysh se

«Planet e aprovuara, vendimet që marrim, urdhëresat e porositë që jepen, duhet të zbatohen pa hezitim. Ato nuk janë fakultative. Kush i merr si të tilla, dëmton punën, prandaj edhe duhet të përgjigjet»².

Në mungesën e disiplinës e kanë burimin, kryesisht, mosplotësimi i detyrave të planit në mjaft sektorë, tejkalimi i fuqisë punëtore dhe i fondit të pagave, i shpenzimeve inproduktive dhe jashtë planit, mosrealizimi i rendimentit në punë, cilësia e dobët në disa prodhime dhe shërbime ndaj popullit, mungesat në punë, në ndërmarrje dhe në kooperativat bujqësore, dëmtimet e pronës socialiste etj., etj. Për çfarë disipline mund të bëhet fjalë kur dëmtohen me dhjetëra e dhjetëra motorë në bujqësi, në industri e në komunikacion në kohën e ngricave të janarit, për shkak se nuk u ishte zbratur uji?

Për këto shkelje flagrante të disiplinës së Partisë dhe të disiplinës shtetërore çfarë presin komitetet e Partisë të rretheve dhe organizatat-bazë për t'i mënjeluar ato, përse mbajnë qëndrim formal e burokratik ndaj tyre, përse nuk i analizojnë thellë shkaqet dhe nuk përcaktojnë përgjegjësinë dhe personat përgjegjës, përse nuk marrin masat e domosdoshme që të zbatohen një më një direktivat e Partisë në këto drejtime? A është

1 Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1978-1979», f. 97.

2 Po aty, f. 98.

me vend që, dhe për çështje të njohura, të cilat janë detyrë dhe krejtësisht në kompetencë të vetë komiteteve të Partisë dhe atyre ekzekutive, të sinjalizojnë, të ndërhyjnë dhe të urdhërojnë medoemos Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave?

Mbledhja e prodhimeve e, sidomos, ajo e pambukut dhe e misrit, do të zvarritej edhe me javë të tëra e do të kishte pasoja të rënda ekonomike, në qoftë se nuk do të ndërhyhej dhe nuk do të merreshin masa të drejtpërdrejta ndëshkimi kundrejt kuadrove drejtues në rrethet Fier, Lushnjë, Durrës etj. Plotësimi i numrit të bimëve për ha në të lashtat e në të mbjella dhe kullimi i ngastrave të grurit, megjithëse të gjithë e dinë se janë masa të domosdoshme për të siguruar rendimentet e parashikuara, nuk do të bëheshin plotësisht e si duhej në qoftë se nuk do të ishin urdhri rigoroz nga Këshilli i Ministrave dhe kontrolli i vazhdueshëm për zbatimin e tij. Kështu qëndron çështja edhe për mbjelljen e perimeve, për mbjelljen e pemëve, për hapjen e tokave të reja, si edhe për shfrytëzimin e mijëra makinerive e pajisjeve, të automjeteve e të rimorkiove, për furnizimin e rregullt të tregut, për shërbimin shëndetësor etj.

Shumë herë është theksuar që treguesit e planit të ndiqen frontalisht, si ata sasiore, ashtu edhe ata cilësorë, treguesit financiarë, asortimenti dhe kontratat, në mënyrë që të evitohet njëanshmëria në drejtimin e ekonomisë. Organet e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike në rrethin e Korçës u zotuan para Komitetit Qendror të Partisë se do të realizonin, edhe në kushtet e vitit 1978, dorëzimin e panxharit të sheqerit; në fakt, ato u mobilizuan mirë, i kapërcyen vështirësitë e thatësirës dhe e plotësuan qind për qind detyrën. Kjo është një punë për t'u lavdëruar. Por ato ranë në pozitat e njëanshmërisë së theksuar e shumë të dëmshme dhe, si pasojë e kësaj, nuk ndoqën me të njëjtën forcë zbatimin e detyrave për dritërat e bukës, për patatën dhe për prodhimet e tjera, gjë që bëri të krijohen deficite të mëdha në këto bimë e me rrjedhime të rënda për ekonominë.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore e ekonomike dhe organizatat e masave kanë nxjerrë konkluzione e mësimë nga organizimi dhe nga mobilizimi i komunistëve dhe i punonjësve, kohët e fundit, për heqjen e prodhimeve të vona nga ara dhe për shërbimet në bimën e grurit. Konkluzioni kryesor, që ka dalë, është se masat janë kurdoherë të gatshme dhe hidhen në zjarr për të çuar në vend fjalën e Partisë, kur organizohen dhe udhëhiqen si duhet nga Partia. Çështja është që të përsoset vazhdimisht organizimi, të përmirësohet e të gjallërohet kontrolli në të gjitha hallkat e nivelet, të forcohen disiplina dhe kërkesa e llogarisë.

Mbi planin e vitit 1979 dhe detyrat kryesore për realizimin e tij

Byroja Politike e Komitetit Qendror i paraqet për miratim këtij Plenumi drejtimet kryesore të planit të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për vitin 1979, në të cilin parashikohen ritme të larta rritjeje në produktin shoqëror, në të ardhurat kombëtare dhe në treguesit e tjerë, që mbështeten në direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë.

Karakteristikë themelore e planit të vitit 1979 dhe që dallon nga të gjitha planet e miratuara deri më sot, është se ai mbështetet tërësisht në forcat tona, në burimet njerëzore, materiale e financiare të vendit tonë, pa asnjë kredi nga jashtë. Në kushtet aktuale të zhvillimit të luftës së klasave, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, të thellimit të krizës së përgjithshme të sistemit kapitalisto-revizionist dhe, kur në frontin e armiqve tanë u rreshtuan edhe revizionistët kinezë, parimi i mbështetjes vetëm në forcat tona merr një kuptim dhe një rëndësi të jashtëzakonshme.

Në vitin 1979, prodhimi i përgjithshëm industrial do të jetë 10,1 për qind më i lartë se në vitin 1978, nga i cili mjetet e prodhimit rreth 13,1 për qind.

Nxjerrja e naftës bruto do të arrijë, afërsisht, aq sa është detyra e pesëvjeçarit. Prodhimi i gazit dhe i qymyreve është parashikuar aq sa janë detyrat e pesëvjeçarit. Përparësi do t'u jepet edhe produkteve të tjera të industrisë nxjerrëse e përpunuese, kurse prodhimi i energjisë elektrike është parashikuar me një rritje rreth 35 për qind kundrejt vitit 1978, një pjesë e mirë e së cilës do të eksportohet. Prodhimi i industrisë mekanike parashikohet 11,4 për qind më i lartë se detyrat e pesëvjeçarit.

Detyra të rëndësishme i dalin industrisë së lehtë e ushqimore për të realizuar planin e prodhimit në sasi, në asortiment e në cilësi, sidomos, për tekstilë, për këpucët e për artikujt e imët metalikë të përdorimit të gjerë.

Shtimi me ritme të larta i prodhimeve bujqësore e blegtorale është një nga drejtimet kryesore të planit të vitit 1979. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor parashikohet të jetë rreth 30 për qind më i lartë se në vitin 1978, për disa prodhime detyrat janë akoma më të mëdha. Si kurdoherë, përparësi do t'u jepet drithërave të bukës, pa lënë në asnjë mënyrë pas dore bimët industriale, perimet, patatet, pemëtarinë, prodhimet blegtorale etj.

Parashikohet të kryhen investime të rëndësishme, që rriten 12,1 për qind kundrejt vitit 1978, nga të cilat ndërtim-montimet 6,7 për qind më shumë. Në këtë mënyrë sigurohen

vazhdimi dhe vënia në shfrytëzim e disa objekteve, që ishin parashikuar të ndërtoheshin me kredi nga Kina dhe do të ndërtojmë një varg veprash të reja.

Eksporti i mallrave, në vitin 1979, parashikohet të jetë rreth 55 për qind më i lartë se ai i vitit 1978, duke përmirësuar, njëkohësisht, strukturën dhe cilësinë e tyre.

Për vitin 1979 janë caktuar detyra për rritjen e transportit, të tregtisë, të shërbimeve komunale, si dhe për përmirësimet e mëtejshme në veprimtarinë e sektorit të arsimit, të kulturës dhe të shëndetësisë.

Të ardhurat e buxhetit të shtetit rriten 14 për qind dhe sigurojnë financimin e pandërprerë të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës dhe forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit.

Në planin e vitit 1979 janë parashikuar masa që shpërpjesëtimet që janë dukur, të mënjanojnë. Në të janë vendosur raporte të drejta midis gjithë faktorëve që determinojnë ecjen e ekonomisë mbi baza të shëndosha e të qëndrueshme.

Projektplanin i vitit 1979 i zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës është i ngjeshur, por plotësisht i realizueshëm. Në të gjen shprehjen e vet politika ekonomike e Partisë, e cila mbështetet në vijën e përgjithshme të Partisë, në ekonominë politike të socializmit dhe në kushtet, në mundësitë e në nevojat konkrete të vendit tonë. Në planin e vitit 1979 pasqyrohen kërkesat e ligjeve ekonomike objektive të socializmit, parashikohen ritme e përpjesëtime që sigurojnë zhvillimin normal, proporcional e pa të çara të ekonomisë.

Prandaj detyra kryesore, që na del përpara, është të marrim të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar planin në të gjithë zërat, në të gjithë treguesit sasiorë e cilësorë dhe në kohën e duhur. Është e qartë se ritmet, përpjesëtimet dhe raportet e parashikuara mund të ruhen vetëm po të realizohet plani. Ndryshe, kur treguesit dhe detyrat e planit realizohen vetëm në disa degë e tregues dhe në disa të tjerë krijohen deficite serioze, siç ndodhi gjatë vitit 1978, atëherë, këto ritme, përpjesëtime e raporte, prishen dhe, dashje pa dashje, krijohen perturbacione në ekonomi. Po të lejohet të përsëritet kjo gjendje, atëherë, pasojat do të jenë të rrezikshme, sepse kjo çon në inflacion, në ngritje të çmimeve dhe në papunësi.

Por Partia nuk e ka lejuar dhe nuk do ta lejojë kurrë një gjë të tillë. Në goftë se vendi ynë po përballon me sukses sabotimin e revizionistëve kinezë, kjo shpjegohet me atë se ekonomia jonë është e fortë dhe e qëndrueshme, se Partia e pushteti kishin menduar e kishin punuar me kohë dhe kështu do të mendojnë e do të punojnë gjithmonë, edhe në të ardhmen, për forcimin e rezervave shtetërore. Mirëpo kjo nuk mund të vazhdojë gjatë, prandaj e vetmja rrugë për të përballuar me

sukses vështirësitë e krijuara nga rrethimi dhe bllokada e egër imperialisto-revizioniste, është realizimi i planit në të gjitha degët, sektorët dhe treguesit e tij.

Ku duhet ta përqendrojmë vëmendjen më shumë në realizimin e detyrave të planit të vitit 1979?

Siç e theksuam edhe më lart, deficitin kryesor në produktin shoqëror, për tre vjetët e pesëvjeçarit, të marrë së bashku, e përbën bujqësia. Që këtej del se, për të realizuar ato ritme e raporte të parashikuara në planin e vitit 1979, është e domosdoshme që, në radhë të parë e mbi të gjitha, të realizohen e të tejkalohen detyrat për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë kërkon që të gjitha organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë dhe organizatat e masave, ta përqendrojnë tërë vëmendjen në bujqësi, se ajo ka qenë e mbetet fronti kryesor i ekonomisë sonë dhe që në situatat aktuale merr një rëndësi të jashtëzakonshme.

Për plotësimin e të gjitha detyrave në sektorin e bujqësisë, është e nevojshme që Partia, me punën e saj dhe me shembullin e komunistëve, në radhë të parë, t'i bëjë sa më të ndërjegjshëm punonjësit e bujqësisë për gjendjen e rrethimit dhe për situatën që na është krijuar me tradhtinë e udhëheqjes revizioniste kineze dhe për mundësitë e mëdha që ka bujqësia për realizimin e detyrave të caktuara. Kjo kërkon, gjithashtu, që të përsosen organizimi e drejtimi i punës dhe secili të marrë përgjegjësi për zbatimin plotësisht të të gjitha detyrave të shumta e komplekse që i dalin bujqësisë.

Planet, në këtë degë bazë të ekonomisë, do të realizohen e do të tejkalohen, po të kapemi fort pas zbulimit e përdorimit të rezervave të brendshme dhe, veçanërisht, pas përgjithësimin e përhapjes së përvojës së përparuar, që ekziston në çdo rreth dhe në çdo ekonomi bujqësore. Nuk ka vend për justifikime e shfajësime. Atë që bëjnë të përparuarit mund dhe duhet ta bëjnë edhe të tjerët. Kushtet atmosferike nuk mund t'i ndryshojmë, por që t'u kundërvihemi me të gjitha mjetet e forcat, këtë mund e duhet ta bëjnë të gjithë.

Rëndësi të veçantë për ekonominë popullore ka nxjerrja e industrisë së naftës nga prapambetja. Për këtë qëllim, organet e organizatat e Partisë të rretheve Berat, Fier, Vlorë, Lushnjë dhe Sarandë, Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe organet e saj vartëse, gjithë komunistët e punonjësit e naftës, duhet të marrin masa sa më të efektshme për zbulimin dhe për vënien në shfrytëzim të vendburimeve të reja të naftës e të gazit, për forcimin e disiplinës tekniko-shkencore, për zbatimin me përpikëri të proceseve teknologjike në shpimin e puseve, për mënjanimin e avarive dhe për përdorimin gjerësisht të me-

todave intensifikuese, për të vënë në punë të gjithë fondin e pu-seve dhe për t'u marrë atyre edhe kombin e fundit të naftës.

Këto detyra Komiteti Qendror nuk i shtron për herë të parë, prandaj paralajmëron organet përkatëse të Partisë dhe levat e tyre që të marrin masa dhe përgjegjësi të plotë për realizimin e planit të naftës e të gazit. Nuk mund të lejojmë që të shkelet disiplina shkencore, të ndodhin avari, të dëmtohen makineritë për neglizhencë, për dobësi organizimi, për mungesë vigjilence.

Detyra të mëdha u shtrohen organeve të tregtisë së jashtme. Sot tregtia e jashtme nga tregu kinez po drejtohet në tregje të reja. Organet e tregtisë së jashtme duhet të shkunden e të marrin përgjegjësi për realizimin e detyrave. Vështirësi ka e do të ketë, por jo prapa tyre të justifikohen të metat në punë. Nga ana tjetër, tregjeve të reja duhet t'u përgjigjemi më me cilësi të lartë, ndryshe nuk çan dot. Është e pafalshme që, së bashku me kromin, të çohen edhe gurë, që cigaret, mallrat e konsumit të gjerë, prodhimet artistike etj., të jenë me defekte. Kështu nuk mund të çahet bllokada, kështu nuk mund të gjenden tregje të reja. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se vetëm mbasi të shesim, mund të blejmë. Në të kundërtën, na krijohen vështirësi të mëdha. Prandaj, krahas shtimit të prodhimit, t'u kushtojmë rëndësi të madhe përmirësimit të cilësisë dhe ambalazhimit.

Në kuadrin e luftës për të plotësuar të gjitha detyrat e planit, problemeve të furnizimit materialo-teknik në sasi të dhe në kohën e caktuar dhe forcimit të disiplinës kontraktore, organet shtetërore dhe ekonomike t'u kushtojnë vëmendje të veçantë. Plotësimi i detyrave reciproke, midis prodhuesve dhe përdoruesve, të quhet ndër detyrat më kryesore, sepse problemet e krijuara në këtë fushë, shpeshherë, kanë sjellë vështirësi serioze dhe pengesa në realizimin e planeve.

Po kështu, një kujdes e preokupim i veçantë të tregohet për shfrytëzimin e plotë të të gjitha makinerive e pajisjeve. Është i dënueshëm qëndrimi që mbahet ndaj shfrytëzimit dhe ruajtjes së tyre. Janë me mijëra makina që nuk vihen në punë, përveç atyre që nuk shfrytëzohen me tri ndërresa ose me kapacitet të plotë. Pse e kanë lejuar këtë gjendje organet dhe organizatat e Partisë dhe nuk ushtrojnë kontrolle e të vënë para përgjegjësisë fajtorët? Po organet shtetërore, përse nuk marrin masa dhe nuk vënë rregulla të forta që të mos ndodhin këto gjëra? A u lejohet bashkimeve profesionale të bëjnë sehir e të mbyllin sytë përpara kësaj gjendjeje? Komiteti Qendror i Partisë kërkon që jo vetëm të vihen në përdorim makineritë, por të nxirren shkaqet e shkaktarët dhe të merren masa ndaj tyre. Asnjë lëshim nuk duhet bërë për shfrytëzimin racional të makinerive e të kapaciteteve prodhuese. Ndryshe, nuk mund të

themi se i kuptojmë drejt situatat dhe luftojmë si duhet për përballimin e tyre.

Në kushtet aktuale, kur Shqipëria është i vetmi vend në botë që ndërton socializmin, kuptohet se realizimi i planit në të gjithë treguesit, frontalisht e zë për zë, merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Prandaj e tërë puna e Partisë duhet t'u shërbejë plotësimit të detyrave ekonomike, arritjes së objektivave dhe zbatimit të zotimeve. Tërë punën politike, ideologjike, organizative dhe kulturore të organeve e të organizatave-bazë të Partisë, të komunistëve dhe të kuadrove, të të gjithë punonjësve ta matim me plotësimin e detyrave të planit. Kjo nuk është aspak ekonomizëm, por marksizëm-leninizëm, sepse realizimi i detyrave ekonomike lidhet me forcimin e diktaturës së proletariatit, me ndërtimin e socializmit, me fuqizimin e atdheut tonë socialist, me mbrojtjen e marksizëm-leninizmit. Vendimtare këtu është rritja e rolit udhëheqës të organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë.

Mosplotësimi i detyrave është, kryesisht, rrjedhim i të metave e i dobësive tona, prandaj edhe mënjanimi i tyre është plotësisht në dorën tonë. Shoku Enver na mëson se është në dorën tonë, ose të ecim përpara me luftë dhe me vetëdijë për të kapërcyer vështirësitë, ose të qëndrojmë në vend numëro, gjë që do të ishte shumë e rëndë, ose të ngelim prapa, gjë që do të ketë pasoja akoma më të rënda për atdheun tonë socialist. Natyrisht, ne kemi zgjedhur rrugën e parë, të ecim kurdoherë përpara. Ne, si marksistë-leninistë, do të dimë t'i përgjigjemi atij misioni të madh që na ka ngarkuar historia. Prandaj dhe i shohim të metat me sy kritik, i zbulojmë ato me kurajë dhe përcaktojmë masa për të përmirësuar më tej punën. Ne i kemi të gjitha mundësitë t'i realizojmë dhe t'i tejkalojmë detyrat e planit. Këtu qëndrojnë dhe ai optimizëm e ajo vendosmëri revolucionare, që karakterizojnë Partinë tonë heroike, klasën punëto-re të mrekullueshme, fshatarësinë patriote, inteligjencien, gratë dhe rininë tonë të zjarrtë.

Që këto mundësi të bëhen realitet, është e domosdoshme të kuptojmë drejt situatat, vështirësitë e problemet që dalin dhe të përcaktojmë rrugët për zgjidhjen e tyre. Të forcojmë kudo organizimin, kontrollin dhe disiplinën. Të bëjmë që kudo të rritet ndjenja e përgjegjësisë personale dhe kolektive e organizatave të Partisë, e kuadrove, e organeve shtetërore e të ekonomisë dhe e organizatave të masave. Për këtë qëllim, të gjallërohet e të forcohet më tej kontrolli punëtor-fshatar, që

asgjë të mos i shpëtojë kontrollit të organizatave-bazë të Partisë dhe secili të vihet para përgjegjësisë kur nuk kryhen mirë dhe në kohë detyrat e caktuara. Asnjë organ dhe organizatë partie nuk duhet të tregohet liberale ndaj njerëzve që nuk kryejnë detyrat e, aq më pak, ndaj atyre që, kur u kërkohet llogari, «hidhen përjetë», ose dorëzojnë edhe çelësat. Sentimentalizmi është i huaj për Partinë. Partia ka nevojë për militantë e revolucionarë e jo për njerëz që braktisin frontin e punës.

Organet dhe organizatat e Partisë të luftojnë më me vendosmëri kundër vetëkënaqësisë dhe euforisë. Në të njëjtën kohë, të luftohen deri në fund shfaqjet e liberalizmit e të indiferentizmit, të luftohet kundër rehatisë, qetësisë mikroborgjeze dhe dembelizmit. Asnjë organ e organizatë partie, asnjë kuadër e punonjës, — porosit Byroja Politike, — nuk duhet t'i lejojë vetes kurrë, por veçanërisht në këtë situatë, që të prodhohet e të ndërtohet me cilësi të keqe, që të dalë ndërmarrja me humbje, që të thyhet disiplina e planit, që të mos mbillen në kohë e të mos u kryhen shërbimet e nevojshme bimëve bujqësore, që të mos plotësohen përditë detyrat e ngarkuara.

Situata që kalojmë kërkon të përmirësohen më tej stili dhe metoda e punës. Kuptimi i drejtë i saj duhet të sjellë, medemos, shpërthime të dukshme të vrullit revolucionar dhe kudo të shënohet një rritje e përgjithshme. Masat punonjëse kurdoherë janë treguar të gatshme të realizojnë planin. Është detyra jonë që t'i frymëzojmë, t'i nxitim, t'i organizojmë e t'i mobilizojmë ato.

Plotësimi i detyrave të mëdha të vitit 1979 kërkon të organizohet e të zhvillohet kudo një emulacion i fuqishëm, në të cilin të përfshihen të gjithë punëtorët, kooperativistët, kuadrot e specialistët. Por ai nuk duron formalizëm, rutinë e shabllonizëm. Sot kërkohet një emulacion socialist dinamik, konkret, që t'u përgjigjet detyrave të kohës, që çdo punonjës të përfshihet në garë, që brigadat, repartet, ndërmarrjet, kooperativat bujqësore dhe institucionet t'i caktojnë vetes objektiva të qartë e konkrete dhe të luftojnë për plotësimin e tyre. Të insistohet më shumë që garat socialiste të përqendrohen në hallkën bazë të prodhimit, të përdoren forma e mjete sa më interesante e të larmishme komunikimi, të shpejta e më dinamike.

Në kushtet kur prodhimi bujqësor do të duhet të rritet rreth 30 për qind, në krahasim me vitin 1978, plotësimi i një pjese të deficiteve në bujqësi kërkon që në çdo brigadë, në çdo sektor dhe në çdo ekonomi bujqësore, veç masave për të realizuar detyrat e planit, të caktohen edhe detyrat e rrugët konkrete, që do të ndiqen për të plotësuar një pjesë të deficiteve, si: në bimët e arave, në prodhimet blegtorale dhe në pemëtari. Por ndaj zotimeve të mbahet qëndrim serioz e kritik,

sepse, edhe vitin e kaluar, u morën zotime e nuk u zbatuan.

Në qendër të zhvillimit të emulacionit socialist të vihen përgjithësimi dhe përhapja e përvojës së përparuar. Të nxiten iniciativat, aksionet e lëvizjet revolucionare të masave për zbulimin e për shfrytëzimin e rezervave të brendshme e të mundësive të mëdha, që ekzistojnë kudo për plotësimin dhe për tejkalimin e planit në të gjithë sektorët. Gjallërimi i emulacionit socialist kërkon të intensifikohet propaganda e prodhimit, që ajo t'i bëjë të ndërgjegjshëm njerëzit për politikën e asaj që prodhojnë dhe të shqetësohen edhe më shumë për problemet ekonomike.

Komiteti Qendror i Partisë kërkon që komitetet dhe organizatat e Partisë ta udhëheqin më mirë emulacionin socialist, që organizatat e masave, sidomos bashkimet profesionale, të gjallërojnë më tej drejtimin dhe ndjekjen e garave socialiste, që organet shtetërore dhe të ekonomisë ta konsiderojnë atë si pjesë të pandarë të punës së tyre për realizimin e detyrave të caktuara.

Janë të gjitha mundësitë që detyrat e planit të vitit 1979 jo vetëm të realizohen, por edhe të tejkalohen, në mënyrë që të mbulohet një pjesë e deficiteve të krijuara. Për këtë, asgjë s'na mungon. Para së gjithash, ne kemi një vijë të drejtë e të kristaltë. Populli ynë ka një besim të patundur te Partia dhe është i lidhur si mishi me kockën me të. Ne kemi bazën e nevojshme materialo-teknike për t'i zbatuar këto detyra që i kemi vënë vetes. Pra, në caktimin e detyrave të planit të vitit 1979, nuk jemi nisur vetëm nga nevojat, por edhe nga mundësitë reale që ka ekonomia jonë. Niveli drejtues e organizativ dhe aftësia teknike e kuadrove dhe e specialistëve tanë në bazë janë rritur dhe këto e bëjnë më të lehtë barrën e qendrës. Partia ka edukuar dhjetëra mijë punëtorë dhe kooperativistë të ndërgjegjshëm, me dije dhe me përvojë të madhe, nga të cilët mund të mësohet për të mënjeluar prapambetjen, që vërtetohet në disa sektorë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë ka besim të plotë se, gjatë vitit 1979, që është viti i 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, do të organizohet e do të zhvillohet kudo një emulacion i fuqishëm socialist, do të ngrihet në një shkallë më të lartë mobilizimi i komunistëve dhe i gjithë masave punonjëse, do të shpërthejnë energji të reja e të mëdha në të gjitha fushat e ndërtimit socialist, për plotësimin dhe për tejkalimin e detyrave të planit, duke vënë në jetë mësimet e Partisë e të shokut Enver.

Botohet për herë të parë me shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1978 E TË TRE VJETËVE TË PESËVJEÇARIT TË GJASHTË, TË MARRË SË BASHKU, DHE MASAT PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË VITIT 1979»

30 janar 1979

Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 29 e 30 janar 1979, pasi shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979».

V e n d o s i :

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979».

2. — Të porositë organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë që të marrin të gjitha masat e duhura për të zbërthyer dhe për të realizuar plotësisht detyrat e planit për vitin 1979.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE «MBI PËRDORIMIN E STIMUJVE MORALE»

13 mars 1979

Nga të dhënat që kemi, rezulton se nga ana e komiteteve të Partisë në rrethe, në njësitë e ushtrisë, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore, nga komandat, nga dikasteret qendrore dhe nga organet qendrore të organizatave të masave po mbahet një qëndrim nënvleftësues, i palejueshëm në përdorimin e stimujve moralë, sidomos të medaljeve, të titujve, të çmimeve të Republikës e të distinktivave të ndryshëm.

Me ligje të shtetit (të cilat i kanë në dispozicion të gjithë), janë caktuar 92 tituj, urdhra, medalje e distinktiva; ka ligje të veçanta për shpikjet e për racionalizimet, si nderohen e si shpërblehen autorët; për çmimet e Republikës etj. Të gjitha këto janë caktuar që të shpërblehen ata që punojnë mirë në të gjitha fushat, të prodhimit, të mbrojtjes, të arsim-kulturës, të shërbimit të shkencës dhe, si aktivistë shoqërorë, të nxitin dhe të tjerët.

Gjatë tre vjetëve të fundit titulli «Punonjës i shquar i shkencës dhe i teknikës» u është dhënë vetëm pesë vetave, në të gjithë vendin; apo titulli «Mjeshtër i shquar në profesion», gjatë këtyre tre vjetëve, u është dhënë 33 vetave. Kështu është gjendja edhe për titujt e medaljet e tjera. Është e qartë se, duke vepruar kështu, nuk nxiten njerëzit të punojnë më mirë, nuk zbatohen detyrat që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë për thellimin e për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, apo për ngritjen e nivelit të punonjësve. Këto dekorata e tituj të shpërndarë, si sasi, nuk pasqyrojnë aspak atë realitet të madh që ekziston në vendin tonë, ku qindra e mijëra punëtorë, kooperativistë, specialistë e kuadro të talentuar i janë përveshur, me të gjitha fuqitë e tyre fizike e mendore, punës për të plotësuar nevojat që i duhen atdheut, duke prodhuar, duke projektuar, duke ndërtuar e duke krijuar

me forcat tona, për të përballuar bllokadën e egër imperia-
listo-revizioniste.

Bujqësia është një nga frontet më të rëndësishme e më të vështira të punës sonë. Partia ka kritikuar ata që nuk i kanë realizuar detyrat, por ka lavdëruar ata që i kanë realizuar e i kanë tejkaluar e që nuk janë pak; ka porositur të përhapet shembulli pozitiv, të bëhet ky pronë e të gjithëve. Por fakti që urdhrin e medaljen «Për punë të shquar në ekonominë bujqësore» e kanë marrë vetëm 0,16 për qind e punonjësve të kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore, në një kohë kur ka mijëra punonjës, brigada e sektorë, që prodhojnë drithëra, perime, fruta, bimë industriale, prodhime blegtorale etj., që i realizojnë e i tejkalojnë detyrat, që kanë rendimente të stabilizuara e në ngjitje, tregon se sa keq përdoren stimujt moralë. Kështu mund të përmendim edhe faktin që vetëm 0,32 për qind e punonjësve të gjeologjisë e të minierave kanë urdhrin e medaljen «Për punë të shquar në miniera e në gjeologji»; apo 0,10 për qind e punonjësve të sektorëve të shërbimit, kanë marrë urdhrin e medaljen «Për shërbim të mirë popullit». Pak janë përdorur edhe urdhrat, medaljet e distinktivat, me të cilët shpërblehen ushtarët, policët, nënoficerët dhe oficerët, aktivë e rezervistë, që shquhen në zbatimin e detyrave të mbrojtjes, të rendit publik etj.

Përdorimi i drejtë ose jo i drejtë, në radhë të parë, i stimujve moralë dhe i atyre materialë, nuk është një çështje e thjeshtë, por me karakter të theksuar politik dhe ideologjik. Në pakujdesitë që ka në këtë drejtim duhet të shikojmë njëfarë njëanshmërie në punën e organizatave të Partisë, të masave, të organeve të pushtetit dhe të ekonomisë në punën me njerëzit. Nëse në bujqësi në disa rrethe, për shembull, jepen më shumë gjopa e masa të tjera disiplinore sesa medalje, urdhëra, distinktiva, flamuj e fletë lavdërimi apo vihen më pak punonjës në tabelën e nderit etj., kjo është një e metë serioze.

Në të metat, që u përmendën më lart, duhet të shohim dhe ato shfaqje të burokratizmit e të teknokratizmit në punën e organeve dhe të organizatave apo të komandave të ndryshme, kundër të cilave duhet të luftojmë me forcë e në mënyrë të vazhdueshme.

Për ta vënë në rrugë më të mbarë këtë problem të shfrytëzojmë këtë vit jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Emulacioni, që ka shpërthyer kudo, duhet të shkojë vazhdimisht në rritje dhe të shoqërohet me përdorimin e drejtë e të vazhdueshëm të stimujve të ndryshëm. Për këtë është e nevojshme të analizoni vetë gjendjen, të trajtohet ky problem në të gjitha organizatat dhe organizmat e ndryshëm, politikisht dhe ideologjikisht; të njihen orientimet e Partisë dhe të gjitha li-

gjet e urdhëresat e shtetit; të studiohen konkretisht njerëzit që i plotësojnë kërkesat e ligjit e që meritojnë t'u jepen, apo të propozohen për dekorata, tituj, çmime, distinktiva etj. Të nxitet iniciativa e bazës në përdorimin e stimujve dhe, përgjithësisht, për emulacionin të luftohet kundër formalizmit.

Të kihet kujdes që të mos kthehet kjo në një fushatë të përkohshme, por të futet në metodën e përhershme, duke zbatuar kritere të shëndosha.

Për konkluzionet dhe për detyrat, që do të nxirrni nga analiza që do të bëni, të njoftoni dhe Komitetin Qendror të Partisë. Herë pas here të informoni mbi përdorimin e stimujve të ndryshëm dhe efektet e kësaj pune.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Hysni Kapo

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «PËR FESTIMIN E 100-VJETORIT TË LINDJES SË J. V. STALINIT»

20 mars 1979

Më 21 dhjetor të këtij viti mbushen 100 vjet nga dita kur lindi J. V. Stalini, revolucionar e mendimtar i madh marksist-leninist, nxënës, bashkëpunëtor dhe vazhdues besnik i veprës së Leninit, udhëheqës i shquar i proletariatit botëror, mik i ngushtë e i shtrenjtë i popullit shqiptar.

Emri dhe vepra e J. V. Stalinit janë të pavdekshëm. Sulmet e shpifjet e armiqve borgjezë e revizionistë nuk mund të errësojnë kurrë meritat e tij historike përpara popullit sovjetik, proletariatit ndërkombëtar dhe popujve të botës.

J. V. Stalini radhitet përkrah klasikëve tanë të mëdhenj: K. Marksit, F. Engelsit dhe V. I. Leninit. Ai, me mjeshtëri dhe me vendosmëri të rrallë, mbrojti parimet themelore të marksizëm-leninizmit, i pasuroi dhe i zhvilloi ato më tej, në kushte të reja historike. Vepra e J. V. Stalinit është një thesar me vlera të mëdha e gjithnjë aktuale, një armë e fuqishme në duart e proletariatit botëror, në luftë për fitoren e revolucionit, të socializmit dhe të komunizmit.

Krah për krah me Leninin, J. V. Stalini luftoi për fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, për themelimin dhe për ndërtimin e shtetit të parë socialist në botë. Për 30 vjet me radhë, në krye të Partisë Bolshevike dhe të shtetit sovjetik, ai organizoi dhe udhëhoqi luftën për të vënë në jetë planin gjenial leninist për ndërtimin e shoqërisë socialiste, për mbrojtjen dhe për forcimin e vazhdueshëm të diktaturës së proletariatit, në luftë të ashpër me armiqtë e jashtëm e të brendshëm të Bashkimit Sovjetik, me oportunistët e me revizionistët e çdo lloji — trockistë, buharinistë, nacionalistë borgjezë e të tjerë. Ndërtimi i socializmit në Bashkimin Sovjetik, nën udhëheqjen e

J. V. Stalinit, përbën një përvojë të pasur nga e cila marksist-leninistët kanë mësuar dhe do të mësojnë kurdoherë.

J. V. Stalini na jep një shembull të shkëlqyer të luftëtarit të vendosur kundër armiqve të klasës, imperializmit e reaksionit për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit, të diktaturës së proletariatit dhe të atdheut socialist. Si një strateg i madh, ai udhëhoqi Luftën e Madhe Patriotike të popullit sovjetik dhe e çoi atë në fitoren me rëndësi historiko-botërore. Nën udhëheqjen e tij Ushtria Sovjetike mbajti peshën kryesore të Luftës Antifashiste dhe dha kontributin vendimtar në shpartallimin e fashizmit dhe në çlirimin e popujve të robëruar.

J. V. Stalini u përket gjithë komunizmit ndërkombëtar, proletariatit dhe gjithë punonjësve të botës. Si internacionalist i madh proletar, si udhëheqës i shquar i lëvizjes komuniste botërore, ai ka luajtur një rol të madh në rritjen dhe në forcimin e saj, në bolshevizimin e partive komuniste, në përpunimin e një strategjie e taktike të drejtë, revolucionare, që çuan në formimin e kampit socialist, në zhvillimin e lëvizjes revolucionare e çlirimtare të popujve.

Atij i përket merita historike që zbuloi dhe demaskoi tradhtinë e udhëheqjes revizioniste jugosllave, që ishte varianti i parë i revizionizmit modern në pushtet. Në kundërshtim me orvatjet e revizionistëve sovjetikë, kinezë e të tjerë, për të rehabilituar revizionizmin jugosllav, jeta ka vërtetuar plotësisht vlerësimin e Stalinit se titizmi ka qenë dhe mbetet një agjunkturë e imperializmit për të përçarë lëvizjen komuniste, për të sabotuar revolucionin dhe për të minuar luftën çlirimtare të popujve.

J. V. Stalini ishte mik i ngushtë dhe i shtrenjtë i popullit shqiptar. Në vitet e zjarrta të Luftës Nacionalçlirimtare emri dhe vepra e J. V. Stalinit u bënë për popullin tonë simbol i luftës dhe i fitores mbi pushtuesit fashistë e tradhtarët e vendit; mijëra partizanë shqiptarë, me emrin e tij në gojë, luftuan me heroizëm dhe dhanë jetën për çlirimin e atdheut. Në momentet e vështira të viteve të para të pasçlirimit, si internacionalist i vërtetë, J. V. Stalini i dha popullit shqiptar një ndihmë të madhe për mbrojtjen e të drejtave të tij në arenën ndërkombëtare, për të rimëkëmbur vendin nga shkatërrimet e luftës, për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit.

J. V. Stalini ka qenë dhe mbetet një marksist-leninist i madh. Vepra e tij, pavarësisht nga shpifjet e revizionistëve sovjetikë, titistë, kinezë e eurokomunistë, është e do të jetë, edhe në të ardhmen, flamur lufte e fitoreje për proletariatin botëror dhe tmerr për armiqtë e revolucionit, të socializmit, të diktaturës së proletariatit. Fushata kundër J. V. Stalinit, e ndërmarrë nga revizionistët hrushovianë në Kongresin e 20-të

famëkeq, siç ka vënë në dukje me kohë Partia jonë, s'kishte qëllim tjetër veçse të shkurorëzonte leninizmin, t'i hapte rrugën restaurimit të kapitalizmit në BS e gjetkë, të godiste forcat e vërteta revolucionare marksiste-leniniste, të degjeneronte partitë komuniste e të sabotonte revolucionin. Duke ecur në këtë rrugë, klika revizioniste e Hrushovit dhe e Brezhnjevicit likuidoi fitoret e Revolucionit Socialist të Tetorit, veprën e ndritur të V. I. Leninit dhe J. V. Stalinit dhe e shndërroi Bashkimin Sovjetik, nga qendër të revolucionit botëror, në një shtet socialimperialist.

Partia jonë e ka konsideruar dhe e konsideron mbrojtjen e J. V. Stalinit e të veprës së tij si një çështje të madhe parimore. Të mbrosh çështjen e J. V. Stalinit do të thotë të mbrosh marksizëm-leninizmin, revolucionin, socializmin, diktaturën e proletariatit, të jesh luftëtar i vendosur kundër imperializmit, borgjezisë ndërkombëtare e revizionizmit të çdo varianti, të mbrosh çështjen e lirisë e të pavarësisë së popujve, të mbash lart flamurin e internacionalizmit proletar.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, me qëllim që 100-vjetori i J. V. Stalinit të festohet kudo në vendin tonë me madhështi,

V e n d o s i :

1. — Të zhvillohet një fushatë e gjerë politike, ideologjike dhe propagandistike kushtuar jetës dhe veprimtarisë së J. V. Stalinit. Kjo fushatë të shërbejë për të njohur më thellë trashëgiminë e madhe teorike e praktike revolucionare të J. V. Stalinit, për t'u frymëzuar nga jeta dhe nga vepra e tij, në luftë për ndërtimin e për mbrojtjen e atdheut tonë socialist, duke u mbështetur në forcat e veta, për të vazhduar me konsekuencë luftën kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit.

2. — Gjatë këtij viti të zhvillohen, me masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit, leksione, biseda dhe aktivitete të tjera, për të propaganduar mësimet e Stalinit, shembullin e madh të tij në luftë për çështjen e revolucionit e të socializmit. Në prag të ditëlindjes së tij, në Tiranë dhe në të gjitha rrethet, të organizohen konferenca solemne.

3. — Për të bërë sa më të njohur trashëgiminë teorike të J. V. Stalinit, të ribotohen disa nga veprat më të rëndësishme të tij. Të përgatiten albume, fotoekspozita dhe materiale të tjera figurative.

4. — Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, pranë Komitetit Qendror të PPSH dhe shkolla e Partisë «V. I. Lenin» të organizojnë një sesion jubilar, kushtuar jetës dhe veprës së J. V. Stalinit.

5. — Veprimtaria kulturore-artistike t'i bëjë jehonë të madhe 100-vjetorit të ditëlindjes së Stalinit. Për këtë të përgatiten e të shfaqen filma, të jepen emisione televizive, të krijohen e të ekspozohen vepra artistike etj.

6. — Komitetet e Partisë, organizatat e masave, institucionet arsimore, kulturore e shkencore të hartojnë programe të posaçme dhe të marrin masa për t'i organizuar sa më mirë të gjitha aktivitetet kushtuar 100-vjetorit të J. V. Stalinit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 71 (9559), 24 mars 1979*

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI FESTIMIN E 35-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT DHE TË FITORES SË REVOLUCIONIT POPULLOR»

20 mars 1979

Këtë vit populli shqiptar do të festojë me madhësi 35-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor.

Më 29 Nëntor 1944 populli shqiptar, me Luftën e tij le gjendare Nacionalçlirimtare dhe nën udhëheqjen e Partisë Komuniste (sot Partia e Punës), me shokun Enver Hoxha në krye, korri fitoren më të shquar në tërë historinë e tij shekullore. Për të parën herë ai fitoi lirinë dhe pavarësinë e vërtetë kombëtare, vendosi pushtetin popullor dhe u bë zot i fateve të tij. Fitorja e revolucionit popullor hapi një epokë të re, epokën e ndritur të socializmit në Shqipëri.

Periudha 35-vjeçare është një epike tjetër heroike, po kaq e lavdishme sa edhe ajo e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar arritje të mëdha me rëndësi historike. Iu dha fund sundimit të kapitalit të huaj dhe grabitjes së pasurive të vendit nga imperialistët. U shpronësuan kapitalistët dhe feudalët, u likuidua prona private e, bashkë me të, edhe klasat shfrytëzuese e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. U krijua sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste që mbështetet në pronën shoqërore mbi mjetet e prodhimit. U hodhën me sukses bazat e socializmit në të gjitha fushat e jetës.

Ekonomia dhe kultura kombëtare kanë marrë një zhvillim të gjerë dhe të gjithanshëm. Është rritur vazhdimisht mirëqenia e popullit. Kudo lulëzon jeta e bukur, farkëtohet njeriu i ri i shoqërisë së re socialiste. Mbrojtja e atdheut është forcuar si kurrë ndonjëherë. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë gëzon një prestigj të madh ndërkombëtar, ajo ka miq e dashamirë të shumtë kudo në botë.

Shqipëria e re socialiste është një provë e gjallë që hedh poshtë shpifjet e armiqve borgjezë e revizionistë kundër socializmit dhe që vërteton forcën dhe vitalitetin e ideve të marksizëm-leninizmit. Zhvillimi i vrullshëm dhe i pandalshëm i socializmit në Shqipëri është vepër e Partisë sonë heroike dhe dëshmi e drejtësisë së vijës së saj dhe të mësimëve të udhëheqësit të dashur të Partisë e të popullit tonë, shokut Enver Hoxha.

Ngjarjen e madhe të 35-vjetorit të Çlirimit populli shqiptar e feston në një kohë kur situata në botë është e turbullt dhe plot rreziqe për popujt, rreziqe që vijnë nga politika agresive dhe ekspansioniste e imperializmit amerikan, e socialimperializmit sovjetik dhe e atij kinez. Imperializmi dhe reaksioni përpiqen t'u grabitin popujve lirinë e pavarësinë, të shtypin revolucionin e të shkatërrojnë socializmin. Këtyre qëllimeve u shërben edhe e tërë veprimtaria e revizionistëve modernë të të gjitha ngjyrave.

Situatat që kalojmë dhe detyrat e mëdha që ka shtruar Partia kërkojnë që të jemi më këmbë, kurdoherë të gatshëm, të punojmë me vrull e me besim të patundur për t'i çuar përpara prodhimin, edukimin dhe mbrojtjen e atdheut, për të çarë me guxim rrethimin e bllokadën imperialiste e revizioniste.

Le të bëhet viti i 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut vit i një mobilizimi të paparë, të shpërthejnë energjitë e pashtershme të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të inteligjencies popullore, të rinisë dhe të gruas, të mbarë popullit, për të shkuar në këtë përvjetor të lavdishëm me rezultate sa më të mëdha në të gjitha fushat! Të zhvillohet kudo emulacioni socialist, ku të përfshihen të gjithë kolektivat punonjës, reparatet ushtarake dhe çdo individ, të përhapet lëvizja për të fituar titullin «Sulmues i 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut».

Plenumi i 6-të i KQ të PPSH shtroi detyra të mëdha për realizimin e planit të shtetit për vitin 1979, sidomos, në bujqësi, në naftë, në ndërtim dhe në tregtinë e jashtme etj. Plotësimi i këtyre detyrave kërkon një kuptim dhe zbatim të thellë të parimit të mbështetjes në forcat tona, kërkon disiplinë të çeliktë proletare në punë, organizim të përsosur dhe ndërgjegje të lartë, kërkon zhvillimin e mendimit krijues të kuadrove, të specialistëve e të masave, për të çuar përpara revolucionin tekniko-shkencor.

Jubileu i 35-vjetorit të Çlirimit të na shërbejë për të çelikorur pareshtur unitetin monolit e të pathyeshëm të popullit rreth Partisë, i cili do të shprehet edhe një herë i fuqishëm në Kongresin e 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë. Festimi i jubileut të na shërbejë, gjithashtu, për të forcuar diktaturën e proletariatit, armën e fuqishme për mbrojtjen e për

ndërtimin e socializmit, për të rritur rolin udhëheqës të Partisë, të organizatores të të gjitha fitoreve të popullit tonë, për ta zhvilluar drejt e me konsekuencë luftën e klasave, për të edukuar e për të kalitur njeriun e ri, për t'i armatosur gjithë punonjësit me ideologjinë dhe me politikën e Partisë.

Vendi ynë ka ndjekur e ndjek një politikë të jashtme të çiltër e parimore, në mbrojtje të interesave të lartë të atdheut dhe në përkrahje të luftës çlirimtare e revolucionare të popujve. Të mbajmë, si kurdoherë, lart flamurin e luftës kundër imperializmit e revizionizmit, flamurin e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar! Detyra e shenjtë e çdo qytetari është të mprehë vazhdimisht vigjilencën, të rritë përgatitjen e tij politike e luftarake dhe të punojë pa u lodhur për forcimin e mbrojtjes së atdheut.

Me qëllim që 35-vjetori i Çlirimit të Atdheut dhe i fitores së revolucionit popullor të festohen me madhështi, KQ i PPSH

Porosit:

1. — Të zhvillohet një punë e gjerë ideopolitike dhe kulturore-artistike me masat punonjëse, për të njohur e për të propaganduar rrugën e përkrahur për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e socializmit, arritjet e mëdha të realizuara në vitet e pushtetit popullor, për të forcuar bindjet e masave në drejtësinë e vijës së Partisë dhe të rrugës socialiste, në të cilën ecën vendi ynë, për t'i frymëzuar e për t'i mobilizuar njerëzit tanë për vepra të mëdha në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e atdheut.

2. — Gjatë vitit jubilar, të festohen me madhështi të gjitha ngjarjet e mëdha historike, kombëtare e lokale, siç janë: themelimi i Partisë, 35-vjetori i Kongresit të Përmetit, i Mbledhjes së Dytë të KANÇ-it në Berat dhe i Kongresit të Parë të Rinisë e të Gruas, përvjetorët e brigadave dhe të formacioneve të tjera partizane, çlirimi i rretheve e i qyteteve dhe të gjitha festat e periudhës së luftës e të pasçlirimit.

3. — Të organizohen e të zhvillohen konferenca, leksione, mbrëmje përkujtimore kushtuar 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Shtypi, botimet, Radiotelevizioni e kinostudioja «Shqipëria e re», tërë krijimtaria letraro-artistike t'i bëjnë jehonë kësaj ngjarjeje të rëndësishme, të pasqyrojnë luftën e masave për çlirimin e vendit dhe për ndërtimin e socializmit.

4. — Për edukimin e masave me traditat patriotike e revolucionare të pasurohen e të shfrytëzohen muzetë, ekspozita kombëtare «Shqipëria sot» dhe ekspozitat e rretheve; të plotë-

sohet me pllaka përkujtimore e lapidarë përjetësimi i ngjarjeve të shquara të Luftës Nacionalçlirimtare etj.

5. — Akademia e Shkencave, në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste, me Universitetin e Tiranës dhe me shkollën e Partisë «V. I. Lenin» të organizojnë konferencën shkencore kombëtare kushtuar problemeve të ndërtimit socialist të vendit.

6. — Të organizohen në stadiumin kombëtar «Qemal Stafa» finale të spartakiadës dhe manifestimi i madh fiskulturoro-sportiv; të hapet ekspozita e madhe e arteve figurative, kushtuar 35-vjetorit të Çlirimit; më 29 Nëntor të bëhen parada ushtarake dhe manifestimi i punonjësve të kryeqytetit.

7. — Komitetet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e masave dhe institucionet kulturore-artistike të marrin të gjitha masat për të organizuar e për të zhvilluar një aktivitet të gjerë politik, edukativ e kulturor, veçanërisht gjatë muajit nëntor, si dhe për të propaganduar arritjet e vendit tonë në botën e jashtme.

Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen e plotë se populli shqiptar, i bashkuar fort rreth Partisë së tij, me komunistët në ballë, do ta kthejë vitin jubilar të 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut në një vit sulmi, në një vit betejash e fitoresh të reja në rrugën e tij revolucionare për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
nr. 68 (9556), 21 mars 1979*

V E N D I M

«M B I B Y R O S Ë P O L I T I K E T Ë K Q T Ë P P S H P Ë R N G U S H T I M I N E M È T E J S H È M T Ë D A L L I M E V E M I D I S F S H A T I T D H E Q Y T E T I T »

5 korrik 1979

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në datën 5 korrik 1979, me qëllim që të krijohen kushte më të gjera lehtësuese për gratë dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në punë të dobishme shoqërore,

V e n d o s i :

1. — Kooperativat bujqësore të zonës fushore dhe të zonës kodrinore-malore, që disponojnë fonde të paprekshme, duke u dhënë kurdoherë përparësi investimeve për forcimin e zhvillimit ekonomik të tyre, mund të investojnë dhe të ngrenë kopshte e çerdhe të përhershme për fëmijët e kooperativistëve, me ose pa ushqim, me mjetet e tyre materiale dhe financiare mbi numrin e çerdheve e të kopshteve dhe të kontingjenteve që përballohen me shpenzimet e shtetit, sipas planit të aprovuar. Gjatë periudhave më intensive të punëve në bujqësi ato mund të ngrenë, gjithashtu, po me mjetet e tyre materiale e financiare, edhe kampe, çerdhe e kopshte të përkohshme.

Investimet, shpërblimi i personelit të shërbimit, shpenzimet për ushqimin etj., për ato që do të ngrihen sipas këtij vendimi, të përballohen nga vetë kooperativat bujqësore, duke u mbështetur në të ardhurat dhe në vlerën e ditës së punës së çdo kooperative, me përjashtim të edukatoreve të kopshteve, të cilat, kur kanë arsim pedagogjik, do të shpërblehen kurdoherë nga shteti. Mbi bazën e të ardhurave e të vlerës së ditës së pu-

nës të kooperativës, të caktohet edhe kuota që do të paguajnë prindërit.

2. — Porositen komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve që investimet dhe shpenzimet, që parashikohen në planin e shtetit për ngritjen e kopshteve ose të çerdheve të reja, të bëhen, kryesisht, në ato kooperativa bujqësore që ende janë të dobëta ekonomikisht.

3. — Këshilli i Ministrave të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI PRODHIMIN, KURSIMIN DHE MUNDËSITË E SHTIMIT TË EKSPORTIT TË LËNDËVE ENERGJETIKE»

13 tetor 1979

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 13 tetor 1979, mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave i RPSSH «Studim kompleks i problemit të lëndëve djegëse energjetike: nafta, gazi, qymyret dhe masat që duhen marrë për shtimin e prodhimit, për kursimin dhe mbi mundësitë e shtimit të eksportit» dhe

V ë r e j t i :

Në sajë të vijës së drejtë të Partisë dhe të punës që kanë bërë punonjësit tanë, burimet energjetike në vendin tonë janë shtuar, në përgjithësi, me shpejtësi, në përputhje me plotësimin e nevojave të ekonomisë dhe të të gjithë vendit, duke krijuar një bilanc pozitiv të energjisë dhe mundësi për eksport. Në mënyrë të veçantë, është rritur prodhimi i qymyrgurit dhe i energjisë elektrike. Masa janë marrë edhe për kursimin dhe për përdorimin me nikoqirllëk të tyre, sidomos për zëvendësimin e lëndëve djegëse të lëngëta me qymyrguri, për kursimin e karburanteve dhe të energjisë elektrike. Hapa përpara janë bërë edhe në drejtim të rritjes së eksportit në sasi, veçanërisht të energjisë elektrike e të qymyreve, si dhe në drejtim të vlerësimit më të mirë të lëndëve energjetike të lëngëta që eksportohen.

Megjithatë, Byroja Politike u tërheq vëmendjen organeve dhe organizatave të Partisë, organeve shtetërore, ekonomike dhe organizatave të masave për të rritur përpjekjet që të shfrytë-

zohen, më mirë se deri tani, mundësitë për shtimin e prodhimit të lëndëve energjetike e, sidomos, për shfrytëzimin më të mirë e më me leverdi të tyre, në mënyrë që t'i jepen eksportit sasi gjithnjë më të mëdha. Por kryesorja është se akoma nuk është kuptuar sa duhet nga komunistët, nga kuadrot dhe nga punonjësit rëndësia e madhe që po marrin, gjithnjë më shumë, lëndët energjetike në situatën e krizës së thellë energjetike, që ka pushtuar botën kapitalisto-revizioniste, puna e madhe që duhet bërë në këto kushte, për të kursyer çdo gjë, edhe gramin e naftës apo të qymyrit dhe çdo vat të energjisë elektrike.

Me qëllim që të zbatohen direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë, lidhur me lëndët energjetike dhe që të bëhet një kthesë rrënjësore për shfrytëzimin më të mirë të burimeve energjetike, Byroja Politike

V e n d o s i :

1. Organet e Partisë dhe organizatat-bazë të saj të zhvillojnë një punë të gjerë edukative bindëse që të kuptohet nga të gjithë punonjësit domosdoshmëria për një kthesë rrënjësore në drejtim të prodhimit, të kursimit e të shfrytëzimit më të mirë të lëndëve energjetike të të gjitha llojeve. Kjo të kuptohet e lidhur ngushtë me situatën aktuale të vendit tonë, që ndërton socializmin duke u mbështetur në forcat e veta, e lidhur me krizën e thellë ekonomiko-financiare, që ka pushtuar botën kapitalisto-revizioniste e, veçanërisht, me krizën energjetike.

Prandaj të gjithë punonjësit, me komunistët në ballë, të mobilizojnë të gjitha forcat për të zbatuar deri në fund të gjitha detyrat për nxjerrjen e naftës, të qymyrgurit, për përdorimin e tyre me nikoqirllëk dhe për rritjen e eksportit.

2. Duke marrë parasysh nevojat e vendit për lëndë energjetike, në të ardhmen dhe në perspektivë, të intensifikohen punimet e kërkimit për të siguruar rezerva të mjaftueshme naftë, gazi e qymyrguri, në përputhje me nevojat e ekonomisë.

a) Të merren të gjitha masat tekniko-organizative për intensifikimin e punimeve gjeologo-gjeofizike në struktura e në rajone të reja për zbulimin e vendburimeve të naftës dhe të gazit dhe për shtimin e rezervave me ritme më të larta në të ardhmen. Për këtë të përqendrohet vëmendja në rritjen e efektivitetit të kompleksit përgatitor të punimeve, duke rritur cilësinë e metodave e të metodikave në përdorimin dhe në futjen e metodave e të metodikave të reja.

b) Kërkimet për qymyrguri të orientohen jo vetëm për shtimin e rezervave në tërësi, por edhe për të zgjeruar rezervat në vendburimet ekzistuese të pjesës jugore e lindore të

vendit, për të zbuluar rezervat në zonat veriore të vendit, për qymyre me cilësi të mirë, sidomos të koksifikueshme.

3. Shtimi i vazhdueshëm i prodhimit të lëndëve energjetike, i naftës, i gazit e i qymyrgurit, të jetë detyra kryesore e organeve të Partisë, e organizatave-bazë, e organeve shtetërore dhe ekonomike, në qendër e në rrethet përkatëse, duke marrë të gjitha masat tekniko-organizative që detyrat jo vetëm të plotësohen, por edhe të tejkalohen.

a) Për naftën, kujdes t'u kushtohet shtimit të prodhimit nga vendburimet e reja dhe zgjerimit me konturimet e vënies sa më shpejt në shfrytëzim të puseve të reja.

Vëmendje t'i kushtohet rritjes së prodhimit të naftës, sidomos, shtimit të metodave të dyta e intensifikuese, duke i shtrirë ato gjerësisht në të gjitha vendburimet e naftës e të gazit.

b) Për qymyrgurin përpjekjet për shtimin e prodhimit të përqendrohen, sidomos, në kapërcimin e vështirësive teknike dhe teknologjike, që pengojnë realizimin e detyrave. Në këtë drejtim, më shumë vëmendje t'i kushtohet Minierës së Valiasit për të zgjidhur problemet teknike, që akoma lindin në këtë minierë, për forcimin e disiplinës në punë dhe të disiplinës teknike dhe për organizimin më të mirë të punës.

Hapja e minierave të reja të bëhet në bazë të leverdisë ekonomike, duke pasur parasysh plotësimin më mirë të nevojave të të gjitha zonave të vendit e, veçanërisht, atyre të Veriut, si dhe rajonizimin e shpërndarjes së qymyrgurit për të shkurtuar transportin etj.

Organet e Partisë dhe organizatat-bazë të marrin masa për të mënjeluar dobësitë në punë, që vihen re në minierat e qymyrgurit, sidomos, për forcimin e disiplinës teknike dhe të disiplinës në punë, për sigurimin e fuqisë punëtore të nevojshme, për përgatitjen dhe për kualifikimin e punëtorëve, për zbatimin në kohë të punimeve minerare, për rritjen e shkallës së mekanizimit të punimeve, duke siguruar makineritë e nevojshme, kryesisht, duke organizuar më mirë prodhimin e tyre në vend.

4. Të merren masa të gjithanshme edukative dhe tekniko-organizative për të bërë një kthesë rrënjësore në trajtimin e problemit të lëndëve djegëse, me qëllim që në vitet e ardhshme të plotësohen më mirë nevojat e vendit dhe të eksportit, nëpërmjet rritjes së prodhimit, uljes së normativave të lëndëve djegëse energjetike dhe përdorimit me leverdi të tyre.

Nga masat që do të merren për zëvendësimin e lëndëve të lëngëta, me gaz e qymyrguri, si dhe për pakësimin e humbjeve dhe të firove, në vitin 1985, duke e krahasuar me gjendjen e tanishme, të arrihet një kursim i këtyre lëndëve sipas tabelës. Këto sasi të parashikohen në projektplanin e pesëvjeçarit të shtatë, për të përballuar nevojat e vendit dhe për eksport.

Për të arritur kursimet e parashikuara, të merren këto masa:

a) Përpunimi i naftës të bëhet në mënyrë që të përftoheshin sa më shumë prodhime prej saj, për të rritur shkallën e rentabilitetit të përpunimit. Për këtë, të shfrytëzohen plotësisht aftësitë ekzistuese të përpunimit të thellë për të përpunuar naftën e hollë të vendburimit të ri, që kërkon aftësi më të mëdha dhe pastaj të merren masat përkatëse për shtimin e aftësive të nevojshme.

b) Me gazin që nxirret, të plotësohen nevojat teknologjike të industrisë kimike, në radhë të parë, dhe pastaj të përdoret si lëndë djegëse, kryesisht, për prodhimin e energjisë elektrike dhe për të zëvendësuar lëndët djegëse të lëngëta. Duke filluar nga viti 1979, të mos prodhohet më energji elektrike me lëndë djegëse të lëngëta, por këto të zëvendësohen me gaz.

c) Të bëhen të gjitha përpjekjet për të zëvendësuar lëndët djegëse të lëngëta, që digjen në kaldaja, kryesisht me qymyrguri. Brenda 3-4 vjetëve të kthehen të gjitha kaldajat, që mund të kthehen me qymyrguri, duke përfshirë edhe të voglat.

Të merren masa, gjithashtu, për një përqendrim të shpejtë të furnizimit të avullit, duke hequr nga përdorimi sa më shumë njësi të vogla, që prodhojnë avull e ujë të ngrohtë, si dhe ato me rendiment të ulët, që përdorin lëndë djegëse të lëngëta e nuk mund të zëvendësohen me qymyrguri. Përqendrimi i furnizimit me avull, në të ardhmen, të kombinohet edhe me prodhimin e energjisë elektrike, me furnizimin e serrave me avull, me ngrohjen e banesave etj., për të thelluar më tej kursimin e lëndëve djegëse.

ç) Të përfundojnë sa më parë studimet dhe eksperimentimet për të prodhuar koxin metalurgjik me qymyre vendi dhe të merren masa për zbatimin e kësaj detyre, duke pakësuar sasi të qymyrit të koksifikueshëm që importohen.

d) Ministria e Industrisë dhe e Minierave të marrë masa për rritjen e koeficientit të nxjerrjes së qymyrgurit dhe për pakësimin e mbetjeve të tij në miniera, si dhe për uljen e varfërimit të tij, duke përdorur metoda shfrytëzimi më të përshtatshme.

Të merren masa për të përmirësuar rrënjësisht cilësinë e qymyrit, duke vendosur kudo, brenda 1-2 vjetëve, impiante seleksionimi e fraksionimi për heqjen e dherave e të lëndëve të huaja, për ndarjen e qymyrit sipas madhësisë së kokrrave. Cilësia e qymyrit të përmirësohet edhe nëpërmjet zgjerimit të pasurimit të qymyrit, duke zgjeruar fabrikat ekzistuese dhe duke ngritur të reja me forcat tona.

dh) Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Komunikacioneve dhe të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike

të marrin masa që të bëhet një kthesë rrënjësore në trajtimin, në ruajtjen, në depozitim e qymyrgurit në miniera, gjatë transportimit nga miniera, si dhe gjatë ruajtjes e trajtimit të konsumatori, me qëllim që të mënjanohej firot dhe humbjet që vërtetohen. Për këtë, në radhë të parë, të rritet kujdesi për qymyrgurin, që nga nxjerrja në miniera e deri të konsumatori dhe të merren masa për të ndërtuar bunkerët, sheshet e depozitimit dhe sheshe të mbuluara në miniera, në stacionet hekurudhore, në portet e të konsumatorët, në përputhje me nevojat.

e) Kudo që përdoret qymyrguri, si dhe lëndë djegëse të tjera, të merren masa për të mënjanoher humbjet e theksuara që vërtetohen nga mosdjegiet deri në maksimum dhe nga gjendja jo e mirë teknike e kaldajave, e furrave dhe e pajisjeve të tjera që përdorin lëndë djegëse. Për këtë të bëhet një përshtatje më e mirë e karakteristikave të qymyrgurit me llojet e kaldajave e të furrave dhe të merren të gjitha masat e nevojshme për një përmirësim rrënjësor të gjendjes teknike të kaldajave, të furrave etj., duke i pajisur këto edhe me aparatet e me pajisjet matëse e kontrolluese të nevojshme, prodhimi e riparimi i të cilave të organizohet në vend.

Për të përmirësuar djegien e qymyrit pluhur të fillohet nga puna për të studiuar, për të eksperimentuar dhe për të kthyer kaldaja nga tipi i djegies me skarë, në atë me pluhurizim, si dhe për të prodhuar në vend kaldaja të këtij tipi.

f) Të merren masa për kursimin e energjisë elektrike veçanërisht në sektorët e industrisë, të bujqësisë, të ndërtimit etj., duke ulur normativat e harxhimit të energjisë elektrike, si dhe në sektorin komunal, në përdorimin e qytetarëve, të enteve etj. Sasitë e kursyera të përdoren për eksport.

— Të thellohen e të përfundojnë studimet për përdorimin e energjisë elektrike për ngrohjen e serrave, për elektrifikimin e hekurudhave, për shkrirjen e mineraleve të nikelit, veçanërisht për mineralet e zonës së Veriut, për prodhimin e ferro-kromit dhe të merren masa për zbatimin e detyrave, vënia në jetë e të cilave është e leverdishme.

— Këshilli i Ministrave të marrë masat përkatëse për të siguruar burime eksporti të energjisë elektrike, duke bërë edhe investimet përkatëse.

— Të organizohet studimi për mundësitë e ndërtimit të hidrocentraleve edhe në zonat jugore e të mesme të vendit, si: në lumin e Vjosës, të Shkumbinit etj.

g) Të merren masa për të kursyer drutë e zjarrit, duke bërë edhe zëvendësimin e tyre, kur është e leverdishme, me qymyrguri, me gaz të lëngët e me burime të tjera energjetike.

5. Për studimin e për zgjidhjen e problemeve që lindin

dhe për kontrollin e për ndjekjen e detyrave, që dalin për sektorin e energjetikës, Këshilli i Ministrave të organizojë dhe të ngarkojë organet përkatëse pranë dikastereve e komiteteve ekzekutive.

6. Këshilli i Ministrave të marrë masa për zbatimin e këtyre detyrave.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KONKLUZIONE

TË SEKRETARIATIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PËRMIRËSIMIN E PUNËS NË BASHKIMET PROFESIONALE»

29 tetor 1979

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e datës 29 tetor 1979, mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale «Mbi masat që duhen marrë për të përmirësuar më tej metodën e stilit e punës së bashkimeve profesionale».

Si një ndër levat më të fuqishme të Partisë, bashkimet profesionale zhvillojnë një veprimtari të gjerë për edukimin e klasës punëtore dhe të punonjësve të tjerë me ideologjinë proletare e me ndërgjegjen socialiste, për mobilizimin e tyre në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e atdheut. Roli i bashkimeve profesionale në jetën e ndërmarrjeve dhe të institucioneve të ndryshme ndihet më shumë dhe ka ardhur duke u rritur. Ato punojnë për të zbatuar sa më mirë mësimet dhe direktivat e Partisë për realizimin e planit të shtetit, për organizimin dhe për zhvillimin e garave socialiste, për ngritjen e nivelit tekniko-profesional të punëtorëve; gjithashtu, luftojnë kundër shfaqjeve të burokratizmit e të liberalizmit, kundër ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste.

Sekretariati i Komitetit Qendror theksoi se puna e bashkimeve profesionale duhet parë e lidhur ngushtë me zhvillimin e shoqërisë sonë socialiste, me kërkesat në rritje të këtij zhvillimi. Te ne ka një rritje jo vetëm numerike, por dhe cilësore të klasës punëtore, një ndërgjegje politike e nivel kulturor më të lartë të saj. Ekonomia jonë është zhvilluar dhe është pajisur me teknikë e teknologji moderne. Problemet e edukimit, të prodhimit e të mbrojtjes janë bërë më komplekse e detyrat

janë më të mëdha. Këto ndryshime, si dhe situatat politike e shtimi i presionit të gjithanshëm imperialisto-revizionist mbi vendin tonë e bëjnë edhe më imperative nevojën e forcimit të mëtejshëm të punës së Partisë e të levave të saj për edukimin dhe për mobilizimin e klasës punëtore, të rinisë, të gruas, të gjithë punonjësve, në luftë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Kjo kërkesë shtrohet, veçanërisht, për bashkimet profesionale, puna e të cilave duhet t'u përgjigjet edhe më mirë vullit të klasës punëtore e të punonjësve të tjerë, gatishmërisë së tyre për të plotësuar detyrat, që rrjedhin nga direktivat dhe orientimet e Partisë, nga vendimet e nga ligjet e shtetit. Në stilin e në metodën e punës drejtuese të bashkimeve profesionale, duke filluar nga Këshilli Qendror, ka të meta e dobësi, ka njëanshmëri e cektësi në punën edukative e mobilizuese.

Përmirësimi i mëtejshëm i veprimtarisë së bashkimeve profesionale, i metodës dhe i stilit të tyre të punës duhet të preokupojë, në radhë të parë e më seriozisht, organizatat dhe komitetet e Partisë, të cilat, në dobësitë e në të metat e bashkimeve profesionale, duhet të shohin dhe punën e pamjaftueshme të tyre.

Partia ka leva të shumta. Të gjitha ato duhet të aktivizohen e të mobilizohen për të zbatuar direktivat e Partisë. Prandaj organizatat dhe komitetet e Partisë duhet t'u japin fund rasteve, kur, për zgjidhjen e problemeve të shumta të ndërtimit socialist, mbështeten vetëm në organet e pushtetit e të ekonomisë dhe lënë pas dore bashkimet profesionale dhe organizatat e tjera shoqërore. Një veprim i tillë është thellësisht i gabuar, sepse ai çon në dobësimin e lidhjeve të Partisë me masat, në nënvleftësimin e punës politike, edukuese e mobilizuese të saj, në ngushtimin e sferës së veprimtarisë të vetë organizatave të Partisë dhe të komunistëve.

Organizatave dhe komitetet e Partisë duhet t'i orientojnë vazhdimisht bashkimet profesionale për detyrat që shtrojnë e për vendimet që marrin në formë sa më të përshtatshme, të ndihmojnë që jo vetëm t'i kuptojnë, por dhe ta organizojnë punën praktike për realizimin e tyre, të bashkërendojnë punën midis bashkimeve profesionale dhe organizatave të tjera shoqërore, me qëllim që e gjithë veprimtaria e tyre të drejtohet në problemet kryesore të ndërtimit socialist dhe të mbrojtjes së vendit, të edukimit dhe të mobilizimit të masave. Udhëheqja e bashkimeve profesionale, nga komitetet e Partisë të rretheve, nuk duhet të reduktohet te lidhjet me një sektor të aparatit, ose me një sekretar të komitetit të Partisë. I gjithë aparati, të gjithë sektorët dhe sekretarët e komiteteve të Partisë duhet të merren më mirë dhe të ndiejnë më shumë përgjegjësinë

për punën e bashkimeve profesionale dhe të organizatave të tjera të masave.

Në organet udhëheqëse të bashkimeve profesionale janë të zgjedhur mijëra komunistë, përveç faktit që të gjithë komunistët militojnë si anëtarë në këtë organizatë. Kjo është një forcë e madhe për të ngritur punën e bashkimeve profesionale në nivelin e kërkesave të kohës e të detyrave që shtron Partia. Por është e nevojshme që të gjithë anëtarët e Partisë ta ndiejnë si duhet përgjegjësinë që kanë e rolin që duhet të luajnë në organizatat e masave. Ata kanë për detyrë të çojnë në bashkimet profesionale vijën e Partisë, të jenë kudo ku janë punëtorët e punonjësit, t'i sqarojnë ata për vendimet që merr e për detyrat që shtron organizata ose komiteti i Partisë dhe t'i mobilizojnë masat për realizimin e tyre. Komunisti duhet të jetë jo vetëm një punëtor i mirë, por edhe militant e aktivist shoqëror i bashkimeve profesionale dhe, për këto, atij duhet t'i kërkohet llogari më shumë në organizatën e Partisë.

Sekretariati i Komitetit Qendror tërheq vëmendjen e organizatave dhe të komiteteve të Partisë, të organizatave dhe të organeve drejtuese të bashkimeve profesionale, nga qendra deri në bazë, që të përmirësojnë punën, sidomos, në këto drejtime kryesore:

1) Bashkimet profesionale duhet t'i japin rëndësi të veçantë punës me direktivat e Partisë e me orientimet e saj. Çështja është që direktivat e Partisë jo vetëm të kuptohen thellë në përmbajtjen e gjithanshme të tyre, por dhe të zërthehen e të konkretizohen në përshtatje me funksionet dhe rolin e bashkimeve profesionale. Vetëm mbi këtë bazë mund të evitohen cektësia, nxitimi dhe njëanshmëria, që vihen re në punën drejtuese të bashkimeve profesionale, mund të luftohet kundër prirjeve për t'u marrë me vogëlma e për t'u përhapur në shumë gjëra, që e rëndojnë bazën dhe e vështirësojnë atë të përqendrohet në çështjet kryesore të prodhimit, të edukimit dhe të mbrojtjes së atdheut.

Zbërthimi i direktivave dhe shtrimi i tyre në forume është vetëm fillimi i punës, ndërsa çuarja në bazë, në klasën punëtorë dhe në punonjësit e tjerë, sqarimi e mobilizimi i tyre për plotësimin e detyrave që dalin nga direktivat e Partisë janë kryesorët në tërë veprimtarinë e bashkimeve profesionale. Këto duhet të luftojnë kundër praktikave stereotipe e burokratike, kundër shfaqjeve të punës së mbyllur vetëm në rrethe të ngushta aktivistësh ose vetëm në mbledhje të shumta e të rëndomta, të tregohen më të shkathëta për forma pune që t'u përshtaten situatave e detyrave, nivelit të masave, kërkesave e nevojave të tyre, që të lehtësojnë si kuptimin e drejtë të direktivave, ashtu dhe pjesëmarrjen e klasës punëtorë dhe të

punonjësve në zgjidhjen e problemeve, që preokupojnë Partinë e shtetin, ndërmarrjen apo institucionin, tërë jetën e vendit.

2) Është e domosdoshme që bashkimet profesionale të bëjnë në një punë më konkrete, në përshtatje me problemet e me detyrat që shtrohen para klasës punëtorë, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë e të nivelit të punonjësve, të lidhur ngushtë, në radhë të parë, me problemet e prodhimit të ndërmarrjes, të rrethit dhe të krejt vendit, me edukimin e me kalitjen revolucionare të klasës punëtorë, me rritjen e rolit të saj në shoqërinë socialiste. Vetëm puna konkrete i largon bashkimet profesionale nga shikimi global i problemeve të prodhimit dhe të edukimit të punonjësve, e bën veprimtarinë e tyre më efektive.

Tërë puna e bashkimeve profesionale është punë sqaruese, edukuese e bindëse, për rritjen e ndërgjegjes socialiste të punonjësve ndaj punës e pronës së përbashkët, për forcimin e patriotizmit, të dashurisë e të besnikërisë për atdheun, për Partinë e për socializmin. Dhe kjo punë bëhet çdo ditë, në forma të ndryshme e me të gjitha mjetet që Partia ka vënë në shërbim të edukimit të punonjësve dhe nuk mund të reduktohet vetëm në një mbledhje të organizatës e të formës së edukimit, siç ndodh në mjaft raste.

Efektiviteti i veprimtarisë së bashkimeve profesionale varet së tepërmi dhe nga masat organizative e nga veprimet praktike, që merren për të siguruar realizimin e direktivave të Partisë. Konstatimet e shumta që bëhen nuk kanë asnjë vlerë në qoftë se ato mbeten vetëm në mbledhje e në seminare, në raporte apo informacione, siç ndodh në mjaft raste. Për bashkimet profesionale kryesore duhet të jetë veprimi i masave, aksioni i tyre revolucionar për zgjidhjen e problemeve e për plotësimin e detyrave në çdo sektor e në të gjitha fushat. Me këtë ato duhet të matin tërë punën e tyre.

3) Krahas përmirësimit të punës për edukimin dhe për mobilizimin e punëtorëve, për realizimin e detyrave të planit, bashkimet profesionale duhet të forcojnë luftën kundër shtrembërimeve burokratike e shfaqjeve liberale që pengojnë e vështirësojnë realizimin e direktivave të Partisë, veprimin revolucionar të masave punëtorë. Ato duhet të luftojnë bashkë me klasën punëtorë e me masat punëtorë, kundër zvarritjeve e lëshimeve, mungesës së organizimit e të drejtimit të mirë të punës, të mos hezitojnë për t'u kërkuar llogari dhe për të vënë para përgjegjësisë cilindo që pengon zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Partia.

Rëndësi e dorës së parë i duhet kushtuar forcimit të kontrollit punëtor-fshatar, si një ndër rrugët kryesore për të rritur rolin e klasës punëtorë, për tërheqjen e gjerë të saj në

problemet e mëdha të shtetit e në qeverisjen e vendit. Bashkimet profesionale kanë këtu një fushë të gjerë veprimi. Ato duhet të ngrenë kritikën e autokritikën e masave, të organizojnë ballafaqime midis punëtorëve, reparteve, turneve, brigadave, fabrikave e ndërmarrjeve, të sugjerojnë e të kërkojnë që të ushtrohet rregullisht kontrolli nga grupet që drejtohen e që udhëhiqen nga organizatat e Partisë, të mobilizojnë punëtorët që ky kontroll të arrijë rezultate sa më të mira etj.

Bashkimet profesionale kanë për detyrë të kujdesen për të drejtat e punëtorëve, të cilat parashikohen dhe sigurohen nga ligjet e shtetit. Ato nuk duhet të pajtohen me asnjë veprim arbitrar, por dhe nuk duhet të marrin në mbrojtje asnjë punëtor që shkel ligjet e shtetit, që thyen disiplinën e që dëmton pronën socialiste. Ruajtja e shëndetit të punëtorëve, sigurimi teknik në punë, interesimi i veçantë për gratë punëtore etj., kërkojnë kujdesin jo vetëm të drejtuesve të ndërmarrjeve dhe të institucioneve, por dhe të bashkimeve profesionale.

Në luftë për realizimin e detyrave të prodhimit duhet të forcohet bashkëpunimi i bashkimeve profesionale me organet e shtetit dhe të ekonomisë. Bashkimet profesionale nuk duhet të qahen, por të luftojnë që të realizohet sa më mirë plani ekonomik, në të gjithë treguesit e tij sasiorë e cilësorë, që punëtorët të punojnë me ndërgjegje, me disiplinë e me rendiment të lartë, të marrin pjesë aktive në zhvillimin e në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor, të ngrenë nivelin ideopolitik dhe shkallën e kualifikimit të tyre. Nga ana e tyre, organet ekonomike dhe shtetërore kanë për detyrë të ngrenë para bashkimeve profesionale probleme, që preokupojnë prodhimin, kuadrot e tyre të japin llogari, si anëtarë të organizatës e si drejtues, për punën që bëjnë.

4) Me qëllim që të forcohet organizimi i brendshëm i bashkimeve profesionale e të gjallërohet puna e tyre edukative e mobilizuese, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë rekomandon:

— Të thellohet organizimi i aparatit të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, sipas sektorëve të ekonomisë e të shtrihet ky organizim dhe në aparatet e bashkimeve profesionale në rrethe, duke u mbështetur, në radhë të parë, në aktivin e organizatës.

— Për probleme të ndryshme, si: për normimin e për kualifikimin, për disiplinën etj., etj., që preokupojnë një fabrikë, uzinë apo ndërmarrje, të punohet me aktive të përbëra nga punëtorë e specialistë, anëtarë të bashkimeve profesionale, të cilët të studiojnë probleme të ndryshme që dalin dhe të sugjerojnë masat organizative, edukative e teknike, që duhen marrë për zgjidhjen e tyre. Ato krijohen e organizohen nga organi-

zatat e bashkimeve profesionale dhe nga komitetet e tyre në ndërmarrje dhe veprojnë derisa plotësohet detyra.

— Anëtarët e forumeve të zgjedhura të aktivizohen gjerësisht, sipas aftësive, profileve e sektorëve ku punojnë. Të ngrihet roli i tërë aktivitetit të bashkimeve profesionale, të inkurajohet e të kualifikohet puna e tij, në shërbim të edukimit dhe të mobilizimit të klasës punëtore. Në këtë punë të angazhohen më mirë dhe organizatat e komitetet e Partisë.

5) Udhëheqja e Partisë ka qenë dhe mbetet faktor kryesor e vendimtar për bashkimet profesionale dhe për organizatat e tjera të masave. Prandaj bashkimet profesionale duhet, si gjithnjë, të vënë në themel të punës së tyre vijën e Partisë, të ngrenë para organizatave dhe komiteteve të Partisë probleme që dalin nga puna dhe nga jeta e punonjësve, të informojnë rregullisht për veprimtarinë që zhvillojnë, të sjellin në Parti zërin dhe mendimin e klasës punëtore e të masave të tjera punonjëse.

* * *

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë shpreh besimin se organizatat dhe komitetet e Partisë, organizatat e bashkimeve profesionale dhe organet drejtuese të tyre do t'i studiojnë me vëmendje këto konkluzione dhe, mbi bazën e tyre, do të analizojnë punën që bëjnë e do të përcaktojnë masat që do të marrin për ta përmirësuar më tej veprimtarinë e bashkimeve profesionale, stilin dhe metodën e tyre të punës.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE E NJËSIVE «MBI MASAT NDËSHKIMORE ME KARAKTER EDUKIMI NË PARTI»

21 dhjetor 1979

Partia vazhdimisht ka treguar vëmendje e kujdes të veçantë për edukimin ideopolitik, marksist-leninist të komunistëve, për të ruajtur pastërtinë e për të forcuar disiplinën dhe unitetin e radhëve të saj. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe masat ndëshkimore, me karakter edukimi, që janë dhënë e jepen ndaj komunistëve.

Organet dhe organizatat-bazë të Partisë kanë përdorur me kritere të drejta masat ndëshkimore, me karakter edukimi në Parti. Efektiviteti i tyre ka qenë i dobishëm për edukimin e komunistëve dhe për forcimin e pandërprerë të organizatave-bazë të Partisë. Megjithatë, për këtë çështje duhet të punohet më mirë në të ardhmen...

Nga Kongresi i 7-të i Partisë e këtej, numri i masave të dhëna ka ardhur duke u ulur, por, si në terren, ashtu dhe në ushtri, përsëri jepen shumë. Prandaj është e nevojshme që komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë ta shikojnë mirë dhe posaçërisht këtë çështje...

Konstatohet se në punën që bëhet për edukimin e komunistëve, nuk mbahen parasysh si duhet ato shfaqje, mungesa e dobësi të formimit ideopolitik e organizativ të tyre, të cilat dalin nga motivacionet e masave ndëshkimore, të lidhura ngushtë me gjendjen shoqërore, me stazhin në Parti etj. Nga organet dhe nga organizatat-bazë të Partisë nuk realizohet si duhet në këtë mënyrë puna edukative për të parandaluar masat. Motivacionet e masave nuk studiohen me tërë atë kujdes që kërkohet për të evidentuar problemet dhe detyrat për një punë më të madhe dhe, me nivel cilësor më të lartë, që duhet bërë me komunistët individualisht apo kolektivisht. Aparatet e komiteteve të Partisë nuk bëjnë përgjithësimet e nevoj-

shme në këtë drejtim. Në byrotë dhe në sekretariatet e komiteteve të Partisë, herë-herë, nuk ka thellim në këtë çështje. Por, po nuk u bë edukata e komunistëve një edukatë konkrete, faktike, që të mbajë parasysh shfaqjet e huaja, të cilat manifestohen te komunistët, duke shpjeguar mirë politikisht dhe ideologjikisht dëmin që gabimet i sjellin Partisë, atëherë, propaganda dhe edukimi nuk do të bëhen si duhet, dënimet do të vazhdojnë.

Në komitetet dhe në organizatat-bazë të Partisë, te çdo komunist e kuadër të rrënjohet thellë një kuptim sa më i mirë, i plotë dhe i qartë për masat ndëshkimore, për përmbajtjen, për karakterin, për qëllimin dhe për rolin e tyre edukativ. Duke luftuar kundër shfaqjeve liberale, ka shumë nevojë të luftohet më mirë edhe kundër shfaqjeve sektare në përdorimin e këtyre masave, se ndodh, jo rrallë, që ato të zënë vendin e punës së gjithanshme edukative, që duhet zhvilluar me komunistët. Në mjaft raste, masat ndëshkimore mbivlerësohen, përdoren pa kriter të drejtë, jepen edhe kur kuptohet sinqerisht gabimi dhe kur premtohet se nuk do përsëritet më, kur kritika e autokritika janë të mjaftueshme. Po përse jepen masat? A duhet dhënë dënim për çfarëdo gabimi, qoftë edhe i rëndë, kur ngrihet dhe bëhet autokritikë nga komunistët? Jo, nuk duhet kurdoherë.

Diskutimi i gabimeve të thellohet, të bëhet me imtësi, në bazë të normave të Partisë dhe jo shpejt e shpejt, sa për të kaluar radhën. Këtë e theksojmë se, jo rrallë, ndodh që më shumë kohë i kushtohet argumentimit të fajësisë së komunistit sesa zërthehen shkaqet, pasojat dhe masat që duhen marrë për parandalimin e gabimeve dhe të të metave.

Shpesh shkohet me mendimin se, po u dha masë shtetërore, duhet dhënë edhe masë partie. Kjo nuk ka munguar të shfaqet edhe në terren, megjithëse masa shtetërore ka qenë e mjaftueshme.

Këto qëndrime kanë ndikuar për një rritje artificiale të masave, për cenim të unitetit në organizatën-bazë, ku veprohet me papjekuri, ndonjëherë, edhe për të komprometuar karakterin edukativ të masave, duke u shprehur në ndonjë rast se «Nuk është gjë e madhe, me aq rëndësi, pse u dha një vërejtje».

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të përmirësojnë rrënjësisht punën dhe metodën e tyre lidhur me masat ndëshkimore. Nuk është mirë që, edhe me këtë gjendje që konstatohet, ka organe dhe organizata-bazë partie, të cilat, për vite të tëra, nuk janë kujtuar të ndalen posaçërisht në këtë çështje, të nxjerrin konkluzione e të bëjnë përgjithësimet e duhura. Sekretarët e komiteteve të Partisë, që merren me çështjet orga-

nizative, shpeshherë, nuk bëjnë punë aq të thelluar e përgjithësuese, por mjaftohen me shënimin për hedhjen ose jo të masave në kartën e regjistrimit. Në disa raste vepron spontaneiteti dhe nuk ka një ndjekje sistematike e me përgjegjësi për masat e dhëna. Qëndrime të tilla, do të thonë: të dënojmë, të dënojmë, pa bërë bilance dhe analiza. Po pse, kështu edukohen komunistët dhe kuadrot? Në qoftë se vazhdojmë kështu, Partinë do ta kemi me shokë plot dënime, pra, të paqartë, të pakënaqur, me burime gabimesh e indisiplinimesh, që fillojnë si pa të keq, mandej trashen dhe çojnë, më në fund, në çarjen e unitetit në organizatën-bazë të Partisë.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të punojnë më mirë se deri tani me komunistët, edhe pas ndëshkimit të tyre, sepse nuk ndiqet kudo mirë e nga afër veprimtaria e tyre, për t'i ndihmuar të reagojnë shpejt e sa më thellë. Kujdesi që tregohet në fillim, kur gjykohet dhënia e masës ndëshkimore, nuk ndihet si duhet gjatë kohës deri në shlyerjen e saj. Edhe kjo është një arsye që, në disa rrethe, ka pasur e ka me dhjetëra raste masash të vjetra të pashlyera, që komunistët nuk kërkojnë shlyerjen e tyre. Puna edukuese të bëhet më mirë edhe me ata komunistë, të cilët, për shkak të koncepteve e të mentaliteteve mikroborgjeze, të mendjemadhësisë apo të sedrës së sëmurë, nuk kërkojnë shlyerjen e masave. Organizatat-bazë të Partisë të luftojnë kundër çdo shfaqjeje të formalizmit, kur diskutohet shlyerja e masave, që ato të mos kalojnë me një aprovim të zakonshëm, pa diskutime apo si me fushata, se, në këtë mënyrë, zbehet roli edukativ i masave si për vetë komunistin, ashtu edhe për shokët e tjerë.

Duke u nisur nga konstatimet e mësipërme dhe nga rëndësia që kanë këto për forcimin e Partisë, edhe një herë, porositim që organet udhëheqëse të Partisë, në rrethe dhe në ushtri, t'i futen, më mirë se deri tani, këtij problemi, duke i dhënë kohën dhe vendin e duhur. Aparatet e Partisë, dhe jo vetëm sektori i Statutit, të merren seriozisht me këto çështje, sidomos sektori i edukimit, t'i ndjekin ato dhe të ngrenë probleme para komiteteve të Partisë, të përgjithësojnë përvojën pozitive dhe të ndihmojnë konkretisht atje ku ndihet nevoja.

Çështjet që ngrihen në këtë letër, para së gjithash, kanë rëndësi që të njihen e të kuptohen sa më mirë, nga të gjithë anëtarët e Partisë, nga ata që japin dënime, por edhe nga ata që i marrin ato. Për këtë arsye, çdo komitet dhe organizatë-bazë partie të analizojë posaçërisht, sipas gjendjes që ka, në radhë të parë, punën edukuese që bëhet e që duhet bërë për formimin e gjithanshëm ideopolitik, marksist-leninist të komunistëve, e cila është bazë për të parandaluar dhënien e masave

ndëshkimore dhe, pasi jepen, për të rritur efektivitetin edukativ të tyre. Të nxirren, gjithashtu, problemet dhe detyrat ideopolitike e organizative për përmirësimin e punës në këtë drejtim.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si-
pas origjinalit që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 7-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 14-15 janar 1980

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 14 e 15 janar 1980, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Stadi i zhvillimit socialist të vendit aktualisht dhe në perspektivë kërkon të përmirësohen më tej drejtimi e organizimi shkencor i punës së Partisë dhe i levave të saj», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Simon Stefani¹.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në fund, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, bëri konkluzionet e punimeve të Plenumit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

¹ Në Kongresin e 8-të të PPSH u zgjodh anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «STADI I ZHVILLIMIT SOCIALIST TË VENDIT AKTUALISHT DHE NË PERSPEKTIVË KËRKON TË PËRMIRËSOHEN MË TEJ DREJTIMI E ORGANIZIMI SHKENCOR I PUNËS SË PARTISË DHE I LEVAVE TË SAJ»

14 janar 1980

Shokë,

Në këtë Plenum të Komitetit Qendror do të analizojmë dhe do të shtrojmë detyrat që u dalin Partisë e levave të saj për ngritjen në një shkallë më të lartë të nivelit shkencor të drejtimit e të organizimit në fushën e ekonomisë, në mënyrë që ato t'i përgjigjen sa më mirë stadi të zhvillimit aktual dhe perspektiv të vendit.

Nga plani i gjashtë pesëvjeçar kaluan katër vjet dhe nuk ka mbetur veçse një vit për të mbyllur krejt pesëvjeçarin. Këta katër vjet pune e lufte të popullit tonë, nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver Hoxha në krye, kanë qenë vite fitoresh të reja, me rëndësi historike në të gjitha fushat. Ato kanë qenë, njëkohësisht, edhe vite të vështira, jo vetëm pse detyrat ishin të mëdha, por edhe sepse Partisë sonë iu desh të bënte një luftë këmbëngulëse kundër pasojave të rrezikshme të veprimtarisë armiqësore në ushtri, në frontin ideologjik dhe në ekonomi. Po kështu, Partisë sonë iu desh të luftojë edhe kundër një armiku tjetër të jashtëm, kundër revizionizmit kinez dhe të përballojë me sukses presionet, sabotimet dhe ndërprerjen e kredive e të ndihmës ekonomike e ushtarake.

Gjatë katër vjetëve të këtij pesëvjeçari, karakteristikë e përgjithshme është ngritja e gjithanshme dhe zhvillimi i pandalshëm në çdo degë dhe në çdo sektor të ekonomisë, të kulturës, të mbrojtjes e kudo. Prodhimi i përgjithshëm industrial, në

fund të vitit 1979, në krahasim me vitin 1975, ishte 28 për qind më i madh, ai bujqësor e blegtoral — 15 për qind, ndërtime — 32 për qind, qarkullimi i mallrave — 15 për qind, numri i nxënësve dhe i studentëve në shkolla — 3 për qind etj. Këto suksese të rëndësishme u arritën në kushtet kur vendi ynë është i rrethuar nga armiq të egër dhe kur bota kapitaliste e revizioniste është zhytur në një krizë të thellë politike, ekonomike, ushtarake, krizë që po thellohet akoma më tepër dhe po e trondit atë nga themelet.

Duke luftuar për të vënë në jetë detyrat e Kongresit të 7-të dhe vendimet e Plenumit të 6-të të KQ të Partisë, gjatë vitit 1979 u shënuan përmirësime në plotësimin e detyrave të planit pothuajse në të gjitha degët e sektorët e ekonomisë. Gjatë këtij viti puna dhe përpjekjet e punonjësve për realizimin e planit janë udhëhequr më mirë nga komitetet e Partisë të rretheve, nga organizatat-bazë të ndërmarrjeve ekonomike e të kooperativave bujqësore dhe nga levat e Partisë në përgjithësi. Organet shtetërore e ekonomike morën e zbatuan masa më efektive për forcimin dhe për përsosjen e drejtimit e të organizimit të punës e të drejtimit në qelizat dhe në hallkat e ndryshme të ekonomisë.

Treguesit kryesorë, që karakterizojnë zhvillimin e ekonomisë, siç janë: produkti i përgjithshëm shoqëror, të ardhurat kombëtare, prodhimi industrial, vëllimi i investimeve, qarkullimi i mallrave, rendimenti i punës, të ardhurat e buxhetit të shtetit, realizohen me një rritje prej 4-15 për qind ndaj vitit 1978. Prodhimi bujqësor shënoi një rritje prej rreth 12 për qind.

Detyrat e planit të vitit të kaluar realizohen e tejkalohen në nxjerrjen e gazit, të kromit, në prodhimin e bakrit blister, të makinerive e të pajisjeve, të tekstileve e të mallrave elektrike të përdorimit të gjerë, në prodhimin e panxharsheqerit dhe me diferenca të vogla në prodhimin e lulediellit e të duhanit, në grumbullimin e qumështit etj. Në shumicën e prodhimeve industriale e bujqësore ka një rritje të ndjeshme në krahasim me vitin 1978.

Këto arritje e kanë forcuar më tej qëndrueshmërinë e ekonomisë sonë. Rëndësi të veçantë ka fakti që përpjesëtimet kryesore, të domosdoshme për sigurimin e riprodhimit të zgjeruar socialist, në tërësi, kanë ecur më mirë. Produkti shoqëror dhe të ardhurat kombëtare rriten përkatësisht 4,6 dhe 6,9 herë me ritme më të larta sesa shtimi i popullsisë; shtesa e produktit shoqëror sigurohet në një pjesë të madhe nga rritja e rendimentit të punës; produkti për shoqërinë rritet më shpejt se produkti për vete dhe, në përgjithësi, të ardhurat kombëtare rriten më shpejt se produkti shoqëror. Të gjitha këto flasin për një përmirësim të dukshëm në efektivitetin e ekonomisë.

Megjithatë, disa mosrealizime të detyrave të planit, veçanërisht në industrinë e naftës, në ndërtim dhe në tregtinë e jashtme, vazhdojnë të mbeten probleme për ekonominë e vendit.

Nga analizat që kanë bërë Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria, si dhe nga ato që u bënë në konferencat e Partisë të rretheve, me rastin e zgjedhjeve në Parti, del se, me vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë, me bazën ekonomike dhe me atë materialo-teknike që është krijuar, me njerëzit që ka përgatitur e ka edukuar Partia, me përvojën e pasur të fituar, objektivisht, në i kemi mundësitë për t'i kryer më mirë detyrat, për të ecur përpara me ritme më të shpejta. Por, në të njëjtën kohë, nga këto analiza del, gjithashtu, se shkaqet e mosrealizimit të disa detyrave të planit të vitit 1979, si dhe të viteve të mëparshme, janë kryesisht të karakterit subjektiv, që kanë të bëjnë, në radhë të parë, me të meta e dobësi në fushën e drejtimit e të organizimit. Përvoja e këtyre katër vjetëve tregon se përmirësimi dhe ngritja e nivelit të drejtimit e të organizimit nga organet e nga organizatat e Partisë dhe nga levat e saj, përbëjnë ndër problemet më të rëndësishme e më të mpreshta, që duhet të vihen më mirë në qendër të vëmendjes e të punës sonë të përditshme.

Forcimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i punës drejtuese e organizuese të Partisë dhe të levave të saj kanë rëndësi të madhe në gjithë veprimtarinë shoqërore e shtetërore, por, në fushën e ekonomisë, ato marrin një rëndësi të veçantë, sepse ekonomia përbën frontin kryesor të ndërtimit socialist dhe sukseset apo dobësitë në këtë front reflektojnë në të gjitha veprimtaritë e tjera. Këtë e diktojnë edhe rrethanat e veçanta në të cilat ne punojmë e luftojmë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Shoqëria jonë socialiste, siç thotë shoku Enver, ndërtohet dhe zhvillohet në një oqean armiqësor, kapitalisto-revizionist, që përpiqet me të gjitha mënyrat të influencojë direkt ose indirekt për të penguar ecjen tonë përpara. Në këto kushte, pa një drejtim e organizim të shëndoshë, të zgjuar e të zhdërvjellët, nuk mund të përballohen me sukses rrethimi e bllokada, nuk mund të ecim përpara me ato ritme që i kemi vënë vetes për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit.

Në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e atdheut, ne vazhdimisht jemi mbështetur në forcat tona. Por, në situatat e tanishme, kuptimi dhe zbatimi i këtij parimi marrin një rëndësi të jashtëzakonshme. Ato kërkojnë që çdo punë, çdo detyrë, çdo realizim dhe e tërë puna drejtuese e organizuese të shikohet e të rishikohet nga këndi se si gjen e duhet të gjejë më mirë konkretizim e zbatim parimi i mbështetjes plotësisht në forcat tona.

Këtë e diktojnë në mënyrë imperative edhe objektivat e mëdhenj, që Partia parashikon për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës në planin e ardhshëm pesëvjeçar. Këtij zhvillimi duhet t'u përgjigjen më mirë edhe drejtimi i ekonomisë dhe organizimi i punëve në çdo sektor.

Ne duhet të nxjerrim mësim nga puna dhe nga përvoja pozitive që është fituar gjatë kësaj periudhe katërvjeçare, të njohim thellë ku janë vërtetuar të metat e dobësitë në punën udhëheqëse, organizuese e drejtuese të organeve e të organizatave të Partisë dhe të levave të saj, të organeve shtetërore, ekonomike dhe të organizatave të masave, me qëllim që të arrijmë në konkluzione sa më të drejta për një përmirësim të gjithanshëm e të mëtejshëm të punës sonë.

I

TË NGREMË MË LART NIVELIN E PUNËS DREJTUESE E ORGANIZUESE, SI HALLKË KYÇ PËR REALIZIMIN E DETYRAVE NË FUSHËN E EKONOMISË

Partia jonë u ka kushtuar kurdoherë një vëmendje të posaçme përsosjes së vazhdueshme të drejtimit e të organizimit të ekonomisë dhe gjithë veprimtarisë tjetër shoqërore e shtetërore.

Në themel të drejtimit të ekonomisë sonë socialiste dhe të të gjithë jetës së vendit, vazhdimisht kanë qëndruar ideologjia marksiste-leniniste, vija e Partisë dhe mësimet e shokut Enver Hoxha. Dhe praktika jonë revolucionare vërteton se udhëheqja e Partisë në ekonomi, që konkretizohet në politikën ekonomike, në vendimet, në direktivat e në orientimet e saj, në planin unik e të përgjithshëm shtetëror, është kusht i domosdoshëm për drejtimin dhe për organizimin e ekonomisë mbi baza socialiste, ndërsa drejtimi i ekonomisë, nga ana e shtetit tonë socialist, si levë e Partisë, është faktor kryesor për zhvillimin e vendit, për realizimin e të gjitha detyrave të planit. Njëkohësisht, derisa problemet e drejtimit të ekonomisë e të qeverisjes së vendit janë komplekse, me karakter politik, ideologjik, ekonomik, teknik dhe administrativ, ato, siç tregon përvoja jonë, nuk mund të zgjidhen me sukses pa pjesëmarrjen e masave të gjera punonjëse e të organizatave shoqërore.

Shoku Enver na mëson që drejtimin e ekonomisë sonë socialiste ta shohim kurdoherë si një drejtim shkencor, që mbështetet në njohjen e thellë e në zbatimin me konsekuencë të kërkesave të ligjeve objektive, në politikën ekonomike të Partisë, si dhe në kushtet konkrete e në rrethanat në të cilat

ndërtohet socializmi në vendin tonë, në punën studimore, kërkimore-shkencore dhe në përvojën e përparuar. Zbatimi me konsekuencë i vijës së Partisë dhe i politikës ekonomike të saj nuk mund të kuptohen e të realizohen pa forcuar, në të njëjtën kohë, edhe punën organizuese. Drejtimi dhe organizimi janë në unitet e të pandarë. Stalini thoshte se

«... pasi të jetë dhënë vija e drejtë politike, puna organizative vendos gjithçka, edhe fatin e vetë vijës politike, realizimin apo dështimin e saj»¹.

Sa më thellë të rrënjoset ky kuptim marksist-leninist, mbi rolin e madh të drejtimit shkencor e të punës organizuese, aq më mirë do të realizohen detyrat politike, ideologjike, ekonomike, kulturore e të mbrojtjes. Por drejtimi dhe organizimi ynë, duke iu përmbajtur me konsekuencë parimeve bazë, përsosjen vazhdimisht në metodat dhe në format, të cilat nuk janë statike e të dhëna njëherë e përgjithmonë. Për këto arsye shkencën dhe artin e të drejtuarit, që zhvillohen vazhdimisht, duhet t'i njohin e t'i përvetësojnë sa më mirë të gjithë, duke filluar nga anëtarët e Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë, nga kuadrot drejtues të Partisë e të pushtetit, deri te komunisti e punonjësi më i thjeshtë.

1. — Të përsosim vazhdimisht udhëheqjen e organeve e të organizatave-bazë për zbatimin e plotë të politikës ekonomike të Partisë

Një ndër çështjet themelore të drejtimit është kuptimi dhe zbatimi më drejt i rolit udhëheqës të organeve dhe të organizatave të Partisë, si në çdo fushë tjetër, edhe në ekonomi. Ky rol ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Organet dhe organizatat e Partisë kanë përmirësuar punën e tyre udhëheqëse ndaj organeve shtetërore dhe organizatave të masave, për zgjidhjen e problemeve ekonomike dhe për realizimin e detyrave të planit.

Por, në praktikë, ka ende mjaft raste kur përgjegjësia e organeve dhe e organizatave të Partisë dhe e levave të saj kuptohet ngushtë. Shpeshherë, mosrealizimet e planit të shtetit, në sektorë a tregues të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës, justifikohen ose se «ka munguar puna e Partisë, se organizatat-bazë të Partisë nuk kanë punuar mirë për edukimin e masave dhe për formimin e ndërgjegjes së tyre socialiste», duke nënkuptuar me këtë punë partie punën e aparateve dhe të sekre-

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 352.

tarëve të byrove e të organizatave të Partisë, ose se «ka pasur dobësi organizative apo mungesa materiale nga ana e organeve shtetërore dhe ekonomike». Në thelb, një arsyetim i tillë është i gabuar, sepse bën një ndarje si me thikë të punës së Partisë dhe të punës së pushtetit, për rrjedhim, kufizon rolin udhëheqës të Partisë dhe dobëson shkallën e përgjegjësisë së organeve të ndryshme.

Shoku Enver ka theksuar më se një herë se Partia udhëheq gjithçka, gjithë jetën e vendit, ekonominë e kulturën, politikën e jashtme, mbrojtjen etj. Dhe Partia nuk janë vetëm komitetet, sekretarët, aparatet, por janë gjithë komunistët. Këta, kudo ku punojnë, në çfarëdo funksioni që u ka ngarkuar Partia, si kadro në aparate të Partisë apo në organe të pushtetit, si sekretarë apo si kryetarë kooperative, drejtorë e inxhinierë në ndërmarrje, komandantë ose komisarë në ushtri, luftojnë që të vënë në jetë politikën e ideologjinë e Partisë, vijën e saj.

Rolin udhëheqës Partia e zbaton duke vënë në lëvizje levat e saj, të cilat kanë detyra specifike e nuk duhet të dublojnë njëra-tjetrën. Këto leva janë organet e pushtetit popullor, organet ekonomike dhe organizatat e masave.

Organet dhe organizatat e Partisë, në punën e tyre udhëheqëse, si në çdo sektor tjetër, edhe në fushën e drejtimit të ekonomisë, duke vënë në lëvizje levat, kanë fituar një përvojë të madhe. Komitetet e Partisë të rretheve Shkodër, Korçë, Tiranë, Berat, Fier, Skrapar, në përgjithësi, i udhëheqin më mirë problemet ekonomike dhe bëjnë një punë drejtuese, edukuese, organizuese e zbatuese më efektive në krahasim me disa rrethe të tjera. Plenumet dhe byrotë e komiteteve të Partisë të këtyre rretheve janë aktivizuar më shumë në drejtimin e në organizimin e punës për zbatimin e detyrave ekonomike dhe udhëheqin më mirë levat e Partisë, sidomos komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Këtu e kanë burimin edhe rezultatet më të kënaqshme, që kanë arritur këto rrethe në plotësimin e detyrave të planit.

Në jetën dhe në veprimtarinë e organizatave të Partisë të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore të përparuara të vendit ndihet më mirë përgjegjësia për realizimin e planit të shtetit, si ajo kolektive, e organizatës, ashtu dhe ajo individuale e çdo komunisti. Ndërmarrjet e kooperativat bujqësore të dalluara janë të tilla, sepse ato udhëhiqen nga organizata partie që dallohen për një metodë dhe stil revolucionar e luftarak, që u përgjigjen kërkesave të kohës e të perspektivës, se organet e tyre ekonomike dhe organizatat e masave punojnë mirë, se komunistët janë shembull, pararojë në disiplinë, në punë, në zbatimin e të gjitha detyrave që shtron Partia.

Por, siç thamë edhe më lart, në plotësimin e detyrave

ekonomike, gjatë këtyre katër vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, kemi edhe mosrealizime të ndjeshme. Lind pyetja: Përse kanë ndodhur këto deficite në plotësimin e planeve të shtetit? Pa mohuar aspak punën e madhe që bëhet dhe sukseset që janë arritur, duhet pohuar se ato kanë ndodhur, kryesisht, se në metodën e udhëheqjes së problemeve ekonomike, nga ana e organeve dhe e organizatave të Partisë, ka dhe të meta, mungesa e boshllëqe.

Të gjithë e pohojnë se, që të realizohen me sukses detyrat në fushën ekonomike, kërkohet nga organet dhe nga organizatat e Partisë një udhëheqje shkencore, e shkathët, operative e problemeve ekonomike, një njohje më e thellë e politikës ekonomike të Partisë, studim dhe zbatim në jetë i kërkesave të ligjeve ekonomike, tërheqje gjerësisht e masave në drejtimin e ekonomisë etj. Por a kuptohen si duhet dhe a zbatohen me vazhdimësi këto kërkesa në praktikën e punës së organeve e të organizatave të Partisë? Sigurisht, përmirësime, nga koha në kohë, janë bërë, por, krahas me këtë, në disa rrethe, si: në Dibër, në Lezhë, në Sarandë, në Krushë, në Vlorë, në Tepelenë e në ndonjë rreth tjetër, gjatë kësaj periudhe, janë vërtetuar boshllëqe në zbatimin e politikës ekonomike të Partisë. Nga analizat e herëpashershme që ka bërë Komiteti Qendror rezulton se komitetet e Partisë të këtyre rretheve, forumet e tyre, plenumi e byroja, si dhe sekretarët, në metodën e në stilin në punë kanë mungesa e dobësi.

Këto komitete partie vazhdojnë të drejtojnë me forma që nuk janë më në përshtatje me ndryshimet dhe me kërkesat e kohës. Në Komitetin e Partisë të Rrethit të Lezhës shpesh ka një punë rutinë, rendje pas çështjeve korentë të ditës, duke bërë një punë fluturimthi në bazë. Në rrethin e Sarandës bëhen mbledhje të shumta të forumeve për të njëjtin problem, që është i qartë në zberthim, por u mungon organizimi për zbatim. Në këtë rreth plenumi dhe aktivet e Partisë, gjatë vitit 1976-1978, janë mbledhur 44 herë, në shumicën e tyre për probleme të bujqësisë, e cila, megjithatë, nuk ecën mirë. Byroja dhe sekretariati i Komitetit të Partisë të Rrethit të Dibrës hartojnë programe të mira, por ato nuk gjejnë zbatim të plotë, sepse, veç të tjerave, mbështeten kryesisht në forcat e aparatit dhe të disa kuadrove, ndërsa lënë pa aktivizuar mirë plenumin dhe nuk orientojnë si duhet levat e Partisë.

Në punën e forumeve të Partisë, në disa rrethe, ka formalizëm, ka një ngarkesë të madhe me mbledhje, shqyrtohen materiale të shumta e të gjata, bëhen diskutime pa bereqet, një punë e lodhshme, por jo sa duhet e frytshme. Ndodh kështu se format e punës, në disa raste, vazhdojnë të jenë shabllone e statike. Tregohet një shqetësim i veçantë derisa

bëhet mbledhja, përgatiten raporti dhe diskutimet, kurse marrjes së vendimeve, ose caktimit të detyrave u kushtohen pak kohë e vëmendje. Përgatitjes së raporteve e diskutimeve, sigurisht, duhet t'u kushtohet kujdes, por, në fund të fundit, çdo mbledhje apo diskutim bëhet për të vënë në rrugën e zgjidhjes një problem, një kontradiktë, për të vendosur se ç'do të bëhet. Vendimi është një normë partie, në të përcaktohet uniteti i mendimit, por rëndësi të veçantë ka pastaj organizimi i punës për zbatimin e tij.

Është shqetësues fakti që në metodën e punës të disa organizatave të Partisë dhe të disa kuadrove shfaqet një praktikizëm i ngushtë. Ata nuk bëjnë studime të thelluara për probleme të rëndësishme ekonomike, zërthime të direktivave të Partisë në kushtet konkrete të rrethit e të sektorit ku veprojnë, përgjithësim të përvojës së fituar, me të mirat e të këqijat e saj. Mjaft kuadro përpiqen t'ua dalin mbanë punëve, duke u bazuar në praktikën që kanë fituar. Por ky praktikizëm, kjo metodë e stil pune rutinë, bëjnë të mbetesh në sipërfaqe të problemeve e të kapesht pas gjërave të vogla të ditës; këto frenojnë krijimtarinë e masave dhe përgjithësimin e mendimit krijues.

Disa kuadro drejtues, midis tyre edhe disa sekretarë të parë të rretheve, me përvojë të gjatë, por edhe të rinj, në metodën e në stilin në punë kanë shfaqje të subjektivizmit. Kjo sjell dëme të mëdha në punën kolegjiale të komiteteve të Partisë të rretheve, në zhvillimin e iniciativës e të rritjes së përgjegjësisë të kuadrove të tjerë, në moszbatimin e vijës së masave dhe të konsultimit me bazën e me masat. Për shkak të manisë për të ditur çdo gjë vetë, për të dhënë mendimin e tyre për çdo çështje, këta kërkojnë që sekretarët e komiteteve të Partisë t'u raportojnë, me kohë e pa kohë, se çfarë bëjnë e me se merren, duke krijuar psikozën se, pa pyetur sekretarin e parë, nuk bëhet gjë.

Të gjithë kuadrot drejtues të Partisë, kudo që punojnë, në qendër, në rreth e në bazë, të heqin dorë nga mania për t'u marrë me çdo gjë e pak nga të gjitha. Secili të organizojë punën, në mënyrë të tillë, që të ketë kohë edhe për të mbajtur lidhje me jetën, me komunistët e me masat, edhe të drejtojë punën dhe të orientojë e t'u hapë horizonte organeve, aparateve e vartësve, edhe të lexojë shtypin e të studiojë teorinë marksiste-leniniste. Pa këtë metodë e stil pune, asnjëri nuk mund të jetë në gjendje t'u përgjigjet dot detyrave të mëdha që shtrohen.

Në bazë kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, janë rritur kuadrot, janë ngritur ndërjegjija e masave punonjëse dhe niveli i përgjithshëm kulturor, prandaj kërkohet që asaj t'i sigurohet një ndihmë më konkrete, efektive dhe e kualifi-

kuar. Por disa komitete partie të rretheve ende nuk i kuptojnë si duhet këto ndryshime e përparime dhe nuk arrijnë të përshtatin metodën dhe stilin e punës së tyre, në raport edhe me këtë nivel të bazës. Mirëpo dihet se barra e zbatimit të direktivave e të vendimeve që jepen nga lart, e zërthimit dhe e konkretizimit të tyre, e dhënies së rezultateve të prekshme të këtyre direktivave dhe e vendimeve, i bie, sidomos, bazës. Ajo ndien shqetësime për zgjidhjen e tyre, prandaj udhëheqja e rrethit duhet të jetë sa më pranë saj, ta ndihmojë, ta inkurajojë, t'i hapë horizonte, të shqetësohet e të gëzohet bashkë me të.

Për t'i siguruar bazës një ndihmë sa më të kualifikuar, komitetet e Partisë të rretheve duhet të përmirësojnë më tej punën me direktivat dhe me vendimet e Partisë e të Qeverisë, sepse, shpeshherë, ato trajtohen cekët, ose punohen ashtu siç janë formuluar në qendër e bëhet një transmetim mekanik, copëzim dhe interpretim i ngushtë e sektorial i tyre. Organizatat e Partisë kanë nevojë që direktivat dhe vendimet, gjatë zërthimit, t'u argumentohen më mirë si praktikisht, ashtu edhe teorikisht, duke i lidhur ngushtë me kushtet konkrete të rrethit e të zonës, duke ua bërë sa më të kuptueshme përmbytjen, në tërë kompleksin e saj, si dhe masat që duhen marrë për zbatimin e vendimeve e të direktivave.

Edhe gjatë fushatës së zgjedhjeve në Parti, u vu përsëri në dukje se mjaft kuadro kryesorë të Partisë në rrethe, si: në Dibër, në Krujë, në Mat, në Gjirokastrë, në Durrës, rrallë shkojnë në bazë, sidomos në fshatra e në zona të thella, pak qëndrojnë atje dhe kur shkojnë nuk përgatiten seriozisht. Në këtë mënyrë, ata jo vetëm nuk ndihmojnë sa duhet, nuk zgjidhin në vend problemet që dalin, por nuk nxjerrin si duhet konkluzione të thella, bëjnë pak përgjithësime të studiuara dhe nuk sjellin në udhëheqjen e Partisë mendimin dhe përvojën pozitive të komunistëve e të masave.

Duke i dhënë bazës një ndihmë më të kualifikuar, duhet luftuar që të rritet më tej edhe përgjegjësia e saj për zbatimin e detyrave që i takojnë dhe jo të vendoset tutela mbi të. Vështirësitë që u dalin organizatave të Partisë dhe kuadrove në punë e sipër ajo duhet t'i zgjidhë dhe t'i përballojë vetë, me forcat e veta, prandaj t'i mësojmë njerëzit si të organizojnë punën, si të mobilizohen e të luftojnë me vështirësitë dhe të zhdukin ndjenjën e mungesës së përgjegjësisë. Nuk është aspak e drejtë që, duke pasur rregulla e udhëzime të qarta, nuk merret iniciativë për të rishikuar normat e punës kur tejkalohen në masë, apo pritet të vënë kuadro nga lart që të japin udhëzime mbi sigurimin e numrit të bimëve, ose si duhet bërë kullimi i tokave. Një barrë e madhe bie edhe mbi byrotë e

Partisë, të cilat, si hallka të rëndësishme në ndërtimin organizativ, të rritin ndihmën ndaj organizatave-bazë të Partisë dhe të forcojnë kontrollin ndaj drejtorive e kryesive të kooperativave bujqësore, për realizimin e detyrave të planeve ekonomike.

Ashtu sikurse komiteti i Partisë i rrethit është përgjegjës përpara Komitetit Qendror, edhe organizatat e Partisë, të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore, janë përgjegjëse përpara komitetit të Partisë të rrethit, si për çdo veprimtari tjetër, edhe për plotësimin e detyrave në fushën e ekonomisë. Ato përgjigjen që plani të hartohet kurdoherë në përputhje me orientimet e Partisë, që të organizohet puna e të merren masa për realizimin e tij në të gjithë treguesit tekniko-prodhues dhe ekonomiko-financiarë, për zbatimin me rreptësi të disiplinës proletare, që secili të kryejë e të mbajë përgjegjësi për detyrën që i është ngarkuar.

Që organizatat-bazë të jenë kurdoherë në krye e në udhëheqje të punëve, duhet të njohin mirë gjendjen e sektorit ku veprojnë e militojnë, të informohen rregullisht nga kuadrot drejtues të sektorit apo repartit për gjendjen, për problemet e për vështirësitë që dalin, të shqetësohen për çdo gjë që nuk shkon mirë, për çdo mosrealizim, për çdo shfaqje e fenomen negativ, që vërehet në procesin e realizimit të planit. Nuk ka gështje me të cilat ato nuk duhet të merren, rëndësi ka që të kuptohet sa më drejt se si të merren. Organizata e Partisë udhëheq drejtorinë apo kryesinë, por nuk i dublon, as nuk i zëvendëson ato, ajo udhëheq organizatat e masave dhe i mobilizon për kryerjen e detyrave. Për të realizuar këtë udhëheqje, në radhë të parë, ajo duhet të punojë që të vihen në rolin pararojë gjithë komunistët, që secili prej tyre t'i çojë te njerëzit në vendin e tij të punës e t'i kryejë me përpikëri detyrat dhe vendimet e organizatës, që, me shembullin e tyre, të udhëheqin e të mobilizojnë gjithë të tjerët, në mënyrë që edhe këta t'i kryejnë sa më mirë detyrat që u janë ngarkuar. Komunistët të jenë shembull jo vetëm në qendrën e tyre të punës, por edhe në stërvitjet ushtarake, në shoqëri, në familje e kudo.

Për të forcuar rolin e tyre udhëheqës, organet drejtuese të Partisë, në rrethe e në bazë, një vëmendje më të madhe t'i kushtojnë organizimit të punës për zbatimin e vendimeve e të direktivave. Ngaqë s'bëhet si duhet kjo, prandaj dhe mjaft punë çalojnë, por më dobët kjo gjë bëhet, sidomos, në bazë, në organizatën e Partisë. Shumë shokë kënaqen me mbledhjet që bëhen në shkallë rrethi apo dikasteri, pa menduar e pa punuar konkretisht se çfarë shkon e si duhet të shkojë aty ku direktiva do të gjejë zbatim, çfarë masash organizative, teknike,

ekonomike duhen marrë për të siguruar zbatimin, ç'forcë e ç'mjete duhen vënë në lëvizje, si do të organizohen kontrolli, informacioni etj.

Një ndër dobësitë më të mëdha, që vërehen sot në punën organizuese, është mungesa e kontrollit frontalisht të zbatimit të vendimeve. Partia e ka bërë të qartë dhe përvoja jonë shumëvjeçare ka vërtetuar se pa kontroll të zbatimit të vendimeve, të direktivave, të ligjeve, të urdhrave e të rregulloreve, s'ka drejtim, s'ka disiplinë dhe plotësim të detyrave, rrjedhimisht, s'ka zbatim të vijës së Partisë.

Komiteti Qendror dhe Qeveria kanë nxjerrë një sërë vendimesh për çështjet më të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë. Vendime marrin edhe organet e Partisë e të pushtetit në të gjitha nivelet, në rrethe e në bazë. Në luftë për zbatimin e vendimit të Komitetit Qendror për fuqinë blerëse dhe për çarkullimin monetar, për kulturën e panxharsheqerit, ose për likuidimin e pasojave të tërmetit, si dhe të disa vendimeve të tjera, janë arritur rezultate të kënaqshme. Por, në qoftë se nuk patëm po ato rezultate në zgjerimin e mekanizimit të punimeve në miniera e në ndërtim, në bimën e pambukut, në tufëzimin e bagëtive, në disa rrethe, këto shpjegohen, në radhë të parë, me mungesën e kontrollit të zbatimit të këtyre vendimeve dhe të kërkesës së llogarisë.

Natyrisht, nuk mund të themi se s'ka kontroll. Kontrolli ushtrohet, por jo sa duhet e në mënyrë sistematike, ai ka mjaft dobësi si të karakterit liberal, ashtu edhe burokratik, prandaj edhe nuk e kryen plotësisht funksionin e vet. Ushtrimi frontalisht i kontrollit të klasës punëtore nëpërmjet Partisë, të shtetit socialist dhe të drejtpërdrejtë, duhet të jenë më të fortë e të vazhdueshëm, të ndërthurur dhe të plotësojnë njëri-tjetrin. Mjafton të mungojë ose të jetë i dobët njëri prej tyre, edhe kontrolli i zbatimit të vendimeve e detyrave do të çalojë.

2. — Të ngremë më lart rolin e organeve shtetërore dhe ekonomike për një drejtim dhe organizim më shkencor të ekonomisë

Shteti ynë socialist, si leva kryesore e Partisë, drejtimin e ekonomisë e kryen mbi bazën e ligjeve ekonomike të shoqërisë socialiste dhe të politikës ekonomike të Partisë. Prandaj forcimi i drejtimit e i organizimit të ekonomisë, nga ana e tij, ka qenë dhe vazhdon të jetë një faktor shumë i rëndësishëm për plotësimin e detyrave ekonomike.

Drejtimi shtetëror i ekonomisë sonë popullore, si ekonomi e vetme socialiste, është një drejtim unik, që kryhet mbi bazën e parimit të centralizmit demokratik dhe të planit të përgjithshëm shtetëror. Partia dhe shteti ynë socialist e kanë bërë organizimin shtetëror-ekonomik sipas degëve e sektorëve, sipas llojit të prodhimit e sipas rretheve, kanë ndërtuar strukturën shtetërore-ekonomike mbi një bazë të atillë parimore, që të ruhet, të forcohet e të përsoset pareshtur drejtimi unik. Në qoftë se cenohet sadopak ky drejtim, kjo tregon se nuk kuptohen thellë e nuk zbatohen drejt direktivat e Partisë, ligjet, dekretet dhe udhëzimet shtetërore.

Por këtë drejtim unik të shtetit e dëmtojnë, veçanërisht, thyerjet e disiplinës shtetërore, moszbatimi me përpikëri i ligjeve, i urdhëresave e i rregullave të vendosura. Është e vërtetë se këtu kemi mjaft përmirësime. Por është po ashtu e vërtetë që disa organe drejtuese, të shtetit dhe të ekonomisë, vazhdojnë të mos e kuptojnë se ligjet dhe vendimet e Partisë e të shtetit janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë. Në mjaft raste, si pa të keq, shkelet disiplina e planit dhe ajo financiare, thyhet disiplina e punës dhe ajo teknike dhe njerëzit që i shkelin këto nuk vihen gjithnjë përpara përgjegjësisë e, kur paraqitet nevoja, edhe përpara ligjit.

Këto janë shfaqje të theksuara të liberalizmit e të burokratizmit, të cilat, siç ka theksuar vazhdimisht Partia, janë mjaft të rrezikshme për vetë ekzistencën e shtetit të diktaturës së proletariatit. Por është fakt që organizatat e Partisë në dikastere, në komitetet ekzekutive të rretheve dhe në bazë, me gjithë përmirësimet, ende nuk bëjnë një luftë të rreptë e frontale kundër këtyre shfaqjeve. Akoma nuk kuptohet si duhet se këto shfaqje nuk mund të zhduken vetëm me masa nga lart. Kryesore është që këtë luftë të ashpër klasore ta udhëheqin dhe ta zhvillojnë më mirë organizatat e Partisë në dikastere, në rrethe, në ndërmarrje e kooperativë, duke ngritur më këmbë klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse.

Drejtimin unik të shtetit e dëmtojnë, gjithashtu, konceptet dhe praktikat e gabuara të shikimit të gjërave nga prizmi i interesave të ngushtë dikasterialë, lokalë e sektorialë. Një frymë e tillë, jorevolucionare, nuk lejon një bashkërendim, një bashkëveprim e një kooperim të shëndoshë, faktorë këta të domosdoshëm për prodhimin, për plotësimin e planeve.

Megjithëse Plenumi i 6-të i KQ të Partisë i kritikoi edhe një herë këto mungesa e dobësi, përsëri, edhe sot, ka raste kur drejtoritë, brenda dikasterit, nuk veprojnë e nuk bashkëpunojnë si duhet me njëra-tjetrën, si aparat unik. Veçanërisht, pak lidhje kanë drejtoritë operative me ato funksionale. Kjo reflektohet edhe në mjaft organizata-bazë, ku është futur fry-

ma sektoriale dhe ku, shpeshherë, secili komunist diskuton sipas sektorit të vet dhe nuk kërkon sa duhet llogari për punën e sektorëve të tjerë, gjë që dobëson kritikën e autokritikën dhe çon në zbehjen e rolit udhëheqës të Partisë.

Disa herë është ngritur problemi i forcimit të lidhjeve dhe i bashkëpunimit të drejtorive të dikastereve me seksionet përkatëse të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, por akoma kjo detyrë nuk po gjen zbatim të plotë. Nga mjaft kuadro të dikastereve, kur shkohet në bazë, injorohen seksionet.

Një mungesë e tillë bashkërendimi e bashkëpunimi reflektohet edhe në seksionet e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, si dhe në punën e aparateve të ndërmarrjeve, të kooperativave dhe të institucioneve të tjera.

Vetëm duke zbatuar me konsekuencë parimin e drejtimin unik të shtetit, mbi bazën e centralizmit demokratik, duke vendosur disiplinë të rreptë proletare, kudo dhe për çdo gjë, një bashkërendim, bashkëpunim dhe kooperim të sinkronizuar, mund të kemi zbatim të planeve në të gjithë treguesit, mund të zgjidhim me kohë dhe drejt problemet e koklavitura ekonomike e teknike, që kërkojnë forma e mjete të bashkuara për zgjidhjen e tyre.

Këshilli i Ministrave duhet të realizojë më mirë, në shkallë kombëtare, drejtimin unik shtetëror, për të ndihmuar e për të kontrolluar më nga afër veprimtarinë e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, për përmirësimin dhe për përsosjen e metodës dhe të stilit në punën e tyre. Inspektimi i Shtetit dhe Arbitrazhi i Lartë, si organizma të rëndësishëm, të merren më mirë me problemet e drejtimin e të organizimit të ekonomisë, të forcojnë kontrollin e të ndiejnë më shumë përgjegjësi për zbatimin e disiplinës së planit.

Për të rritur më tej efektivitetin e punës drejtuese, Partia një kujdes të veçantë i ka kushtuar përcaktimit drejt të funksioneve dhe të kompetencave të organeve shtetërore dhe ekonomike në të gjitha hallkat e nivelet, sipas kërkesave që ka shtruar stadi i zhvillimit ekonomiko-shoqëror i vendit. Në këtë drejtim, janë marrë vazhdimisht masa të rëndësishme, të cilat kanë ngritur në një shkallë më të lartë të gjithë punën drejtuese e organizuese. Megjithëkëtë, në praktikën e punës së aparateve të disa dikastereve, të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të këshillave të fshatrave të bashkuara nuk punohet sa duhet për t'i zbrëthyer e për t'i zbatuar drejt këto kompetenca.

Funksionimi i aparateve shtetërore dhe ekonomike, mbi bazën e kompetencave të aprovuara, lidhet me caktimin sa më të studiuar të detyrave dhe të të drejtave të secilës drejtori

ose seksion, degë apo ndërmarrje. Ndonëse tashmë është krijuar shtrati i punës së hallkave drejtuese të secilës instancë, përsëri është e nevojshme të njihet më thellë përmbajtja e detyrave e të drejtave dhe e përgjegjësisë së tyre për zbatimin e plotë në të gjitha drejtimet.

Ka vend, gjithashtu, të shikohen më me kujdes përcaktimi dhe ushtrimi i kompetencave të komitetit ekzekutiv të rrethit dhe të seksioneve të tij për zbatimin e detyrave në fushën e ekonomisë. Pa dobësuar parimin e kolegjalitetit, duke e lehtësuar komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit nga disa kompetenca, do t'i krijohet atij mundësia për t'u thelluar më shumë në probleme thelbësore, që shqetësojnë ekonominë e rrethit përkatës.

Në të njëjtën kohë, duhet të shikojmë çfarë rregullimesh është e nevojshme t'u bëhen strukturave drejtuese të prodhimit e të pushtetit të administratës e të aparateve, jo vetëm për të zhdukur ndonjë anomali që vërehet, por, në mënyrë të veçantë, për t'i përsosur ato më tej, në përshtatje me kushtet e reja që krijohen, me përparimet që realizohen në zhvillimin e ekonomisë dhe të gjithë shoqërisë sonë socialiste. Në çështjet e organizimit e të strukturave organizative ne kemi bërë hapa përpara, por nuk duhet të harrojmë edhe faktin se kemi trashëguar disa forma artizanale, se kemi huajtur forma organizative e struktura edhe nga të tjerët. Tani kemi një përvojë të madhe tonën, të cilën duhet ta studiojmë me kujdes dhe ta përmirësojmë më tej.

Duke pasur parasysh këto probleme dhe detyrat e mëdha që u dalin për të zgjidhur dikastereve dhe komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, Komiteti Qendror, vazhdimisht, ka theksuar se në to duhet të rriten akoma më shumë roli udhëheqës i organizatave të Partisë, përgjegjësia e tyre për të realizuar të gjitha detyrat e planit, për të përsosur punën drejtuese e organizuese të organeve e të aparateve të tyre.

Ministria, si një nga organet qendrore të administratës shtetërore, ka kompetencat e veta, të caktuara me ligj, të cilat duhet t'i zbatojë më mirë e deri në fund. Por Partia është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit, pra, edhe e ministrisë. Nuk u lejohet aspak organizatave të Partisë që të mos shqetësohen e të mos alarmohen kur detyrat e planit në sektorët e tyre nuk realizohen, kur ka shkelje të rënda të disiplinës proletare, ose kur disa punonjës kryejnë punë formale e burokratike. Ato nuk duhet të qëndrojnë indiferente, por, menjëherë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa për të vënë në lëvizje organet dhe kuadrot përkatës të dikasterit. Në vend që t'u futen thellë problemeve të sektorit, ku ato udhëheqin, në disa raste e kanë më lehtë të thonë se kjo

çështje është në kompetencë të ministrisë, duke harruar se janë ato që drejtojnë e kontrollojnë punën e ministrisë, që udhëheqin politikisht dhe kontrollojnë edhe zbatimin e kompetencave të organeve shtetërore.

Komiteti Qendror, kohët e fundit, porositi dhe një herë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror, të cilët punojnë në dikasterë, që të kryejnë më mirë punën e tyre edhe si drejtues, edhe si komunistë e anëtarë të Komitetit Qendror në zbrëthimin e direktivave dhe të vendimeve të Partisë e të Qeverisë, që të kontrollojnë më shumë e të marrin përgjegjësi për rritjen e mëtejshme të nivelit të punës së organizatave të Partisë, për të siguruar e për të forcuar rolin udhëheqës të tyre në të gjitha drejtimet.

Ai tërhoqi vëmendjen, gjithashtu, që organet qendrore t'u japin një ndihmë më të madhe organeve të tyre vartëse për zgjidhjen e problemeve. Kur rrethet ngrenë probleme, duhet t'u jepet rrugëzgjdhje në vend, ndërsa ato çështje që kanë nevojë të studiohen me kujdes, duhet t'u parashtrohen drejtuesve të dikasterit ose më lart, por jo të mbahen nëpër blloqe e sirtare.

Nga ky kënd duhet ta shohin punën e tyre edhe organizatat e Partisë dhe kuadrot kryesorë, që punojnë në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore, sepse, në punën e organeve dhe të aparateve të tyre, ka akoma mjaft boshllëqe, ka zvarritje e sorollatje.

3. — Të rriten më tej roli dhe përgjegjësia e organizatave të masave për mobilizimin e punonjësve, në luftë për zbatimin e detyrave në fushën ekonomike

Organizatave të masave, si leva të fuqishme të Partisë, bëjnë një punë të madhe për edukimin komunist të punonjësve dhe për mobilizimin e tyre në ndërtimin socialist të vendit. Pas kritikave të bëra nga Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të Partisë, veprimtaria e organizatave shoqërore është gjallëruar më shumë, roli dhe përgjegjësia e tyre ndihen më mirë si në fushën e ekonomisë, ashtu edhe në sektorët e tjerë të jetës së vendit. Megjithatë, stili dhe metoda e punës së tyre nuk u përgjigjen si duhet situatave që kalojmë e detyrave të mëdha që rrjedhin prej tyre, nivelit e ndërgjegjes në rritje të masave dhe gatishmërisë së tyre të lartë për të plotësuar detyrat e planit të shtetit.

Në themel të gjithë veprimtarisë së organizatave të masave qëndrojnë vija e Partisë, direktivat e orientimet e saj. Në çdo direktivë të Partisë, secila nga organizatat e masave gjëra detyrat e veta, sepse s'ka problem që të preokupojë Partinë për të cilin të mos jenë të interesuara masat dhe s'ka problem që mund të zgjidhet pa pjesëmarrjen aktive të masave. Specifikat e veçanta që ka secila organizatë duhen mbajtur parasysh, por ato nuk mund të ngushtojnë e të copëzojnë punën për kuptimin dhe për zbatimin e direktivave të Partisë, të çojnë në qëndrime e në veprime të njëanshme. Organet qendrore të organizatave të masave kanë për detyrë të thellohen më mirë në direktivat e Partisë. Ato nuk duhet të bëjnë një punë të përciptë e të nxitohen për t'iu përgjigjur gjoja flakë për flakë direktivave. Zbërthimin t'ua përshtatin jo vetëm forumeve, por, në radhë të parë, bazës, ku dhe materializohet çdo direktivë, çdo orientim ose çdo detyrë, duke u mbështetur më mirë në aktivin e gjerë. Nga ato kërkohet të bëjnë më shumë studime e përgjithësime për t'u hapur horizont organizatave të tyre për problemet që shqetësojnë dhe të organizojnë konkretisht punën për zgjidhjen e tyre.

Detyra kryesore e organizatave të masave mbetet edukimi i punonjësve me ideologjinë proletare e me ndërgjegjen socialiste, por kjo nuk duhet reduktuar thjesht në një punë formash dhe aktiviteteve të mirëfillta edukative, siç ndodh në mjaft raste. Edukimi realizohet, në radhë të parë, në punë e në luftë për ndërtimin e socializmit. Veçanërisht, ka rëndësi që të kuptohet drejt e të realizohet më mirë në praktikë lidhja e punës politike edukative me problemet e prodhimit që puna politiko-edukative t'u shërbejë rritjes së ndërgjegjes të punonjësve e mobilizimit të tyre dhe të matet me rezultatet që arrihen në plotësimin e detyrave të planit ekonomik të shtetit.

Përmirësimi i punës në organizatat e masave kërkon që të rritet më shumë forca e tyre organizuese dhe realizuese. Kryesore janë veprimi, aksioni për zgjidhjen e problemeve e për plotësimin e detyrave të planit dhe jo konstatimet, mbledhjet e ballafaqimet. Ato, veçanërisht bashkimet profesionale, duhet të luftojnë kundër çdo pengese burokratike e shfaqjeje liberale dhe të mos ndikohen nga presioni i aparateve dhe i punonjësve të prapambetur. Ato duhet të luftojnë me forcë kundër shfaqjeve të globalizmit, të hallakatjes në shumë gjëra, të cektësisë e formalizmit, të zhvillojnë një punë politike më konkrete, me objektiva të qartë, të ndalen mirë në propagandimin e shembullit pozitiv, të përvojës së përparuar, të organizojnë dhe të hyjnë më mirë në brendinë e emulacionit socialist. Në mënyrë të veçantë, të merren me punë-

torët e prapambetur, që nuk realizojnë normat, me ata që thyejnë disiplinën, që dëmtojnë e shpërdorojnë pronën socialiste etj.

Më mirë duhet të ndihen edhe roli e përgjegjësia e organizatës së rinisë në zhvillimin e në forcimin e ekonomisë, në plotësimin e detyrave të planit të shtetit. Ajo të nxitë e të inkurajojë iniciativën krijuese dhe aksionin revolucionar të rinisë, të zhvillojë shpirtin novator e sulmues të saj. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet edukimit të rinisë me dashurinë për çdo lloj pune, për të shkuar atje ku ka nevojë atdheu, me frymën e qëndrimit të papajtuëshëm ndaj shfaqjeve e ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste. Organizata e rinisë duhet të shqetësohet më shumë për ata të rinj e të reja që nuk janë të zënë në punë, se kërkojnë punë të preferuar, që braktisin shkollën, që mbajnë një qëndrim josocialist ndaj punës e pronës, që nuk kanë sjellje të kulturuar në shoqëri e në familje.

Në kuadrin e kërkesave dhe të detyrave që shtrohen, duhet të shihet edhe përmirësimi i mëtejshëm i punës në organizatën e BGSH e të Frontit Demokratik, për të rritur rolin e tyre si leva të Partisë në edukimin politik e ideologjik të grave dhe të gjithë popullit, në mobilizimin e tyre për të realizuar detyrat e ndërtimit socialist të vendit.

Organizatave të masave të forcojnë më shumë bashkëpunimin dhe bashkërendimin midis tyre. Bashkëpunimi midis organizatave të masave nuk është çështje fakultative e dëshirash, por domosdoshmëri, që buron nga vetë kërkesat e direktivave të Partisë, nga karakteri që kanë organizatat e masave, si leva të Partisë, nga roli që luajnë ato për krijimin e opinionit shoqëror. Ky bashkëpunim nuk mjafton të realizohet vetëm midis drejtuesve apo forumeve, por, në radhë të parë, në qendrat e punës e në kooperativa bujqësore, në shkolla e në lagje, ku punojnë e jetojnë masat punonjëse dhe jo vetëm për problemet me karakter ideologjik, por edhe në frontin ekonomik.

Çështja e bashkëpunimit duhet parë më gjerë, jo vetëm midis organizatave të masave, por edhe midis tyre dhe organeve të pushtetit e të ekonomisë, sepse, në praktikë, ky bashkëpunim akoma çalon. Ndodh që dikasteret dhe organet e pushtetit e të ekonomisë në rrethe të mos e kërkojnë sa duhet ndihmën e organizatave të masave, nuk shtrojnë para tyre probleme të planit e të prodhimit, të drejtimit e të organizimit të ekonomisë, sepse ato i mundon besimi i tepruar në masat tekniko-organizative, duke nënvleftësuar, kështu, rolin e madh që kanë organizatat shoqërore në mobilizimin e punonjësve. Edhe organizatat e masave, nga ana e tyre, duke

mos ndier si duhet përgjegjësinë që kanë, nuk interesohen për t'u konsultuar e për të bashkëpunuar me drejtuesit e dikasterëve dhe me organet e pushtetit e të ekonomisë në rrethe. Vetëm duke luftuar këto dobësi forcohet bashkëpunimi dhe realizohet fronti unik, me në ballë komunistët, për edukimin e punonjësve dhe për realizimin e detyrave të planit.

Përmirësimi i punës në organizatat e masave varet shumë edhe nga kujdesi që tregojnë organet e organizatat e Partisë, nga roli që luajnë komunistët, që militojnë në këto organizata. Sot shtrohet çështja e një udhëheqjeje e drejtimi më të kualifikuar të këtyre organizatave nga Partia, e një ndihme e kontrolli më të madh mbi veprimtarinë e tyre, me qëllim që të rritet më tej pjesëmarrja e masave në problemet e drejtimit dhe të organizimit të ekonomisë. Për këtë, është e nevojshme të luftohen konceptet e ngushta e shpeshherë të thjeshtëzuara, që «me këto organizata merret një sektor në komitetin e Partisë, një komunist i ngarkuar në organizatën-bazë, që ato kanë forumet drejtuese, të cilat përgjigjen për punën e tyre» etj. Duhet kritikuar, sidomos, ato koncepte e veprime kur, për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, organizatat e Partisë mbështeten, kryesisht, në organet shtetërore dhe ekonomike dhe lënë pasdore organizatat shoqërore. Këto praktika janë të gabuara e të dëmshme, ato shprehin njëfarë mosbesimi ndaj forcës dhe rolit të masave dhe të organizatave të tyre, ndaj punës ideopolitike e mobilizuese të Partisë dhe çojnë në ngushtimin e sferës së punës të Partisë e në dobësimin e lidhjeve të saj me masat.

Në organizatat e masave dhe në forumet e tyre militojnë mijëra e mijëra komunistë, por ka jo pak prej tyre që nuk e ndiejnë si duhet përgjegjësinë dhe që u shmangen detyrave shoqërore. Sikur vetëm komunistët, që janë të zgjedhur në organet drejtuese të organizatave të masave, të aktivizoheshin më mirë, puna e këtyre organizatave do të ngrihej shpejt në një nivel më të lartë. Nga ana e tyre, vetë organizatat e masave kanë për detyrë që të sigurojnë, gjithnjë e më mirë, udhëheqjen e Partisë, të ngrenë para organizatave e forumeve të saj probleme që dalin nga puna e nga lufta e punonjësve për realizimin e direktivave të Partisë.

Detyrat e mëdha, që na shtrohen, kërkojnë që organet e organizatat e Partisë të analizojnë me sy kritik punën udhëheqëse të tyre, si dhe gjithë veprimtarinë e organizatave të masave, që ato t'u përgjigjen më mirë vrullit dhe entuziazmit të punonjësve, veçanërisht në realizimin e planit ekonomik.

4. — Të rritim më tej ndjenjën e përgjegjësisë dhe efektivitetin e punës së kuadrove

Vendi ynë ka tani një armatë të tërë kuadrosh, të të gjitha niveleve dhe specialiteteve, me zotësi e me ndërgjegje të lartë, bij besnikë të Partisë e të popullit. Ata kanë luajtur rolin e tyre të rëndësishëm në të gjithë punën e luftën që janë bërë dhe bëhen për ndërtimin socialist të vendit. Por Partia kërkon që çdo kuadër e çdo specialist të japë maksimumin e mundësive që ka, që çdo njeri t'i shkrijë tërësisht forcat mendore, në dobi të fuqizimit dhe të mbrojtjes së atdheut tonë socialist.

Për përdorimin me një efektivitet sa më të lartë të dijeve dhe të aftësive të kuadrove e të specialistëve, është e domosdoshme që këta të aktivizohen e të dëgjohen më mirë. Specialistët e të gjitha profileve e niveleve mund e duhet të ndihmojnë më shumë me mendimet e me dijet e tyre klasën punëtore e kooperativistët, të cilët kanë investuar për t'i përgatitur ata; të ndihmojnë organet dhe organizatat e Partisë e të pushtetit me mendimin më të përparuar shkencor, me variante të ndryshme zgjidhjeje, nga më të leverdishmet të problemeve. Kuadrot tanë kanë kulturë, kanë mendime, por këto mendime duhen tërhequr, duhen dëgjuar e inkurajuar. Ata duhet të merren gjithnjë e më mirë me teknikën e me teknologjinë, me ekonominë e me financën, por, në radhë të parë, të punojnë me masat, si njerëz politikë, si edukatorë të masave.

Por jo gjithnjë mendimet dhe propozimet e vlefshme të specialistëve gjejnë zbatim të plotë, jo kurdoherë ata vihen përpara detyrash konkrete për t'i zgjidhur. Ka raste kur edhe dikasteret qendrore, për të mos krijuar telashe, si pa të keq, thonë se «këtë s'e kemi në plan», se «atë s'kemi mundësi ta bëjmë», sikur këto propozime nuk kanë të bëjnë me planin dhe me realizimin e tij.

Është e domosdoshme që, kudo, organizatat e Partisë të bëjnë një luftë të vendosur kundër këtyre koncepteve e qëndrimeve frenuese dhe të nxitin mendimin krijues dhe iniciativën e të gjithë specialistëve e të kuadrove, për të projektuar e për të zbatuar, për të revolucionarizuar më tej prodhimin dhe punën.

Partia, me punën e saj, t'i bëjë gjithnjë e më të ndërgjegjshëm kuadrot e specialistët e ndryshëm që të rritin vazhdimisht dijet e tyre. Me gjithë punën që bëhet për të zbatuar detyrat që shtroi Plenumi i 3-të¹ i Komitetit Qendror

¹ Shih në këtë vëllim f. 269.

për këtë çështje, përsëri, organet dhe organizatat-bazë të Partisë ende nuk kanë mundur ta krijojnë një ndjenjë të tillë të gjithë specialistët e kuadrot, si në ata që kanë funksione më të larta, ashtu edhe tek ata më të thjeshtët. Edhe format e organizuara të kualifikimit pasuniversitar, të kualifikimit të lartë pedagogjiko-shkencor e të atestimit kulturor e profesional nuk funksionojnë kudo në rregull, ka kërkesa të ulëta dhe disiplinë të dobët. Organizatat e Partisë duhet ta udhëheqin më mirë këtë punë dhe të vënë para përgjegjësisë si organizatorët e dobët, ashtu edhe dembelët.

Përdorimin e kuadrove, rritjen e nivelit të tyre, përgatitjen e specialistëve të rinj, të mesëm e të lartë t'i shikojmë të lidhur ngushtë me nevojat që kemi dhe me perspektivën e zhvillimit të degëve të reja të ekonomisë, të kulturës, të shkencës e të mbrojtjes.

Rëndësi e veçantë të tregohet për disa kategori kuadros që konsiderohen me përgjegjësi «të ulëta», siç janë: kuadrot e njësive më të vogla të prodhimit — brigadierët, përgjegjësit e sektorëve të fabrikave, të turneve, përgjegjësit e hozrashoteve, kontrollorët, komandantët e togave e të kompanive, bile dhe magazinierët e normistët, mjeshtrit e prodhimit etj. Në këto njësi të vogla organizohet puna dhe vihet në jetë direktiva. Këtu dalin organizatorët e zotë të prodhimit dhe rriten kuadro për përgjegjësi më të larta.

Efektiviteti i punës së kuadrove rritet sa më shumë të rritet ndjenja e përgjegjësisë së tyre. Kjo nuk realizohet as vetëm me të thënë, as me premtime boshe, por me një punë të vazhdueshme e konkrete politike, ideologjike dhe organizative. Organizatat e Partisë në dikasteret qendrore dhe në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të luftojnë për të vënë në punë e në lëvizje të gjithë kuadrot, por, sidomos, ata të rangut të mesëm e të ulët, që secili prej tyre të kryejë plotësisht detyrën që i është ngarkuar dhe jo t'i shmanget përgjegjësisë e t'ia lërë barrën drejtuesit. Nga ana e tyre, kuadrot me funksione më të larta t'i ndihmojnë, t'i kontrollojnë e t'u kërkojnë më shumë llogari vartësve, të mos i lejojnë të merren me gjëra të vogla e të bëjnë punë rutinë. Të gjithë kuadrot, pavarësisht nga funksioni, në bazë të vijës dhe të vendimeve të Partisë, të ligjeve të shtetit, të detyrave që u janë caktuar, kanë kompetenca të gjera për të vepruar e për të zgjidhur problemet e jo thjesht të regjistruar e të konstatojnë faktet.

Çdo funksion që u ngarkohet kuadrove, duhet kuptuar nga ana e tyre se ai nuk është privilegj, por detyrë me përgjegjësi, që kërkon më shumë mund e sakrificë. Funksionet që ka se-

cili, ua ka dhënë Partia në bazë të aftësive dhe të cilësive të tyre, si dhe të nevojave që ka. Ata që i konceptojnë ndryshe funksionet që mbajnë, në vend që të jenë të dobishëm, bëhen të dëmshëm. Prandaj çdo kuadër, qoftë ky ministër, drejtor, kryetar, sekretar, komandant apo referent i thjeshtë duhet të përgjigjet plotësisht për detyrat që kryen dhe si i kryen, në radhë të parë, në organizatën-bazë dhe në kolektivin e qendrës së punës ku punon.

Vetë politika e drejtë e avancimit të kuadrove është, njëkohësisht, edhe një edukim konkret i tyre. Me gjithë punën e mirë që është bërë e bëhet në avancimin e kuadrove, është fakt se, ndërmjet tyre, ka edhe të pazotë e të mefshtë, servilë e dembelë, që nganjëherë vazhdojnë ca gjatë të mbajnë funksionet që u janë besuar, megjithëse nuk kanë rezultate në punë. Këto të meta duhet t'i ndreqim e të mos i lëmë të trashen. Të pa aftëve t'u tregohet vendi, se ndryshe dëmtohet seriozisht puna. Të zgjidhen e të avancohen ata kuadro, që me punë e me sakrificë kanë bërë përpjekje të mëdha për të kryer detyrat, që kanë treguar zotësi në punë, zgjuarsia e guxim, që kanë dhënë shembull në zgjerimin e dijeve, në organizim e në disiplinë. Besimi politik dhe aftësitë e cilësitë e kuadrit duhet të gjejnë shprehjen e tyre konkrete në punë dhe në luftën për realizimin e detyrave.

Janë krijuar mundësi reale që të ecet më me guxim në avancimin e kuadrove të rinj, të cilët, duke bashkëpunuar ngushtë me kuadrot me përvojë, bëhen një rezervë e pashtershme dhe sigurojnë atë vazhdimësi të domosdoshme kuadros në të gjithë sektorët e nivelet. Por, duke luftuar shfaqjet e konservatorizmit e të teknokratizmit, nuk na lejohet as të bëjmë veprime të pamatura në ngritjen e kuadrove. Në kushtet e tanishme, me këto avantazhe që ka krijuar sistemi ynë shoqëror, janë të gjitha mundësitë të ngrihen punëtorë e bij punëtorësh, gra e të reja në funksionet nga më të ulëtat, deri tek ato më të lartat, sigurisht, njerëz të aftë e që me punë i kanë treguar cilësitë dhe aftësitë e tyre. Trajtimi si një qëllim në vetvete i problemeve të përbërjes shoqërore të kuadrove, ose lëvizjet e shpeshta e të pathëlluara të tyre nuk janë në vijën e Partisë, përkundrazi, e dëmtojnë atë, ashtu sikurse nuk është në vijën e Partisë edhe dobësimi i punës për edukimin e vazhdueshëm politik, ideologjik, kulturor e profesional të kuadrove të rinj të ngritur nga klasa punëtoare dhe nga masat e tjera punonjëse.

Kur ngrihen kuadro të rinj në vende me përgjegjësi, të zgjedhur apo të emëruar, vetëm akti i emërimit apo i zgjedhjes dhe dorëzimi formal i punës e dhënia e disa porosive të për-

gjithshme, nuk e bën atë as ministër, as sekretar apo kryetar, as komandant e drejtor. Ata vetë duhet të shumëfishojnë përpjekjet që të bëhen të tillë. Por, nga ana tjetër, kuadrot e rinj, siç porositi Partia, duhen ndihmuar në forma e me mjete të ndryshme, gjë që nuk bëhet gjithnjë mirë.

Kuadrot kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme e të kualifikuar, sidomos, të njohin shkencën e drejtimit e të organizimit, të njohin thellë legjislacionin socialist, parimet themelore dhe metodologjinë e planifikimit, rregullat e administrimit të ekonomisë dhe ato financiare, si dhe metodat e përparuara të punës drejtuese. Kjo shtrun nevojën që përmbajtja dhe format organizative të kualifikimit të kuadrove të rinj t'u përgjigjen më mirë këtyre kërkesave.

II

ORGANET DHE ORGANIZATAT E PARTISË TË UDHËHEQIN MË MIRË ZGJIDHJEN E DISA PROBLEMEVE TË RËNDËSISHME TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË

Partia dhe shoku Enver gjithnjë kanë vënë në dukje se ekonomia përbën bazën e zhvillimit të jetës sonë, të ngritjes së mirëqenies dhe të forcimit të pavarësisë e të aftësisë mbrojtëse të atdhëut. Karakteristikat kryesore dalluese të saj: stabiliteti dhe zhvillimi me ritme të shpejta, pa kriza, pa inflacion e pa papunësi, dëshmojnë për faktin se ajo drejtohet në mënyrë shkencore e në përputhje me ligjet objektive të socializmit nga ana e Partisë dhe e shtetit tonë socialist. Organet dhe organizatat-bazë bëjnë përpjekje që t'i njohin e t'i zbatojnë gjithnjë e më mirë kërkesat e këtyre ligjeve e të politikës ekonomike të Partisë.

Por, me gjithë përmirësimet e bëra, fakti që në praktikë ne ndeshemi, jo rrallë, me shfaqje të drejtimit në përgjithësi, të njëanshmërisë e të globalizmit, të voluntarizmit e të subjektivizmit tregon se akoma nuk njihen e nuk zbatohen si duhet këto ligje, orientimet dhe politika ekonomike e Partisë. Këtu e kanë burimin, ndërmjet të tjerave, edhe ato fenomene negative e kontradikta që janë vërejtur në plotësimin e detyrave të planit nga disa rrethe ose sektorë.

Për zgjidhjen e tyre është e nevojshme që organet e organizatat e Partisë dhe levat e saj, të kapen më fort pas disa problemeve kyç, të cilat ndikojnë në zgjidhjen e problemeve të tjera ekonomike dhe në realizimin e planit në tërësi.

1. — Të njihen më thellë dhe të zbatohen më mirë disa nga problemet më të rëndësishme në drejtimin me plan të ekonomisë

Komiteti Qendror vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen që organet dhe organizatat e Partisë t'u futen më thellë problemeve të planifikimit. Në këtë fushë, me gjithë përmirësimet që janë bërë, vazhdojmë akoma të kemi të meta e dobësi. Në praktikë rezulton se, në mjaft raste, nuk ekziston një unitet dhe lidhje organike midis gjithë pjesëve përbërëse të planit.

Shpeshherë, në hartimin e planeve, mbahen rezerva, sikurse ndodh me planifikimin e aftësive prodhuese në industrinë mekanike e në atë ushqimore të disa treguesve financiarë; nuk mbahet mirë parasysh në planifikim mesatarja e përparuar, veçanërisht për shfrytëzimin e makinerisë, për rritjen e rendimenteve të kulturave në bujqësi e për përdorimin e lëndëve të para; furnizimi materialo-teknik, në disa drejtime, bëhet me normativa të larta harxhimi, ose vihen detyra plani që nuk mbështeten plotësisht me bazë materiale, siç ndodh, disa herë, me mbulimin e fuqisë blerëse me mallra e me shërbime, me investimet dhe me shërbimet komunale në kooperativat bujqësore. Fakt është se, kur ra tërmeti i 15 prillit të vitit të kaluar, patriotizmi i lartë socialist, solidariteti, organizimi, mobilizimi dhe fryma revolucionare e masave punonjëse zbuluan shumë rezerva materiale e njerëzore e zgjidhën mjaft detyra; kjo përvojë duhet të shërbejë edhe për një planifikim më të shtrënguar, mobilizues e revolucionar. Fakt është, gjithashtu, se mjaft kuadro të Partisë, drejtues në dikastere, në rrethe e në bazë flasin shumë për rrethimin e për bllokadën dhe për vështirësitë që rrjedhin prej tyre, por, kur vjen puna në praktikë, ata nuk e kuptojnë dhe nuk e ndiejnë thellë këtë. Ndryshe s'ka si shpjegohen ato kërkesa të fryra, që bëhen në kohën e hartimit të planeve për investime, për fuqi punëtore, për lëndë të para e për materiale etj. Të gjitha këto tregojnë se në disa ndërmarrje, në kooperativa e në rrethe, planet nuk janë kurdoherë mobilizuese, reale dhe të argumentuara shkencërisht.

Gjithashtu, vërehet se në planet tona, si në ato vjetore, ashtu dhe në ato me afat të gjatë, shpeshherë, krahas zhvillimit të forcave prodhuese, nuk gjen pasqyrim të plotë edhe përsosja e anëve të veçanta të marrëdhënieve në prodhim. Në këtë drejtim, të meta e dobësi shfaqen, sidomos në ndërmarrje, në kooperativa e në rrethe, kur është çështja e vendosjes së përpjesëtimeve të drejta ndërmjet shtimit të prodhimit dhe shpërndarjes, ndërmjet fondit të akumulimit dhe fondit të konsumit në kooperativat bujqësore etj. Po kështu, forca nxitëse

dhe shtytëse e planifikimit shkencor në rritjen e efektivitetit të shpenzimeve të produktit shoqëror, i cili, aktualisht, përbën një problem kyç e nevralgjik të ekonomisë, duhet të jetë më e madhe.

Këto ndodhin, sepse organet dhe organizatat e Partisë nuk i kanë sa duhet në dorë problemet e planifikimit dhe bëjnë një punë formale. Ato nuk i zbërthejnë si duhet, në përshtatje me kushtet dhe me detyrat që u shtrohen rrethit, ndërmarrjes e kooperativës, direktivat e Kongresit, orientimet e Komitetit Qendror e udhëzimet e Qeverisë dhe nuk organizojnë mirë punën politike e ideologjike për t'u sqaruar punonjësve përmbytjen dhe qëllimin e tyre, për të tërhequr gjerësisht mendimin e përparuar në zbulimin e rezervave e të mundësive që ekzistojnë dhe të rrugëve për shfrytëzimin e tyre. Nuk mjafton që komitetet e Partisë dhe organizatat-bazë të marrin në shqyrtim e të aprovojnë formalisht shifrat e planeve vjetore apo pesëvjeçare, që u paraqiten nga organet shtetërore e të ekonomisë. Ato duhet t'u futen më thellë problemeve të planifikimit, problemeve ekonomike e financiare dhe të shikojnë me kujdes se si kanë gjetur pasqyrim në plan vija dhe politika e Partisë, orientimet konkrete, që ato u kanë dhënë organeve përkatëse për zhvillimin e rrethit, të ndërmarrjes apo të kooperativës.

Komiteti Qendror, herë pas here, ka dhënë porosi të qarta për të ngritur në një nivel më të lartë planifikimin shkencor të ekonomisë dhe të kulturës. Dhe përmirësime në këtë fushë ka. Por Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Financave dhe dikasteret e tjera qendrore, në këtë drejtim, kanë shumë për të bërë. Të metat e dobësitë, që vërehen në argumentimin shkencor të planeve, në bashkërendimin e tyre në të gjithë komponentët, ndërmjet dikastereve, si dhe ndërmjet dikastereve e rretheve, tregojnë se këto organe bëjnë një punë jo të thelluar shkencërisht në procesin e hartimit të planit dhe ndodh që nuk u japin rrugëzgjdhje të studiuar disa problemeve konkrete, që dalin në fushën e ekonomisë, siç janë: ai i zënies me punë të forcave të reja, problemet që u dalin rretheve në zhvillimin e disa degëve etj.

Gjithashtu, organet qendrore të planifikimit, dikasteret dhe institucionet e tjera shkencore me ngadalësi po futin metodat e reja të planifikimit, sidomos, metodat matematike e të programimit linear, metodat bilancuese, të cilat sot bëhen më të meta e boshllëqe. Studimet dhe planet prognozë, siç janë hartuar për zhvillimin e disa degëve të bujqësisë, mund e duhet të bëhen edhe për degë të tjera të ekonomisë, sidomos, për zhvillimin kompleks të rretheve, për një shpërndarje sa më proporcionale të forcave prodhuese etj., të cilat, kohë pas kohe,

t'i paraqiten edhe Komitetit Qendror të Partisë. Të gjitha këto do të bëjnë të mundur që proceset e fenomenet ekonomike të drejtohen mbi baza më shkencore.

Problem i madh mbetet realizimi në praktikë i unitetit të domosdoshëm midis planit dhe zbatimit të tij. Përvoja ka treguar se, sado mirë që të hartohet plani, rëndësi të madhe ka realizimi i tij. Shpërpjesëtimet dhe fenomenet negative, që vihen re në degë e në sektorë të veçantë, shfaqen e rishfaqen me intensitet e në përmasa të ndryshme qysh kur plani fillon të mos realizohet në një tregues, në një ndërmarrje apo kooperativë, në një degë apo sektor. Këto çojnë pastaj në shpërpjesëtime dhe prirje negative, që rëndojnë ekonominë në tërësi.

Në qoftë se rrethi i Fierit, i Vlorës dhe i Tiranës nuk realizojnë planin e prodhimit të naftës e të qymyrgurit, ose rrethi i Sarandës, i Gjirokastrës, i Durrësit, i Krujës, i Lushnjës e i Vlorës nuk prodhuan sipas planit disa mijëra tonë grurë, në qoftë se plani i ndërtimit e i bonifikimit u realizua vetëm 93 për qind, ose kur ndodh që gjendja e mallrave në depo të rritet më shpejt sesa prodhimi industrial, të gjitha këto e vënë ekonominë përballë vështirësish.

Këto ndodhin, pikërisht, se disa komitete partie rrethesh dhe organizata-bazë në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore, si dhe në disa dikasterë bëjnë punë të përgjithshme, shpesh merren me detyra të çastit dhe problemet i marrin të shkëputura nga njëra-tjetra. Shumë tregues tekniko-prodhues e ekonomiko-financiarë, ku pasqyrohet zbatimi i politikës ekonomike të Partisë, nuk bëhen ende si duhet objekt diskutimi, analizash, konkluzionesh dhe të përcaktohen ato detyra që do të ndikojnë në realizimin e të gjithë planit.

Organet dhe organizatat e Partisë nuk duhet të merren thjesht me njoftimet që u jepen mbi realizimin e planeve, siç ndodh shpeshherë, por, sidomos, të ndjekin e të kontrollojnë me vëmendje të madhe se si zbatohen kërkesat e ligjeve objektive, të politikës ekonomike të Partisë, si punohet konkretisht për realizimin e tyre, si mobilizohen njerëzit, si janë ndër-gjegjja e niveli kulturor-profesional etj. Ashtu siç kërkohet planifikimi proporcional i zhvillimit të degëve të ekonomisë, është e nevojshme të kërkohet edhe zbatimi i planeve, ndryshe krijohen shpërpjesëtime dhe prishen treguesit e planifikuar.

Unitetin midis hartimit të planit e të buxhetit dhe realizimit të tyre duhet ta kuptojnë dhe ta zbatojnë më thellë të gjitha organet e shtetit e të ekonomisë. Por këtë duhet ta kuptojnë më mirë edhe organet e specializuara të planifikimit ekonomik e financiar, duke filluar nga Komisioni i Planit të Shtetit e Ministria e Financave, si dhe drejtoritë përkatëse të dikastereve qendrore dhe seksionet e planit e të financës në komi-

tetet ekzekutive të rretheve, sepse, edhe pas kritikave të Komitetit Qendror e të Qeverisë, akoma vërehen raste që tregojnë se ato nuk po shkëputen plotësisht nga ajo metodë e praktikë pune, sipas të cilave thuajse e quajnë të përfunduar punën e tyre me hartimin e planeve.

Kjo është njëra anë e punës së tyre, të cilën ato duhet ta kryejnë sa më mirë, por kryesorja pastaj është të ndjekin gjithë procesin e realizimit të planeve, të ndihmojnë për këtë qëllim, sidomos, organet e shtetit dhe të ekonomisë në bazë, të zgjidhin ato probleme që u takojnë, të çastit e të perspektivës, dhe të marrin përgjegjësi për plotësimin e të gjitha detyrave që kanë. Njëkohësisht, ato duhet të përmirësojnë punën e tyre e të marrin masa për të organizuar sa më mirë shërbimin statistikor e të kontabilitetit, për një informim të shpejtë e operativ, sepse, shpeshherë, disa të dhëna e tregues të domosdoshëm përpunohen e paraqiten me vonesë, ose nxirren për periudha kohe relativisht të gjata. Nuk mund të shërbejnë për një drejtim operativ ato raporte, analiza e informacione, që i dërgohen udhëheqjes së Partisë e të shtetit në qendër, në rrethe e në bazë, kur, shpeshherë, përmbajnë një koment të sipërfaqshëm e të cekët të disa shifrave, ose nuk dalin nga kuadri i ngushtë i një trajtimi global, për të nxjerrë problemet e shkaqet e vërteta dhe për të bërë propozime konkrete mbi masat që duhen marrë.

2. — Përsosja e drejtimit të sigurojë rritjen e efektivitetit të prodhimit shoqëror me ritme më të larta

Të dhënat tregojnë se në vitin 1978, në krahasim me vitin 1976, fondet themelore dhe shpenzimet materiale të prodhimit nuk janë rritur kudo me ritmet e parashikuara, për pasojë, edhe të ardhurat kombëtare.

Me gjithë rezultatet pozitive, që arrijnë një pjesë e madhe e ndërmarrjeve të degëve të ndryshme të ekonomisë, të cilat i plotësojnë dhe i tejkalojnë detyrat e planit të prodhimit dhe të akumulimit socialist, në të njëjtën kohë, një pjesë tjetër e tyre paraqiten me rentabilitet të ulët, ose dalin me humbje, duke ulur dhe akumulimin që është krijuar nga puna e mirë e ndërmarrjeve të tjera. Gjatë vitit 1979, kundrejt planit, janë shtuar si numri i ndërmarrjeve me humbje, ashtu edhe shuma e humbjeve në lekë.

Në industrinë e naftës, sidomos në shpim-kërkimet dhe në shpim-shfrytëzimet, në disa miniera e vepra të reja, që janë vënë në shfrytëzim vitet e fundit, veçanërisht në Kombinatin Me-

talurgjik, si dhe në sektorin e transportit, efektiviteti ekonomik është ende i ulët.

Edhe efektiviteti i shpenzimeve në kooperativat bujqësore paraqitet i ulët, në radhë të parë, për faktin se, ndërsa shpenzimet për mekanikën bujqësore, për plehrat kimike e organike, për ujitjen e për farërat janë kryer afërsisht në nivelin e parashikuar, detyrat për shtimin e prodhimit dhe të të ardhurave janë realizuar në një nivel më të ulët.

Tregtia e jashtme, në vitin 1978, rezultoi me një mosrealizim të akumulimit. Në vitin 1979 kjo gjendje është përmirësuar dhe ajo doli me një rentabilitet relativisht të kënaqshëm, por organet e tregtisë së jashtme duhet të shfrytëzojnë, më mirë se deri tani, koniunkturat e çmimeve, me qëllim që të rritet më shumë efektiviteti ekonomik i eksport-importit.

Siç shihet, në fushën e efektivitetit të prodhimit, kemi akoma mjaft probleme. Gjatë vitit 1978 dhe veçanërisht gjatë vitit 1979, janë bërë përpjekje më të mëdha dhe disa rezultate janë arritur, por këto çështje duan një njohje më të thellë dhe drejtim më konkret, më efektiv.

Një problem tjetër mjaft i rëndësishëm është ai i forcimit të pareshtur të kursimit, si ligj objektiv dhe që është në natyrën e shoqërisë sonë socialiste. Në kushtet kur shpenzimet materiale të prodhimit kapin më shumë se gjysmën e vlerës së produktit shoqëror, kuptohet se sa rëndësi të madhe ekonomike ka kursimi i tyre. Mjafton të themi se kursimi vetëm 1 për qind i këtyre shpenzimeve gjatë një viti, bën të mundur ndërtimin e aq apartamenteve, sa të strehohet një popullsi e barabartë me atë që ka sot qyteti i Lushnjës ose i Gjirokastrës.

Por çfarë shohim në praktikë? Në qoftë se plani i prodhimit industrial u realizua me 6,5 për qind më pak energji elektrike dhe në qoftë se u hoqën nga plani disa mijëra tonë karburante, pa ndryshuar planin e prodhimit industrial e bujqësor e të degëve të tjera, këto flasin si për planifikimin me rezerva, ashtu edhe për luftë e përpjekje të pamjaftueshme për të kursyer. Normativat e disa materialeve e lëndëve të para, duke qenë të vjetruara e me rezerva, vazhdojnë të tejkalohen. Koeficienti i përdorimit të dobishëm të çeliqueve, të llamarinës, të lëndës së drurit etj. është ende i ulët. Megjithëse dihet se në shumë uzina të vendit për të njëjtin detal përdoren 15-20 për qind më shumë metale sesa në Kombinatin e Autotraktorëve, përsëri nuk po merren masa të plota e të shpejta për të përsosur teknikën dhe teknologjinë e prodhimit të tyre.

Fryma e kursimit ende nuk është futur në gjakun e çdo punonjësi, të çdo punëtori e kooperativisti. Nuk është gjithnjë i fortë dhe i pasur ai vend që prodhon shumë, na mëson shoku

Enver, por ai që edhe prodhon shumë e aq sa i nevojitet dhe që di ta përdorë çdo gjë me nikoqirllëk.

Rritja e efektivitetit të prodhimit dhe forcimi i regjimit të kursimit janë të lidhur drejtpërdrejt me shtimin e akumulimit dhe me përdorimin me efektivitet të tij. Në qoftë se nuk realizohet norma e akumulimit, krijohen vështirësi për financimin e ekonomisë.

Mbështetja tërësisht në forcat tona kërkon në mënyrë imperative zbatimin më në thellësi të parimit të shlyerjes së shpenzimeve me të ardhurat dhe me krijimin e akumulimit nga ndërmarrjet e nga kooperativat bujqësore, si parim themelor që duhet ta sigurojë mekanizmi i drejtimit ekonomik. Rentabiliteti dhe fitimi nuk kanë qenë dhe nuk përbëjnë qëllimin kryesor të veprimtarisë së ndërmarrjeve tona, por, njëkohësisht, duhet të mbajmë mirë parasysh se rentabiliteti i secilës ndërmarrje e kooperative shpie edhe në rritjen e rentabilitetit të përgjithshëm të ekonomisë dhe, pra, në shtimin e akumulimit, që është burim i vetëm i riprodhimit të zgjeruar socialist. Në ekonominë tonë mund të pranohet që një ndërmarrje apo produkt, në kushte të caktuara, të dalë përkohësisht me humbje. Por kjo gjendje nuk duhet lejuar për një kohë të gjatë, mbasi, për ndërmarrjet që punojnë me humbje, shoqëria është e detyruar të përdorë një pjesë të mirë të akumulimit socialist. Prandaj lufta e ndërmarrjeve dhe e kooperativave bujqësore, për realizimin e detyrave të planit, është e lidhur ngushtë me pakësimin e vazhdueshëm të shpenzimeve dhe me shtimin e të ardhurave në tërësi, për çdo sektor e repart, për çdo produkt e aktivitet të veçantë, me forcimin e hozrashotit.

Janë bërë studime e janë marrë edhe vendime për t'i bërë ndërmarrjet rentabël dhe për t'i nxjerrë nga prapambetja ato që nuk plotësojnë treguesit ekonomik-financiarë. Por fakti është se, ndërsa çdo vit shumica e ndërmarrjeve tejkalojnë detyrat e rentabilitetit, ose dalin nga prapambetja, një pjesë tjetër futen në prapambetje. Kjo flet për studime të cekëta e jokomplekse, tekniko-ekonomike, si dhe për masa të pathëlluara e të pamjaftueshme gjatë realizimit të planit. Prandaj Këshilli i Ministrave të ngarkojë dikasteret përkatëse që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Komisionin e Planit të Shtetit, të rishikojnë me sy kritik gjendjen dhe, brenda vitit, t'i raportohet Komitetit Qendror për problemet dhe për masat konkrete që do të merren. Në këtë kuadër, të studjohen edhe rrugët e masat për forcimin e kooperativave bujqësore të dobëta ekonomikisht.

Një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar hartimit të shtrënguar të kostove të prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit,

sepse vetëm mbi bazën e një plani të tillë kostoje, mund të bëhet një luftë më e organizuar e më këmbëngulëse për kurtime. Në strukturën e kostos së prodhimit nuk pasqyrohen plotësisht e në mënyrë dinamike ndryshimet pozitive që ndodhin në teknologji, në organizimin e punës e në përdorimin e lëndëve të para. Kjo shtron nevojën që në të gjitha ndërmarrjet e kooperativat bujqësore, me pjesëmarrjen e gjerë të masave, nën udhëheqjen e organeve e të organizatave të Partisë, gjatë vitit 1980, të bëhet një analizë e thellë e një për një e tërë strukturave të kostove. Kjo analizë të nxjerrë mirë në pah faktorët që kanë ndryshuar, si dhe të parashikojë faktorë të rinj të mundshëm për ndryshime të tjera cilësore, të cilat të jenë bazë për të ulur më tej koston e prodhimit, preventivat e ndërtimit e të shërbimeve për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Me këtë sy duhen parë edhe çështjet e rritjes së efektivitetit të tregtisë së jashtme, për forcimin e regjimit të kursimit kudo, në sferën e arsimit e të kulturës, në shëndetësi e në institucionet shtetërore e shoqërore, deri në çdo familje.

Problemet e kostos, të rentabilitetit e të akumulimit socialist janë probleme me rëndësi jetike për zhvillimin dinamik të ekonomisë. Organet dhe organizatat-bazë të Partisë kanë filluar të merren më mirë me këto probleme, megjithatë, kjo është e pamjaftueshme, veçanërisht në kooperativat bujqësore. Në komitetet e Partisë të disa rretheve dhe në organizatat e Partisë të mjaft ndërmarrjeve e kooperativave ende nuk është shkukur nga rrënjët mentaliteti burokratik, sipas të cilit problemet ekonomik-financiare konsiderohen si probleme të komitetit ekzekutiv, të drejtorisë apo të kryesisë dhe nuk e ndiejnë sa duhet përgjegjësinë për udhëheqjen e gjithë veprimtarisë ekonomik-financiare të ndërmarrjes e të kooperativës.

Socializmi është llogari, por kjo nuk duhet të mbetet një formulë e zbrazët. Organet dhe organizatat e Partisë nuk duhet t'i lënë në hije çështjet ekonomik-financiare, çështjet e efektivitetit e të rentabilitetit të prodhimit shoqëror. Ato duhet të bindin, në radhë të parë, komunistët dhe të bëjnë të ndër-gjegjshëm drejtuesit, specialistët dhe gjithë punonjësit, se prodhimi nuk është vetëm sasia, as vetëm cilësia, por është një kompleks i tërë, që përfshin koston, rendimentin, fitimin, tatinin mbi xhiro, shpërndarjen etj. Për këtë qëllim, të mbështeten dhe të aktivizohen më mirë organet e financës, të bankës e të llogarisë, të cilat, nga ana e tyre, duhet t'i informojnë organizatat e Partisë vazhdimisht për gjendjen, për problemet që dalin dhe për masat që duhen marrë.

Në tërësinë e tyre, këto çështje, si dhe vlerësimi i veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore, i punës së organizatave të Partisë dhe të çdo drejtuesi

duhet të trajtohen më me kujdes. Në këtë kuadër, Qeveria të studiojë edhe mundësinë e lidhjes së pagës e të shpërblimit të personelit drejtues e tekniko-administrativ të punonjësve me rezultatet që arrihen në treguesit ekonomik-financiarë.

3. — Të drejtojmë më mirë, në gjerësi e në thellësi revolucionin tekniko-shkencor dhe kooperimin

Zhvillimi dhe çuarja përpara me ritme të shpejta e prodhimin nuk mund të realizohen pa drejtuar e pa organizuar në baza më të shëndosha revolucionin tekniko-shkencor dhe pa thelluar e pa përmirësuar punën kërkimore-shkencore. Pas fjalimit të shokut Enver Hoxha, mbajtur në shtator të vitit 1977, ky revolucion po zhvillohet në përmasa më të gjera e me pjesëmarrjen më aktive të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste e të specialistëve. Për këtë flet qartë futja në qarkullimin ekonomik e shumë burimeve të reja natyrore, fuqizimi i pareshtur i bazës materialo-teknike të socializmit dhe prodhimi në vend i afro 90 për qind të pjesëve të ndërrimit, prodhimi dhe përvetësimi i pajisjeve dhe i makinerive të reja.

Po ashtu, plani i aprovuar nga Qeveria për studimin në mënyrë të përqendruar të më shumë se 200 problemeve teknike e shkencore, si dhe i mjaft problemeve të tjera që studion vetë baza, tani kanë hyrë më mirë në rrugën e zgjidhjes. Megjithatë, nga analiza që Byroja Politike i bëri përsëri, në muajin tetor të vitit 1979, punës që kryhet nga këto grupe, del që ende ka zvarritje e javashllëk. Nga drejtuesit kryesorë në dikastere, në rrethe e në bazë, në mjaft raste, mungojnë kontrolli, ndihma dhe mbështetja e nevojshme shkencore, materiale e financiare, të cilat duhet të futen më mirë në rrugën e planifikimit.

Veç kësaj, tani që një pjesë e temave kanë arritur në fazën kur kanë nevojë për projektim, kërkohet një bashkërendim më i organizuar i forcave studiuese me ato projektuese e zbatuese. Koha nuk pret që me vite të tëra të studiohet më parë dhe të pritët pastaj një kohë tjetër e gjatë për projektimin e pajisjeve të objekteve dhe, më vonë, të mendohet se si ato do të vihen në jetë. Prandaj Byroja Politike porositi edhe një herë që t'i jepet fund mungesës së bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të anës studimore me atë projektuese e zbatuese. Ajo porositi, gjithashtu, që organet dhe organizatat e Partisë t'u kushtojnë një vëmendje më të madhe grupeve të punës, që janë ngritur pranë dikastereve, rretheve e ndërmarrjeve, që ato të mos shndërrohen në grupe studimesh akade-

mike e në qoshe të rehatshme, por të luftojnë, që në embrion, çdo shfaqje të huaj e të sëmurë, si: individualizmi, egoizmi e cmira profesionale, që duken aty-këtu. Duke u kushtuar një vëmendje më të madhe grupeve studimore, në të njëjtën kohë, të ngrihen në një shkallë më të lartë puna e byrove teknike e teknologjike në ndërmarrjet ekonomike, si dhe puna kërkimore në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore.

Shoku Enver Hoxha ka theksuar se revolucioni tekniko-shkencor nuk mund të çohet përpara pa objektiva të qartë, pa konkretizuar, pa programuar e pa ndjekur, hap pas hapi, vënieën e tyre në jetë. Me gjithë punën më të mirë që ka filluar të bëhet, përsëri ndodh që, në mjaft ndërmarrje e kooperativa bujqësore, nuk caktohet, qysh në kohën kur bëhet plani, se çfarë do të bëjë konkretisht kolektivi punonjës për mekanizimin, për përmirësimin e teknologjisë, për shtimin e artikujve të rinj, për përmirësimin e cilësisë, të lidhur ngushtë këta me detyrat për rritjen e rendimentit të punës. Përse lejojnë organet dhe organizatat e Partisë, që militojnë në uzinat dhe në oficinat mekanike, që të mos zbatohen detyrat e caktuara nga Komiteti Qendror për prodhimin e mekanizmave të thjeshtë, të cilët zëvendësojnë punën e krahut në bujqësi, në ndërtim, në pyje?

Po kështu ndryshime rrënjësore duhet të bëhen në mjaft reparte e ndërmarrje, ku teknika dhe teknologjia janë të vjetruara dhe punohet me rendiment dhe me efektivitet të ulët. Këtyre ndërmarrjeve nuk u mungojnë as kuadrot e as specialistët, as baza materialo-teknike. Asgjë nuk ka më tepër Uzina e Gozhdë-Bulonave në Kavajë, por, atje, organizata-bazë e Partisë, duke i bërë të ndërgjegjshëm për situatat e për vështirësitë dhe duke i mobilizuar kuadrot e kolektivin punonjës, me komunistët në ballë, arritën të prodhojnë të reja pothuajse gjithë makineritë që kishin dhe të shtojnë aftësitë prodhuese. Përse nuk veprojnë kështu edhe organizatat-bazë të ndërmarrjeve të tekstilit, të lëkurë-këpucëve, të mobilje-orendive, të konfeksioneve etj. dhe, veçanërisht, ato të disa ndërmarrjeve të prodhimeve të ndryshme, që janë relativisht më të prapambetura për nivelin e mekanizimit dhe të teknologjisë? Në një kohë kur mendimi ynë teknik e shkencor ka arritur dhe është angazhuar të atakojë e të zgjidhë probleme të mëdha teknike e teknologjike, si është e mundur që të mos zgjidhë plotësisht përpunimin industrial të disa lloj lëkurëve, ose të bimëve mjekësore e etero-vajore?

Zhvillimi dhe çuarja përpara e revolucionit tekniko-shkencor nuk mund të kuptohen pa përkrahur e pa përgjithësuar përvojën e përparuar, që pasqyron edhe një drejtim e organizim më progresiv të punëve. Rezultatet e arritura gjatë vitit

1979 në rrethin e Korçës, për prodhimin e grurit, të panxhar-sheqerit e të qumështit; në rrethin e Beratit për prodhimin e lulediellit, të pambukut e të qumështit; në rrethin e Shkodrës për prodhimin e misrit, të orizit, të duhanit e të qumështit, si dhe disa rezultate të mira të arritura në rrethet e Tiranës, të Fierit, të Elbasanit, të Skraparit, të Pogradecit e të Tropojës tregojnë për një punë më të organizuar që kanë bërë komitetet e Partisë të këtyre rretheve për përgjithësimin e asaj përvoja të pasur, që është fituar në vitet e kaluara dhe për zbatimin e rezultateve të arritura në eksperimentimin shkencor.

Trajtimi dhe zgjidhja drejt e problemeve të zhvillimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor kanë nxjerrë më në pah nevojën e studimeve më të thella dhe marrjen mëdemos dhe sa më parë të masave më të plota në fushën e përqendrimit, të specializimit e të kooperimit. Ne kemi akoma mjaft ndërmarrje, si dhe sektorë e reparte brenda tyre, me profile shumë të gjera, heterogjene. Disa prej tyre përbëhen nga njësi të vogla, që nuk kanë ngjashmëri teknologjike ose ndonjë lidhje ekonomike apo kooperuese midis tyre.

Në sistemin e dy ministrive të industrisë makineritë e pajisjet prodhohen në 60 ndërmarrje, por vetëm 18 prej tyre janë uzina dhe ofiçina mekanike të profilizuara. Pjesët e ndërrimit për makineri të ndryshme, për automjetet e traktorët janë shpërndarë në 28 uzina e ofiçina mekanike, si dhe në 50 ndërmarrje të tjera jomekanike. Mallrat metalike të përdorimit të gjerë prodhohen në 30 ndërmarrje etj.

Por profilizimi dhe specializimi i prodhimit në industrinë mekanike lidhen ngushtë me masat për përqendrimin e makinerive metalprerëse. Ato sot i kemi mjaft të shpërndara dhe vetëm 40 për qind e tyre ndodhet e përqendruar në uzinat dhe në ofiçinat e mëdha, ndërsa të tjerat janë të shpërndara andej-këtej. Nga një shpërndarje e tillë shteti dhe ekonomia kanë humbje të mëdha, sepse koeficienti i përdorimit dhe rendimenti i tyre janë të ulët.

Të tilla probleme kemi edhe në industrinë e drurit, në industrinë e lehtë e ushqimore, ku disa ndërmarrje bashkojnë fabrika, reparte e sektorë, që kanë mbetur të vegjël e me rendiment të ulët, sepse nuk mbështeten as në ngjashmërinë e lëndëve të para, as në ngjashmërinë e proceseve teknologjike; kemi në transportin automobilistik, ku, jashtë sistemit të Ministrisë së Komunikacionit, ndodhen afro 60 për qind e automjeteve dhe ku as gjysma e tyre nuk është e përqendruar në parqe të specializuara. Prandaj del e nevojshme që Qeveria të studiojë e të marrë masa më të plota për profilizimin e uzi-

nave e të ofiçinave mekanike dhe për përqendrimin e makinave metalprerëse, si dhe për të çuar më përpara kooperimin.

Projektuesit, prodhuesit dhe ndërtuesit bënë një punë të mirë për zgjerimin e Fabrikës së Sheqerit në Maliq, por, njëkohësisht, doli se ka nevojë të ngrihet në një nivel më të lartë bashkëpunimi midis tyre. Tërë ato vepra që ne do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e ardhshëm kërkojnë, qysh tani, një planifikim rigoroz të anëve të ndryshme të kooperimit e të bashkëpunimit. Për t'i drejtuar më mirë problemet që lidhen me përqendrimin, me specializimin e veçanërisht me kooperimin, të studiohet edhe mundësia e drejtimit të tyre nga një organ i përqendruar.

Për sa i përket përqendrimit e specializimit në bujqësi, janë bërë disa përmirësime. Shpërndarja dhe vendosja e prodhimit bujqësor janë vënë mbi baza më të shëndosha. Por Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e muajit mars të vitit 1979, nënvizoi edhe një herë se këto probleme ende nuk kanë marrë zgjidhje të plotë, se disa drejtues e trajtojnë specializimin shumë ngushtë, sikur gjoja specializimi përjashton zhvillimin e disa degëve plotësuese, gjë që i ka çuar disa ekonomi bujqësore sa të mos mbajnë as shpendë për nevojat e brendshme të tyre. Specializimi i ekonomive të mëdha bujqësore kërkon shfrytëzimin e të gjitha burimeve të brendshme dhe bashkërendimin racional të të gjitha degëve e nëndegëve të prodhimit. Prandaj, në bazë të studimeve më të thelluara, brenda afateve të caktuara, të bëhet, kudo ku është e nevojshme, një rishpërndarje më e mirë e kulturave bujqësore, si midis rretheve, ashtu edhe midis ekonomive bujqësore, por, sidomos, brenda ekonomive, sektorëve e brigadave.

Në kuadrin e zhvillimit e të thellimit të revolucionit tekniko-shkencor, vitet e fundit, edhe puna studimore e kërkimore-shkencore është vënë në baza më të shëndosha organizuese. Por ende ajo nuk është shkëputur nga disa shfaqje të praktikizmit të ngushtë, të rutinës, të shikimit të njëanshëm dhe të cekët të problemeve. Puna studimore-shkencore është e nevojshme, si për zgjidhjen e problemeve të përditshme, operative, ashtu edhe në shkallë rrethi, ndërmarrjeje, kooperative, sektori e reparti. Mungesa e saj e bën më të koklavitur, spontane e të pafrytshme edhe punën operative.

Ai që punon vetëm për sot e s'mendon për nesër, do ose s'do, nuk akumulon sa duhet, ha nga rezervat që ka krijuar. Ai që nuk bën studime të posaçme perspektive, nuk shkon dot larg, në mos sot, nesër, do të ngecë në vend, ose do të bëjë prapa, nuk do të jetë në gjendje t'u bëjë ballë kërkesave të përparimit të vazhdueshëm të vendit. Prandaj shoku Enver Hoxha ka theksuar me forcë se kurrë nuk duhet të ecet

kuturu, qorrasi, pa përcaktuar objektiva të qartë për sot e për të ardhmen. Këtej del edhe detyra që Partia ta marrë më mirë në dorë këtë çështje, të kryejë vetë dhe të kërkojë edhe nga levat e saj që të bëjnë sa më shumë studime të vlefshme dhe të ndjekë zbatimin e tyre.

Më mirë duhet të angazhohen e të punojnë për çuarjen përpara të revolucionit tekniko-shkencor edhe institutet kërkimore dhe bërthamat e tjera shkencore. Ato të ndihmohen e të kontrollohen më nga afër nga dikasteret përkatëse. Po kështu, edhe Akademia e Shkencave t'i futet më thellë revolucionit tekniko-shkencor, të zgjerojë e të pasurojë tematikën e saj me probleme që dalin nga prodhimi, si dhe për të koordinuar më mirë punën në fusha të ndryshme të shkencës. Në të gjitha institucionet shkencore duhet punuar më mirë edhe për rritjen e nivelit të kualifikimit shkencor të kadrove që punojnë në to. Komitetet dhe organizatat e Partisë, brenda këtij viti, ta analizojnë punën që bëhet në këtë drejtim e t'i pastrojnë ato nga disa njerëz të pazotë, duke çuar atje nga specialistët më të përgatitur dhe që kanë arritur rezultate të mira në prodhim.

4. — Të përsosim vazhdimisht organizimin socialist të punës dhe të rritim pa ndërprerje rendimentin e saj

Organizimi socialist dhe rritja e rendimentit të punës përbëjnë një fushë të gjerë e të rëndësishme të drejtimit shkencor të ekonomisë. Planifikimi dhe shpërndarja e drejtë e burimeve të punës në degët e në sektorët e ndryshëm të ekonomisë e të kulturës, normimi i punës dhe kualifikimi i punonjësve, rritja e pandërprerë e rendimentit dhe shpërblimi i punës, janë ndër problemet e mprehta, me karakter politik dhe ekonomiko-shoqëror, me të cilat organet dhe organizatat e Partisë, si dhe levat e saj, në mënyrë të veçantë organet e pushtetit e të ekonomisë, ndeshen përditë në punën e tyre.

Është pozitiv fakti që, duke luftuar për zbatimin e vendimeve të Plenumit të 6-të të Komitetit Qendror, në nëntëmujorin e vitit të kaluar rendimenti i punës në industri u rrit 3,1 për qind kundrejt nëntëmujorit të vitit 1978. Në ndërtim-montimet e Ministrisë së Ndërtimit plani i rendimentit të punës u plotësua në masën 100 për qind. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 1979, pjesëmarrja e punëtorëve në punën me norma arriti në 82,2 për qind dhe koha e punuar me norma teknike në 62 për qind të kohës së punuar me norma. Janë

rishikuar normat, në të gjitha degët e ekonomisë, në rreth 70 mijë procese pune, e barabartë kjo me kursimin e afro 2100 punëtorëve.

Por këtu nuk ka vend për vetëkënaqësi, sepse, në problemet e organizimit të punës e të rritjes së rendimentit, vazhdojnë të ekzistojnë të meta e dobësi. Edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar detyra e planifikuar për rritjen e rendimentit të punës në industri nuk u plotësua në masën e parashikuar. Si rrjedhim, u vërtetua fenomeni që, ndërsa plani i rendimentit të punës në prodhimin industrial nuk u plotësua, paga mesatare e planifikuar gati u realizua.

Në shkallë republike, pa arsye, mungojnë një numër i konsiderueshëm punëtorësh e kooperativistësh.

Normat e punës në disa sektorë mbahen të ulëta dhe tejkalohen shpejt, në një kohë kur, gjatë turnit të ditës, në disa ndërmarrje, efektivisht, punohet 6-7 orë. Megjithëse, në përgjithësi, normat mesatare realizohen e në mjaft degë të ekonomisë tejkalohen, nga një numër i madh punëtorësh ato nuk arrihen. Gjithashtu, gjenden një mijë justifikime për të mos vendosur norma teknike të punës.

I konsiderueshëm është numri i ndërmarrjeve apo i sektorëve që nuk plotësojnë planin në të gjithë treguesit e tij, kryesisht për të meta e dobësi në organizimin e punës. Minierat e qymyrgurit të Memaliajt, të Mborje-Drenovës e të Valiasit, megjithëse e kanë të siguar fuqinë punëtore, si dhe frontet e punës, makineritë e pajisjet, nuk kanë plotësuar planin e prodhimit. Dhe, kur hyn në analizën e shkaqeve, del se në këto ndërmarrje mungesat pa arsye zenë rreth 5 për qind, në një kohë kur numri i punëtorëve të tyre zë vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të punëtorëve.

Këto fakte flasin për dobësi në punën edukative të Partisë dhe të levave të saj me njerëzit, për të meta organizative, që nuk e ngrenë peshë tërë opinionin në luftën klasore kundër forcës regresive të psikologjisë mikroborgjeze e të interesit të ngushtë personal. Në këtë drejtim kërkohet një punë edukative më rezultative, kërkohet edhe një luftë frontale dhe e gjithanshme kundër frymës së liberalizmit, kundër mentaliteteve mikroborgjeze për punën, kundër frymës së të kënaqurit me pak.

Ato flasin, njëkohësisht, edhe për të meta në organizimin e punës nga disa drejtues të ekonomisë, të cilët, në mjaft raste, nuk janë në krye të detyrës, nuk e ndiejnë si duhet përgjegjësinë për të ndjekur ardhjen dhe largimin në kohë të punonjësve nga puna, për marrjen dhe për dhënien në dorëzim të punës midis turneve, për caktimin e detyrave të secilit në

kohë, për furnizimin e punonjësve me materiale e me vegla pune, për krijimin e kushteve normale për punë etj.

Organizimi i punës ende nuk shikohet e nuk trajtohet kudo si art, që mbështetet në njohuri të gjera teorike, politike, shkencore e organizative, i cili merr parasysh fitimin e kohës, zbatimin e teknikës së fundit etj. Këtej burojnë dhe ai kuptim i cekët dhe ai nënvleftësim i problemeve të organizimit, që ndeshen në punën e disa organeve dhe organizatave të Partisë, të cilat nuk kërkojnë sa duhet llogari dhe nuk i vënë akoma para përgjegjësisë organet shtetërore dhe ekonomike, për të vendosur kudo rregull e disiplinë të fortë, për të forcuar kontrollin shtetëror rigoroz në zbatimin e detyrave.

Organet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të forcojnë kontrollin dhe kërkesën e llogarisë për punën e organeve të pushtetit, të ekonomisë e të bashkimeve profesionale, për të kapërcyer atë punë të cekët e me karakter fushate që bëhet në çështjet e disiplinës e të shfrytëzimit të kohës së punës, të normimit etj. Normat janë element i rëndësishëm e i përhershëm i organizimit shkencor të punës dhe të rritjes së rendimentit të saj dhe jo vetëm si masë shpërblimi, siç kuptohen e trajtohen në disa raste. Prandaj ato duhet të vendosen kurdoherë mbi baza shkencore, pasi të jenë bërë matje teknike, vrojtime kronometrike e fotografime të operacioneve e të kohës së punës nga ana e normistëve, e ekonomistëve dhe e specialistëve të prodhimit dhe jo t'u lihen spontaneitetit. Me këto çështje duhet të merren më mirë, sidomos, organizatat e bashkimeve profesionale, që të ngrenë gatishmërinë dhe interesimin e klasës e të masës për të punuar me norma të përparuara e të mos lejojnë ngurrime e pazarllëqe, që janë pasojë e pajtimit me metodat e vjetruara në punë. Duhet të jemi shumë të rreptë dhe të luftojmë pa hezitim rastet kur regjistrohesh më shumë punë nga sa është kryer në fakt, kur në sasinë e mineralit të kromit apo të qymyrit regjistrohen e paguhen edhe gurët e lëndët e huaja. Në çdo rast të paguhet vetëm ajo punë që punëtori ka kryer në fakt, sipas kërkesave të standardeve shtetërore, ai prodhim që është futur në magazinë.

Forcimit të mëtejshëm të organizimit socialist të punës t'i shërbejë më mirë zbatimi me rigorozitet i dispozitave që janë në fuqi, si dhe i masave më të forta për disa punonjës, që nuk respektojnë rregullat e vendosura në punë. Po kështu, të zbatohen pa lëshime masat disiplinore, që parashikohen në statut, edhe në kooperativat bujqësore, ndaj atyre që nuk marrin pjesë në punë, që nuk kryejnë minimumin e detyrueshëm të ditëve të punës, që nuk respektojnë orarin e punës dhe që punojnë me cilësi të dobët.

Në kuadrin e organizimit të punës dhe të shpërndarjes me

plan të fuqisë punëtore, vëmendje më të madhe kërkon studimi shkencor i problemeve të demografisë, i burimeve të punës dhe i zënies së tyre me punë. Me një kujdes të veçantë duhet trajtuar e duhet planifikuar zënia me punë e forcave të reja në disa qytete. Këtu të zbatohet më me rigorozitet orientimi i Partisë që në qytete e në ndërmarrjet bujqësore pranë tyre të dërgohen, kryesisht, gra e vajza, ndërsa të rinjtë të sistemohen në punë edhe në frontet e tjera të punës, që janë larg qyteteve dhe në kooperativat bujqësore. Kujdes i veçantë të tregohet për sistemimin në punë të nxënësve, që mbarojnë çdo vit shkollat e mesme të përgjithshme dhe ato të ulëta e të mesme profesionale.

Gjithashtu, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të punojnë më mirë që profilet e shkollave të mesme profesionale të mos përgatitin mbi nevojat mekanikë, elektrikistë e të tjerë, por t'u përgjigjen kërkesave për punëtorë të kualifikuar për minierat, naftën, gjeologjinë, sharrat, bujqësinë etj. Kjo çështje kërkon studime perspektive, të cilat t'u paraqiten për shqyrtim edhe Qeverisë e Komitetit Qendror të Partisë.

Sikurse shihet, problemet e përsosjes së organizimit socialist të punës janë të shumta e të ndërlikuara dhe kanë nevojë për një bashkërendim më të organizuar. Aktualisht, ato janë të shpërndara në shumë organizma: me disa probleme të punës merret Komisioni i Planit të Shtetit, me disa Ministria e Financave, me disa të tjera dikasteret qendrore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve. Ka ardhur koha që çështjet e zënies me punë, të shpërblimit, të riaftësimin, të sigurimit teknik, të sigurimeve shoqërore etj. të drejtohen në mënyrë të përqendruar, nga baza deri në qendër.

5. — Të forcojmë punën edukative të Partisë dhe të ngremë më këmbë masat për ruajtjen dhe për administrimin e pronës socialiste

Në fushën e ruajtjes dhe të administrimit të pronës kemi përmirësime në krahasim me të kaluarën. Gjatë viteve të fundit janë ngritur ndërgjegjja dhe qëndrimi socialist ndaj pronës, është forcuar vigjilenca e drejtuesve, e komunistëve dhe e punonjësve dhe është bërë një punë më e organizuar për njohjen dhe për zbatimin e ligjeve që rregullojnë administrimin e pronës socialiste.

Por fakti që dëmtimet në ekonomi, aktualisht, zënë një

pjesë të madhe të krimeve të ndryshme, tregon se ndaj pronës, nga disa njerëz, mbahen ende mjaft qëndrime të huaja e antisocialiste. Kundër pronës socialiste ka vepruar edhe armiku, i cili jo vetëm ka nxitur vjedhjet, dëmtimet e shpërdorimet, por ka përdorur edhe formën e sabotimit e të diversionit.

Dëmtimet e shpërdorimet shtrihen pothuajse në të gjithë ekonominë, por më të theksuara ato janë në sektorin e bujqësisë, të tregtisë e të grumbullimeve dhe të industrisë së lehtë e ushqimore. Për sa u përket rrethëve ato janë më të theksuara në atë të Tiranës, të Durrësit, të Elbasanit, të Vlorës, të Fierit e të Dibrës.

Shfaqjet e psikologjisë mikroborgjeze e të pronës private, qëndrimet e pakujdesshme dhe veprimet keqbërëse ndeshen në të gjitha shtresat e popullsisë, në fshat e në qytet, bile dhe në kadro e komunistë...

Natyrisht, të konstatosh gjendjen dhe pasojat e tyre, është njëra anë, ndërsa ana më kryesore, më e rëndësishme dhe më e vështirë, në të cilën duhet ta përqendrojnë më mirë vëmendjen e tyre edhe në të ardhmen organet dhe organizatat e Partisë e levat e saj, është zbulimi i shkaqeve që i shtojnë disa njerëz të vënë dorë mbi pasurinë e përbashkët shoqërore.

Përvoja tregon se, në analizë të fundit, shkakut themelor i këtyre qëndrimeve e veprimeve të huaja është ndjenja mikroborgjeze e vënies së interesit të ngushtë personal, mbi atë të përgjithshëm. Në praktikë, këto qëndrime duken në rendjen pas sasisë, në dëm të cilësisë, në tendencën për të marrë nga shoqëria më shumë nga sa i takon, në përvetësimet e në shpërdorimet, në indiferentizmin ndaj gabimeve të të tjerëve, në hatëret e akrobaleqet, në tendencat për punë të rehatshme dhe shfaqje të tjera negative të kësaj natyre. Organet e organizatat e Partisë dhe levat e saj, duke mos i konceptuar në tërë këtë gjerësi qëndrimet antisocialiste ndaj pronës, si një presion i vazhdueshëm që ushtron ideologjia borgjezo-revizioniste, duke mos e zhvilluar sa duhet luftën e klasave në këto fusha, nuk i kanë goditur e nuk i godasin me forcën e duhur këto shfaqje e qëndrime të huaja.

Organizatave të Partisë, njëkohësisht, duhet të luftojnë edhe kundër koncepteve që absolutizojnë rolin e punës edukative ideologjike e që nënvleftësojnë rolin e punës organizuese e drejtuese në luftën kundër dëmtimeve, shpërdorimeve dhe vjedhjeve të pronës së përbashkët. Çdo qëndrim i njëanshëm në këto çështje është subjektivist dhe me pasojë negative. Shoku Enver na mëson se edukimi, disiplina shtetërore, kontrolli, organizimi e drejtimi shkencor i ekonomisë dhe i gjithë jetës së vendit, duhet të veprojnë frontalisht.

Çështja është që të bëhet një gërshetim më i mirë i punës edukative me masat administrative. Në fushën e organizimit, në zbatimin e rregullave, të dokumentacionit e të ligjeve në fuqi kemi mjaft të meta. Neglizhencat tona dhe dobësimi i vigjilencës u lënë fushë të lirë elementëve keqbërës dhe armikut të veprojnë. Akoma mbahen në detyra me përgjegjësi materiale e monetare persona të papërshtatshëm, ose njerëz të mirë, por me arsim të ulët. Këto flasin për atë që organet dhe organizatat e Partisë, sidomos, në tregti, në bujqësi e në grumbullim vuajnë nga një frymë e theksuar liberalizmi, nga shfaqje të sentimentalizmit mikroborgjez ndaj atyre që kryejnë faje e që duhet të përgjigjen përpara ligjit; ato nuk kontrollojnë sa duhet e nuk vënë përpara përgjegjësisë organet përkatëse shtetërore e ekonomike dhe organizatat e masave, që të zbatojnë gjer më një detyrat e caktuara.

Është e domosdoshme dhe e ngutshme që, në të gjitha hallkat e nivelet e organeve të Partisë, të shtetit e të ekonomisë dhe në të gjitha organizatat shoqërore, të përmirësohen e të forcohen më tej masat për të përsosur organizimin e punës, për vënien në jetë, me konsekuencë, me rreptësi e pa lëshime, të të gjitha rregullave e të dispozitave ligjore, për të organizuar e për të forcuar kontrollin e gjithanshëm, nga lart e nga poshtë, për të mbyllur të gjitha shtigjet dhe për të krijuar një atmosferë mbytëse ndaj gjithë elementëve të pandërgjegjshëm e keqbërës. V. I. Lenini theksonte se administrimi i pronës socialiste kërkon një forcë të hekurt kundër spekulatorëve, plaçkitësve, ryshfetzhinjve, çorganizuesve e vjedhësve. Partia jonë këtë forcë të hekurt e ka vendosur, kjo forcë është diktatura e proletariatit, janë ligjet, që rregullojnë të gjithë procesin e prodhimit, të shkëmbimit dhe të shpërndarjes të të mirave materiale.

Kontroll-revizioni financiar, vitet e fundit, është përmirësuar mjaft, por fakti që kontrolli i brendshëm në ndërmarrjet dhe në kooperativat, i cili është kontrolli më efektiv dhe më i vazhdueshëm, është ende një hallkë e dobët, tregon se masat për kontroll-revizionin duhen fuqizuar e duhen intensifikuar akoma më shumë. Gjithashtu, ka vend që, pa u mbetur strikt afateve globale, të caktuara për përsëritjen e revizionimit financiar të specializuar në ndërmarrjet e tregtisë, të grumbullimit dhe në ekonominë bujqësore, revizioni të kryhet jo një herë në vit, siç bëhet sot, por më i shpeshtë, duke përdorur forma të ndryshme dhe më operative. Krahas me këtë, organet e specializuara të kontroll-revizionit ta shtrijnë kontrollin e tyre më dendur, deri në sektorë e reparte e jo të kufizohen në aparatet qendrore të ndërmarrjeve ose të kooperativave bujqësore. Organizatat e Partisë konkluzionet e revizionit financiar

t'i diskutojnë edhe në mbledhje të tyre, t'i shtrojnë e t'i diskutojnë bashkë me kolektivin dhe të tërheqin konkluzione e të marrin masa për të përmirësuar gjendjen.

Tërheqja e masave dhe kontrolli punëtor janë faktorë vendimtarë për të parandaluar të keqen në këtë fushë. Shembulli i komunistëve, i punëtorëve e i kooperativistëve, që japin jetën për të shpëtuar pronën shoqërore, dhe të tillë ka në çdo rreth, duhet të popullarizohen më shumë e të bëhen burim frymëzimi për të gjithë punonjësit.

Krahas këtyre, është e nevojshme të rritet edhe forca zbuluese, sepse ende ka krime të pazbuluara. Veprimtaria e organeve të punëve të brendshme, e gjykatave dhe e prokurorëve, me gjithë përmirësimet, nuk po u kundërvihet si duhet, në kohë dhe me efikasitetin e plotë, metodave gjithnjë më të kamufluara që po përdoren nga armiqtë e nga keqbërësit. Për të rritur efektivitetin e punës në këtë çështje të rëndësishme, organizatat-bazë të Partisë duhet të këmbëngulin që të forcohet edhe më shumë bashkëpunimi midis këtyre organeve me organet e institucionet e tjera, sidomos me organizatat e masave, për ngritjen e opinionit shoqëror, për popullarizimin e ligjeve dhe për marrjen e masave kundër dëmtuesve të pronës socialiste.

Problem më vete e që kërkon vëmendje është edhe ai i dëmtimeve e i përvetësimeve në bujqësi, që kryhen nga kooperativistët, veçanërisht, për të mbajtur e për të ushqyer bagëtitë e tyre personale. Si rrjedhim i kësaj, në mjaft kooperativa bujqësore bëhen gjobitje të përsëritura, ka grindje e mërira. Këtu, në radhë të parë, del detyra e intensifikimit të punës ideopolitike nga organet dhe nga organizatat e Partisë. Ato, gjithashtu, duhet të forcojnë punën e tyre për të përfunduar sa më parë tufëzimin e bagëtive të imëta, sepse mundësitë për këtë qëllim janë kudo, por të ecet, gradualisht, edhe drejt tufëzimit të lopëve, dora-dorës në fshatra të veçanta e, pastaj, në sektorë e në kooperativa që kanë kushtet.

Por këtu një problem që nuk ngrihet për herë të parë e që nuk po zgjidhet është zbatimi i përpiktë i Deklaratës së përbashkët të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Këshillit të Ministrave të 29 prillit 1967, për të furnizuar anëtarët e kooperativave me ushqime për bagëtitë e tyre. Dhe kjo ndodh, në radhë të parë, se organet dhe organizatat-bazë nuk ndiejnë përgjegjësi, nuk i vënë përpara disiplinën së Partisë të gjitha organet përkatëse, duke filluar nga kryesitë e kooperativave, komitetet ekzekutive të rretheve dhe deri te Ministria e Bujqësisë dhe dikasteret e tjera. Organizatat e Partisë në fshat, duke aktivizuar këshillat popullorë dhe organizatat e masave, të ndjekin hap pas hapi realizimin e detyrës që tokat, të cilat

u janë dhënë anëtarëve në përdorim, të mbillen me kultura foragjere dhe me perime për të plotësuar nevojat vetjake dhe të mos lejojnë të mbajnë bagëti mbi kufijtë e caktuar, duke zbatuar me rigorozitet Statutin e Kooperativave Bujqësore.

Për të metat e dobësitë që vërehen në punën e Partisë, lidhur me problemet që trajtuam më sipër, një përgjegjësi të madhe mban edhe aparati i Komitetit Qendror të Partisë, i cili duhej të kapte më mirë e në kohën e duhur, problemet e drejtimit e të organizimit, veçanërisht në fushën e ekonomisë dhe t'u siguronte komiteteve të Partisë të rretheve një ndihmë më të kualifikuar dhe efektive.

Shokë,

Viti 1980 është viti i fundit i pesëvjeçarit të gjashtë dhe, si i tillë, ai shënon cakun e arritjeve dhe të përpjekjeve të popullit tonë në plotësimin e detyrave ekonomike, që miratoi Kongresi i 7-të i Partisë, si dhe pikën e nisjes për pesëvjeçarin e ri 1981-1985, të cilin po e hartojmë më të përgatitur nga të gjitha pikëpamjet. Sipas projektplanit të vitit 1980, në krahasim me vitin 1979, produkti shoqëror parashikohet të rritet rreth 10,7 për qind, të ardhurat kombëtare — 11,7 për qind, prodhimi i përgjithshëm industrial — 8,6 për qind dhe ai bujqësor — 17,8 për qind, vëllimi i investimeve — 7,6 për qind, rendimenti i punës në industri — 4,2 për qind, të ardhurat e buxhetit — 3,2 për qind etj.

Realizimi me sukses i detyrave të vitit 1980, sikurse u tha më lart, kërkon, në radhë të parë, përmirësimin e punës së Partisë dhe të levave të saj për rritjen e mobilizimit të masave punonjëse dhe për forcimin e drejtimit e të organizimit të punës në çdo hallkë e në çdo qelizë të ekonomisë. Krahas masave që duhen marrë për të siguruar realizimin e detyrave nga çdo ndërmarrje, çdo kooperativë e rreth dhe në të gjithë zërat e treguesit e prodhimit, ekonomikë e financiarë, plotësimi i planit në naftë, në bujqësi dhe në tregtinë e jashtme mbetet detyra kryesore, ku duhet përqendruar vëmendja e gjithë organeve dhe organizatave të Partisë, e organeve shtetërore e ekonomike dhe e organizatave të masave.

Në vitin 1980, në krahasim me vitin 1979, nxjerrja e naftës parashikohet të rritet 14,3 për qind dhe e gazit natyror e shoqërues mbi dy herë më shumë. Po kështu, gjatë këtij viti, parashikohet që prodhimi i qymyrgurit të rritet 20,4 për qind më shumë. Me realizimin e planit të nxjerrjes së naftës, sipas detyrave të caktuara dhe me kursimin e saj lidhen jo vetëm plotësimi i nevojave në rritje të ekonomisë

për gazoil e karburante të tjera, por edhe plotësimi i planit të eksportit. Prandaj nuk na lejohet të krijojmë asnjë boshllëk, sado të vogël, në realizimin e planit të prodhimit e të përpunimit të naftës.

Kjo shtron detyrën që plani i nxjerrjes së naftës të realizohet kudo, në çdo rreth e në çdo vendburim, të vjetër e të ri, që disiplina teknike e shkencore të zbatohet me rreptësi në të gjitha pusët e shpim-kërkimit e të shpim-shfrytëzimit, që organizimi i punës për të rritur efektivitetin e kërkimeve, për të parandaluar avaritë e ndërprerjet, për zbatimin më gjerë të metodave të dyta e intensifikuese të ngrihen në një nivel më të lartë. Vetëm kështu mund të krijohen kushtet konkrete, si për realizimin e detyrave të vitit 1980, ashtu edhe për të hedhur baza të shëndosha e të qëndrueshme edhe për shtimin e mëtejshëm të prodhimit në vitet e pesëvjeçarit të ri.

Vëmendje e veçantë t'u kushtohet vendburimeve të reja, ku probleme kryesore janë shpimi i puseve në afatet e parashikuara dhe përcaktimi i brezit naftëmbajtës. Masa të veçanta duhet të merren për realizimin e detyrave në qymyrgurin e Valiasit, si dhe të zbatohen dhe të thellohen më tej masat për pakësimin e humbjeve dhe të fuqisë kalorifike të qymyrgurit, në të gjitha minierat, gjatë transportimit e depozitimit. Po kështu, të merren masa dhe për përdorimin sa më racional të qymyrgurit nga të gjithë konsumatorët.

Detyrat e vitit 1980 në fushën e bujqësisë janë të mëdha në të gjitha drejtimet, por veçanërisht në shtimin e prodhimit të drithërave të bukës, i cili parashikohet të jetë 15 për qind më i madh sesa ai që u arrit vitin e kaluar, në prodhimin e patates, që parashikohet të rritet mbi 40 për qind, në të perimeve, që do të rritet rreth 24 për qind, të pambukut — rreth 30 për qind, të frutave e të rrushit — 46-48 për qind, të mishit — 14 për qind.

Faktori përcaktues në realizimin e këtyre detyrave, sikurse e ka theksuar vazhdimisht Partia, është, në radhë të parë, mobilizimi i të gjithë punonjësve të bujqësisë për zbatimin me përpikëri të disiplinës shkencore në të gjitha hallkat e procesit teknologjik. Jo vetëm të pohohen e të propagandohen përvoja e përparuar, rezultatet e larta të arritura nga brigadat, sektorët e ekonomitë bujqësore më të mira të vendit, jo vetëm të zbulohen e të evidentohen gjithë faktorët pozitivë që kanë përcaktuar arritjen e këtyre rezultateve, por e tërë puna politike, organizative e teknike të ngrihet medoemos në nivelin e ekonomive të përparuara dhe të zbatohen ato pa krijuar asnjë këputje e të çarë.

Vëmendja kryesore të përqendrohet, në radhë të parë, në përdorimin më me efektivitet të punës e të bazës mate-

rialo-teknike, për të marrë më shumë prodhime për çdo njësi pune e materiale të përdorura. Është e tepërt të theksojmë se çdo bimë bujqësore e frutore dhe çdo lloj bagëtie ka kërkesa të veçanta e se këto kërkesa duhen parë, duhen ndjekur e duhen realizuar në mënyrë krijuese.

Partia vazhdimisht ka theksuar se bujqësisë duhet t'i vënë shpatullat të gjithë. Me sy kritik duhet ta shikojnë punën e tyre dikasteret, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të gjithë punonjësit e ndërmarrjeve e të institucioneve të ndryshme për plotësimin gjer më një të detyrave që kanë ndaj bujqësisë. Nuk duhet të përsëriten të metat e vërtetuara vitin e kaluar, kur plehrat kimike nuk shkonin në destinacion në kohën e caktuar, kur nuk realizoheshin sipas planit furnizimi i bujqësisë me makineri e me pajisje, me vegla pune e me pjesë ndërrimi, me pompa kullimi e ujitje, me insekticide etj. Organizatat e Partisë, që militojnë në këto institucione e ndërmarrje, të ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm e të vënë para përgjegjësisë gjithë drejtuesit, që detyrimet ndaj bujqësisë t'i plotësojnë në sasinë e në kohën e duhur.

Arritja e niveleve dhe e ritmeve të parashikuara për rritjen e prodhimit, të investimeve, të furnizimit të popullit etj. në një shkallë të madhe varen edhe nga plotësimi një për një i detyrave nga organet e tregtisë së jashtme. Vleftha e mallrave, që prodhuesit do të dorëzojnë për eksport këtë vit, parashikohet të jetë rreth 17 për qind më tepër se plani i vitit të kaluar.

Siç e dimë të gjithë, vendimtar në plotësimin e detyrave të tregtisë së jashtme është realizimi ritmik, në të gjithë zërat dhe me cilësinë e kërkuar të planeve të prodhimeve për eksport. Prandaj organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit në bazë dhe dikasteret qendrore të prodhimit realizimin e detyrave, në këtë fushë, ta konsiderojnë si problem numër një, me rëndësi të veçantë politike dhe ekonomike. Nga ana e saj, Ministria e Tregtisë së Jashtme duhet të përmirësojë vazhdimisht punën, të sigurojë në kohën e duhur kontraktimin dhe evadimin e mallrave të eksportit e të importit dhe me çmime sa më të leverdishme. Komitetet e Partisë të rretheve dhe organizatat-bazë në organet e tregtisë së jashtme nuk duhet të lejojnë asnjë mbulim apo zvogëlim të përgjegjësisë së tyre. Gjatë vitit 1979, janë vërejtur zvarritje e javashllëk nga këto organe.

Përqendrimi i vëmendjes, veçanërisht, në industrinë e naftës e të lëndëve të tjera djegëse, në bujqësi dhe në tregtinë e jashtme, të cilat përbëjnë kycin kryesor prej nga varet plotësimi i planit edhe në degët e sektorët e tjerë, siç ka theksuar

vazhdimisht Partia, nuk do të thotë aspak se në degët e sektorët e tjerë të ekonomisë nuk kemi probleme e preokupacione. Plan i duhet të realizohet frontalisht, në të gjithë zërat e treguesit, sepse ekonomia dhe populli kanë nevojë për çdo gjë dhe, të paktën, për aq sa është vënë në plan.

Këto ishin çështjet kryesore, që menduam të shtrojmë për shqyrtim në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Në raport ato analizohen në frymë të thellë kritike, jo se nuk kemi suksese, përkundrazi, ato përbëjnë karakteristikën e përgjithshme. Por, njëkohësisht, jemi të ndër-gjegjshëm se në punën tonë kemi akoma të meta e dobësi, të cilat do të eliminohen, po të luftojmë më shumë e më mirë. Duke i mënjeluar ato, do të bëhet e mundur që punët tona të ecin gjithnjë e më mirë. Ne i kemi të gjitha mundësitë për të përsosur nivelin e drejtimit e të organizimit të ekonomisë sonë, për të revolucionarizuar më tej metodën dhe stilin në punë. Përvoja e fituar gjatë vitit 1979, si vit jubilar i 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, si dhe ajo që u fitua gjatë likuidimit të pasojave të tërmetit, me siguri, këtë vit, do të ngrihen në një shkallë më të lartë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror shpreh bindjen e plotë se klasa punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore, me pjekurinë politike që i karakterizon e në unitet të çeliktë rreth Partisë, do të shkojnë gjithnjë përpara, të vendosur për të plotësuar e për të tejkaluar edhe detyrat që shtron Partia në këtë Plenum të Komitetit Qendror të saj.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «STADI I ZHVILLIMIT SOCIALIST TË VENDIT AKTUALISHT DHE NË PERSPEKTIVË KËRKN TË PËRMIRËSOHEN MË TEJ DREJTIMI E ORGANIZIMI SHKENCOR I PUNËS SË PARTISË DHE I LEVAVE TË SAJ»

15 janar 1980

Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 14 e 15 janar 1980, pasi shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Stadi i zhvillimit socialist të vendit aktualisht dhe në perspektivë kërkon të përmirësohen më tej drejtimi e organizimi shkencor i punës së Partisë dhe i levave të saj», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Simon Stefani,

V e n d o s i :

1. Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Stadi i zhvillimit socialist të vendit aktualisht dhe në perspektivë kërkon të përmirësohen më tej drejtimi e organizimi shkencor i punës së Partisë dhe i levave të saj».
2. Të porositë organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore dhe të ekonomisë që të marrin të gjitha masat e duhura për të zbrëthyer dhe për të vënë në jetë detyrat që dalin prej tij.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KOMITETEVE TË PARTISË
TË RRETHEVE «MBI UDHËHEQJEN E ORGANEVE
DHE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË
NË KËSHILLAT POPULLORË»**

21 janar 1980

Partia jonë, duke e çmuar rolin e rëndësishëm që luajnë këshillat popullore, si organe të pushtetit në bazë, për forcimin dhe për revolucionarizimin e pushtetit popullor, vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në to. Këto probleme Partia i ka shtruar, gjithmonë, si probleme me rëndësi të madhe parimore.

Këshillat popullore, si organe të pushtetit në bazë, në përgjithësi, ushtrojnë veprimtari politike, ekonomike, kulturore, organizative e shoqërore. Kompetencat që u janë dhënë atyre, nga këshilli popullor i rrethit, janë përpjekur t'i zbatojnë. Kohët e fundit, nga këshillat popullore të fshatrave të bashkuara, ka përpjekje për të zgjeruar gamën e veprimtarisë së tyre edhe në drejtim të problemeve ekonomike. Megjithatë, kjo punë nuk po shkon mirë. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë, kohët e fundit, kontrollon veprimtarinë e këshillave popullore të fshatrave, të fshatrave të bashkuara, të lagjeve të qyteteve dhe të rretheve, në drejtim të zbatimit të rolit udhëheqës të organeve dhe të organizatave të Partisë në ta.

Nga këto kontrolle konstatohet se në punën e këshillave popullore ka të meta, dobësi e boshllëqe, të cilat e kanë bërë burimin në konceptet e gabuara, për rolin e për veprimtarinë e këshillave popullore, që vihen re si në komitetet e Partisë dhe në komitetet ekzekutive të rretheve e deri në këshillin popullor të çdo fshati të veçantë. Këto koncepte duken në punën që bëhet për njohjen e kompetencave të këshillave popullore, të cilat njihen shumë pak si nga vetë këshilltarët, ashtu dhe nga shokët drejtues, nga anëtarët e komiteteve ekzekutive e të aparateve të tyre dhe aq më pak nga komi-

tetet e Partisë, nga byrotë dhe nga organizatat-bazë. Si rezultat i këtyre qëndrimeve, ndodh që kompetencat që u japin këshillave popullore në bazë, u merren nga këshillat popullorë më të lartë ose nga komitetet ekzekutive të rretheve.

Vërehet se në organet ekzekutive në rrethe manifestohet tendenca nënvleftësimi ndaj këshillave popullore dhe mbivleftësimi ndaj aparateve të tyre. Ky nënvleftësim vërehet dhe në organe e në organizata të Partisë. Duke qëndruar çështja kështu, organet drejtuese në rrethe, për të gjitha problemet që lindin, sidomos në fshatra, u drejtohen kryesisht organeve ekonomike, për të cilat interesohen, kërkojnë llogari e i ndihmojnë, ndërsa me këshillat popullorë nuk e bëjnë një gjë të tillë. Kjo gjendje arrin deri atje, saqë ka punonjës në aparatet e komiteteve ekzekutive, që shprehen: «Ne nuk kemi pse shkojmë në këshillat popullorë, sepse ata nuk merren me problemet tona».

Këto qëndrime, ndaj këshillave popullore, kanë zënë vend edhe në drejtuesit e ekonomisë, të cilët nuk e ndiejnë forcën e kërkesës së llogarisë dhe të kontrollit nga ana e këshillave popullore, edhe si rezultat i qëndrimeve nënvleftësuese, që mbajnë organet e Partisë dhe ato të pushtetit në rrethe ndaj tyre.

Në punën e byrove dhe të organizatave-bazë të Partisë shfaqet nënvleftësuese kanë zënë vend, sepse në to është rrënjësor mendimi i gabuar se «Përderisa kemi organin ekonomik, nuk ka pse t'i kërkojmë llogari këshillit popullor, mbasi, në të kundërtën, do të bënim një punë të dubluar». Së këtjmi del konkluzioni se në byrotë dhe në organizatat-bazë të Partisë nuk është e qartë që organi ekonomik është organ, i cili drejtohet e kontrollohet jo vetëm nga pushteti në rreth, por edhe nga ai në bazë.

Si rezultat i këtyre koncepteve jo të drejta, që kanë organet dhe organizatat e Partisë për veprimtarinë dhe për rolin e këshillave popullore, puna e tyre në këtë drejtim, deri tani, është kufizuar vetëm me interesimin që bëhet për ta gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe për pjesëmarrjen e kryetarëve të këshillave popullore në disa aktive të organizuara në rreth për probleme që, sipas tyre, «u takojnë edhe këshillave popullore». Nga këto konstatime del se këshillit popullor në fshat nuk ia vë veshin njeri, pra, ai nuk pyetet. Dhe kjo vjen se atë nuk e vlerëson Partia në bazë, e cila, siç duket, ka harruar ç'është pushteti i këshillave popullore dhe mbështetet vetëm e vetëm te kryesia e kooperativës dhe te kryetari i kooperativës bujqësore.

Shokët e udhëheqjes së Partisë në bazë dhe njerëzit e pushtetit, siç duket, kanë harruar se këshillat popullorë të

fshatrave dhe të fshatrave të bashkuara kanë shumë detyra që duhet të kryejnë, të cilat, përveç të tjerave, kanë të bëjnë me ruajtjen dhe me administrimin e pronës socialiste, me problemet financiare në përgjithësi e jo vetëm të kredive që jep shteti. Këshilli popullor mbikëqyr punën e mësuesit, të mjekut e të shumë kuadrove të tjerë, që punojnë në juridiksionin e tij administrativ. Po nuk i kreu këto detyra këshilli popullor në fshat, atëherë pushteti në bazë nuk mund të jetë operues.

Qëndrimet ndaj këtyre problemeve, të cilat janë ngritur edhe herë të tjera, duhet të korrigoohen medoemos se, në qoftë se ato nuk vihen në rrugë të drejtë dhe me tërë kompetencat, pushteti popullor në bazë nuk mund të ekzistojë dhe ky kthehet në një pushtet teknokratik e burokratik. **Të kemi kujdes nga rreziku i këtij devijimi parimor.**

Për t'i vënë këshillat popullorë në vendin e tyre, që ata të luajnë me të vërtetë rolin si organe të pushtetit në bazë, që ky pushtet në bazë të jetë operues, është e domosdoshme që në punën e organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë t'i jepet përparësi punës me këshillat popullorë. Është e nevojshme që në planet e punës të këtij viti, për forumet udhëheqëse të Partisë në rrethe, të parashikohen probleme dhe analiza për këshillat popullorë, po ashtu edhe për punën e byrove të organizatave-bazë të Partisë për udhëheqjen në këshillat popullorë. Në komitetin e Partisë të rrethit një nga sekretarët të mbulojë drejtpërsëdrejti veprimtarinë e këshillave popullorë dhe kjo veprimtari, medoemos, duhet të jetë objekt i punës së gjithë aparatit të komitetit të Partisë.

Në këtë çështje rëndësi të veçantë ka **propaganda e Partisë**. Ajo duhet të trajtojë problemin e këshillave popullorë, si leva kryesore të Partisë në realizimin e detyrave të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit dhe në udhëheqjen konkrete të organeve dhe të organizatave të Partisë ndaj tyre.

Për forcimin e rolit të këshillave popullorë, një rëndësi të dorës së parë ka edhe **problemi i kuadrit**, që zgjidhet në ta. Të mbahet mirë parasysh që njerëzit, të cilët do të zgjidhen në këshillat popullorë, sidomos kryetarët e këshillave popullorë të fshatrave të bashkuara, të jenë të zotë e drejtues të aftë.

Partia në rreth duhet të tregojë kujdes të veçantë lidhur me punën që bëjnë komiteti ekzekutiv dhe aparati i tij në drejtimin e këshillave popullorë. Është nevojë e domosdoshme që me këshillat popullorë të merret komiteti ekzekutiv i rrethit dhe i gjithë aparati i tij dhe jo si deri tani që kjo punë i është lënë kryesisht seksionit të organizimit. Komiteti ekzekutiv i këshillat popullor të rrethit të vendosë lidhje të drejt-

përdrejta me këshillat popullorë të fshatrave të bashkuara e të fshatrave të veçanta dhe t'i drejtojë ato në mënyrë konkrete e të vazhdueshme. Të ndihmohen këshillat popullorë për drejtimin e ekonomisë, sidomos në kooperativat bujqësore, për t'i marrë më mirë në dorë këto probleme, sipas kompetencave që u janë dhënë.

Për të realizuar këto detyra kaq të rëndësishme është nevojë urgjente që komiteti ekzekutiv, nën udhëheqjen e Partisë, të organizojë në mënyrë të menjëhershme njohjen e kompetencave për të gjitha shkallët e këshillave popullorë dhe të korrigojen menjëherë kufizimet e paligjshme të kompetencave të tyre.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të sigurojnë një udhëheqje të plotë e të pandarë mbi këshillat popullorë, nga rrethi në bazë, dhe të punohet në mënyrë të tillë që të riparohet sa më parë dëmi i madh, që i është sjellë punës së Partisë në këtë drejtim.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR GJITHË ORGANIZATAVE-
-BAZË TË PARTISË «MBI FORCIMIN E UDHËHEQJES SË
PARTISË NË BASHKIMET PROFESIONALE PËR
REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT
TË SHITËTIT PËR VITIN 1980»**

26 shkurt 1980

Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale, në fillim të këtij muaji, shqyrtoi dhe përcaktoi detyrat që dalin nga Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të Partisë për realizimin e planit ekonomik të shtetit të vitit 1980, vit i fundit i pesëvjeçarit të gjashtë.

Veprimtaria e bashkimeve profesionale do të përqendrohet në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, në atë të naftës, të bujqësisë, të minierave, të ndërtimit dhe të eksportit. Veçanërisht, ato do të luftojnë për të forcuar disiplinën e punës, të planit dhe atë tekniko-shkencore, regjimin e kursimit të lëndës së parë e ndihmëse dhe të karburanteve, për të përhapur shembullin e punëtorëve pararojë dhe përvojën e përparuar, për të respektuar ligjet e shtetit për kushtet e punës e të sigurimit teknik.

Organizatat e Partisë duhet të njihen me këto detyra, me qëllim që të udhëheqin luftën e bashkimeve profesionale për plotësimin e tyre me sukses. Ato duhet të ndihmojnë që çdo organizatë e bashkimeve profesionale të konkretizojë detyrat mbi bazën e problemeve që preokupojnë ndërmarrjen e të organizojë punën për sigurimin e për mobilizimin e klasës punëtoresh dhe të punonjësve të tjerë, për t'i bërë ata sa më të ndërgjegjshëm për detyrat që duhet të realizojnë në fuqishën e prodhimit.

Në mbledhjen e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale u vu në dukje se në mjaft ndërmarrje e reparte janë arritur rezultate të mira në realizimin e të gjithë treguesve të planit, se komunistët, me shembullin e tyre personal, udhë-

heqin punëtorët, ata janë të parët që venë në punë dhe largohen të fundit, punojnë në frontet më të vështira dhe bëjnë përpjekje të vazhdueshme edhe për rritjen e për kualifikimin profesional dhe arsimor. Por, gjithashtu, disa nga diskutantët bënë vërejtje se ka edhe komunistë e kuadro, që nuk mili-tojnë si duhet në veprimtarinë e bashkimeve profesionale e që nuk janë kurdoherë shembull. Ka prej tyre që edhe në mbledhje nuk venë, edhe në diskutime nuk marrin pjesë aktive. Disa drejtues të ndërmarrjeve nuk i vlerësojnë si duhet rolin dhe forcën e madhe të bashkimeve profesionale, nuk ngrenë para tyre probleme që preokupojnë prodhimin e nuk japin llogari për punën e tyre, si anëtarë të kësaj organizate.

Këto janë vërejtje e kritika të drejta, që duhen vlerësuar me tërë seriozitetin e duhur. Atje ku ka shfaqje të kësaj natyre, organizatat e Partisë nuk duhet të heshtin as t'i lënë ato të kalojnë pa u ndier. Partia dhe shoku Enver Hoxha kanë theksuar shumë herë se komunistët e kuadrot, kudo që janë, kudo ku punojnë e jetojnë, duhet të çojnë te masat direktivat e vendimet e Partisë e t'i sqarojnë për detyrat që u dalin, të jenë shembull për punonjësit e të lidhur ngushtë me ta, të konsultohen e të dëgjojnë zërin e tyre.

Asnjë komunist e asnjë kuadër nuk duhet të harrojë se është anëtar i bashkimeve profesionale. Pjesëmarrja e tyre aktive në këtë organizatë nuk është fakultative, por një detyrë që ka për qëllim të fuqizojë këtë levë të fuqishme që lidh Partinë me klasën punëtoresh dhe me punonjësit e tjerë, që e ndihmon atë në edukimin e në mobilizimin e tyre për ndërtimin e socializmit e mbrojtjen e atdheut. Sa më mirë të punojnë komunistët dhe kuadrot në bashkimet profesionale, aq më shumë do të gjallërohen ato, aq më lart do të qëndrojnë në nivelin e misionit e të detyrave që u ka ngarkuar Partia.

Në mbledhjen e Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale u bë dhe një vërejtje tjetër e drejtë e me rëndësi. Disa specialistë, inxhinierë, ekonomistë, planovikë e të tjerë nuk ndihmojnë si duhet për të nxitur mendimin krijues të punëtorëve, për t'u hapur më shumë horizont për ligjet ekonomike, për problemet e prodhimit, të teknikës, të shkencës e të teknologjisë. Ka prej tyre që bëjnë një punë të mbyllur, që nuk e kuptojnë si duhet se, pa pjesëmarrjen e klasës punëtoresh e të masave punonjëse, nuk mund të ecë përpara prodhimi e të zhvillohet me sukses revolucioni tekniko-shkencor. Organizatat e Partisë e drejtuesit e ndërmarrjeve duhet të kujdesen që personeli inxhiniero-teknik të lidhet ngushtë me punëtorët, të jetë aktiv në veprimtarinë e bashkimeve profesionale, t'i ndihmojë punëtorët e të ndihmohet prej tyre. Ky personel është një forcë e madhe, që duhet e mund të

kontribuojë më shumë e të luajë një rol më të madh në përmirësimin e veprimtarisë edukuese e mobilizuese të bashkimeve profesionale, për të çuar përpara prodhimin dhe për të realizuar sa më mirë detyrat e planit ekonomik të shtetit.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se organizatat e Partisë, komunistët, kuadrot dhe specialistët, gjithë punëtorët e punonjësit e tjerë do të mobilizohen me të gjitha forcat për ta bërë vitin 1980, vit të një pune sulmuese për të realizuar me sukses detyrat e planit të shtetit në të gjithë sektorët e në të gjithë treguesit e tij, se bashkimet profesionale, të udhëhequra nga Partia, duke përmirësuar stilin dhe metodën e tyre të punës e duke forcuar bashkëpunimin me organizatat e tjera të masave, do t'i plotësojnë më së miri detyrat që dalin nga vendimet e Plenumit të 7-të të KQ të Partisë.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

Simon Stefani

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH «MBI DISA ÇËSHTJE E DETYRA PËR PËRSOSJEN E MËTEJSHME TË STAZHIT TË KANDIDATIT TË PARTISË»

24 prill 1980

Sekretariati i KQ të PPSH, në mbledhjen e datës 24 prill 1980, shqyrtoi relacionin e paraqitur nga aparati i Komitetit Qendror «Mbi përvojën, mbi disa çështje që dalin dhe mbi detyrat për zbatimin më të mirë të Statutit dhe të udhëzimeve të Komitetit Qendror të Partisë për stazhin e kandidatit të Partisë».

Nga analiza doli se, kudo, komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë kanë përvojë të mirë në punën me kandidatët e Partisë dhe punojnë me kujdes për të rritur efektivitetin e stazhit, si një kohë prove, kalitjeje dhe përgatitje të gjithanshme, para se kandidati të pranohet anëtar partie. Për këtë qëllim, pas Kongresit të 7-të të Partisë, kudo janë bërë përpjekje për ta përsosur më tej këtë sistem të aprovuar kalitjeje revolucionare.

Përvoja tregon, gjithashtu, se kërkesat e Statutit të Partisë dhe udhëzimet e Komitetit Qendror e kanë vënë stazhin e kandidatit mbi një bazë më të organizuar dhe puna më e mirë për zbatimin rigoroz e krijues të tyre mbetet një nga kushtet kryesore për përsosjen e mëtejshme të tij.

Megjithatë, për një punë më të mirë në të ardhmen, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë vendosi të mbahen parasysh këto porosi e detyra:

1. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, si dhe çdo komunist të thellohen më tej në kuptimin dhe në rëndësinë ideopolitike e organizative që ka stazhi i kandidatit të Partisë për cilësinë e pranimeve në Parti, si një kohë prove, që

vërteton nëse kandidati është në gjendje të mbajë me nder titullin e lartë të anëtarit të Partisë.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të zbatojnë, gjithnjë e më mirë, udhëzimet e Komitetit Qendror të Partisë për kryerjen e stazhit të kandidatit. Ato të luftojnë kundër çdo koncepti e qëndrimi liberal, si dhe ndaj presioneve e ndërhyrjeve, që bëhen, herë-herë, nga disa administrata e kuadro për aplikimin e kërkesave më minimale që kanë udhëzimet për stazhin.

2. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë të rritin më tej kujdesin për kandidatët e Partisë, gjatë tërë kohës së stazhit, duke punuar kolektivisht e individualisht me ta, duke ndjekur nga afër e në dinamikë gjithë jetën e veprimtarinë e tyre, në punë e jashtë saj. Puna aktive e lodhshme dhe puna ideopolitike e vazhdueshme dhe e kontrolluar janë të domosdoshme.

Komitetet e Partisë, më mirë se deri tani, të përqendrojnë vëmendjen, ndihmën e kontrollin për të rritur rolin e organizatave-bazë të Partisë në punën me kandidatët. Organizatat-bazë të Partisë të përmirësojnë kujdesin dhe punën e gjithanshme për edukimin e kandidatëve. Në këtë drejtim, të konceptohet më mirë edukimi i tyre dhe puna që duhet bërë nga ana e organizatave-bazë dhe e çdo anëtarit të Partisë për këtë qëllim. Kujdesi për kandidatët e Partisë duhet parë më gjerë, jo vetëm në punën politike dhe ideologjike, që bëhet tok me anëtarët e Partisë dhe në atë që bëhet në mënyrë të diferencuar me ta, por edhe në ndihmën që u duhet dhënë atyre në drejtim të realizimit të planit, të normave, të kualitetit të punës e të prodhimit, të disiplinës në punë, në përvetësimin e zënatit, në sjelljen dhe në aktivitetin shoqëror, në kohën e lirë etj. Një interesim i tillë për këto probleme të bëhet, në radhë të parë, edhe nga vetë kandidatët e Partisë.

Ky interesim të jetë i përditshëm dhe çdo vit organizatat e Partisë të gjykojnë në bazë të tyre, duke i bërë edhe një karakteristikë kandidatit, e cila të vendoset në dosjen e tij. Në fund të stazhit, nga tërësia edhe e këtyre të dhënave dhe nga çdo kërkesë tjetër, në bazë të Statutit dhe të udhëzimeve të Partisë, të gjykohet e të vendoset pranimi ose jo i tij në Parti.

3. — Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të interpretojnë drejt dhe në mënyrë krijuese kërkesat e Statutit dhe udhëzimet e Komitetit Qendror të Partisë për stazhin. Duke luftuar kundër shfaqjeve liberale, njëherësh të luftohet edhe kundër shfaqjeve të shabllonizmit dhe të zbatimit mekanik e standard të tyre.

Veçanërisht, të realizohet sa më thellë dhe mirë parimi

i gjykimit individual, lidhur me vendin dhe me kohën e stazhit, me punën e tyre në prodhim, me objektivat që u caktohen etj.

4. — Më mirë se deri tani, si në terren, dhe në ushtri, për kalitjen e tyre, kandidatët e Partisë nëpunës të dërgohen të bëjnë stazhin, sidomos, në veprat e mëdha, por edhe në kooperativat bujqësore e në punë të tjera krahu, si: në miniera, në ndërtim, në ndërmarrje bujqësore etj., sa më afër bazës. Puna në prodhim, për aq kohë sa caktohet, sipas udhëzimeve që kemi, të bëhet në frontet kryesore, në punë me normë ose me ditë-punë dhe shpërblimin për këtë kohë ta marrin sipas punës që bëjnë.

Organizatave-bazë të Partisë dhe kolektivat punonjës, ku bëjnë stazhin kandidatët, të kujdesen për kalitjen e tyre dhe të mos lejojnë qëndrime liberale, gjykime sentimentale e shfaqje familjariteti, që ndikojnë negativisht në kalitjen e kandidatëve të Partisë.

5. — Duke gjykuar individualisht, në raste të veçanta, shoqet arsimtare, që janë gra të martuara, pavarësisht nga cikli i shkollës, kur pranohen kandidate partie, mund ta bëjnë stazhin në profesionin e vet edhe në shkollën ku pranohen, por, në këto raste, gjatë kohës trevjeçare të stazhit të bëjnë jo më pak se 9 muaj punë drejtpërdrejt në prodhim.

6. — Të lejohet dërgimi i kandidatëve të Partisë nëpunës në kurse perfeksionimi ose edukimi 3-9-mujore, brenda vendit, si: në ato të bashkimeve profesionale, të gruas, ushtarake etj.

7. — Vendi i stazhit të mos kondicionohet në mënyrë kategorike me çfarëdo funksioni. Në raste të rralla, kur gjykohet me vend, mund të bëhet ndonjë përjashtim, por gjithnjë vetëm pasi të merret miratimi, të paktën nga një sekretar i Komitetit Qendror të Partisë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen komitetet e Partisë dhe aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI I 8-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 24-25 qershor 1980

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 24 e 25 qershor 1980, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të Partisë, shoku Ramiz Alia.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Në mbyllje të punimeve të Plenumit të 8-të të KQ të PPSH, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «TË NGREMË NIVELIN E PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE TË RITIM EFEKTIVITETIN E SAJ PËR ZHVILLIMIN AKTUAL E PERSPEKTIV TË VENDIT»

25 qershor 1980

Partia jonë, duke qenë plotësisht e ndërgjegjshme për rolin e madh të shkencës në zhvillimin e forcave prodhuese, në forcimin e mbrojtjes, në përparimin arsimor e kulturor të njerëzve, përgjithësisht në ndërtimin me sukses të socializmit, i ka kushtuar asaj, që në fillim, një kujdes të veçantë dhe sukseset janë me të vërtetë madhështore.

Po të kemi parasysh Shqipërinë e vjetër, po të kemi parasysh nga jemi nisur, mund të themi se në fushën e shkencës e të teknikës është realizuar një revolucion i vërtetë, që i ka kapërcyer etapat e tij me hapa gjigantë. Krijimi dhe zhvillimi i shkencave të reja shqiptare përfaqësojnë një fitore të madhe të Partisë e të popullit tonë.

Gjatë viteve të pushtetit popullor, shkenca, nga një punë e ngushtë e disa personave të veçantë, u shndërrua në një veprimtari të gjerë, që organizohet e zhvillohet me plan nga shteti socialist. Ajo zhvillohet në organizma të shumtë në bazë, në rrethe e në qendër, siç janë bërthamat e këshillat shkencorë, byrotë teknike e teknologjike, katedrat e shkollave të larta, institutet e profilizuara dhe Akademia e Shkencave. Në të gjithë këta organizma punojnë një numër i madh kuadros, specialistësh e punëtorësh të përparuar. Rreth tyre aktivizohen shumë të tjerë, duke u dhënë studimit dhe eksperimentimit shkencor një karakter të gjerë masiv.

Shkenca tona janë përshkuar kurdoherë nga partishmëria proletare dhe kanë milituar për vijën dhe për ideologjinë e Partisë. Ato janë zhvilluar në lidhje të ngushtë me jetën e me

prodhimin dhe janë vënë plotësisht në shërbim të ndërtimit socialist të vendit dhe të fuqizimit të mbrojtjes së atdheut.

Është një fakt i pamohueshëm që në realizimet madhështore, që janë arritur në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës socialiste, ne shohim të mishëruar jo vetëm vijën e drejtë të Partisë e punën krijuese të masave punonjëse, por edhe kontributin e shquar të mendimit teknik e shkencor të studiuesve e të kërkuesve tanë.

Me forcat e bashkuara të specialistëve, të teknikëve e të punëtorëve të talentuar janë kryer studime të rëndësishme në fushat më të ndryshme të ekonomisë, të kulturës e të mbrojtjes. Njerëzit tanë të shkencës e të teknikës projektojnë e ndërtojnë tani vepra të ndërlikuara e të mëdha hidroenergjetike të nivelit të sotëm botëror, zbulojnë e shfrytëzojnë pasuritë e nëntokës, ndërtojnë objekte industriale e vepra bonifikimi, prodhojnë makineri për bujqësinë, industrinë, ndërtimin, transportin etj.

Edhe shkencat shoqërore, të udhëhequra nga Partia dhe nga ideologjia e saj, kanë dhënë një kontribut me vlerë në sqarimin e në argumentimin e ligjësive të shoqërisë socialiste e të zhvillimit të sotëm botëror, kanë demaskuar pikëpamjet e praktikat borgjeze e revizioniste dhe kanë mbrojtur kurdoherë parimet e marksizëm-leninizmit. Ato kanë bërë një punë të madhe për njohjen e thellë dhe trajtimin shkencor të historisë së popullit tonë, të kulturës, të gjuhës e të traditave të tij. Shkencat shoqërore kanë ndihmuar Partinë në gjithë punën e luftës e saj për arsimimin e për edukimin komunist të brezit të ri e të punonjësve, për përsosjen e tërë superstrukturës së shoqërisë sonë socialiste.

Tani është nevoja ta çojmë punën shkencore edhe më përpara. Në Kongresin e 7-të të Partisë shoku Enver ka theksuar se

«Stadi aktual i zhvillimit të vendit dhe detyrat e mëdha që kemi përpara, kërkojnë që studimet e kërkimet shkencore të shndërrohen në metodë të përgjithshme që të përshkujë e të paraprijë çdo punë, që të ndihmojë efektivisht për zgjidhjen e problemeve aktuale e perspektive të ndërtimit të socializmit e të mbrojtjes së atdheut»¹.

Veçoria më e rëndësishme e këtij stadi të zhvillimit tonë, veçanërisht të ekonomisë, është thellimi i procesit të zhvillimit të saj intensiv. Kjo e bën edhe më të domosdoshme nevojën e mbështetjes fort në shkencën e në teknikën e përparuar, në

¹ Shih në këtë vëllim, f. 127.

njohjen e në zbatimin në jetë të rezultateve të tyre, në përdorimin e teknikave, të teknologjive dhe të metodave të reja shkencore në të gjithë sektorët e prodhimit e të ndërtimit.

Industria jonë e re është e pajisur me një teknikë e teknologji ku zbatohen ligjet e shumë shkencave. Si rrjedhim, shfrytëzimi dhe efikasiteti maksimal i saj, drejtimi e funksionimi i mirë mund të realizohen vetëm duke u mbështetur, gjithnjë e më mirë, në njohuri të thella tekniko-shkencore. Zbulimi dhe shfrytëzimi i naftës, i gazit, i qymyrgurit dhe i mineraleve të ndryshme të vendit varen drejtpërdrejt nga njohja dhe nga përdorimi me aftësi i të dhënave të një sërë shkencash natyrore e teknike, të metodave të tyre të përparuara. Rendimentet e larta të kulturave bujqësore e të prodhimeve blegtorale, që ne kërkojmë të arrijmë, mund të merren vetëm duke u mbështetur dhe duke zbatuar në prodhimin e gjerë të dhënat e shkencave biologjike, agroteknike, agrokimike, zooteknike, veterinare etj. Në tërësi, ekonomia jonë është bërë jo vetëm një ekonomi e madhe e komplekse, por edhe një fushë e gjerë e veprimit të shkencës. Kjo do të thotë se sot nuk ka më asnjë sektor apo degë të saj ku mund të punohet e të drejtohet me empirizëm, me koncepte e praktika të vjetra artizanale. Kudo kërkohen kulturë e dije të gjera, studime të thella e disiplinë e fortë shkencore.

Nevojën e ngutshme të zhvillimit e të thellimit të punës studimore e kërkimore, të revolucionit tekniko-shkencor e diktojnë edhe kushtet e veçanta, në të cilat populli ynë ndërton socializmin. Shqipëria është sot i vetmi vend që ndërton shoqërinë e re socialiste, jo vetëm i rrethuar nga bota kapitalisto-revizioniste, por edhe pa marrë asnjë ndihmë ekonomike e kredi nga jashtë.

Në këto situata, parimi i mbështetjes në burimet e brendshme materiale e njerëzore nuk mund të zbatohet pa zhvilluar e pa thelluar revolucionin tekniko-shkencor. Për këtë është e nevojshme të rritet besimi në njerëzit tanë, në aftësitë e tyre krijuese, të nxitet e të mbështetet mendimi i tyre shkencor e inovator, të inkurajohet e të përkrahet çdo iniciativë që çon përpara prodhimin.

Detyra të mëdha shtrun përpara nesh plani i ri pesëvjeçar që jemi duke hartuar. Ky është plani i parë pesëvjeçar që ne do të hartojmë e do të zbatojmë, duke u mbështetur vetëm në forcat tona. Kjo është, pa dyshim, një fitore e madhe, që dëshmon për drejtësinë e vijës së Partisë, për zhvillimin e një ekonomie të pavarur, kusht i domosdoshëm për forcimin e për sigurimin e pavarësisë politike të vendit.

Nga llogaritjet paraprake del se në pesëvjeçarin e ardhshëm fondet që do të përdoren për investime prodhuese e

për shërbimet e ndryshme janë më të mëdha se në çdo pesëvjeçar tjetër, duke përfshirë edhe kreditë e përdorura. Në pesëvjeçarin 1981-1985, rreth 50-70 për qind e shtesës së prodhimit, në degë të ndryshme të ekonomisë, do të arrihet nga rritja e rendimentit të punës, 65 për qind e të ardhurave neto të ndërmarrjeve do të sigurohet nga ulja e kostos së prodhimit dhe 85 për qind e shtesës së prodhimit do të realizohet nga shfrytëzimi i aftësive prodhuese ekzistuese dhe nga rikonstruksioni i tyre.

Për plotësimin me sukses të detyrave të mëdha, që do të shtrojë plani i shtatë pesëvjeçar, faktorë vendimtarë janë puna e ndërgjegjshme, krijuese dhe me rendiment të lartë e punonjësve tanë, ngritja e nivelit të punës drejtuese e organizuese të organeve, të organizatave të Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë. Por në pesëvjeçarin e 7-të, siç ka thënë shoku Enver, si asnjëherë tjetër detyra të mëdha dalin për zhvillimin e thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Nga zhvillimi i tij varet direkt dhe në një shkallë të madhe plotësimi i objektivave të prodhimit, të ndërtimit, të mbrojtjes, të rendimentit dhe në shumë fusha të tjera.

Në tërë punën e luftën tonë për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës kombëtare duhet të mbajmë, gjithashtu, parasysh se sot në botë zhvillohet një revolucion i madh e i paparë tekniko-shkencor. Ky revolucion që i ka përfshirë të gjitha fushat e jetës, po sjell ndryshime të mëdha në bazën teknike e teknologjike të prodhimit. Këtej del nevoja e njohjes së të rejave të shkencës e të teknikës bashkëkohore, del detyra që njerëzit tanë të rritin përpjekjet për të studiuar, për të mësuar, për t'u azhurnuar jo vetëm me atë çka bëhet brenda vendit, por edhe në botë. Kjo do të na ndihmojë, nga njëra anë, që ato vepra, objekte, linja e pajisje etj., që do të ndërtojmë e do të prodhojmë vetë, t'i bëjmë me një teknikë e teknologji sa më të përparuar dhe, nga ana tjetër, të jemi në gjendje për të marrë nga jashtë atë çka është më e mirë, më e përshtatshme e më e leverdishme dhe të dimë ta përdorim me kapacitet të plotë e me rendiment të lartë.

Janë të gjitha këto rrethana e arsye që i shtojnë zgjerimin e thellimin e punës kërkimore-shkencore si detyra aktuale e imperative. Tani ne kemi mundësi reale më të mëdha, një bazë materiale-teknike shumë të fuqishme, e cila krijon kushtet e nevojshme që t'i vëmë vebes objektiva më të lartë, kemi një armatë të tërë kuadrosh e punonjësish të kualifikuar, të aftë për të marrë përsipër e për të kryer detyra më të mëdha. Çështja shtrohet që përvojën e pasur, të grumbulluar në fushën e organizimit e të drejtimit të veprimtarisë shkencore, ndërtuese e prodhuese, ta përdorim me efikasitet të

plotë, që mundësitë që ofrojnë ekonomia dhe rendi ynë socialist, t'i shfrytëzojmë deri në fund.

Për t'u dhënë shkencës dhe gjithë revolucionit tekniko-shkencor një shtytje të vrullshme përpara, është e nevojshme të krijohen kudo një kuptim dhe vlerësim i drejtë i punës kërkimore e studimore, që forcat e shumta teknike e shkencore të angazhohen e të përdoren si duhet në punë të kualifikuar. Një luftë e vendosur duhet të zhvillohet, njëkohësisht, me konceptet e ngushta e artizanale, që, shpesh, frenojnë zhvillimin e mendimit teknik e shkencor dhe futjen e metodave të reja në prodhim. Përvoja e përparuar, në të cilën mishërohen gjerësisht ligjet e shkencave, duhet të përgjithësohet e të zbatohet kudo e me këmbëngulje.

Mbajtja e këtij Plenumi të Komitetit Qendror të Partisë, orientimet e detyrat që ai do të shtrojë, do t'u japin, me siguri, një impuls të ri tërë punës kërkimore-shkencore dhe zbatimit të arritjeve të saj, në të gjitha fushat e jetës, për të ngritur në një nivel më të lartë prodhimin, mbrojtjen, kulturën dhe edukimin e njerëzve tanë.

Zhvillimi i ekonomisë kërkon përvetësimin dhe zbatimin e gjerë të shkencave teknike e natyrore

Politika e Partisë për zhvillimin e industrisë dhe të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë, për ngritjen e mirëqenies së popullit dhe për fuqizimin e mbrojtjes së atdheut është mbështetur dhe mbështetet në shfrytëzimin e pasurisë natyrore të vendit.

Duke ndjekur këtë politikë të drejtë e largpamëse, në vendin tonë janë zbuluar e janë shfrytëzuar shumë burime të rëndësishme lëndësh të para e materialesh të ndryshme, të nevojshme për zhvillimin e të gjitha degëve kryesore të ekonomisë. Kundrejt vitit 1960, në vitin 1980 parashikohet të nxirret më shumë: naftë bruto 1,2 herë, gymyrguri 4,7 herë, mineral kromi 3,1 herë, mineral bakri 8,8 herë, mineral hekur-nikeli 2,4 herë etj. Krahas këtyre, ka filluar e po rritet nxjerrja edhe e disa mineraleve të tjera, mjaft të nevojshme për ekonominë.

Në këtë punë kolosale, që kanë bërë populli dhe Partia, një kontribut të çmuar kanë dhënë edhe shkencat teknike e natyrore, të cilat kanë bërë të mundur që të zbulohen e të shfrytëzohen lloje të reja mineralesh të dobishme, të rritet shkalla e përdorimit kompleks të tyre, të përsoset teknologjia e prodhimit dhe të ngrihet niveli i mekanizimit të proceseve të punës.

Por nevojat e sotme dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë

së vendit shtrojnë detyra të reja, edhe më të mëdha, për studimin e rrugëve për shfrytëzimin integral e të dobishëm të lëndëve të para, të lëndëve djegëse dhe të materialeve.

Në pesëvjeçarin e ardhshëm, nga përlllogaritjet paraprake, del se prodhimi industrial rritet 40-42 për qind, kundrejt pesëvjeçarit të gjashtë dhe ai bujqësor — 41 për qind. Arritja e këtyre objektivave është e lidhur me rritjen e zbulimit dhe të nxjerrjes së mineraleve të dobishme dhe të lëndëve djegëse, me shfrytëzimin e me përpunimin e tyre, me përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomikë etj. Nga ana tjetër, do të duhet të sigurohen në vend edhe lloje të reja mineraleve të lëndësh të para, si: hekur pa nikel, qymyre të koksifikueshme, fosforite e bokside më të pasura, argjile zjarrdruuese etj. Për të gjitha këto do të duhet të bëhen studime, kërkime e eksperimentime të niveleve më të larta teknike e shkencore. Në mënyrë të veçantë, studime të thelluara kërkon zbulimi i rezervave të reja të naftës e të gazit, të qymyreve e të kromit, si dhe teknika e nxjerrjes së tyre nga nëntoka.

Fakt është se me gjithë sukseset e arritura në fushën e kërkimit e të zbulimit të rezervave të reja, zona të tëra të vendit janë ende të pakërkjuara si duhet. Ritmi i kërkimit dhe i zbulimit të rezervave të reja nuk u përgjigjet kudo detyrave që shtrohen. Për shkak të nivelit relativisht të ulët të punës kërkimore e shkencore, në naftë nuk janë arritur kurdoherë objektivat për zbulimin e vendburimeve të reja. Kompleksi i punimeve gjeologo-gjeofizike nuk është akoma në nivelin e kërkuar. Ka përfytyrime gjeologjike që nuk vërtetohen në jetë. Teknologjia e shpimit dhe e përvetësimit është akoma prapa arritjeve më të përparuara.

Përpara shkencave tona gjeologo-kërkuese shtrohet detyra të rritet më tej efektiviteti i kërkimeve gjeologjike, i cili është ende i ulët. Ka ndërmarrje e ekspedita të veçanta ku ky tregues është edhe më i ulët. Edhe në kërkimin e naftës e të gazit koeficientet e puseve produktive, kundrejt atyre që shpohen për kërkim, si dhe ai i strukturave gaz-naftëmbajtëse, kundrejt atyre që atakohen, janë akoma të pakënaqshme.

Është e nevojshme që Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe institucionet përkatëse shkencore të marrin masa efikase për të kapërcyer prapambetjen relative në këto drejtime. Në gjithë kompleksin e kërkimit, duhet ngritur niveli jo vetëm i shkencave të mirëfillta gjeologjike, por edhe i atyre kufitare, si: gjeofizika, gjeokimia etj. Është e domosdoshme të përdoren më gjerë metoda të reja të përparuara të studimit e të përgjithësimit shkencor. Gjithashtu, duhet të përgatiten, gradualisht, specialistë e punonjës shkencorë me kualifikim të

lartë, si dhe të planifikohet e të sigurohet baza teknike e materiale e përshtatshme.

Kërkimi dhe zbulimi i rezervave të reja të mineraleve të dobishme është njëra anë e çështjes. Ana tjetër është shfrytëzimi sa më racional i mineraleve tona, pasurimi dhe përpunimi në vend i tyre. Ky orientim i Partisë vë përpara shkencës sonë detyra shumë të rëndësishme e të ngutshme, si në fushën e nxjerrjes, ashtu dhe në atë të industrializimit të mineraleve, me tregues tekniko-teknologjikë dhe ekonomikë të lartë.

Sot, me gjithë përparimet e sukseset që kemi arritur, nuk mund të kënaqemi me shkallën e shfrytëzimit të rezervave minerare. Kështu, për shembull, në vendburimet ranore të naftës, shpesh, merren vetëm 15-18 për qind të rezervave, në ato gëlqerore — 40-50 për qind, në mineralet e ngurta — 80-93 për qind, ndërsa humbjet cilësore të mineraleve arrijnë 8-20 për qind.

Përdorimi racional i rezervave minerare ka të bëjë jo vetëm me brezin tonë, po edhe me brezat e ardhshëm. Prandaj ka ardhur koha të bëhen studime më të plota e vlerësime më të mira edhe për ato lëndë të para, që deri tani konsiderohen të varfra. Këto përfaqësojnë një pasuri të madhe për ekonominë, prandaj të konsiderohen si objekte pune në perspektivë. Shfrytëzimi i këtyre pasurive të mëdha, në të ardhmen, shtrohet para shkencës detyra për të studiuar e për të përsosur teknologjinë e përpunimit të mineraleve të varfra. Organet shtetërore dhe ekonomike të rritin kujdesin për evidentimin, për ruajtjen dhe për stokimin e kësaj pasurie të vlefshme.

Ajo që kërkohet tani e në të ardhmen është të thellohen studimet për përsosjen e teknologjisë së nxjerrjes dhe të pasurimit. Duhet të arrihet që të shfrytëzohen me efektivitet sa më të lartë mineralet, të sigurohet një shkallë rikuperimi rreth 95 për qind të elementeve të dobishme. Pasurimi të shtrihet jo vetëm për disa minerale, si: bakri, kromi, qymyrguri, hekur-nikeli, por për të gjitha mineralet, jo vetëm për ato të varfrat, por, në perspektivë, edhe për ato të pasurat, duke i kthyer në concentrate. Kjo është rrugë me rëndësi për rritjen e efektivitetit ekonomik të industrisë minerare.

Lëndët e para minerare, në pjesën më të madhe të tyre, kanë disa përbërës të dobishëm. Por jo gjithmonë ata shfrytëzohen në mënyrë komplekse. Kështu, duhet studiuar e duhet zgjidhur problemi i shfrytëzimit të kobaltit dhe të nikelit nga minerali i hekur-nikelit. Në uzinat e metalurgjisë me ngjyra, krahas shfrytëzimit të bakrit, të metaleve të çmuara e të selenit, duhet të zgjidhet problemi i marrjes së kobaltit e të telurit, që, në disa raste, kanë vlerë të barabartë me atë të elementeve që shfrytëzojmë.

Një drejtim tjetër i shfrytëzimit në kompleks të lëndëve

të para dhe të materialeve është pakësimi i mbetjeve teknologjike dhe përdorimi sa më i plotë i tyre. Këtij qëllimi do t'i shërbente përdorimi me efektivitetin më të lartë i metodave të reja shkencore për normimin dhe për përdorimin racional të lëndëve të para e materialeve, si dhe zbatimi i proceseve të reja më të përsosura kimike për përpunimin e lëndëve të para, të materialeve dhe të lëndëve djegëse etj. Specialistët dhe teknikët tanë nuk duhet të pajtohen me fakte të tilla që, në mbetjet e fabrikave të pasurimit të kromit, të ketë 10-12 për qind oksid kromi, në mbetjet e pasurimit të qymyrgurit në Valias të ketë, në të ashtuquajturat sterile, rreth 1000 kilokalori për kilogram. Po kështu, ata nuk duhet të pajtohen me shkallën relativisht të ulët të rikuperimit të bakrit dhe të hekur-nikelit, me rrezën e ulët të sheqerit apo të vajit, me shfrytëzimin e ulët të dobi-shëm të pambukut apo të lëkurëve, të sodës apo të karburanteve. Gjithashtu, nuk duhen pranuar koeficientët relativisht të ulët të shfrytëzimit të metaleve në industrinë mekanike, të lëndës drusore në fabrikat e letrës, në mobileri e në ndërtim, të materialeve inerte në ndërtim, të kripës etj., pa përmendur këtu, edhe një herë, koeficientët, jo gjithnjë racionalë, në harxhimin e karburanteve, të qymyreve, të energjisë elektrike etj.

Rëndësi të madhe ka përdorimi i mbetjeve teknologjike, për t'i shndërruar ato në elemente të dobishme. Në këtë fushë ka edhe përvojë pozitive, siç është përdorimi i hirave të TEC-eve dhe i skorjeve të metalurgjisë, i ashklave të gizës, i shkumbëzimeve në Kombinatin Metalurgjik, i pluhurave në metalurgjinë me ngjyra etj. Megjithatë, duhet thënë se jemi larg asaj që kërkohet. Kështu, studime duhet të bëhen për shfrytëzimin e skorjeve e të tymrave në metalurgjinë me ngjyra, për mbetjet në industrinë ushqimore dhe në atë të përpunimit të drurit, për prodhimin e acidit sulfurik nga gazrat e metalurgjisë së bakrit etj.

Në kushtet e ashpërsimit të krizës në botën kapitalisto-revizioniste dhe të bllokadës kundër vendit tonë, kur çmimet e lëndëve të para dhe të materialeve në tregjet e jashtme janë rritur në përmasa të papara, shtrohet si detyrë e rëndësishme të studiohet dhe të zgjidhet problemi i zëvendësimit të lëndëve të para dhe i materialeve të importit me lëndë të para e materiale vendi. Nga shuma e përgjithshme e shpenzimeve në valutë të këtij pesëvjeçari, 2/3 përdoren për të importuar lëndë të para e materiale të ndryshme dhe vetëm 1/3 përdoren për të blerë makineri e pajisje të veçanta e komplete. Prandaj përmirësimi rrënjësor i këtij raporti në të ardhmen, kërkon që të intensifikohen studimet për prodhimin në vend, sidomos, të lëndëve e të plehrave fosfatike, të koksit metalurgjik, të ferro-lidhjeve, të mineralit të manganit, të tullave zjarrduruese, të

rërave kuarcore, të pesticideve e të oligoelementeve për bujqësinë etj.

Gjithashtu, studime më të thella nevojiten për zëvendësimin e lëndës së drurit me lëndë të tjera jodrusore, sidomos në miniera dhe në ndërtim, për zëvendësimin e lëndës djegëse të lëngët me qymyrguri dhe me energji elektrike, si dhe për zëvendësimin e lëndëve të para natyrore me sintetike.

Të gjitha këto janë probleme të mëdha për ekonominë tonë, që kërkojnë interesimin dhe kujdesin e veçantë të dikastereve, sidomos të Ministrisë së Industrisë e të Minerave dhe të Ministrisë së Lehtë dhe Ushqimore, të organeve shtetërore dhe ekonomike, në rreth e në bazë. Duke mënjanuar rutinën dhe duke mos u marrë me probleme të vogla apo thjesht administrative, ato duhet të organizojnë punën dhe të orientojnë specialistët e prodhimit, institutet kërkimore dhe punonjësit shkencorë që, sipas degëve e profileve që kanë, t'u futen një për një këtyre problemeve, t'i zgjidhin ato pjesë-pjesë e sa më parë.

Kjo do të arrihet, kryesisht, duke përmirësuar teknologjinë e prodhimit.

Në këtë fushë janë arritur një varg suksesesh si në përveçësimin e teknologjisë së re, ashtu edhe në përmirësimin e teknologjisë ekzistuese, si: në uzinën e plehrave azotike «Gogo Nushi», në Uzinën e Superfosfatit, në Uzinën e Instrumenteve, në fabrikat e pasurimit të mineraleve etj. Rezultate të mira janë arritur, gjithashtu, në përsosjen e teknologjisë së prodhimit të çimentos, që ka çuar në marka më të larta dhe në rritjen e aftësisë prodhuese. Janë bërë përsosje teknologjike për shtimin e mishit të gjedhit, të shpendëve e të vezëve. Në industrinë e lehtë janë futur procese të reja, si ai i përpunimit të fibrave artificiale etj.

Specialistët, teknikët dhe punëtorët tanë të talentuar, gjithashtu, kanë dhënë një kontribut të çmuar në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme projektuese e zbatuese, në fushën e teknologjisë së prodhimit, në mjaft objekte të lëna në mes të rrugës, ose të sabotuara nga revizionistët kinezë, si dhe në shumë objekte të tjera të ndërtuara me forcat tona, siç janë: uzinat e pasurimit të mineraleve, uzinat e përpunimit të naftës, zgjerimi i Kombinatis të Sheqerit, Fabrika e Përpunimit të Rërave Bituminoze, disa fabrika e linja të industrisë së lehtë dhe ushqimore, të prodhimeve kimike etj.

Por, krahas arritjeve pozitive, në fushën e teknologjisë ka të meta dhe vështirësi të karakterit objektiv e subjektiv, për kapërcimin e të cilave duhet të japin një kontribut akoma më të madh edhe shkencat teknike e natyrore. Uzinat e shkrirjes së bakrit në Kukës e në Rubik, nga shkalla e shfrytëzimit të mineralit dhe e teknologjisë, në përgjithësi, qëndrojnë më prapa

nga ajo e Laçit. Mjaft uzina e ofiçina mekanike kanë koeficient të shfrytëzimit të çeliqueve më të ulët sesa Kombinati i Auto-traktorëve. Ka fabrika e linja në industrinë e lehtë e ushqimore, si: në prodhimin e këpucëve, në përpunimin e qumështit etj., që i kanë të theksuara ndikimet e prodhimit artizanal. Teknologji relativisht të prapambetur ka edhe industria e materialeve të ndërtimit, si: në prodhimin e tullave, të gëlqeres, të pllakave etj.

Problem i madh i ekonomisë, që lidhet drejtpërdrejt me teknologjinë, është përmirësimi i cilësisë së lëndëve të para, i materialeve dhe i prodhimeve të gatshme. Zgjidhja e këtij problemi ka rëndësi të veçantë ekonomike e politike, sepse lidhet, si me plotësimin gjithnjë e më mirë të nevojave të popullit, ashtu edhe me rritjen e mundësisë që mallrat tona të konkurrojnë në tregjet e huaja. Dobësitë e të metat, që vërehen në këtë drejtim, i sjellin dëme të mëdha ekonomisë, sepse, në fund të fundit, mallrat me cilësi të dobët janë humbje vlerash të mëdha materiale e financiare. Tani ekzistojnë mundësi të mëdha materiale e teknike për të bërë një kthesë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve, të ndërtimeve e të shërbimeve.

Përvetësimi dhe zbatimi i plotë i çdo teknologjie janë të lidhur ngushtë me zbatimin e disiplinës teknike dhe shkencore. Mosrespektimi i kësaj discipline, që te ne është një fenomen shqetësues, si: në industri, në bujqësi, në transport etj., e ka bërë në konceptet e vjetra për prodhimin, në shkallën e ulët të kualifikimit, në tërheqjen pas interesit të ngushtë personal, si dhe në mungesën e kontrollit rigoroz për kryerjen e proceseve të ndryshme teknike. Zbatimi i disiplinës shkencore kërkon njohjen e përmbajtjes teorike e praktike të çdo norme, rregulli, procesi apo operacioni, duke e veshur praktikën me dituri shkencore dhe duke forcuar bindjet mbi domosdoshmërinë e zbatimit të këtyre diturive. Kjo është një fushë e gjerë pune për organizatat e Partisë dhe të masave, për organet shtetërore dhe ato ekonomike. Ato, në mënyrë të veçantë, duhet të kujdesen për përhapjen e dijeve tekniko-shkencore në masat, nëpërmjet shkollave, kurseve e formave të tjera, sepse, pa dije të thella, nuk mund të zbatohet disiplina teknike e shkencore.

Në përsosjen e teknologjisë një rol të rëndësishëm luajnë edhe treguesit tekniko-cilësorë të standardeve shtetërore dhe të kushteve teknike, të cilët, në disa raste, nuk shprehin arritjet më të mira dhe mundësitë reale që ekzistojnë. Standardizimi duhet parë e duhet vlerësuar jo si punë thjesht administrative, por si punë e rëndësishme studimore, që përgjithëson arritjet më të mira dhe i çon ato përpara. Është e nevojshme që organet shtetërore, në qendër e në rrethe, t'i rishikojnë ato herë pas here.

Arritja e objektivave, që shtrohen në fushën e përsosjes së teknologjisë, kërkon të aktivizohen më mirë në punën kërkimore e shkencore grupet studimore dhe byrotë teknologjike, gjithë specialistët e prodhimit. Organet shtetërore të studiojnë mundësinë e forcimit e të profilizimit të instituteve teknologjike ekzistuese, si dhe mundësinë e domosdoshmërinë e krijimit të organizmave të rinj studimorë e projektues për të zgjidhur me forcat tona detyrat që dalin për studimin, për eksperimentimin dhe për projektimin teknologjik të veprave industriale, që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e shtatë dhe në të ardhmen. Të merren të gjitha masat e nevojshme që këta organizma shkencorë, teknologjikë, sidomos ata në fushën e kimisë dhe të mekanikës, të sigurohen me kuadro më të kualifikuar e me perspektivë dhe të pajisen me një bazë më të mirë materialo-teknike. Universiteti të marrë masa për ngritjen e cilësisë së përgatitjes të kuadrove të rinj dhe për kualifikimin pasuniversitar, në mënyrë që t'u përgjigjen me kompetencë e me nivel të lartë shkencor kërkesave që shtrohen për përsosjen e teknologjisë në të gjitha fushat. Për të gjitha këto probleme, Këshilli i Ministrave, brenda vitit 1980, të përcaktojë detyrat dhe masat konkrete që duhen marrë.

Krahas përsosjes së teknologjisë, **objekt i rëndësishëm i revolucionit tekniko-shkencor është rritja e shkallës së mekanizimit e të automatizimit të proceseve të punës e të prodhimit.** Në fushën e mekanizimit janë arritur një varg suksesesh. Por, megjithëkëtë, në industri dhe në ndërtim mjaft procese pune kryhen me dorë, në bujqësi gjysma e shërbimeve të bimëve kryhet po në këtë mënyrë, kurse korrja e foragjereve, shpërndarja e plehrave, drenazhimi, mbjellja e fidaneve, korrja e misrit dhe vjelja e shumë prodhimeve bujqësore bëhen, kryesisht, me krahtë. Në prodhimin e përgjithshëm të mjeteve të prodhimit, mjetet e punës zënë vetëm 15 për qind, që është një tregues i ulët. Midis degëve të ekonomisë, e në disa raste edhe midis ndërmarrjeve të së njëjtës degë, ka ndryshime të theksuara në shkallën e mekanizimit, të cilat nuk janë të kushtëzuara nga natyra e punës dhe e procesit teknologjik. Kështu, për shembull, në Minierën e Qymyrgurit në Korçë shkalla e mekanizimit të punimeve është 57 për qind, kurse në atë të Tepelenës — 30 për qind. Në Ndërmarrjen e Përpunimit të Drurit në Fushë-Arrëz transportimi i lëndës së drurit është mekanizuar 77 për qind, kurse në Rrëshen është i pamekanizuar. Në gërmimin dhe në transportimin e dheut Ndërmarrja e Ndërtimit në Berat ka arritur mekanizimin në masën 92 për qind, kurse ajo në Korçë dhe në Elbasan — 45 për qind etj.

Shkenca e teknika duhet të futen më mirë, sidomos në mekanizimin kompleks e sa më të përparuar, për nxjerrjen nga nëntoka të qymyreve, të mineraleve dhe në transportimin e

tyre, për transportimin e lëndës drusore e të prodhimeve bujqësore e blegtorale nga zonat e thyera, me anë të teleferikëve e të mjeteve të tjera më të leverdishme, për ngarkim-shkarkimin e mallrave, për proceset e punës që kryhen akoma me dorë në industri, në ndërtim e në degë të tjera. Me rëndësi të veçantë është mekanizimi kompleks i kultivimit të disa bimëve bujqësore, si: misër, luledielli, pambuk, foragjere etj., gjë që krijon kushte të favorshme për futjen e teknologjive të përparuara.

Ne sot i kemi të gjitha mundësitë që, me përpjekje e me një kujdes më të madh nga ana e dikastereve dhe e ndër-marrjeve ekonomike, të projektojmë e të ndërtojmë mekanizma të shumtë, të thjeshtë në përdorim e të leverdishëm nga ana ekonomike, me qëllim që ata të zëvendësojnë punën e krahut, të rritin rendimentin e punës e cilësinë e prodhimit. Këtij qëllimi i shërben, në një shkallë më të lartë, automatizimi i proceseve të prodhimit. Sistemi automatik i drejtimit ka kohë që është futur në teknologjinë industriale e në fusha të tjera edhe në vendin tonë. Por ai duhet zotëruar më mirë e duhet vënë kudo në funksionim. Njëkohësisht, të rriten përpjekjet për zgjerimin e automatizimit edhe në degë e në sektorë të tjerë të ekonomisë, duke kapërcyer konceptet frenuese se gjoja automatizimi është i parakohshëm.

Zgjerimit e thellimit të revolucionit tekniko-shkencor, në fushën e mekanizimit dhe të automatizimit, organizatat e Partisë t'u kushtojnë një vëmendje të posaçme. Ato të vënë në lëvizje organet shtetërore dhe ekonomike, të nxitin mendimin krijues, novator e racionalizator dhe të aktivizojnë gjerësisht masën e specialistëve, të teknikëve e të punëtorëve tanë.

Në planin e ardhshëm pesëvjeçar parashikohet që rreth 60 për qind e prodhimit të industrisë mekanike ta zërë prodhimi i pajisjeve dhe i makinerive të ndryshme. Në këto kushte, rëndësi të veçantë marrin standardizimi, unifikimi e tipizimi i nyjave dhe i detajeve të veçanta, si dhe specializimi e përqendrimi i prodhimit të tyre, në mënyrë që mjeshtrit, konstruktorët, novatorët dhe të gjithë punonjësit këto prodhime t'i gjejnë të gatshme për t'i futur në makinat e në mekanizmat që ndërtojnë. Për të zgjidhur këto probleme, është e nevojshme të ndërmerren studime më të thelluara dhe masa organizative më efikase.

Detyra të mëdha e me shumë rëndësi dalin sot para shkencës sonë për zhvillimin e bujqësisë, kësaj dege bazë e jetike të ekonomisë sonë. Bujqësia jonë socialiste, në sajë të kujdesit të Partisë dhe të pushtetit popullor, ka hyrë në rrugën e intensifikimit e të modernizimit. Fakti që në ekonomi të veçanta, në gjithë sipërfaqen e mbjellë, është arritur të merren 45-50 kv për ha grurë, 70-75 kv për ha misër, 24-25 kv për ha luledielli,

18-20 kv për ha pambuk, 500-540 kv për ha panxharsheqeri, mbi 80 kv njësi ushqimore për ha, 3 200-3 700 kg qumësht për lopë e në mjaft sektorë e brigada rendimente edhe më të larta, tregon se shkenca bujqësore po zbatohet gjerësisht në prodhim.

Megjithëkëtë, në fushën e bujqësisë ekzistojnë akoma probleme të mëdha, për zgjidhjen e të cilave duhet të japin kontributin e tyre të rëndësishëm edhe shkencëtarët tanë, studiuesit, specialistët dhe eksperimentuesit e shumtë.

Një nga drejtimet kryesore të punës studimore e shkencore në bujqësi është **ruajtja, shtimi e pasurimi i tokës.** Ky problem ka rëndësi të posaçme për faktin se toka është mjeti kryesor i prodhimit në bujqësi.

Gjatë 35 vjetëve janë përfituar 50 mijë ha tokë nga tharja e kënetave, janë hapur 370 mijë ha tokë të reja ose 1,3 herë më shumë sesa sipërfaqja e punueshme që kishte vendi më 1938. Megjithatë, sipërfaqja e tokës së punueshme, gjatë 20 vjetëve të fundit, për çdo frymë të popullsisë, është pakësuar rreth 18 për qind. Duke marrë parasysh se edhe në të ardhmen, për shkak të shtimit të popullsisë me ritme të larta, sipërfaqja e tokës për frymë do të vijë duke u pakësuar, kurse nevojat për prodhime bujqësore e blegtorale do të vijnë vazhdimisht duke u shtuar, hapja e tokave të reja mbetet gjithnjë detyrë e dorës së parë.

Vendi ynë ka akoma shumë tokë për të hapur. Vetëm nëpërmjet përvetësimit të mëtejshëm të masiveve bregdetare, që kanë mbetur jashtë sistemit të bonifikimit e të masiveve të tjera me përbërje ranore, të shtretërve të lumenjve, me anë të mbathjeve e të mënyrave të tjera të përvetësimit, mund të përfitohen disa mijëra ha. Toka ka kudo, sidomos në zonat mallore, por ato duhen studiuar, duhen njohur sa e si janë, në mënyrë që hapja e tyre të bëhet mbi baza shkencore, që ato të mos shkasin e të na ikin, siç ka ndodhur në mjaft raste, duke krijuar vatra të reja erozioni me duart tona.

Prej kohësh, Komiteti Qendror i Partisë ka shtruar detyrën përpara Ministrisë së Bujqësisë, Institutit të Studimit të Tokave dhe organeve shtetërore përkatëse për shpejtimin e përmirësimit të tokave të kripura. Sigurisht, mjaft masa janë marrë, edhe rezultate janë arritur, por a është e pranueshme që në një kohë kur luftojmë të hapim toka të reja edhe në shkëmb, të kemi akoma, në tokat e bonifikuara, 7 000 ha të pashkripëzuara plotësisht, ose që, nga trajtimi joshkencor i procesit të largimit të ujërave të tepërta, të ndodhë edhe fenomeni i rikripëzimit të tyre? Probleme dalin edhe për përmirësimin e tokave acide dhe të atyre me kripëzime magneziale, që zënë disa dhjetëra mijë hektarë. Këto nuk mund të zgjidhen pa kontributin e organeve shkencore të specializuara, pa studime të thelluara e pa projekte të hartuara me nivel të lartë.

Është i njohur fakti se ujërat e lumenjve, çdo vit, bartin e përcjellin në det rreth 60 milionë tonë lëndë të imëta, me vlerë bujqësore, ose mesatarisht rreth 2 000 tonë për çdo km² dhe, në disa pellgje, si: ato të lumenjve Shkumbin, Erzen, Devoll, Seman nga 3 200 deri në 5 700 tonë për çdo km². Kjo është një humbje e madhe dhe e pazëvendësueshme. Prandaj shtrohet si detyrë e ngutshme koordinimi dhe përqendrimi i forcave shkencore të institucioneve të ndryshme dhe të prodhimit për një studim e programim shumëvjeçar për zbatimin e një sistemi kompleks të mbrojtjes së tokës nga erozioni.

Fushë të gjerë studimi përbën rregullimi i regjimit ujqor të tokës. Në këtë drejtim, të thellohen më tej studimet për t'u siguruar bimëve vlagën optimale të nevojshme gjatë gjithë periudhës, sipas tipit të tokës dhe përbërjes fiziko-mekanike të saj. Po kështu, të thellohen studimet për përsosjen e bonifikimit të tokave të ulëta fushore, të sistemit kullues e të rrjetit të drenazhimit të përhershëm, si dhe për sistemimin sipërfaqësor.

Vendi ynë ka pasuri të mëdha ujore. Vëllimi aktiv i ujërave rrjedhëse llogaritet në rreth 31 miliardë m³ ujë në vit, ose 16 mijë m³ ujë për frymë të popullsisë, që është nga më të lartat në Evropë. Ujitja, në krahasim me periudhën e paraqitjes, është shtuar mbi 13 herë, duke i dhënë një shtytje të fuqishme intensifikimit të prodhimit bujqësor. Aftësia ujitëse, në vitin 1979, ka arritur 52 për qind të sipërfaqes së punueshme, duke zënë vendin e parë në Evropë dhe ndër vendet e para në botë.

Vështirësi nga më të ndryshmet janë kapërcyer për të ndërtuar 18 mijë km kanale ujitëse, mbi 600 rezervuarë, sidomos në zona pa burime të rrjedhshme uji etj. Por ujin, këtë pasuri kaq të madhe që na jep natyra, ne duhet ta grumbullojmë, ta ruajmë e ta shfrytëzojmë me nikoqirllëk, që ai të na shërbejë plotësisht, sot e brez pas brezi, jo vetëm për ujitjen, por edhe për të pirë, edhe për industrinë, për energjinë elektrike, për kultivimin e peshkut etj. Por, duke pasur parasysh se nevojat për ujë rriten, mbetet detyrë që të zbulohen vazhdimisht burime të reja uji. Ne kemi ligene natyrore në lartësi deri mbi 1 700 metra, që akoma nuk i shfrytëzojmë plotësisht. Janë zbuluar burime uji të rëndësishme karstike, siç janë ato që u gjetën në hapjen e tuneleve në Qafëthanë e Sasaj. Mundësitë për të gjetur ujë janë të mëdha, sepse karsti te ne është mjaft i përhapur.

Në trajtimin shkencor të tokës, siç dihet, rëndësi ka plehërimi. Si rezultat i punës së kujdesshme, që bëhet me tokën, prirja shkon gjithnjë drejt pasurimit të saj. Për çdo ha tokë bujqësore grumbullohen, mesatarisht, 90 kv pleh organik dhe përdoren 145 kg lëndë aktive nëpërmjet plehrave kimike. Në rreth 20 000 ha përdoren edhe plehra bakteriale, të prodhuara në vend. Megjithëkëtë, efektet në prodhim nuk janë të kënaq-

shme. Kështu, për shembull, për çdo kv pleh kimik të përdorur, ne marrim një shtesë prej rreth 1,6 kv për ha grurë dhe 2 kv për ha misër, që janë tregues akoma të ulët, po të krahasohen me të dhënat e eksperimenteve shkencore e të ekonomive pararojë që marrin 2-3 herë më shumë. Tani duhet të thellohen më tej studimet për shtimin e burimeve të plehrave organike dhe për shpejtimin e proceseve të dekompozimit të tyre, për rritjen e koeficientëve të shfrytëzimit të plehrave, për dozat e kohën, për mënyrën dhe kombinimin e plehrave organike me ato kimike, për rolin dhe dozën e përdorimit të oligoelementeve në shtimin e rendimenteve etj.

Plehërimi integral i tokës kërkon thellimin më tej të studimeve për problemet fiziologjike e biokimike, të veçorive gjenetike të ushqimit mineral e të bimëve bujqësore, duke përcaktuar më mirë parametrat e prodhimit të lartë të bimëve në kushte të ndryshme ekologjike të vendit, si dhe në fusha të pastudiuara mirë deri sot, siç janë: perimet, bimët foragjere, ato drufrutore, kullotat dhe pyjet.

Në rritjen e aftësive gjenetike të farërave e të racave të blegtorisë, specialistët dhe punonjësit e bujqësisë e kanë çarë rrugën në luftë me vështirësitë e ndryshme e të shumta dhe kanë arritur rezultate të dukshme. Në çdo 4-5 vjet janë futur në prodhim lloje të reja gruri dhe janë krijuar hibride misri në prodhimin e farërave të bimëve industriale, në speciet dhe në varietetet e druve frutorë, në prodhimin e fidanëve pyjorë etj. Në blegtori dominojnë racat e pastra dhe kryqëzimet e tyre. Janë përmirësuar afërsisht 100 për qind e derrave dhe e shpendëve, si dhe 72 për qind e gjedhëve dhe 50 për qind e dhenve.

Por shkalla e përmirësimit gjenetik në bujqësi është relativisht e ulët. Prapambetje kemi, sidomos, në frutikulturë e në blegtori. Shtimi dhe përmirësimi i bimëve bujqësore dhe i racave të kafshëve duhet të vendosen mbi baza më shkencore. Grumbullimi dhe përpunimi i vazhdueshëm i materialeve bimore e shtazore, në radhë të parë, i atyre të vendit, por edhe i vendeve të tjera, përhapja dhe shumëzimi më i studiuar dhe më i programuar i llojeve dhe i racave më të mira, mbeten problem i rëndësishëm për shkencat bujqësore.

Drejtimi i seleksionimit në bujqësi tani duhet të përqendrohet në krijimin dhe në përhapjen në prodhim të biotipeve të reja në grurë e tritikale të qëndrueshme ndaj rrëzimit dhe sëmundjeve, me aftësi prodhuese 70-80 kv për ha dhe me cilësi të mira për bukë. Në misër të vazhdojnë përmirësimi gjenetik dhe drejtimi i seleksionimit për rritjen e aftësive prodhuese në masën 10-15 për qind më tepër se hibridet ekzistuese. Ky përmirësim të sjellë, njëkohësisht, shtimin e proteinave e të amino-

acideve në përmbajtjen e tyre. Të punohet që, brenda vitit 1985, të gjitha kërkesat e ekonomive të plotësohen me hibride të reja. Detyra të rëndësishme mbeten krijimi dhe përhapja e llojeve të pambukut, me aftësi prodhuese 30-40 kv për ha dhe me cilësi të lartë të fijos. Duhet të arrihet që hapja e boçeve të këtyre llojeve të reja të pambukut të përfundojë brenda tetorit. Në luledielli të krijohen hibride e lloje me aftësi biologjike mbi 30-35 kv për ha dhe mbi 45 për qind yndyrna në farë. Ndërsa për panxharsheqerin të fillojë puna gjenetike e seleksionuese për krijimin në vend të llojeve e të hibrideve poliplloide, shumë e njëfarësh dhe me përqindje të lartë sheqeri. Puna seleksionuese dhe gjenetike të thellohet edhe në bimët e tjera industriale, në drurët frutorë, në pyje etj.

Një vëmendje e veçantë t'u kushtohet seleksionimit dhe prodhimit të farërave të perimeve e të patates. Nuk duhet të ndodhë që, për këto bimë, puna të arrijë deri aty, sa, gati çdo vit, të importojmë farëra, pastaj i dëmtojmë e përsëri i importojmë, pa bërë fjalë për rendimentet e ulëta që merren prej tyre.

Në sektorin e blegtorisë, me gjithë rezultatet e arritura, shkalla e përmirësimit racor, teknologjia e mbarështimit dhe niveli i prodhimit të kafshëve ende nuk u përgjigjen investimeve të mëdha që janë bërë dhe nevojave gjithnjë në rritje për qumësht e vezë, për mish, lesh e lëkurë.

Detyrat që shtrohen për pesëvjeçarin e ri, në të ardhmen kërkojnë një rritje të shpejtë të numrit të krerëve, por, në mënyrë të veçantë, të produktivitetit të të gjitha llojeve të kafshëve. Në vendin tonë duhet të krijohen tufa masive me lopë të racës laramane, që të japin 4 000-5 000 litra qumësht, me dhen — mbi 4 kg lesh dhe me dhi — mbi 150 litra qumësht, me dosa që të prodhojnë mbi 15-20 kv mish dhe me pula që bëjnë mbi 200 kokrra vezë në vit.

Këta tregues nuk mund të arrihen pa një punë aktive, të gjerë e të thellë shkencore. Puna shkencore në blegtori, në radhë të parë, të synojë në shpejtimin dhe në përsosjen e mëtejshme të përmirësimit racor në të gjitha llojet e kafshëve, në shtrirjen më gjerësisht të kryqëzimit industrial për prodhim mishi, në përmirësimin e teknologjisë ekzistuese dhe në rritjen e në aplikimin e teknologjive të reja e bashkëkohore në mbarështimin e kafshëve. Në kuadrin e kësaj pune duhet të rishikohen me sy kritik dhe të merren masa për të përsosur tërë sistemin e dokumentacionit tekniko-shkencor dhe organizimin e punës kërkimore-studimore në blegtori, për ta vendosur atë, kudo, mbi baza të shëndosha shkencore.

Detyrat që shtrohen për zhvillimin intensiv të blegtorisë janë të ndërvarura e të lidhura pazgjidhshmërisht me përmirësimin rrënjësor të tërë punës që bëhet për prodhimin e ushqi-

meve. Me rendimente të tilla të ulëta, 25-30-40 kv njësi ushqimore për hektar, siç marrin sot shumica e ekonomive bujqësore, nuk mund të ecet më tej. Institucionet tona shkencore dhe organet e bujqësisë, në qendër e në rrethe, mbi bazën e studimeve komplekse, të përpunojnë dhe të zbatojnë një sistem më të plotë e më të përshtatshëm për të dyfishuar e trefishuar rendimentin e kulturave foragjere dhe të aftësive prodhuese të kullotave natyrore. Studimet shkencore duhet të synojnë, gjithashtu, ngritjen e linjave teknologjike për përpunimin racional të kashtërave, të ushqimeve të koncentruara e të nënprodukteve të tjera bujqësore e industriale.

Studime shkencore kërkohen për të gjitha degët e bujqësisë, për frutikulturën e pyjet, për vreshtat, agrumet dhe ullinjë, për mbrojtjen e bimëve dhe të kafshëve nga sëmundjet e dëmtuesit etj. Institutet kërkimore, specialistët e prodhimit, në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore, punonjësit e pararojës duhet të ndërmarrin me guxim studime e eksperimentime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin në këto fusha. Kështu, në frutikulturë të ndërmerren studime për t'u hapur rrugë të gjerë shtimit dhe përmirësimit të varieteteve, si dhe të metodave të reja, që shkurtojnë afatin e prodhimit të fidanëve dhe të futjes së tyre në prodhim. Në zhvillimin e ekonomisë pyjore të synohet në përcaktimin e strukturave dhe të varieteteve më ekonomike, që t'u përshtaten më mirë kushteve tokësore e klimaterike të vendit. Për mbrojtjen e bimëve të arave, të drurëve frutorë e atyre pyjorë, të ndërmerren studime në zona e në kultura të ndryshme për inventarizimin, për diagnostikimin dhe për luftimin e sëmundjeve dhe të dëmtuesve.

Zhvillimi i industrisë dhe i bujqësisë është i lidhur ngushtë me ndërtimet dhe me komunikacionin. Njerëzit tanë të shkencës dhe të teknikës kanë zgjidhur probleme të mëdha e të vështira për të përballuar vëllimin e madh të ndërtimeve. Është një fitore e madhe që vendi ynë sot është në gjendje të projektojë e të ndërtojë me forcat e veta çdo objekt që i nevojitet ekonomisë, goftë ky objekt industrial, hidroteknik, hekurudhor, kulturor etj.

Në fushën e ndërtimit është krijuar një traditë e mirë dhe është fituar një përvojë e pasur në organizimin e punës kërkimore-projektuese. Kjo jep mundësi që para specialistëve dhe instituteve projektuese të ndërtimit të shtrojmë kërkesa më të larta për të projektuar e për të ndërtuar me metoda më të përparuara. Duhet shtuar përpjekjet për të gjetur e për të zbatuar konstruksione më të lehta e më ekonomike, për të bërë studime më të thella e komplekse urbanistike, për zgjidhje sa më të hijshme e të larmishme arkitekturore, për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së materialeve të ndërtimit. Qëllimi është që të shpejtohen ritmet dhe të rritet efektiviteti i ndërtimeve.

Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e njeriut kanë qenë kurdoherë në qendër të vëmendjes së Partisë e të shtetit tonë socialist. Për shëndetësinë janë bërë dhe bëhen investime e shpenzime të mëdha, janë ngritur institucione të shumta, të përgjithshme e të profilizuara, janë përgatitur me mijëra specialistë e kuadro të kualifikuar. Si rezultat i këtyre masave, vendi ynë ka një shërbim shëndetësor të organizuar e të përparuar, që përvetëson dhe zbaton shkencën mjekësore të kohës. Mbi këtë bazë, në vendin tonë janë zhdukur një sërë sëmundjesh masive, është përmirësuar dhe forcohet vazhdimisht shëndeti i brezit të ri dhe i të gjithë njerëzve tanë.

Përpara punonjësve shkencorë dhe specialistëve të shëndetësisë dalin detyra të mëdha. Ata duhet të njohin dhe të përdorin gjerësisht në profilaksi, në diagnostikim dhe në mjekim metodat e reja të mjekësisë bashkëkohore, të njohin shkallën e përhapjes së sëmundjeve të ndryshme në vend, të studiojnë faktorët që i shkaktojnë ato dhe rrugët për mënjanimin e tyre. Vëmendje të veçantë kërkojnë studimet dhe masat për uljen e vazhdueshme të vdekshmërisë foshnjore. Punonjësit e këtij sektori të thellojnë specializimin dhe profilizimin, t'u futen më me guxim studimeve në fushat më pak të lëvruara, siç janë: ato të fiziologjisë së punës, të gjenetikës mjekësore, të imunobiologjisë etj., të ngrenë nivelin shkencor të organizimit të të gjithë punës në shëndetësi.

Me shëndetin e njerëzve lidhet drejtpërdrejt problemi i mbrojtjes së ambientit nga ndotjet. Në këtë fushë kanë dalë, qysh tani, një sërë problemesh, që kërkojnë zgjidhje shkencore. Aty-këtu janë dukur koncentime me rritje të ndotjes së ajrit, të ujërave sipërfaqësore të lumenjve, të rezervuareve, të detit etj. Përdorimi në masë të gjerë i herbicideve, i insekticideve dhe i pesticideve nuk bëhet kurdoherë me kritere të drejta shkencore.

Punonjësit shkencorë të shëndetësisë, në bashkëpunim me specialistët, me kuadrot dhe me punëtorët e prodhimit, duhet t'i thellojnë e t'i zgjerojnë edhe më shumë kërkimet në këto drejtime, duke kapërcyer karakterin empirik e diletant, që vihet re në disa raste.

Për zhvillimin e shkencave të aplikuara dhe për përparimin teknik, një rol të madh luajnë **shkencat teorike bazë, si: matematika, fizika, kimia, biologjia etj.** Në Kongresin e 7-të të Partisë shoku Enver shtroi si një detyrë të rëndësishme shpejtimin e ritmeve për zhvillimin e këtyre shkencave dhe për armatosjen me dijet e tyre të specialistëve që përgatiten në shkollat tona. Por, për zbatimin si duhet të kësaj direktive të Kongresit, duhen marrë masa më efektive, sidomos, nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, nga Akademia e Shkencave dhe nga Universiteti i Tiranës.

Ka vite që probleme të tilla të rëndësishme, të cilat i përmendëm më sipër, si: shkripëzimi i tokave, përmirësimi racor i blegtorisë, krijimi i hibrideve të bimëve industriale, i perimeve e i foragjereve, përpunimi i fosforiteve, përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë në kompleksin e punimeve gjeologo-gjeofizike në naftë dhe në miniera, thjeshtimi e lehtësimi i konstruksioneve në ndërtim e në makineri etj., nuk po marrin rrugë si duhet, përveç të tjerave, edhe për shkak të mungesës së njohurive të thelluara në shkencat teorike bazë.

Për zhvillimin e këtyre shkencave, detyra të rëndësishme dalin si përpara institucioneve shkencore të specializuara, ashtu edhe përpara shkollës së lartë. Këta organizma, në radhë të parë, duhet të ngrenë nivelin e shkencave teorike, duke njohur e duke përvetësuar arritjet e shkencës bashkëkohore, t'i lidhin ato me problemet konkrete të prodhimit dhe të ndihmojnë drejtpërdrejt për zgjidhjen e tyre, të përhapin gjerësisht metodat më të përparuara në kërkim, në projektim, në zbatim e në prodhim.

Në shkencat matematike përpjekjet të drejtohen në ato fusha, që janë bazë e përgjithshme e ndërtimit të modeleve matematike të problemeve të ndryshme të prodhimit dhe të shkencës. Në të ardhmen, këto të zënë vendin që u takon, krahas matematikës llogaritëse. Qendra e matematikës llogaritëse të rritë më shumë nivelin shkencor të punës së vet në përvetësimin e degëve të reja të matematikës së zbatuar, të shfrytëzojë metodat e reja për zgjidhjen e problemeve të mëdha e komplekse të ndërtimit, të prodhimit, të shfrytëzimit të lëndëve të para etj. Të shikohet mundësia që kjo qendër të pajiset edhe me mjete e me aparatura më të përparuara.

Tani është bërë e nevojshme që t'u kushtohet vëmendje edhe fushave të tilla, si: kibernetika dhe informatika, duke përgatitur për këtë edhe kuadrin e specializuar.

Në shkencat fizike të thellohen studimet dhe të kryhen kërkime në problemet e fizikës bërthamore të aplikuara. Të përvetësohen metodat e fizikës së neutroneve e të përdoren ato në dobi të prodhimit. Të kryhen studime për fizikën e trupit të ngurtë, që është bazë e përgjithshme e përdorimeve themelore të fizikës në prodhim dhe në shkencë. Të merren masa për organizimin e studimeve dhe për zbatimin e teknikës së rrezeve lazer në ndihmë të prodhimit, të shkencës dhe të forcimit të mbrojtjes së vendit. Të fillojnë studimet edhe në fushën e biofizikës.

Një fushë e gjerë hapet përpara shkencave të kimisë, për të siguruar transformime sa më të thella e më të leverdishme të lëndëve të para, që futen në procesin e prodhimit, për të krijuar kombinime optimale të lëndëve të para e të ndërmjetme për

prodhime të reja, për të thelluar punën kërkimore, sidomos, në lëmin e gjeologjisë e të naftës, në atë të agrobiologjisë, të metalurgjisë etj.

Për sa i përket biologjisë, ajo që kërkohet është që të kapërcejë fazën e punës thjesht seleksionuese, për të kaluar në një fazë studimesh e eksperimentimesh të gjenetikës moderne, për krijimin e varieteteve, të hibrideve e të racave të reja, me rezistencë e me prodhimi të lartë.

Për zhvillimin e shkencave teorike bazë dhe për lidhjen e tyre më të mirë me prodhimin, është e nevojshme që të merren disa masa të veçanta për forcimin e bazës eksperimental-laboratorike të instituteve të specializuara dhe të katedrave përkatëse të shkollave të larta, për ngritjen e impianteve pilot dhe për përgatitjen e kuadrove të specializuara, sidomos në disa profile të domosdoshme.

Ndërtimi socialist i vendit dhe roli i shkencave shoqërore

Ndërtimi e zhvillimi i shoqërisë socialiste është një proces kompleks, që përfshin shndërrimin e të gjitha anëve të jetës, të bazës materialo-ekonomike, të superstrukturës dhe të të gjitha marrëdhënieve shoqërore. Në këtë proces një rol të madh luajnë edhe shkencat shoqërore. Kontributi i tyre ka gjetur shprehjen e vet në të gjitha ato shndërrime të thella revolucionare, që janë realizuar nga populli ynë gjatë këtyre 35 vjetëve, nën udhëheqjen e Partisë.

Këtu spikat, në mënyrë të veçantë, mendimi krijues i Partisë, vepra e shquar teorike e shokut Enver Hoxha. Në materialet e Partisë e në Veprat e shokut Enver ne gjejmë, të përgjithësuar në mënyrë shkencore, përvojën e pasur revolucionare të Partisë e të popullit tonë, gjejmë trajtimin marksist-leninist të problemeve të ndërtimit të shoqërisë socialiste, gjejmë çelësin për zgjidhjen e detyrave të mëdha që kemi përpara.

Parimet e marksizëm-leninizmit, mësimet e Partisë e të shokut Enver kanë qenë dhe janë kurdoherë në themel të shkencave tona shoqërore. Ato kanë armatosur politikisht e ideologjikisht studiuesit tanë dhe u kanë ndriçuar rrugën në punën e tyre krijuese. Kjo është edhe arsyeja kryesore që shkencat tona shoqërore janë zhvilluar kurdoherë në rrugë të drejtë dhe kanë qenë e janë një armë e fuqishme luftarake në duart e Partisë.

Një ndër objektivat kryesorë të shkencave shoqërore ka qenë dhe mbetet studimi i thellë dhe i gjithanshëm i përvojes revolucionare të Partisë e të popullit tonë në revolucionin dhe në ndërtimin e socializmit. Në këtë fushë janë ndërmarrë shumë

studime me vlerë dhe janë organizuar një varg aksionesh shkencore. Por tani kërkohet që kjo punë të thellohet më tej. Të përgjithësosh përvojën nuk do të thotë të regjistrosim faktet e të përshkruajmë ngjarjet, siç ndodh në mjaft studime, referate e kumtesa. Ajo kërkon të zbulohen ligjësitë e procesit të zhvillimit, të nxirren mësimet e konkluzione për të sotmen e për të ardhmen.

Vendi ynë ka hyrë tani në një fazë të tillë të zhvillimit socialist, kur shtrohen shumë probleme të reja për t'u zgjidhur dhe për të cilat mungon përvoja e nevojshme. Në këto rrethana, përpara shkencave shoqërore, sot, më tepër se kurrë, shtrohet detyra që, duke u mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në përvojën e derisotme, të zhvillojnë më tej mendimin krijues, të përballojnë me kurajë e me guxim problemet e mëdha që nxjerr jeta, të argumentojnë teorikisht perspektivat e zhvillimit tonë. Kjo do të thotë që shkencat shoqërore të orientohen, në radhë të parë, nga tematika aktuale, nga ato probleme që kërkohen zgjidhje. Këtu kërkohet që ato të japin kontributin e tyre të madh.

Detyra të mëdha dalin para shkencave ekonomike, roli i të cilave rritet krahas me vetë zgjerimin e zhvillimin e ekonomisë socialiste.

Një problem i mprehtë, që po e thekson gjithnjë më shumë zhvillimi i ekonomisë sonë, mbetet rritja e efektivitetit të prodhimit shoqëror. Krijimi dhe zhvillimi i degëve kyç, siç janë: industria e naftës dhe e gazit, minierat, metalurgjia, industria energjetike, mekanike e bujqësia, kanë pasur dhe do të vazhdojnë të kenë rëndësi jetike për ndërtimin e socializmit me forcat tona dhe për forcimin e pavarësisë së vendit. Zhvillimi intensiv dhe rritja e efektivitetit të këtyre degëve shtrojnë nevojën e ngutshme që të studiohen në mënyrë komplekse, veç problemeve me karakter tekniko-teknologjik, edhe një varg problemesh ekonomik-financiare. Qëllimi është që të përcaktohen sa më drejt mundësia, radha dhe leverdia e zhvillimit të njëres degë apo të tjetrës, që të gjendet zgjidhja optimale e efektivitetit ekonomik, që duhet të sigurojnë investimet dhe ndërtimet themelore, që të pakësohen sa më shumë shpenzimet e përvitshme të prodhimit në veprat e reja, që të parashikohen sa më saktë efektet, që do të sjellin kapacitetet e krijuara rishazi në bilancin e eksport-importit dhe të të ardhurave të shtetit.

Mungesa e studimeve komplekse, me karakter tekniko-teknologjik dhe ekonomik-financiar, ka bërë që në mjaft vepra të rëndësishme zgjidhja e anës teknike të tyre nuk ka çuar kurdoherë në rezultatet e pritura për shtimin e prodhimit e të akumulimit, për pakësimin e importit, sidomos, të lëndëve të para e të materialeve ndihmëse etj. Në mungesën e këtyre stu-

dimeve duhet kërkuar edhe një nga shkaqet që, vetëm gjatë vitit 1979, qindra milionë lekë u ngurtësuan në formën e investimeve në mjaft vepra të papërfunduara, të cilat duhet të ishin dhënë për shfrytëzim; që rentabiliteti në ndërmarrjet e industrisë e të minierave në vitin 1979 u ul në 11,8 për qind, nga 14,3 për qind që ishte në vitin 1976; që në bujqësi vihet re një prirje për rritjen e kostos për njësi prodhimi, në vend që të ndodhë e kundërta.

Mirëpo fenomene të tilla, që ulin efektivitetin e prodhimit, janë me pasoja frenuese për zhvillimin e ekonomisë sonë. Ato duhet të kishin tërhequr me kohë vëmendjen dhe t'u ishte dhënë rrugëzgjdhje nga ana e Komisionit të Planit të Shtetit, e Ministrisë së Financave, e Ministrisë së Ndërtimit, e Ministrisë së Industrisë, e asaj të Bujqësisë, si dhe nga ana e institucioneve kërkimore-shkencore.

Me përmasat e sotme që ka marrë prodhimi ynë shoqëror, ruajtja e zhvillimit të tij të mëtejshëm, me ritme relativisht të larta e të qëndrueshme, nuk mund të mendohet dhe të arrihet pa rritur rendimentin e punës dhe pa ulur shpenzimet e prodhimit e të qarkullimit. Kjo ka qenë dhe mbetet një çështje parimore për realizimin e riprodhimit të zgjeruar socialist. Shoku Enver na mëson se, sa të rëndësishëm janë buka e çeliku, nafta e çimentoja, tekstilet dhe artikujt ushqimorë, po aq të rëndësishme janë edhe burimet financiare e valutore. Po pakësuam dhe po frenuam këto të fundit, medoemos, do të pakësohen e do të frenohen edhe të parat. Kush nuk e kupton e nuk thellohet në këtë, nuk ka kuptuar abëcënë e doktrinës ekonomike marksiste-leniniste.

Sa më shumë që ekonomia jonë ecën në rrugën intensive të zhvillimit, aq më tepër rritja e rendimentit të punës bëhet faktori vendimtar për shtimin e prodhimit shoqëror dhe të të ardhurave kombëtare. Vetëm duke siguruar nga rritja e rendimentit të punës pjesën më të madhe të shtimit të produktit shoqëror, mund të mbahet një normë akumulimi relativisht e lartë, mund të rritet mirëqenia e përgjithshme e popullit. Mbi këtë bazë mbështetet edhe ai kapërcim i madh që parashikohet të bëhet në normën e akumulimit në pesëvjeçarin e shtatë, e cila duhet të arrijë në rreth 35 për qind.

Plotësimi me sukses i kësaj detyre kërkon një mobilizim dhe marrje masash jo të zakonshme. Këtu është fjala për të gjetur rrugë e mundësi të reja, për të vënë në lëvizje e në veprim të gjitha rezervat e brendshme, që kushtëzojnë uljen e kostos në përpjesëtime më të mëdha se gjer më sot dhe rritjen e efektivitetit të mjeteve të shumta financiare, që përdoren çdo vit për shtimin e fondeve themelore e të xhiros në ndërmarrje e në kooperativë.

Puna e ndërgjegjshme, krijuese e njerëzve tanë, të ngritur politikisht dhe ideologjikisht e të udhëhequr nga Partia, si dhe baza materialo-teknike, me të cilën është pajisur ekonomia dhe që po fuqizohet e po modernizohet pareshtur, kanë qenë dhe do të jenë kurdoherë faktori vendimtar si për rritjen e rendimentit të punës, ashtu edhe për uljen e shpenzimeve të prodhimit. Por, krahas me këtë, është e domosdoshme që organet shtetërore, të planifikimit e të financës, si dhe shkencë jonë ekonomike, të gjejnë forma e metoda më shkencore, që nga qendra deri në bazë, për planifikimin e evidentimin, për ndjekjen dhe kontrollin sistematik të çdo shpenzimi, që bëhet në prodhim dhe në qarkullim, qoftë ky shpenzim materialesh apo pagë e punës.

Zhvillimi i pandërprerë dhe me ritme të larta i ekonomisë sonë socialiste ka garantuar dhe ka bërë të mundur zënien me punë të të gjitha forcave aktive të vendit, në qytet dhe në fshat. Papunësia, e cila në vendet borgjezo-revizioniste është kthyer sot në një tragjedi të vërtetë kombëtare, sidomos për brezin e ri, është zhdukur te ne dhe nuk ka asnjë bazë ekonomiko-shoqërore që ajo të mund të lindë.

Megjithatë, Partia ka vënë në dukje se zënia me punë e të gjitha forcave të reja aktive, që shtohen nga njëri vit në tjetrin, nuk është një problem që zgjidhet vetiu, pa vështirësi e pa përpjekje të veçanta. Në këtë kuptim, edhe për pushtetin dhe për ekonominë tonë zgjidhja e tij mbetet një çështje e mprehtë. Mjafton të përmendim se në pesëvjeçarin e ardhshëm (1981-1985) do të duhet të hapen vende të reja pune për më shumë se 185 000 veta dhe po kaq do të duhen edhe në pesëvjeçarin 1986-1990. Po t'i shtojmë kësaj rrethanë edhe faktin se shpenzimet që duhen bërë për hapjen e një vendi të ri pune kanë prirjen të shtohen, atëherë bëhet edhe më e qartë rëndësia ekonomike, politike e shoqërore që merr ky problem.

Në këto kushte, Partia kërkon që shkencat ekonomike ta thonë më mirë e më me kompetencë fjalën e tyre, duke dhënë një ndihmë konkrete, lidhur me drejtimet më të leverdishme dhe me efektin ekonomiko-shoqëror më të madh për hapjen e vendeve të reja të punës, në qytet dhe në fshat, në sferën prodhuese e joprodhuese, në degët e ndryshme të ekonomisë dhe brendapërbrenda secilës degë. Në këtë vështrim Komisioni i Planit të Shtetit dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve lipset ta përsosin më tej dhe ta vënë mbi baza më të shëndosha shkencore tërë punën që bëhet për hartimin e bilancit koorent e perspektiv të nevojave për fuqi punëtore, për specialistë të mesëm e të lartë. Kjo punë të udhëhiqet, kurdoherë, nga politika e drejtë që ka ndjekur e ndjek Partia për shpërndarjen e popullsisë, sidomos ndërmjet qytetit

dhe fshatit dhe për ngushtimin e dallimeve thelbësore, që ekzistojnë ndërmjet tyre.

Zhvillimin e forcave prodhuese Partia jonë e ka lidhur kurdoherë ngushtë me zgjidhjen e problemeve ekonomiko-shoqërore që shtrun ndërtimi i socializmit, aktualisht dhe në perspektivë, me konsolidimin dhe me përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim.

Në rendin tonë shoqëror marrëdhëniet socialiste në prodhim përfaqësojnë një sistem lidhjesh ekonomike të shuman-shme, që ka në themel të tij pronën shtetërore dhe atë kooperative mbi mjetet e prodhimit. Prandaj e tërë vëmendja jonë duhet të përqendrohet në studimin e atyre proceseve ekonomiko-shoqërore, e atyre formave të organizimit e të drejtimit të ekonomisë, në përdorimin e atyre levave ekonomike, të cilat çojnë në fuqizimin e të dyja formave të pronës socialiste, në ngritjen e mëtejshme të shkallës së shoqërizimit të pronës kooperative, deri në nivelin e pronës së të gjithë popullit.

Në rendin kooperativist janë në zhvillim e sipër disa procese me përmbajtje të thellë ekonomiko-shoqërore, si: krijimi i kooperativave të tipit të lartë, kufizimi i madhësisë së oborrit kooperativist, futja e disa elementeve të reja shoqërore, siç janë: tufëzimi i bagëtive vetjake, ngushtimi i dallimeve midis fshatit e qytetit dhe brenda vetë fshatit, që duhen studiuar dhe duhen ndjekur me kujdes, për të përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre në të ardhmen.

Edhe në fushën e marrëdhënieve të këmbimit e të shpërndarjes, lindin, kohë pas kohe, probleme, që kërkojnë një zgjidhje të studiuar e sa më të thelluar shkencore, mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të përvojës sonë revolucionare. Qysh sot Partia ka tërhequr vëmendjen që të bëhen përpjekje për të përsosur format e këmbimit midis sektorit shtetëror dhe atij kooperativist, format e shpërblimit të punës në ndërmarrjet shtetërore dhe në kooperativat bujqësore, duke synuar, kurdoherë, që ky shpërblim të lidhet sa më ngushtë me rezultatet e punës, me shpenzimet dhe me cilësinë e prodhimit, me rritjen e rendimentit të punës, me ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve ekonomike midis klasave dhe grupeve të punonjësve brenda tyre.

Një rëndësi të madhe ka edhe zgjidhja e problemeve, që lidhen me përsosjen e formave të drejtimit dhe të organizimit racional të ekonomisë sonë të planifikuar, duke synuar një bashkërendim më të mirë të metodave ekonomike me ato administrative, mbi bazën e kërkesave të ligjeve ekonomike të socializmit dhe të përdorimit të levave të tilla, siç janë: paraaja, malli, çmimi, financat, sistemi i drejtimit me llogari më vete etj., duke iu përmbajtur, si gjithnjë, mësimëve të marksizëm-leninizmit.

Aktualisht, shtimi i eksportit dhe rritja në tërësi e efektivitetit të qarkullimit në tregtinë e jashtme bëhen faktorë të rëndësishëm, që kushtëzojnë, në një shkallë të caktuar, zhvillimin e shpejtë të ekonomisë, të mbështetur tërësisht në burimet tona valutore. Prandaj Partia kërkon që problemet e eksportit e të importit, të strukturës e të leverdisë së tyre, të shtrirjes gjeografike të tregjeve, të koniunkturës dhe të prirjeve të tyre të studiohen në kompleks e të harmonizuara me njëri-tjetrin. Në këto studime t'u kushtohet kujdes gjendjes së sotme në tregjet ndërkombëtare dhe zhvillimit të tyre në të ardhmen.

Në këtë kuadër, lipset të studiohen më mirë se deri tani çështjet që lidhen me krizën ekonomike, energjetike e valutore botërore, me ndikimet që ajo mund të ushtrojë ndaj vendit tonë, me synimin për të gjetur rrugët e përballimit e të shmangies së tyre. Gjithashtu, duhen studiuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e doktrinës ekonomike marksiste-leniniste nga shtrëmbërimet që i bëjnë ideologët borgjezë e revizionistë, si dhe ato që kanë të bëjnë me demaskimin e karakterit shtypës e shfrytëzues të rendit kapitalist, borgjez e revizionist.

Në ekonomi janë të shumta problemet që kërkojnë studime e zgjidhje shkencore. Detyra e ekonomistëve, e planovikëve, e financierëve tanë, në qendër e në bazë, është që, duke u udhëhequr nga vija e Partisë dhe duke u mbështetur në ligjet objektive, ta thonë më mirë fjalën e tyre me peshë. Ata duhet të kenë parasysh se roli i tyre nuk është të regjistrujnë e të konstatojnë, të bëjnë një punë rutinë, por të ndërmarrin studime, të bëjnë përgjithësime dhe të përcaktojnë rrugët për të mënjeluar të metat e për të parandaluar fenomenet e padëshirueshme. Prapambetja, që kemi në fushën e mendimit shkencor ekonomik, duhet kapërcyer sa më shpejt, sepse vetëm kështu mund të luftohen cektësia, voluntarizmi e subjektivizmi, zgjidhjet e çastit e të nxituara, që vihen re disa herë në trajtimin e problemeve ekonomike dhe që janë me pasoja për zhvillimin e ekonomisë. Për këtë është e nevojshme që nga ana e komiteteve dhe e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe ekonomike të nxitet dhe të përkrahet kudo mendimi shkencor ekonomik, të përmirësohet puna për përgatitjen e për kualifikimin e kuadrove ekonomike dhe të vihen këta në kushte pune të tilla që të kryejnë detyrat e tyre.

Në stadin e tanishëm të zhvillimit të vendit, një rol veçanërisht të rëndësishëm kanë **shkencat politike, filozofike e sociale**. Duke pasur si orientim e si udhëheqje dokumentet e Partisë e Veprat e shokut Enver këto shkencat kanë dhënë një kontribut me vlerë në forcimin e në përsosjen e superstrukturës socialiste dhe në edukimin komunist të masave. Vepra të tilla, si: «Historia e PPSH», «Kushtetuta e RPSSH», tekstet e shko-

llave të larta, monografite e studimet e tjera, konferencat e sesionet shkencore për problemet e Luftës Nacionalçlirimtare, të ndërtimit socialist e të zhvillimit të sotëm botëror kanë shënuar arritje të rëndësishme.

Por, me gjithë këto rezultate, ende mungojnë studime shkencore serioze për shumë probleme të mëdha të revolucionit e të ndërtimit socialist. Mjaft studime janë të cekëta, vuajnë nga trajtimi i problemeve në përgjithësi, nga perifrazimi i parimeve e i tezave të njohura marksiste.

Duke mbajtur parasysh detyrat e mëdha aktuale e të perspektivës për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e vendit dhe për edukimin e masave, studimet është e nevojshme të përqendrohen, veçanërisht, në çështjet më themelore.

Objekt i studimeve shkencore duhet të bëhen proceset e zhvillimit të sotëm të revolucionit socialist në të gjitha fushat e drejtimet politike, ekonomike, ideologjike e kulturore. Partia jonë tashmë ka fituar një përvojë të pasur dhe jep një shembull të madh në vazhdimin fitimtar dhe të pandërprerë të revolucionit. Detyra është që kjo përvojë, me vlerë kombëtare e ndërkombëtare, të përgjithësohet akoma më mirë dhe ndërtimi socialist të çohet përpara, duke i prerë rrugën çdo rreziku të mundshëm të kundërrëvolucionit revizionist, i cili çoi në restaurimin kapitalist në Bashkimin Sovjetik e gjatë.

Partia jonë, duke vënë në jetë mësimet e marksizëm-leninizmit, ka luftuar dhe lufton për të zgjidhur probleme të tilla të mëdha të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, siç janë: problemet e raportit të zhvillimit material e shpirtëror, të faktorit objektiv e subjektiv në ndërtimin e socializmit, të përsosjes së bazës e të superstrukturës së shoqërisë, të karakterit të kontradiktave në etapat e ndryshme të revolucionit dhe të rrugëve për kapërcimin e tyre, të harmonizimit të interesave në socializëm, të luftës së klasave dhe të forcave të tjera lëvizëse të shoqërisë, të dallimeve klasore socialekonomike midis fshatit e qytetit, midis punës fizike e asaj mendore etj. Të gjitha këto probleme kaq të rëndësishme kërkojnë studime dhe analiza të mëtejshme, të përgjithshme e konkrete. Në organizimin e në nxitjen e studimeve në këto fusha, një rol i veçantë i takon të luajë, ashtu si deri më sot, sidomos Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të Partisë.

Problemet e revolucionarizimit dhe të përsosjes së superstrukturës socialiste, në radhë të parë, të superstrukturës politike e juridike, që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me sistemin e diktaturës së proletariatit, duhet të jenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së studiuesve tanë të shkencave ideologjike, politike e juridike. Por duhet thënë se shkencat për shtetin dhe për të drejtën nuk janë në nivelin që kërkon koha e sotme.

Vihet re një mospërputhje midis mendimit të përparuar dhe politikës revolucionare të Partisë e të shtetit tonë dhe studimeve e përgjithësimeve nga institucionet shkencore. Në mënyrë të veçantë, nuk është trajtuar në gjerësinë dhe në nivelin që meriton përvoja e pasur e Partisë dhe e shtetit tonë në luftën kundër burokratizmit e liberalizmit. Të pakta janë edhe studimet kritike, kundër pikëpamjeve e praktikave të revizionistëve modernë si në ndërtimin shtetëror, ashtu edhe në fushën e legjislacionit. Studime më të thelluara kërkojnë, gjithashtu, probleme të tilla, si: zhvillimi historik i shtetit dhe i së drejtës sonë socialiste, ose trajtimi sociologjik i fenomeneve, që ka po aq rëndësi për shkencat juridike sa edhe për shkencat e tjera shoqërore.

Jo më pak do t'i shërbenin përsosjes së sistemit të diktaturës së proletariatit e të demokracisë socialiste studimet për të përgjithësuar përvojën e gjerë revolucionare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të masave në punët e drejtimit të shtetit e të ekonomisë. Studime të tilla do të ndihmonin për të ngritur më lart rolin e organeve të pushtetit popullor, si të vetmet organe që ushtrojnë sovranitetin e popullit, për të forcuar e për të përsosur kontrollin punëtor e fshatar, raportin kuadro-masa etj. Me të gjitha këto probleme dhe me studimin e tyre duhet të merren më seriozisht se deri më sot institucione të tilla, si: Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike në Universitetin e Tiranës, organet e drejtësisë dhe organizma të tjerë në qendër e në rrethet.

Një ndër detyrat më të mëdha e delikate të shndërrimeve socialiste ka qenë e mbetet formimi i njeriut të ri të shoqërisë sonë, të brumosur me botëkuptimin marksist-leninist, me virtyte morale komuniste, me koncepte të drejta për jetën e me shije të shëndosha, me shpirt të paepur revolucionar. Kjo përbën thelbin e revolucionit ideologjik, që është kryer e kryhet në vendin tonë. Shndërrimi i marksizëm-leninizmit në ideologji sunduese, e cila jo vetëm udhëheq tërë veprimtarinë e shtetit e të shoqërisë sonë, por edhe është përfaqëuar nga masat e gjera të popullit, shënon një ndër fitoret historike më të thella. Por problemet e edukimit të njeriut të ri, thellimi i mëtejshëm e i pandërprerë i revolucionit ideologjik, lufta kundër të gjitha ndikimeve të huaja ideologjike, të së kaluarës e të sotmes, mbeten në qendër të vëmendjes së Partisë e të levave të saj. Për pasojë, përbëjnë edhe një ndër fushat më të gjera e shumë të rëndësishme të studimeve për shkencat tona shoqërore, të cilat duhet të bëhen një mbështetje e shëndoshë e tërë punës së Partisë për edukimin e njeriut të ri.

Ndihet me forcë nevoja e studimeve në sferën e ndërgjegjes e të psikologjisë shoqërore, në mënyrë të veçantë, e studi-

meve kushtuar problemeve të qëndrimit ndaj punës e pronës socialiste, të raportit midis interesit të përgjithshëm e vetjak, të luftës kundër shfaqjeve e presionit të mentaliteteve mikroborgjeze. Në studimet të zbulohen më mirë ata faktorë materialë e shpirtërorë, ideologjikë e historikë, politikë e organizativë, që kanë çuar e çojnë në ndryshimin rrënjësor të ndërgjegjes së punonjësve, që ndikojnë në formimin dhe në evolucionin e mëtejshëm të saj.

Me rëndësi të madhe janë sot edhe problemet sociale, që kanë të bëjnë me kompleksin e marrëdhënieve familjare, me mënyrën e jetesës, me emancipimin e plotë të gruas, me konceptet e drejta për jetën etj. Transformimet socialekonomike kanë sjellë ndryshime të thella edhe në marrëdhëniet midis njerëzve. Norma e zakone të reja po pasurojnë çdo ditë e më shumë jetën e popullit tonë. Në të gjitha këto fusha, e reja e çan rrugën dhe fiton në luftë e në ndeshje me ndikimet e ideologjive të së kaluarës, të trashëguara nga shoqëria e vjetër patriarkale e feudo-borgjeze, si dhe me agresionin ideologjik të botës së sotme borgjezo-revizioniste që na rrethon. Të gjitha shfaqjet e fenomenet, që lufton ideologjia jonë, kanë historinë e tyre, shkaqet reale, objektive dhe subjektive.

Detyra e studiuesve tanë, si edhe e organizatave të Partisë dhe e atyre të masave është që të futen më thellë në njohjen e ndërgjegjes e të psikologjisë shoqërore, të zbulojnë veçoritë e tyre në zona e në shtresa të ndryshme të popullsisë, që, krahas luftës kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, të përpunojnë e të zhvillojnë vlerat e reja morale, që t'i pohojnë e t'i mbështetin normat e zakonet e reja socialiste, që të afirmojnë botëkuptimin dhe moralin komunist, në punë e në jetë, në shoqëri e në familje.

Studiuesit tanë duhet të argumentojnë e të propagandojnë se vetëm shoqëria socialiste, idealet dhe normat e saj sigurojnë çlirimin e vërtetë shpirtëror, liritë individuale, personalitetin e njeriut, të pandarë nga liria e kolektivit, nga interesat e shoqërisë socialiste, kurse shoqëria e shthurur borgjeze, me moralin dhe me mënyrën e saj të jetesës, e fut njeriun në një krizë shpirtërore pa rrugëdalje, në një kaos e pasiguri të frikshme, e zhyt në apati e në mjerim.

Mungesa studimesh të veçanta vihen re në disa fusha të rëndësishme, si, për shembull, në atë të historisë së filozofisë, të etikës, të sociologjisë etj. Në mënyrë të veçantë, është e domosdoshme të ndërmerren studime për demaskimin e argumentuar të pikëpamjeve e të tezave oportuniste të revizionistëve modernë, të cilët orvaten t'i vënë një bazë «teoriko-filozofike» vijës së tyre të mohimit të revolucionit proletar, të likuidimit të diktaturës së proletariatit e të restaurimit

të kapitalizmit, që përpiqen «të pajtojnë» e «të plotësojnë» marksizëm-leninizmin me teoritë filozofike borgjeze e fetare, që janë sot në modë. Në mënyrë të veçantë, ka ardhur koha që të vihen mbi një bazë më të organizuar studimet rreth problemeve të ndryshme të mendimit filozofik marksist-leninist të Partisë sonë. Aktualisht, rrethi i studiuesve, që punojnë në këto fusha, është tepër i ngushtë. Këtu duhet të inkuadrohen të gjitha institucionet kërkimore përkatëse, si: Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, katedrat e Shkollës së Lartë të Partisë, të universitetit etj.

Fusha të rëndësishme studimesh për shkencat shoqërore janë edhe marrëdhëniet e sotme ndërkombëtare, lëvizjet revolucionare çlirimtare të popujve, lëvizja punëtore e komuniste ndërkombëtare, zhvillimi i sotëm botëror. Studimet për këto probleme janë shumë të dobishme. Ato ndihmojnë për zbatimin sa më të mirë të politikës sonë të jashtme, për edukimin e kadrove e të punonjësve, që të jetojnë me situatat, për të zhvilluar me sukses luftën kundër imperializmit e revizionizmit, për të kryer detyrën tonë internacionaliste ndaj proletariatit dhe popujve. Për t'i dhënë një hov kësaj pune, është e nevojshme të studiohet mundësia e ngritjes së një organizmi të veçantë shkencor, kërkimesh e studimesh, për problemet ndërkombëtare.

Detyrë e madhe u shtrohet shkencave tona shoqërore për të rritur kontributin në luftën që zhvillojnë Partia e shteti ynë kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste në të gjitha fushat: filozofike, politike, ekonomike, kulturore, ushtarake, historike etj., në mbrojtje të marksizëm-leninizmit. Për këtë qëllim, institucionet përkatëse kërkimore të vazhdojnë të bëjnë studime të thelluara, të cilat t'i karakterizojnë analiza e thellë, kritika parimore dhe konkluzionet shkencore.

Në të njëjtën kohë, del e nevojshme që shkencat shoqërore të forcojnë e të përsosin luftën kundër veprimtarisë antishqiptare që zhvillojnë në mënyrë të organizuar imperializmi e revizionizmi modern. Në vendet kapitaliste e revizioniste ka institucione të ashtuquajtura shkencore dhe organizma të tjerë të posaçëm, që merren me veprimtari studimore e botuese antishqiptare. Institucionet tona shkencore, të fushave të ndryshme shoqërore, është e domosdoshme ta ndjekin e ta njohin mirë këtë veprimtari armiqësore e ta demaskojnë atë me argumente shkencore.

Në kuadrin e thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, një rol të rëndësishëm kanë luajtur **shkencat shoqërore, që studiojnë historinë e popullit shqiptar, gjuhën e kulturën e tij.**

Një varg veprash themelore, nga fusha e historisë, e gjuhësisë, e folklorit, e etnografisë, e arkeologjisë etj., kanë hedhur

dritë mbi vlerat e trashëgimisë historiko-kulturore të popullit tonë, nga lashtësia deri në ditët tona, kanë nxjerrë në pah forcën krijuese të masave punonjëse në të gjitha fushat e jetës shoqërore, luftën shekullore të tyre për liri, për pavarësi dhe për drejtësi shoqërore, kanë zbuluar veçoritë historike të popullit tonë, origjinalitetin, individualitetin dhe kontributin e tij për pasurimin e kulturës përparimtare botërore. Studimet në këto fusha tani njihen dhe çmohen edhe në opinionin shkencor jashtë vendit.

Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për të kaluar tani një studim më të thelluar e më të gjerë të trashëgimisë historiko-kulturore të popullit tonë. Aktualisht, duhet të ndërmerren dhe të zgjidhen disa probleme themelore, siç janë: gjeneza e ilirëve dhe e popullit shqiptar, historia e gjuhës dhe zhvillimi historik i strukturës së saj, formimi i kombit shqiptar, historia e kulturës sonë popullore, aspektet ekonomike shoqërore të historisë së popullit etj. Puna që ka nisur Akademia e Shkencave, për botimin e «Trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar» në fushën e folklorit, të gjuhës, të letërsisë, të etnografisë, të mendimit shoqëror, politik, pedagogjik etj., duhet të ecë me ritme më të shpejta dhe të bëhet në nivelin e duhur shkencor, që të evidentojë më mirë vlerat kulturore e artistike të popullit tonë në shekuj dhe të shërbejë si bazë e gjerë buri-more për të bërë sinteza më të thella rreth problemeve kyç të këtyre shkencave.

Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon zhvillimin e studimeve komplekse ndërdisiplinore.

«...historia e popullit tonë, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — është një e tërë, dhe si e tillë duhet të bëhet objekt i një studimi shkencor, letrar, artistik, të shumanshëm, nga të gjithë njerëzit tanë të të gjitha fushave të krijimtarisë, studimore, historike e letrare dhe këto të plotësojnë njëra-tjetrën»¹.

Që të plotësohet kjo detyrë, që shtron shoku Enver, kërkohet, gjithashtu, që të përmirësohet raporti ndërmjet punës për grumbullimin, për klasifikimin e për përshkrimin e materialeve dhe studimeve përgjithëse, analizave e sintezave të reja shkencore.

Në të ardhmen është e domosdoshme të tregohet një vëmendje më e madhe për studimin e proceseve të sotme historike, të fenomeneve të reja shoqërore e kulturore dhe të ndryshimeve që kanë ndodhur e po ndodhin në jetën e po-

¹ Enver Hoxha. «Raporte e fjalime, 1965-1966», f. 142.

pullit tonë, si rezultat i drejtpërdrejtë i revolucionit popullor dhe i ndërtimit të socializmit. Problemet aktuale duhet të vendosen në qendër të interesimit të institucioneve të specializuara dhe me to të merren kuadro të kualifikuar e të përgatitur. Studimi i problemeve të tilla, siç janë: historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe e ndërtimit të socializmit, njësimi e zhvillimi i mëtejshëm i gjuhës sonë letrare kombëtare, historia e zhvillimit të letërsisë e të arteve tona të realizmit socialist dhe përgjithësimi teorik i përvojës së tyre, historia e mendimit pedagogjik marksist-leninist dhe e shkollës sonë socialiste, historia botërore bashkëkohore etj., duhet të marrin përparësi. Për këto studime, që ushtrojnë një ndikim të madh edhe për edukimin patriotik e revolucionar të masave, duhet të zhvillohen kërkime serioze, duke angazhuar në to historianë, arsimtarë, filozofë, ekonomistë e studiues të tjerë nga më të zotët.

Në shkencat që merren me historinë dhe me kulturën e popullit tonë ka disa fusha dhe tema të mëdha, që kanë mbetur ende të patrajtuara, siç janë: historia e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, disiplina të veçanta të folklorit dhe të arteve të aplikuara popullore, problemet e kulturës bashkëkohore etj. Të dukshme janë mungesat në studimin e gjeografisë së Shqipërisë. Gjendja e pakënaqshme, që ekziston në këto fusha, duhet të studiohet sa më parë nga Akademia e Shkencave dhe nga organet e tjera të interesuara dhe të merren masat e nevojshme për të zhvilluar studimet edhe në këto drejtime.

Zhvillimi i shkencave shoqërore është i lidhur ngushtë me trajtimin e disa problemeve të tyre të veçanta teorike e metodologjike. Niveli i trajtimit të këtyre problemeve në shkencat gjuhësore, etnografike, historike, letrare, folklorike, pedagogjike nuk është i barabartë dhe, në disa raste, është ende i pakënaqshëm. Jashtë vëmendjes së duhur të institucioneve kërkimore ka mbetur edhe njohja mbi bazën e filozofisë marksiste-leniniste e rezultateve të disa shkencave të sakta bashkëkohore, që kanë rëndësi për të përballuar kërkesat e sotme të zhvillimit të shkencës. Kjo prapambetje është pasojë jo vetëm e nënvleftësimit të studimeve, me karakter teorik, në shkencat e veçanta shoqërore, që, gabimisht, identifikohen me «teorizimet abstrakte», por edhe e përpjekjeve të pamjaftueshme për formimin teorik e metodologjik të mjaft specialistëve, që punojnë në këto fusha.

Një fushë shumë e rëndësishme për studime shkencore mbetet gjithnjë shkolla, e cila është vatra kryesore e edukimit. Janë të njohura përparimet e mëdha që ka bërë shkolla jonë në rrugën e revolucionarizimit të përmbajtjes së saj ideore e metodike dhe në rritjen e nivelit të saj pedagogjiko-shkencor. Janë kryer edhe në këtë fushë studime, por këto janë prapa, si

në pikëpamje të përgjithësimin të përvojës së madhe të grumbulluar, ashtu edhe në pikëpamje të zgjidhjes së detyrave aktuale e të perspektivës së zhvillimit të shkollës. Këtu ka një varg problemesh, që duhen studiuar. Të tilla janë ato që kanë të bëjnë me forcimin e ndikimit të shkollës në formimin e njeriut të ri me botëkuptimin marksist-leninist, problemet e rritjes së cilësisë dhe të efektivitetit të mësimin, të ngritjes së nivelit shkencor të tij, problemet e lidhjes me të ngushtë të mësimin me prodhimin e me jetën në përgjithësi, probleme të modernizimit shkencor pedagogjik të brendisë dhe të metodave të mësimin dhe të edukimit, të zhvillimit të mendimit aktiv dhe krijues dhe të shpirtit praktik të nxënësve dhe të studentëve.

Edhe zhvillimi i letërsisë dhe i arteve ka nxjerrë mjaft probleme, që duhet të bëhen objekt studimesh të thella nga institucionet tona shkencore dhe nga një rreth më i gjerë studiuesish. Të tilla janë: problemet e metodës së realizmit socialist, si ato të vërtetësisë artistike, të pasqyrit të temës aktuale dhe historike, të konfliktit, të afirmimit të idealit socialist, të traditës e të novatorizmit, të specifikës së komikës etj., si dhe problemet që kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm të funksionit edukativ të letërsisë dhe të artit.

Interesimi për Shqipërinë, për jetën e për zhvillimin e saj, për historinë, artin, gjuhën dhe letërsinë tonë është rritur shumë në botë. Tani ka një numër jo të vogël qendrash e studiuesish, që interesohen, ose që merren drejtpërdrejt me këto probleme, që i vlerësojnë drejt faktet e ngjarjet, si dhe arritjet e shkencës shqiptare. Me këta studiues dhe dashamirë është e nevojshme të mbahen lidhje të vazhdueshme, të ndihmohen ata për të njohur sa më mirë vendin dhe popullin tonë, historinë dhe kulturën e tij.

Të përsosim drejtimin dhe organizimin e punës shkencore

Niveli i arritur dhe perspektivat e zhvillimit të shkencës shtrojnë një varg problemesh, në thelb vërtet të njohura, por që tani kërkojnë një konceptim, trajtim e zgjidhje me një horizont më të gjerë. Ato kanë të bëjnë me planifikimin e shkencës, me bashkërendimin e punës shkencore dhe me kooperimin për vënien në jetë të rezultateve të saj, me strukturat organizative, me përgatitjen, me kualifikimin dhe me përdorimin racional të kuadrit etj. dhe, mbi të gjitha, me sigurimin e një drejtimi më të përsosur të këtij sektori prej organizatave të Partisë dhe organeve shtetërore.

Tani shkenca është zgjeruar shumë, ka depërtuar në të

gjithë sektorët dhe është bërë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë e përparimin e gjithë vendit. Prandaj, për zhvillimin e saj të mëtejshëm, është e nevojshme që të vihet në baza më të plotë e më të sakta edhe planifikimi i veprimtarisë shkencore. Me gjithë përmirësimet e mëdha të kohëve të fundit, në planifikimin tonë nuk pasqyrohet akoma në masën e duhur ajo lidhje e ngushtë, natyrore e reciproke, që ekziston ndërmjet shkencës e prodhimit. Kjo mungesë e ka burimin në një gjendje të kapërcyer, kur edhe ekonomia jonë s'kishte «pretendime» të mëdha ndaj shkencës dhe shkenca jonë e kishte fort të vështirë të merrte përsipër probleme nga ato që nxjerr zakonisht një prodhim modern. E meta e përmendur është shfaqur, konkretisht, në dy aspekte në praktikën ekzistuese të planifikimit, prandaj, për korrigjimin e saj, është e nevojshme të kërkojmë që, nga njëra anë, planet ekonomike të vënë detyra konkrete për punën shkencore dhe, nga ana tjetër, planet shkencore ta paraprijnë më mirë zhvillimin e harmonizuar të ekonomisë, të ndihmojnë për hartimin sa më shkencor të planeve të të gjitha niveleve. Në mënyrë të veçantë, të planifikojmë studime prognozë e afatgjatë, që të mos jemi të zbuluar, siç ndodh disa herë, kur detyrohemi të zgjerojmë ndonjë uzinë, pa pasur në dorë studimin paraprak, të plotë e largpamës të perspektivës së saj, kur, për projektimin e disa fabrikave të kryera nga institucionet studimore, pajtohemi me mbajtjen për bazë, kryesisht, të teknologjisë ekzistuese, qoftë edhe të vjetruar, sepse mungojnë kërkimet për një teknologji të re më të përparuar. Për mënjanimin e defekteve të mësipërme, është e nevojshme të shikohet metodologjia e planifikimit të punës shkencore, në mënyrë që të evidentohen sa më qartë objektivat që i vihen shkencës, investimet që bëhen për të dhe efektiviteti i kërkimeve shkencore.

Përsosja e mëtejshme e planifikimit të punës shkencore është e pandarë nga përsosja e bashkërendimit të kësaj pune, si brenda çdo ndërmarrjeje e institucioni, dege të ekonomisë popullore, dikasteri, ashtu edhe ndërmjet tyre. Në bashkërendimin e punës kërkimore nuk përfshihet vetëm kërkesa elementare e bashkërendimit të planeve për të mënjeluar punët paralele ose të kryera. Këtu, në radhë të parë, është problemi i drejtimit të temave të mëdha e komplekse, në të cilat gërshetohen shumë shkenca të përafërta, kryesore dhe ndihmëse, teorike dhe aplikative. Përvoja e deritanishme e studimit dhe e projektimit të hidrocentraleve, e projektimit të portit të ri të Vlorës etj., për të cilat bashkëpunojnë disa institucione kërkimore e projektuese, e shqyrtimit nga aspekte të shkencave të ndryshme e mjaft problemeve të naftës, të gjeologjisë, të bujqësisë etj. vërteton më së miri se, po ta organi-

zojmë punën më me përpikëri, me një disiplinë më të fortë shkencore dhe me kërkesa më të rrepta llogarive se deri tani, i kemi të gjitha mundësitë të kryejmë me sukses të tilla studime komplekse dhe në fusha të tjera të rëndësishme.

Rezervë e pashfrytëzuar si duhet, për një bashkërendim më racional të forcave të kualifikuara, është ndërthurja më efektive e punës shkencore të disa katedrave të veçanta të shkollës së lartë me veprimtarinë e institucioneve shkencore, që bëjnë kërkime në të njëjtën fushë me to. Kështu, s'ka arsye që bashkëpunimi ose kërkesat e herëpashershme për ndihmë reciproke të mos konkretizohen në një integrim të vërtetë të punës shkencore, fjala vjen, katedra e naftës me Institutin e Naftës e të Gazit, katedra e gjuhës shqipe dhe ajo e historisë së Shqipërisë me institutet përkatëse të Akademisë, katedrat e gjeologjisë e të minierave me institutet korresponduese etj.

Planifikimin më të studiuar të punës shkencore e bashkërendimin më të përsosur të kërkimit mund t'i zhvlehtësojë një kooperim i paorganizuar. Studimet shkencore nuk janë qëllim në vetvete. Ato kryhen për t'u vënë në jetë. Për mishërimin teknik e teknologjik të rezultateve të sotme të shkencës, kërkohet angazhimi i shumë uzinave e ndërmarrjeve në shkallë dikasteriale ose ndërdikasteriale, për të shfrytëzuar në mënyrë optimale specializimin e arritur në nomenklaturën e prodhimit dhe në bazën materiale që disponohet. Duhet thënë se kooperimi është hallka jonë më e dobët, që pengon seriozisht rritjen e efektivitetit të shkencës. Ai është shtyrë përpara me vështirësi, me humbje kohe, me shqetësime, me ndërhyrje deri të organeve të larta shtetërore, sepse, praktikisht, është konceptuar, hera-herës, sipas një mentaliteti jo të kohës dhe, rrjedhimisht, nuk është planifikuar ashtu siç e kërkon ekonomia socialiste, me parashikimin e plotë të ndërmarrjeve e të sektorëve që kooprojnë, të mjeteve, të lëndës së parë, të materialeve të nevojshme të importit etj.

Zgjerimi i punës shkencore duhet shoqëruar me përmirësime të vazhdueshme, të organizmave e të strukturave përkatëse të saj, me vënien e tyre më mirë në rolin që u takon. Vitet e fundit, në përputhje me problematikën dhe për të siguruar një profilizim më të studiuar, janë riorganizuar disa institute kërkimore, janë ngritur dhe janë forcuar institute, qendra e sektorë të veçantë. Këto masa e kanë çuar punën më përpara. Ne duhet të përgatitemi me kohë për krijimin e sektorëve të tjerë shkencorë për mbulimin e aktiviteteve të reja të rëndësishme, që i imponon zhvillimi i ekonomisë, i teknikës dhe i kulturës.

Shkenca e përligj vetveten plotësisht kur ajo ka një efek-

tivitete shoqërore të lartë. Pas Kongresit të 7-të të Partisë dhe, veçanërisht, pas fjalës së shokut Enver, në tetor 1977, për thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor, kanë ndodhur ndryshime të dukshme edhe në rritjen e efektivitetit të shkencës në të gjitha sferat e jetës. Ne kemi sot mjaft institucione shkencore, si: në industri, në bujqësi apo në ndërtim, kemi grupe studimi, byro teknike e teknologjike që punojnë me të vërtetë me një rendiment e me efektivitet të lartë, duke zgjidhur probleme themelore, që i kanë sjellë ekonomisë përfitime të mëdha.

Por nuk mund të thuhet se punojnë kështu të gjitha institucionet e organizmat tanë shkencorë. Ka prej tyre që, ndonëse janë ngritur shumë vjet më parë, nuk e kanë justifikuar veten me studime serioze dhe me rezultate konkrete në prodhim siç janë, për shembull, institutet kimiko-teknologjike dhe disa ekspedita gjeologjike në industri, stacionet e foragjereve, të pyjeve e të frutikulturës në bujqësi. Edhe disa grupe pune të revolucionit tekniko-shkencor, pranë dikastereve e ndërmarrjeve të ndryshme, janë prapa me studimin e temave të ngarkuara. Po kështu qëndron puna edhe në disa institucione të shkencave shoqërore, ku ngarkesa vjetore dhe rendimenti i punës janë të ulët, gjë që pasqyrohet në botimet e tyre të kufizuara. Kudo në ekonomi ne kërkojmë rendiment dhe efektivitet. Këtë nuk mund të mos e kërkojmë edhe në shkencë. Dikasteret dhe organet e tjera shtetërore duhet t'i vlerësojnë e t'i orientojnë drejt organizmat shkencorë, t'u japin atyre ndihmën e nevojshme, për ta bërë punën e tyre sa më të frytshme.

Nuk duhet lejuar që institutet dikasteriale të merren me çështje anësore, me punë të dorës së dytë, me të cilat i ngarkojnë drejtoritë operative, që i kanë në varësi. Këto institute duhet të merren me problemet e mëdha të kërkimit teknologjik, të krijimit të teknikës së re, të mekanizimit, të vlerësimit kompleks të lëndëve të para të vendit e të shfrytëzimit të tyre optimal etj.

Në procesin e thellimit të revolucionit tekniko-shkencor është fituar një përvojë e re në lëmin e organizimit me krijimin e këshillave tekniko-shkencorë e të grupeve të punës kërkimore, studiuese e projektuese. Ato kanë bërë një punë vërtet të dobishme, por, për të rritur më tej efektivitetin e tyre, duhet të merren më seriozisht me punën që u është ngarkuar dhe jo me probleme operative e administrative. Për të rritur autoritetin shkencor dhe kompetencën profesionale të këshillave shkencorë, në to të ketë më shumë specialistë të aftë e shkencëtarë e më pak punonjës të aparateve. Grupet e punës kërkimore të kenë fizionomi më të qartë si bërthama

studimi, të jenë më të disiplinuar shkencërisht, të udhëhiqen gjithnjë nga kadro të përgatitur e me përvojë dhe të forcohen ndihma e kontrolli shtetëror për veprimtarinë e tyre.

Një veprimtari kaq dinamike kërkimore-shkencore kërkon edhe një drejtim më të organizuar e të centralizuar të punës shkencore në shkallë kombëtare. Shkenca është një veprimtari që futet në të gjithë sektorët dhe i kalon kufijtë e secilit, prandaj zhvillimi i saj, si dhe i teknikës e i teknologjisë, që lidhen ngushtë me të, ka nevojë edhe për një organizim e drejtim mbisektorial.

Në këtë fushë Akademia e Shkencave ka bërë një punë bashkërenduese e konsultuese, por tani që vëllimi i kësaj pune është rritur shumë, ajo nuk mund ta kryejë këtë detyrë. Akademia e Shkencave është institucion i mirëfilltë kërkimor, që ka, në radhë të parë, si funksion studimin dhe kërkimin në fusha të ndryshme të shkencës. Problemet e bashkërendimit dhe të kooperimit, si edhe probleme të tjera që ndërthuren me to, siç janë ato të investimeve, të bazës materialo-laboratorike, të kuadrit, të vënies në jetë të rezultateve të studimeve e të kërkimeve shkencore etj., mund të zgjidhen vetëm atëherë kur organi i ngarkuar me to të ketë kompetenca të plota administrative.

Në këto rrethana, lind nevoja për krijimin e një organizmi tjetër, që mund të ishte një komitet për shkencën e për teknologjinë, pranë Këshillit të Ministrave, ose ky komitet, në të cilin do të bënin pjesë shkencëtarë të shquar, do të kishte si detyrë përpunimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të shkencës dhe të revolucionit tekniko-shkencor në vendin tonë, në përputhje me politikën e Partisë dhe me planet tona të zhvillimit ekonomik, me bashkërendimin e forcave shkencore, të mjeteve financiare e të bazës materiale etj. Organizimi i tij nuk nënkupton aspak krijimin e organizmave të tjerë të drejtimit të punës shkencore në dikastere, në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve apo në ndërmarrje, veç atyre ekzistueseve.

Akademia duhet të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm si institucioni më i lartë i kërkimit shkencor. Zhvillimi i ekonomisë sonë, nevoja për të ecur në një hap me zhvillimin e shkencave natyrore e teknike në shkallë botërore, kërkojnë që edhe Akademia e Shkencave, krahas forcimit të institucioneve ekzistuese, të zgjerojë sistemin e saj me ngritjen e institucioneve ose të sektorëve shkencorë të rinj për shkencat natyrore e teknike, që të trajtojnë problemet më themelore të tyre.

Në kompleksin e çështjeve që po shqyrtojmë, **hallkë e dorës së parë është përgatitja e kualifikimi i kuadrit.** Në kushtet

kur vëllimi i dijeve shkencore dyfishohet çdo 8-10 vjet, kur në botë e në vendin tonë ndodhin ndryshime të shpejta në pajimin teknik e në teknologji, kur metodat e vjetra ua lënë vendin metodave shumë më efikase të kërkimit, shkolla jonë e lartë është e detyruar të ngrejë, vazhdimisht, nivelin ideoshkencor të përgatitjes së specialistëve. Për këtë, ajo duhet të përpiqet më shumë për forcimin e bazave teorike të të gjitha disiplinave mësimore, në pajtim me zhvillimin e sotëm të shkencave përkatëse, si dhe për rritjen e peshës specifike të dijeve shkencore, nëpërmjet dhënies së koncepteve e teorive më përgjithësuese, metodave me spektër të gjerë zbatimesh, si dhe zhveshjes së lëndëve nga materiali përshkrues. Kjo do të arrihet kur të përdoren edhe metoda të reja e më efikase të mësimdhënies. Në të gjitha këto drejtime shkolla e lartë duhet të rritë përpjekjet për t'iu përgjigjur edhe më mirë kërkesave, që shtrohen sot për përgatitjen e kuadrove të kualifikuar.

Probleme të pazgjidhura si duhet janë cilësia akoma e ulët e përvetësimit të dijeve dhe qëndrueshmëria e pamjaftueshme e tyre në një masë jo të vogël studentësh, te të cilët mungon interesimi i nevojshëm për të arritur rezultate sa më të larta në mësim. Defekt, që duhet korrigjuar, është liberalizmi në kërkesat, veçanërisht në ushtrimet, në detyrat, në punët laboratorike, në seminarët etj., ku studenti aftësohet për të përdorur gjërat e njohura në situata të panjohura. Një ndër kërkesat që shtrun sot jeta ndaj kuadrit të ri është që ai të merret me punë shkencore. Prandaj është e nevojshme që shkolla e lartë të përmirësojë rrënjësisht aftësimin fillestar të masës së studentëve në kërkimin e pavarur, ta ndërtojë këtë të fundit me një problematikë reale, me interes dhe me shkallëzimin e nevojshëm, nga viti në vit.

Zgjerimi i veprimtarisë sonë në fusha të tjera do të kërkojë krijimin e profileve të reja, ose ndonjë specializim më të thelluar në profilet ekzistuese, prandaj arsimit i lartë duhet të marrë masa t'u dalë përpara me kohë nevojave që lindin.

Kualifikimi i mëtejshëm i të gjithë kuadrove është i pandarë nga angazhimi i tyre në punën kërkimore-shkencore dhe në zgjidhjen e problemeve që shtrun revolucionin tekniko-shkencor. Vetëm puna me kërkesa të larta e vë në lëvizje kuadrin, e detyron të studiojë, të zgjerojë e të thellojë kulturën e vet, të mprehë aftësitë krijuese. Kuadri që s'është në vendin që i takon, ose kryen një punë rutinë, pa asnjë sforcim intelektual, ose, në vend ta rritë, e humbet gradualisht dhe kualifikimin e fituar. Për këtë arsye, vendosja sipas aftësive dhe përdorimi i drejtë i kuadrit janë nga detyrat më të rëndësishme të punës së Partisë. Këtu kemi të meta. Ka ende mjaft kadro që

nuk bëjnë punë plotësisht të kualifikuar jo vetëm në ndërmarrjet e në institucionet e bazës, por edhe në institucionet kërkimore-shkencore. Kjo ndodh edhe për shkak të paaftësisë së ndonjë kuadri, por, ndonjëherë, edhe për shkak të një përdorimi joracional të kuadrit të lartë.

Një angazhim më serioz në punën shkencore kërkohet, veçanërisht, nga pedagogët e shkollës së lartë. Nuk mund të jetë kurrësi pedagog i mirë ai që nuk ka interesa kërkimore në shkencën që përkon me disiplinën mësimore që jep. Duhet thyer koncepti se pedagogu është «në rregull» me detyrën kur plotëson normën mësimore, pavarësisht se nuk boton asnjë faqe studimi në vit, por duhen krijuar edhe kushte më normale ngarkese që ai të merret efektivisht me punë shkencore. Zgjerimi i veprimtarisë shkencore në shkollën e lartë dhe lidhja më harmonike e saj me tërë jetën shkencore të vendit dhe me problemet e revolucionit tekniko-shkencor janë domosdoshmëri pa të cilat nuk do të kemi rritje efektive të kualifikimit të pedagogëve dhe përgatitje të kualifikuar të specialistëve të ardhshëm. Prandaj katedrat e shkollave të larta duhet të marrin fizionominë e plotë të njësive shkencore, sepse, kështu, do të kryejnë edhe më mirë rolin e tyre si njësi mësimore dhe edukative.

Shkollat e larta dhe institucionet kërkimore-shkencore nuk janë vende rehatie dhe ku mund të punojë kushdo. Për zgjedhjen e kuadrit të këtyre sektorëve komitetet e Partisë dhe organet shtetërore duhet të kenë një koncept të drejtë, pasi deri më sot ka ndodhur që në këta organizma janë caktuar dhe kuadro e specialistë të paaftë e të papërgatitur, ashtu siç ka pasur pakujdesi në plotësimin e organikave të tyre. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të kenë parasysh se specialistët e paaftë, që nuk kanë pasion e dëshirë për punë shkencore, ulin efektivitetin e punës shkencore dhe kultivojnë mediokritetin. Në të njëjtën kohë, në këto institucione, nuk duhet nënvleftësuar as aparati ndihmës e teknik, pasi nga puna e tyre varen rendimenti dhe cilësia e punës së studiuesve.

Rritja e nivelit të punës kërkimore, e rendimentit dhe e efektivitetit të saj, zgjidhja e problemeve të ndërlikuara të revolucionit tekniko-shkencor shtrojnë me forcë problemin e kualifikimit pasuniversitar dhe specializimin e disa kuadrove të veçantë në profile më të ngushta. Shkolla e lartë dhe institucionet e ndryshme shkencore duhet të merren seriozisht me kualifikimin dhe me specializimin e kuadrit të lartë, ta ndërtojnë këtë punë me plane e me programe të posaçme, të realizuara në rrugët më të përshtatshme. Tani është bërë urgjente që të studiohen nevojat për të gjitha llojet e speciali-

zimeve të ngushta, me qëllim që të kemi në dorë një plan afatgjatë për t'u dalë punëve përpara.

Specializimi i kuadrit, brenda vendit ose jashtë shtetit, duhet të shoqërohet me ngritjen e një aktiviteti të ri, me transmetimin e dijeve dhe të përvojës së fituar në një rreth më të gjerë kuadrosh dhe të mos ndodhë që, për shkak të rutinës dhe të liberalizmit në kërkesat, specializimi i kuadrit të mbetet vetëm një përfitim thjesht personal.

Ndër faktorët që ndikojnë për zgjerimin dhe për ngritjen e nivelit të kërkimeve shkencore, i rëndësishëm është edhe përvetësimi e shfrytëzimi, i mbështetur në parimet tona, i progresit shkencor dhe teknik botëror. Kjo është një çështje e shtruar me kohë e me ngulm nga Partia dhe shoku Enver.

Për këtë, një kusht i rëndësishëm është zotërimi i gjuhëve të huaja, për të cilat duhet të rritin përpjekjet vetë specialistët, në rrugë e në forma të ndryshme. Por zgjidhja e plotë e këtij problemi duhet kërkuar në kthesën rrënjësore të punës së shkollës sonë, që vazhdon të ketë dobësi në këtë drejtim.

Një hallkë tjetër është sistemi i informimit shkencor për të rejat dhe për arritjet e shkencës në katedra, në institucione e në sektorë shkencorë, në ndërmarrje etj. Informimi ynë shkencor do të mbetet në një fazë artizanale në qoftë se nuk do të mbështetet edhe në një shërbim të organizuar e të specializuar. Kjo çështje kërkohet të studiohet e të konkretizohet nga Këshilli i Ministrave dhe nga Akademia e Shkencave.

Zhvillimi i kërkimit shkencor lidhet ngushtë me krijimin e një baze të përshtatshme laboratoriko-eksperimentale. Fuqizimi i mëtejshëm i kësaj baze duhet parë në gjithë gjerësinë e vet. Ne duhet ta ripërtërijmë e ta modernizojmë atë me aparaturë të re, sepse s'mund të kuptohen metodat e reja në fushën e kërkimit e të eksperimentimit pa pajisjet e sotme, që japin rezultate të sakta e të shpejta. Në veçanti shkolla e lartë nuk mund të ngrëjë nivelin teorik e praktik të mësimit e të punës së vet, po s'e mbështeti atë në laboratore që t'i përgjigjen këtij niveli. Krahas sjelljes nga jashtë të aparaturave të nevojshme, duhet të organizojmë në vend prodhimin e gjerë të pajisjeve të përdorimit masiv, në mënyrë që të krijojmë mundësi reale për plotësimin gradual me aparatura minimale të nevojshme edhe të njësive të prodhimit.

Që shkencat tona të ngrënë më tej nivelin e tyre, është e domosdoshme të mbështeten në një dokumentacion sa më të pasur. Lidhur me këtë, është veçanërisht i mprehtë problemi i sistemimit të arkivave, si për shkencat shoqërore, ashtu edhe për shkencat teknike, ku dobësitë janë më të mëdha. Duhet marrë masa që në arkivat e të gjitha organeve të Partisë, të organizmave shtetërore, ekonomike dhe shkencorë, gjithë doku-

mentacioni të ruhet e të sistemohet me kritere shkencore, me qëllim që ai t'u shërbejë sa më mirë studimeve për sot e në perspektivë.

Një vëmendje e posaçme i duhet kushtuar zgjerimit të botimeve të ndryshme shkencore, origjinale ose të përkthyer. Aktualisht, te ne botohet një numër jo i vogël revistash, buletinesh e almanakësh shkencorë nga Akademia e Shkencave, nga universiteti e shkollat e tjera të larta dhe nga ministritë. Puna që ato bëjnë është mjaft e dobishme dhe i shërben një rrethi të gjerë specialistësh e lexuesish të thjeshtë. Por, në qoftë se deri tani ato janë shtrirë në gjerësi, këtej e tutje duhet të zhvillohen në thellësi. Fjala është për një specializim e profilizim më të mirë të tyre, për forcimin e për aktualizimin e përmbajtjes, për rritjen përgjithësisht të nivelit shkencor të tyre.

Të gjitha problemet, që nxjerr zhvillimi i tanishëm i veprimtarisë shkencore në vendin tonë, duhet të jenë objekt i një shqyrtimi dhe interesimi shumë të vëmendshëm nga ana e komiteteve dhe e organizatave të Partisë.

Partia ka përcaktuar qartë objektivat e shkencës sonë e të revolucionit tekniko-shkencor. Ata gjenden të sintetizuar në vijën e përgjithshme të saj për ndërtimin e socializmit, në politikën ekonomike dhe në planet korente e perspektive të zhvillimit të vendit. Partia ka dhënë vazhdimisht direktiva dhe orientime të përpikta për drejtimet dhe për rrugët më racionale që duhet të ndjekë veprimtaria shkencore për arritjen e objektiveve të caktuara. Kuptimi i drejtë dhe zbatimi i këtyre direktiveve dhe orientimeve përbën detyrën kryesore të organizatave të Partisë për udhëheqjen e punës shkencore.

Por, për ta kryer si duhet këtë detyrë, komitetet dhe organizatat e Partisë duhet t'i kuptojnë e t'i vlerësojnë më mirë se deri sot rëndësinë dhe rolin e veprimtarisë shkencore, si kusht i domosdoshëm për tërë zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit. Në veprimtarinë e tyre problemet e shkencës e të revolucionit tekniko-shkencor duhet të zënë një vend më të madh dhe të shqyrtohen me një nivel më të kualifikuar. Organizatat e Partisë, edhe vetë, të bëjnë më shumë studime e përgjithësime për probleme politike, ideologjike, ekonomike e shoqërore, pa të cilat nuk mund t'i zgjidhin me sukses problemet e ndryshme që dalin para Partisë dhe nuk mund të realizojnë një udhëheqje të kualifikuar. Në të njëjtën kohë, ato duhet të bëjnë që me punën kërkimore-shkencore të merren më shumë e më mirë, sidomos, organet shtetërore dhe ekonomike, dikasteret qendrore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore.

Për zbatimin e mirë të direktiveve ose të orientimeve të Partisë, organizatat e Partisë nuk duhet të kënaqen vetëm me përcaktimin e një tematike të përshtatshme studimesh shkencore. Ky është fillimi i punës. Kryesorja është që organizatat e Partisë të ndalen në përmbajtjen e veprimtarisë shkencore dhe në efektivitetin e saj. Këtu duhet luftuar formalizmi që vihet re, kur disa organizata partie dhe organe shtetërore kënaqen me ndonjë informacion të përgjithshëm apo me ndonjë «listë» realizimi të temave. Formalizmi luftohet kur kërkohen përgjigje të sakta për pyetjet: «Ç'gjë të re i solli shkencës sonë kjo temë?», «Ç'hap të ri hodhi prodhimi ynë?», «Ç'përmirësim teknik a teknologjik ishte pasojë e këtij studimi?», «Ç'perspektiva të reja hapen për ekonominë, për mbrojtjen ose për kulturën tonë, po të vihen në jetë konkluzionet e këtij punimi shkencor?» etj. Vetëm kur krijohet një atmosferë e tillë, mund të luftohen me sukses konceptet e «shkencës për shkencë», e një «shkencë» shterpë, që zhvillohet larg nevojave reale të vendit, koncepte që, në analizë të fundit, e pengojnë vetë përparimin shkencor.

Masivizimi i shkencës është aspekt kryesor i politikës shkencore të Partisë, prandaj organizatat-bazë duhet të arrijnë që çdo kolektiv inxhinierësh, ekonomistësh, mësuesish, mjekësh e të tjerë, të jetë një organizëm veprues shkencor, që puna shkencore të kthehet në një detyrë funksionale, në një normë e kriter të rëndësishëm për vlerësimin e punës së tyre. Sigurisht, kjo s'bëhet me dekret, por duke i edukuar dhe duke i nxitur njerëzit, duke i ngarkuar me punë, duke krijuar atë atmosferë të ngrohtë interesimi, inkurajimi për të kapërcyer vështirësitë, për të cilën ka aq nevojë veprimtaria kërkimore-shkencore.

Realiteti ynë dhe arritjet tona shkencore e teknike i lejojnë organizatat e Partisë që, me një propagandë të shkathët, të krijojnë te të gjithë besimin e vetëdijshëm në forcën e vërtetë të shkencës dhe në mundësitë që secili të përfshihet dhe të kontribuojë në revolucionin tonë tekniko-shkencor. Bindja e të tjerëve fillon nga bindja e komunistëve. Kjo e vërtetë është provuar nga përvoja jonë edhe për veprimtarinë shkencore. Në ata kolektiva ku komunistët kanë qenë në ballë të përpjekjeve dhe janë aktivizuar vetë tërësisht në revolucionin tekniko-shkencor, kemi edhe jetë më të gjallë shkencore, edhe pjesëmarrje më masive të njerëzve në të.

Një kujdes i veçantë duhet treguar për novatorët e për racionalizatorët, puna e të cilëve nuk është vetëm materiale e teknike, por, në të njëjtën kohë, edhe shkencore. Është e nevojshme që organizatat e Partisë të bëjnë që mendimi i punëtorëve dhe i kooperativistëve pararojë, i mjeshtërve dhe i

specialistëve të zotë të dëgjohej më mirë dhe të luftohet mendimi mediokër, i prapambetur i njerëzve që nuk duan t'i nxjerrin telashe vetes e që bëhen pengesë për përparimin e ekonomisë e të kulturës. Pa një edukim të vazhdueshëm, të përditshëm, progresiv në zhvillimin e intelektit dhe në zgjerimin e në pasurimin e pandërprerë të praktikës së të gjithëve, organizatat e Partisë nuk do të jenë në lartësinë e detyrës së tyre në fushën e veprimtarisë shkencore.

Zhvillimi i pandërprerë i shkencës lidhet ngushtë me studimin dhe me përgjithësimin e përvojës së përparuar, e cila është një gur themeli mbi të cilin ngrihet, zhvillohet dhe pasurohet shkenca jonë kombëtare. Në çdo përvojë të përparuar gjen jo vetëm qëndrim e ndërgjegje komuniste, por edhe punë, drejtim e organizim shkencor, që shprehen në rezultatet konkrete e më të larta në prodhim dhe në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme ekonomike.

Përhapja e përvojës së përparuar realizohet me sukses, po qe se me të merren njerëzit që e kuptojnë nevojën dhe rëndësinë e saj, njerëzit që nuk u tremben vështirësive, ata që dinë të depërtojnë në thelbin, në esencën dhe në rëndësinë e përvojës së përparuar e që luftojnë, deri në fund, për ta vënë atë në jetë. Ta kuptosh, ta vlerësosh e pastaj ta zbatosh përvojën e përparuar, do të thotë të kuptosh e të vlerësosh aftësitë krijuese të masave punonjëse, të zbatosh në praktikë mësimin e Partisë se revolucionin teknik e shkencor, ashtu si çdo revolucion, e bëjnë masat, se ai është vepër e masave të udhëhequra nga Partia.

Kusht i domosdoshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të shkencës e të teknikës ka qenë dhe mbetet mbështetja në ideologjinë tonë.

«Revolucioni tekniko-shkencor në vendin tonë socialist, — thotë shoku Enver, — nuk synon çfarëdolloj zhvillimi të elementeve materiale të forcave prodhuese, të shkencës dhe të teknikës, por një zhvillim të tillë që të përputhet me ideologjinë dhe me interesat e klasës punëtore, me zhvillimin dhe përsosjen në rrugë revolucionare të marrëdhënieve socialiste në prodhim»¹.

Prej këndej rrjedh qartë se organizatat e Partisë, në ndërmarrje e në institucionet kërkimore duhet të ndjekin kurdoherë me vëmendje e të shqyrtojnë me këtë sy përmbajtjen e punës shkencore. Ato duhet të luftojnë që shkencat tona të mbështeten fort në botëkuptimin dhe në dialektikën materialiste, në

1 Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1976-1977», f. 402.

parimet e metodologjisë marksiste-leniniste. Mbështetja në parimet e marksizëm-leninizmit është e domosdoshme për të gjitha shkencat, jo vetëm për ato shoqërore, por edhe për ato natyrore-teknike.

Të udhëhiqesh nga metodologjia marksiste-leniniste do të thotë që kërkimet e studimet shkencore t'u përmbahen parimeve themelore të saj, siç janë: objektiviteti shkencor, njohja e jetës dhe pasqyrimi i saj me vërtetësi; trajtimi materialist dialektik i fakteve e i ngjarjeve; partishmëria proletare, analiza klasore e problemeve dhe e fenomeneve. Vetëm duke përvetësuar e duke zbatuar këto parime, shkencat tona do të ecin gjithnjë përpara dhe do të arrijnë suksese të reja.

Ruajtja e pastërtisë ideologjike të shkencës sonë dhe zhvillimi i saj në rrugën marksiste-leniniste shtron kërkesën që të rriten në një nivel më të lartë kritika dhe debati shkencor. Gjendja e tyre e sotme, si në shtyp, ashtu edhe në aktivitetet e ndryshme shkencore, nuk u përgjigjet si duhet kërkesave të kohës. Prandaj organizatat e Partisë dhe organet drejtuese të institucioneve shkencore duhet të nxitin dhe të inkurajojnë kritikën shkencore parimore dhe të krijojnë për këtë qëllim një atmosferë sa më të favorshme.

* * *

Problemet që shtrohen për diskutim në këtë Plenum janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës sonë socialiste, për të gjithë jetën e vendit. Shoqëria e re, që ne ndërtojmë, nuk mund të kuptohet e të zhvillohet pa u mbështetur në shkencën. Por, në të njëjtën kohë, socializmi është i vetmi rend që krijon të gjitha kushtet dhe hap rrugët më të gjera për zhvillimin e vrullshëm e të gjithanshëm të shkencës e të teknikës. Revolucioni tekniko-shkencor është pjesë përbërëse e pandarë e revolucionit dhe e ndërtimit të socializmit.

Epërsitë e rendit socialist dhe kujdesi i madh i Partisë e i pushtetit popullor përbëjnë atë garanci e siguri të madhe që detyrat e zhvillimit e të rritjes së shkencave tona të realizohen me sukses. Por arritja e objektivave, që do të caktojë ky Plenum, do të kërkojë mobilizimin e angazhimin e të gjitha forcave krijuese, të shkencëtarëve, të specialistëve e të punëtorëve tanë të talentuar, do të kërkojë përmirësimin e udhëheqjes së Partisë dhe të drejtimit shtetëror të të gjithë punës shkencore.

Partia është e bindur se njerëzit tanë të shkencës e të

teknikës, të edukuar nga Partia me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me frymën e patriotizmit socialist, në vendimet e këtij Plenumi do të gjejnë frymëzime e nxitje të reja për të çuar më përpara krijimtarinë e tyre në të gjitha fushat, për të dhënë kontribute edhe më të mëdha në luftën e popullit tonë për ndërtimin e për përparimin e atdheut socialist dhe për fuqizimin e mbrojtjes së tij.

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 153 (9953), 27 qershor 1980

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «TË NGREMË NIVELIN E PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE DHE TË RRRITIM EFEKTIVITETIN E SAJ PËR ZHVILLIMIN AKTUAL E PERSPEKTIV TË VENDIT»

25 qershor 1980

Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 24 e 25 qershor 1980, pasi dëgjoi e shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i KQ të PPSH, shoku Ramiz Alia,

Vendosi:

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit».

2. — Të porositë organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore e të ekonomisë, si dhe institucionet kërkimore-shkencore që të marrin të gjitha masat e duhura për të zbërthyer dhe për të vënë në jetë detyrat që dalin prej tij.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TREGUESI I LËNDËS

	Faqe
Parathënie	5
1976	
1. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH «Mbi uljen e pagave të larta, mbi disa përmirësime në sistemin e pagave të punonjësve dhe mbi ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit». 22 mars 1976.....	9
2. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa masa për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit në fushën e sigurimeve shoqërore-shtetërore». 26 prill 1976.....	17
3. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Edhe një herë mbi kujdesin që duhet treguar me letrat e popullit». 9 qershor 1976	19
4. Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 19-20 korrik 1976	
— Komunikatë	23
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH mbi thirrjen e Kongresit të 7-të të zakonshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë. 20 korrik 1976	24
5. Plenumi i 10-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 12-14 tetor 1976	
— Komunikatë	26
6. Kongresi i 7-të i Partisë së Punës të Shqipërisë. Tiranë, 1-7 nëntor 1976	27
— Raport i mbajtur në Kongresin e 7-të të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha	

«Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë», 1 nëntor 1976.....	29		
— Vendim i Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH». 6 nëntor 1976.....	190		
— Vendim i Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit «Mbi direktivat për planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1976-1980». 6 nëntor 1976.....	191		
— Vendim i Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit të Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të PPSH. 6 nëntor 1976.....	192		
— Vendim i Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë mbi miratimin e direktivave për planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1976-1980. 6 nëntor 1976.....	193		
— Vendim i Kongresit të 7-të të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi disa ndryshime në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë». 6 nëntor 1976.....	194		
— Direktivat e Kongresit të 7-të të PPSH mbi planin e gjashtë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1976-1980. 6 nëntor 1976.....	195		
7. Protokoll i Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH për zbatimin e udhëzimit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e lidhjeve midis organeve dhe organizatave-bazë të Partisë të ushtrisë, me organet dhe organizatat-bazë të terrenit». 22 dhjetor 1976.....	210		
1977			
8. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi organizimin e kontrollit punëtor e fshatar për problemin e drithërave të bukës». 13 janar 1977.....	216		
9. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi fushatën e zgjedhjeve të këshillave dhe të gjykatave popullore». 26 janar 1977.....	219		
10. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa probleme që dalin nga përgjithësimi i përvojës së deritanishme të kooperativeve të tipit të lartë». 3 shkurt 1977.....			223
11. Protokoll i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi përbërjen e organeve të zgjedhura të Partisë për vitin 1976». 3 shkurt 1977.....			228
12. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi gjendjen dhe disa drejtime për zhvillimin e mëtejshëm të botimeve politiko-shoqërore». 25 maj 1977.....			235
13. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi përkujtimin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare, të themeluar në Prizren». 14 qershor 1977.....			242
14. Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 28-29 qershor 1977.....			
— Komunikatë.....			243
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për miratimin e raportit «Mbi plotësimin e pritshëm të planit të gjashtëmuajorit të parë dhe mbi masat për të plotësuar planin vjetor». 29 qershor 1977.....			244
15. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përsosjen e sistemit të planifikimit». 19 shtator 1977.....			245
16. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës në ndërmarrjet bujqësore». 21 shtator 1977.....			251
17. Konkluzione të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përgatitjen, shpërndarjen, përdorimin dhe kualifikimin e specialistëve, siç domos të atyre me arsim të lartë e të mesëm». 25 tetor 1977.....			257
18. Vendim i Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi masat për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor». 27 tetor 1977.....			262
19. Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 17-18 nëntor 1977.....			
— Komunikatë.....			269
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të forcojmë punën e Partisë për edukimin e komunistëve dhe të kuadrove». 17 nëntor 1977.....			270
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Devijimi i Kinës nga marksizëm-leninizmi dhe nga rruga socialiste». 18 nëntor 1977.....			309

20. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi kujdesin për organizatën e veteranëve dhe për veteranët pensionistë». 12 janar 1978	310
21. Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 30-31 janar 1978	
— Komunikatë	313
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi dhënien llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978». 30 janar 1978	314
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi dhënien llogari për plotësimin e detyrave të planit të vitit 1977 dhe mbi detyrat e planit të vitit 1978». 31 janar 1978	343
22. Konkluzione të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi disa probleme të emancipimit të plotë të gruas». 25 shkurt 1978	344
23. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të organizatave të masave për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 7-të të PPSH». 27 shkurt 1978	349
24. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi zbatimin e detyrave që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë për përmirësimin e mëtejshëm të punës në sektorin e fizkulturës e të sporteve». 27 shkurt 1978	354
25. Vendim i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi masat për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit për prodhimin dhe për grumbullimin e pambukut». 4 mars 1978	359
26. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH «Për plotësimin e detyrave të planit për prodhimin dhe për grumbullimin e panxharsheqerit». 4 mars 1978	365
27. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi fuqinë blerëse të popullsisë, mbulimin e saj me mallra e me shërbime, mbi qarkullimin monetar dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të tyre». 27 mars 1978	370
28. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi punën e organizatave të Partisë për edukimin ideologjik e politik të punonjësve	

në ndërmarrjet e transportit të jashtëm detar e automobilistik». 29 mars 1978

29. Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 26-27 qershor 1978	376
— Komunikatë	380
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi punën e bërë për zbatimin e vendimeve të plenumeve të 5-të dhe të 6-të të Komitetit Qendror të Partisë, të vitit 1974, dhe të detyrave që shtroi Kongresi i 7-të i Partisë për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes së vendit». 27 qershor 1978	381
30. Letër e KQ të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Qeverisë së RPS të Shqipërisë drejtuar KQ të Partisë Komuniste të Kinës dhe qeverisë kineze. 29 korrik 1978	382
31. Përshëndetje e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë drejtuar shokut Enver Hoxha, me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes së tij. 16 tetor 1978	417
32. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi caktimin e raporteve kryesore të pagave të nëpunësve në krahasim me ato të punëtorëve dhe të kooperativistëve». 6 dhjetor 1978	423

1979

33. Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 29-30 janar 1979	
— Komunikatë	424
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979». 29 janar 1979	425
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi plotësimin e planit të vitit 1978 e të tre vjetëve të pesëvjeçarit të gjashtë, të marrë së bashku, dhe masat për realizimin e detyrave të vitit 1979». 30 janar 1979	444
34. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi përdorimin e stimujve moralë». 13 mars 1979	445
35. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH «Për festimin e 100-vjetorit të lindjes së J. V. Stalinit». 20 mars 1979	448

36. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi festimin e 35-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor». 20 mars 1979	452
37. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi disa përmirësime në sistemin e pagave dhe për ngushtimin e mëtejshëm të dallimeve midis fshatit dhe qytetit». 5 korrik 1979	456
38. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi prodhimin, kursimin dhe mundësitë e shtimit të eksportit të lëndëve energjetike». 13 tetor 1979	458
39. Konkluzione të Sekretariatit të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi përmirësimin e punës në bashkimet profesionale». 29 tetor 1979	464
40. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve e njësive «Mbi masat ndëshkimore me karakter edukimi në Parti». 21 dhjetor 1979	470

1980

41. Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 14-15 janar 1980	
— Komunikatë	474
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Stadi i zhvillimit socialist të vendit aktualisht dhe në perspektivë kërkon të përmirësohen më tej drejtimi e organizimi shkencor i punës së Partisë dhe i levave të saj». 14 janar 1980	475
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Stadi i zhvillimit socialist të vendit aktualisht dhe në perspektivë kërkon të përmirësohen më tej drejtimi e organizimi shkencor i punës së Partisë dhe i levave të saj». 15 janar 1980	519
42. Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rretheve «Mbi udhëheqjen e organeve dhe të organizatave të Partisë në këshillat popullorë». 21 janar 1980	520
43. Letër e KQ të PPSH drejtuar gjithë organizatave-bazë të Partisë «Mbi forcimin e udhëheqjes së Partisë në bashkimet profesionale për realizimin e detyrave të planit të Shtetit për vitin 1980». 26 shkurt 1980	524
44. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH «Mbi disa çështje e detyra për përsosjen e mëtejshme të stazhit të kandidatit të Partisë». 24 prill 1980	527

45. Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 24-25 qershor 1980	
— Komunikatë	530
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit». 25 qershor 1980	531
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH «Të ngremë nivelin e punës kërkimore-shkencore dhe të rritim efektivitetin e saj për zhvillimin aktual e perspektiv të vendit». 25 qershor 1980	575

Tirazhi 20.000 kopje

Format 60x92/16

Stash 2204-65

Shtyp. Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1982